Come emerge da questi confronti, il cui numero è, e non può che essere, relativamente elevato, ci troviamo di fronte a concordanze sbalorditive persino negli errori di numerazione dei capitoli; si tratta, nello specifico, di sviste comuni agli autori nella fase di registrazione che coincidono, non di rado, in un rapporto di 1:1. In altri termini, tali mancanze appesantiscono di fatto sensibilmente il quadro 'problematico' del testo in quanto tale, ma aprono al contempo una nuova prospettiva riguardo alla valutazione complessiva dell'edizione: ovvero, l'evidente colorito umanistico del testo stesso, proprio come risulta essere nel LEE 1551 (§7.2). Sono dunque anche questi casi comuni, che emergono con maggior frequenza proprio tra la seconda parte del 'Messale' di Buzuku e il LEE 1551, a rafforzare ulteriormente la nostra ipotesi, divenuta ormai una certezza: che Buzuku avesse sul proprio tavolo di lavoro e abbia utilizzato, sviste fortuite comprese, per lo meno il LEE 1551 in entrambe le sue varianti, latina e italiana.

7.2 La natura di tali edizioni

Ai fini di una valutazione dell'opera nel contesto culturale e religioso dell'epoca in cui il 'Messale' vide la luce, non si può trascurare il fatto che il LEE 1551 sia un prodotto della casa editrice Al Segno della Speranza. Quest'ultima era ben nota non solo per le cosiddette edizioni a basso costo, ma anche per la pubblicazione di testi di orientamento umanistico considerati sospetti (se non addirittura proibiti)²¹, proprio come rileva anche Menis nel DTEIC (I 138: Bernardino Bindoni) a proposito di tali edizioni dalla qualità quanto mai modesta, ma che garantivano all'editore espedienti efficaci per sfuggire all'occhio vigile del Sant'Uffizio dell'Inquisizione²². In merito a tale constatazione, non si possono parimenti trascurare, quali ulteriori dati fattuali, i risultati di altre analisi comparative intertestuali unitamente ai relativi errori editoriali. In questo contesto, le concordanze con il LEE BRU occupano di fatto il secondo posto per frequenza, pur essendo altrettanto significative per contenuto e sviste tipografiche; esse portano infatti la firma di Antonio Brucioli, figura celebre tra le fila dell'élite umanistica italiana, ma anche condannata e perseguitata dal Sant'Uffizio dell'Inquisizione (nella Venezia dell'epoca di Buzuku)²³.

Pertanto, crediamo di non discostarci dal vero nel sostenere che il 'Messale' di Buzuku non sia soltanto il primo libro pubblicato in lingua albanese a noi noto, ma rappresenti anche un'opera pionieristica dal marcato accento umanistico nella cultura scritta dell'Albania. Al contempo, ci è consentito annoverare senza esitazione il suo autore, Don Gjon Buzuku, tra le fila dell'élite umanistica, ponendolo accanto ad altri corifei del pensiero

²¹ Così, ad esempio, ancora negli anni Quaranta del XVI secolo, questa casa editrice non esitava a pubblicare le opere dell'umanista italiano Girolamo Savonarola (Schutte 1983: 454), bollato fin dal 1497 come 'eretico', 'scismatico' e 'detrattore della Santa Sede'; i suoi scritti erano già stati dati alle fiamme il 7 e il 17 febbraio 1497-1498, prima che egli stesso finisse sul rogo, nel 1498, in Piazza della Signoria a Firenze.

²² "Bernardino Bindoni – Venezia 1532-1562; Padova 1547-1548: ...Tali caratteristiche non sembrerebbero giustificate, se pensiamo che B[indoni] eliminò la letteratura popolare e lavorò molto per conto di altri. Un'ipotesi plausibile si può forse ricondurre alle scelte personali, alla stampa, cioè opere religiose vicine a un ambiente « riformato » che aveva fatto anche a Venezia i suoi adepti: così, un formato in genere piccolo e una veste tipografica modesta cercavano probabilmente di « mascherare » i contenuti pericolosi di certe opere, che pubblicate assieme a tante altre volevano passare inosservate." (Menis 1997: 138; si veda anche Nadin 2015: 55ss.)

²³ In dettaglio Bonnet 1876: 3ss.; si veda anche Grendler 1977: 82: "Acting upon a denunciation in July 1548, the tribunal discovered three bales of heretical books belonging to Antonio Brucioli...The books were burned on July 12, and on November 21, Brucioli – conveniently absent from the city the whole time – was fined 50 ducats and exiled for two years."

intellettuale albanese nella diaspora storica del XVI secolo, quali Marin Barleti, Marin Beçikemi, Dhimitër Frangu e altri.

8. Conclusioni

Concludiamo qui questo capitolo, con la speranza di aver raggiunto l'obiettivo annunciato fin dal titolo: ricercare e individuare l'edizione modello che meglio si adatta alla seconda parte del 'Messale' di Gjon Buzuku. Tale sezione, nella sua organizzazione, assume una fisionomia peculiare, accostandosi maggiormente a un lezionario inteso come libro pastorale di uso comune in un contesto culturale e religioso cattolico. Quanto all'organizzazione del materiale liturgico in essa contenuto, questa parte si accosta in un certo senso anche al Messale Romano, qualora si considerino le preghiere del giorno (*Oratio*) e quelle conclusive (*Oratio post communionem* e *Super populum*) poste in apertura e in chiusura delle pericopi come parte del formulario di ogni messa; testi, questi, che solitamente non sono inclusi nei lezionari dell'epoca. L'estensione delle analisi intertestuali a 70+10 pericopi, condotta attraverso due nuove dimensioni comparative (LEE 1551 lat/it e LEE BRU), non ha fatto che rafforzare ulteriormente le conclusioni raggiunte nella prima parte di questo lavoro (§§4-4.1²⁴). Tali riscontri testimoniano in modo naturale, e dunque convincente, l'orientamento di Don Gjon Buzuku verso la letteratura ecclesiastica umanista del tempo, la quale verosimilmente – e perché no? – lo stimolò in questa felice impresa per la cultura scritta albanese.

Questo chierico – per quanto semplice potesse essere allora la sua posizione nella gerarchia amministrativa della Chiesa Cattolica Romana – finì per essere assorbito nel solco dell'Umanesimo Cristiano, inteso come movimento progressista e moderato all'interno dell'ambiente teologico-intellettuale dell'epoca. E ciò è testimoniato non tanto dall'interpretazione preliminare e occasionale di qualche passo nel testo della postfazione del 'Messale', quanto – e soprattutto – dalle prove di un utilizzo intensivo, seppur indiretto, del *Novum Instrumentum omne* del grande umanista Erasmo da Rotterdam; un'edizione, quest'ultima, che assunse rapidamente la funzione di confine orientativo per i successivi sviluppi della Riforma in Europa, venendo poi semplicemente ribattezzata come *Textus receptus* (§3). È proprio questa edizione – insieme ai contributi di Antonio Brucioli²⁵ e a quelli rimasti nell'anonimato del LEE 1551 (lat/it) – la chiave di volta che ha permesso di risolvere il 'fenomeno Buzuku' nella cultura scritta albanese antica, persino laddove esso coincide, (non) casualmente, con le edizioni albanesi del Nuovo Testamento del XIX secolo.

²⁴ Si veda anche Demiraj 2023a, 2024b, 2026a, 2026b.

²⁵ Per un'analisi dettagliata dell'influenza di Erasmo sull'attività teologico-intellettuale di Brucioli, si veda Leushuis 2013: 237 ss.

Pertanto, i fatti che abbiamo raccolto, analizzato e classificato in questi due capitoli difficilmente consentono di mettere in dubbio – oggi o in un futuro più o meno prossimo – la nostra naturale conclusione: ovvero che Buzuku volle *me u fëdigunë, përsa mujti me ditunë, me zdritunë pak mendetë e atyne që duonin me ëndigluom* le Sacre Scritture in albanese. Egli realizzò così un capolavoro eterno nella storia della cultura e del pensiero intellettuale albanese, proprio a partire dalle posizioni dell'Umanesimo Cristiano del tempo in cui visse.

Përktheu: Anila Omari

Bibliografia

1. Sigle e abbreviazioni

BIZ = cfr. oltre, sezione n. 2: Robinson, Maurice A. & Pierpont, William G. (eds.)

BRU = cfr. oltre, sezione n. 2: Brucioli, Antonio

BRU IOB = cfr. oltre, sezione n. 2: Brucioli, Antonio

BUM = cfr. oltre, sezione n. 2: Çabej, Eqrem (ed.) e Ressuli, Namik (ed.)

BSV = cfr. oltre, sezione n. 2: Weber, Robert & Gryson, Roger (ed.) e Wordsworth, Iohannes S.T.P & White, Iuliano A.M. (ed.)

DE GIUNTA = cfr. oltre, sezione n. 2: De Giunta (ed.)

LBS = cfr. oltre, sezione n. 2: Maretić, Tomislav (ed.).

LEE 1551 (lat/it) = cfr. oltre, sezione n. 2: LEE 1551

LEE BRU = cfr. oltre, sezione n. 2: Brucioli, Antonio

MISSALE 1509 = cfr. oltre, sezione n. 2: Cuspinianus, Iohannes

NIO = cfr. oltre, sezione n. 2: Erasmus, Desiderius

LXX = cfr. oltre, sezione n. 2: Leiner, Gregory R. & Ross, William A. (eds.)

ME-GJ = cfr. oltre, sezione n. 2: Meksi, Vangjel – Gjirokastriti, Grigor

MRM = Missale Romanum Mediolani 1474: v. Lippe, Robert & Ward, Anthony (eds.)

K = cfr. oltre, sezione n. 2: Kristoforidhi, Konstandin

RL = cfr. oltre, sezione n. 2: Rešetar, Milan (ed.)

ZL = cfr. oltre, sezione n. 2: Rešetar, Milan (ed.)

2. Opere citate

Arapi, Ina. 2007. "Über die syntaktische Verwendung des Konjunktivs und des unabhängigen Infinitivs im Altalbanischen". In: (B. Demiraj – Hrsg.) *Nach 450 Jahren. Buzukus "Missale" und seine Rezeption in unserer Zeit*. Wiesbaden: Harrassowitz, 105-139.

_____. 2012. "Der Gebrauch des *velle*-Futurs in der altalbanischen Literatur". In: (Demiraj, B. – Hrsg.) *Aktuelle Fragestellungen und Zukunftsperspektiven der Albanologie*. Wiesbaden: Harrassowitz, 94-115.

Ascarelli, Fernanda & Menato, Marco. 1989. *La tipografia del '500 in Italia*. Firenze.

Ashta, Kolë. 1996. LHGJSH. *Leksiku historik i gjuhës shqipe*, bl. I. Shkodër.

Bonnet, Jules. 1876. "Procès d'Antonio Brucioli (1548-1559)". *Bulletin historique et littéraire* (Société de l'Histoire du Protestantisme Français), 25, nr 1 (1876), 3-14.

Brucioli, Antonio. BRU *La Biblia...Il Nvovo Testamento di Christo Giesv Signore, et Salvatore nostro... Di greco tradotto in lingua Toscana, per Antonio Brucioli*. Impresso in Vinegia, ne le case di Lucantonio Giunti fiorentino.

_____. BRU IOB *In sancti Job confessoris et prophete...* Impresso in Vinegia, ne le case di Lucantonio Giunti fiorentino. Stampato in Vinegia per Aurelio Pincio Veneto.... MDXXXIII.

_____. LEE BRU *Epistole, Lettioni, & Euangelii, che si leggono in tutto l'anno, Tradotte in lingua toscana per Antonio Brvccioli*. Con la Tauola che dimostra a gior|no per giorno quelle che ne le messe si leggono, secondo la corte Romana. In Venetia.

Buzuku, Gjon. BUM 'Meshari' i Gjon Buzukut (1555), vedi oltre Ressuli (ed.) 1958; Çabej (ed.) 1968.

Cuspinianus, Johannes. 1509. *Missale Patauiense*. (ed.) Ioănes Winterburger ciuis Uienneñ. Uienna, Pannonia.

Çabej, Eqrem (ed.). 1968. "*Meshari*" i Gjon Buzukut, Bl. I-II. Tiranë.

De Giunta (ed.). 1521. *Missale romanum nuper adoptatũ ad cõmodum*. Venetijs in edibus Luce antonij de giunta.

- De Leucho, Iacobus (ed.). 1521. *Missale Romanum nouiter Impressum*. Venetijs in edibus iacobi de leucho [M.D.XX. die XX: Octobris].
- Demiraj, Bardhyl. 2005. "Viti i zbulimit të 'Mesharit' të Buzukut dhe ndonjë çështje që lidhet me të". *Biblios* 26 [2005] 47-53. Palermo.
- _____. 2023a. "Shfaqje të humanizmit kristian në tekstet biblike të 'Mesharit' të Gjon Buzukut". *Hylli i Dritës*, 2 [2023] 165-200. Shkodër.
- _____. 2023b. "Velle-Futurum im Albanischen". *Balkanica et Slavia* 3 [2023] 19-53. Venice
- _____. 2024. "Manifestazioni dell'umanesimo cristiano nei testi biblici del 'Messale' di Gjon Buzuku (I)". *Shëjzat – Pleiades* anno IX, n. 1-2, 3-42. Roma/Tirana.
- _____. 2025a. "Viti liturgjik në 'Mesharin' e Gjon Buzukut (1555)". *Hylli i Dritës*, nr 2 (in corso di stampa).
- _____. 2025b. "Ndikimi kulturor-gjuhësor sllav në 'Mesharin' e Gjon Buzukut – një narrativ shkencor-filologjik". *Studime Filologjike*, nr. 2, 5-56.
- _____. 2026a. "Manifestazioni dell'umanesimo cristiano nei testi biblici del 'Messale' di Gjon Buzuku II". *Shëjzat – Pleiades* nr. 1-2 (in corso di stampa).
- _____. 2026b. "Pjesa e parë e 'Mesharit' të Gjon Buzukut. *Hylli i Dritës*, nr 1 (consegnato per la stampa).
- _____. 2026c. "Nachtrag zum velle-Futurum im Albanischen" (in corso di stampa).
- Demiraj, Shaban. 1986. *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*. Tiranë.
- Erasmus, Desiderius. NIO *Novum Instrumentum omne* di Erasmus. Basel 1516⁽¹⁾, 1519⁽²⁾, 1522⁽³⁾, 1527⁽⁴⁾, 1535⁽⁵⁾, ecc.
- Fiedler, Wilfried. 2004a. *Das albanische Verbalsystem in der Sprache des Gjon Buzuku (1555)*. Prishtinë.
- Grendler, Paul F. 1977. *The Roman Inquisition and the Venetian Press, 1540-1605*. Princeton, New Jersey.
- Kristoforidhi, Konstandin. 1866. *Katër Ungjillat e Zotit edhe Shëlbuesit Tynë Iezu Krishtit edhe Punët e Apostuivët, këthymun prej greqishtes Vietër shqip ndë gjuhë gegënishte prei Konstantinit Kristoforidhit, Elbasanasit*. Konstantinopol.

- Stampuem për Bretaniken & të Hujën Shoqëninë e Biblës.
Prei A. I. Bojagjian.
- _____. 1872. *Dhiata e Re e Zotit edhe Shëlbuesit tynë Iezu-Krishtit, këthyem prej greqishtesë Vietër shqip prei Konstantinit Kristoforidhit, Elbasanasit*. Konstantinopol. Ndë shtypë-shkronjë të Bojagjianit.
- LEE 1551. *Lettoni, Epistole, et Euangeli, che si dicono tutto l'anno, latine & ulga|re per più commodita di ogniuno. Con un ordine facillissimo a trouar di di in di ogni lettione, ó epistola, ouero euangelio*. LE le QVAL MOLTE ne sono state aggiunte, che mai per adietro ne le altre impressioni, so|no state stampate. IN VENETIA AL SEGNO de la speranza. MDLI.
- Leiner, Gregory R. & Ross, William A. (ed.). 2018. *Septuaginta – A Reader's Edition*. Deutsche Bibelgesellschaft: <
<https://www.die-bibel.de/>>
- Leushuis, Reiner. 2013. “Antonio Brucioli and the Italian Reception of Erasmus: the *Praise of Folly* in Dialogue”. In: (K.A.E. Enenkel – ed.) *The Reception of Erasmus in the Early Modern Period*. Leiden, Boston, 237-260.
- Lippe, Robert Ll. D. (ed.). 1899. *Missale Romanum Mediolani 1474*, Vol. I. Text. Harrison and Sons, London. (= MRM)
- Matzinger, Joachim. 2010. “Die albanische Sprache im Zeitalter Skanderbegs, Teil 2”. In: Bardhyl Demiraj (Hg.), *Wir sind die Deinen. Studien zur albanischen Sprache, Literatur und Kulturgeschichte, dem Gedenken an Martin Camaj (1925-1992) gewidmet*, in: “Albanische Forschungen” 29. Harrassowitz Verlag, Wiesbaden, 451 ss.
- _____. 2011. “Ein Beitrag zur Buzuku-Philologie: Die Anordnung der Heiligennamen in der Allerheiligenlitanei des altalbanischen Seelsorgehandbuchs (‘Missale’)”. *Zeitschrift für Balkanologie* 47 (1), 81-96.
- _____. 2012. “Die Heiligenfeste, oder wie sich das Proprium de Sanctis und das Commune Sanctorum im Seelsorgehandbuch des Gjon Buzuku (1555) prasentieren”. In: B. Demiraj (Hg.), *Aktuelle Fragestellungen und Zukunftsperspektiven der Albanologie. Akten der 4. Deutsch-Albanischen kulturwissenschaftlichen Tagung “50 Jahre Albanologie an der LMU München”*. Wiesbaden, 270–293.

- _____. 2013. "Nuovi indizi su Buzuku. Alcune osservazioni sul volume "Shqipëria e rigjetur – Albania ritrovata" di Lucia Nadin". *Hylli i Dritës*, nr. 1-2, 76-83. Shkodër.
- _____. 2022. "Eine Randnotiz zu Gjon Buzukus Seelsorgehandbuch". *Shëjzat* 1-2, 49-59. Roma.
- Menato, Marco et al. (ed.). 1989. cfr. supra Ascarelli.
- _____. 1997. cfr. infra Menis, Ilde.
- Menis, Ilde. 1997. "Bernardino Bindoni", in *Dizionario dei tipografi e degli editori italiani. Il Cinquecento, I A-F* (a cura di Marco Menato et al.), Milano.
- Meksi, Vangjel & Gjirokastriti, Grigor. 1824. *Ungjilli i Jizu Hrishtoit Zotit sene që na shpëtoi. Sikundër shkruan Shënt Mattheua. Mbë di gjuhë greqishte edhe shqipe*. Korfoi En ti tipografia tis Dhiokiseos.
- _____. 1827. *Dhiata e Re e Zotit sonë që na shpëtoi, Iizu Hrishtoit 1827. Mbë di gjuhë do me thënë greqishte e dhe shqipëtarçe (nën kujdesin e Grigorit, kryepeshkopit të Eubeas)*. Korfoi En ti tipografia tis Dhiokiseos.
- Nadin, Lucia. 2012. *Shqipëria e rigjetur. Zbulim gjurmësh shqiptare në kulturën dhe artin e Venetos në shek. XVI – Albania ritrovata. Recupero di presenze albanesi nella cultura e nell'arte del cinquecento veneto*. Onufri. Tiranë.
- _____. 2015. "Ancora sul Meshari di Gjon Buzuku". *Hylli i Dritës* 1-2, 43-66.
- Omari, Anila. 2026. <kor>, in: *Digitales philologisch-etymologisches Wörterbuch des Altalbanischen (15.-18. Jh.) (= DPEWA: <https://www.dpwa.gwi.uni-muenchen.de/> – B. Demiraj & O. Hackstein – eds.)*.
- Qendro, Thoma. 2013. *Fjalor i shqipes së Gjon Buzukut (me rreth 3200 fjalë, 350 emra të përveçëm dhe 260 fjalë e shprehje latinisht)*. Tiranë.
- Ressuli, Namik (ed.). 1958. *Il "Messale" di Giovanni Buzuku. Riproduzione e trascrizione*. Città del Vaticano.
- Robinson, Maurice A. & Pierpont, William G. (ed.). 2005. *The New Testament in the Original Greek Byzantine Textform*. Chilton Book Publishing: Southborough, Massachusetts.
- Roques, Mario. 1932. *Recherches sur les anciens textes albanais*. Paris.

- Rrota, Justin. 1930. *Monumenti më i vjetri i Gjyhës Shqype. D. Gjon, Buzuku (1555)*. Shkodër.
- Schumacher, Stefan & Matzinger, Joachim. 2013. *Die Verben des Altabanischen. Belegwörterbuch, Vorgeschichte und Etymologie*. “Albanische Forschungen” nr. 33. Wiesbaden.
- Scoto, Girolamo (ed.). 1543. *Missale Romanum, faciliore & miro quodam ordine... distinctum*. Venetijs, apud Hieronymum Scotum.
- _____. 1552. *Missale Romanum post omnes alias impressiones recens... distinctum*. Venetijs apud Hieronymum Scotum.
- Spini, Sergio. 1940. “Bibliografia delle opere di Antonio Brucioli”. *La Bibliografia* vol. 42, n. 5/7 (Maggio-Luglio), 129-180.
- Ward, Anthony (ed.). 1996. *Missalis Romani editio princeps Mediolani Anno 1474 preliis mandata*. Roma C. L. V. Ed. Liturgiche (= MRM)
- Weber, Robert & Gryson, Roger (ed.). 2007. BSV *Biblia Sacra Iuxta Vulgatam Versionem* – Adiuvantibus B. Fisher, I. Gribmont, H.F.D.Sparks, W. Thiele – recensuit et brevi apparatu critico instruxit Robert Weber. Editionem quintam amendatam retractatam praeparavit Roger Gryson. Deutsche Bibelgesellschaft. C.H.Beck, Nördlingen
- Zamputi, Injac. 1986. “Mbi rrethanat historike të botimit të “Mesharit” të Gjon Buzukut dhe vendin e tij në letërsinë e vjetër shqipe”. *Studime filologjike* n.3, 185-204.
- https://drive.google.com/file/d/1Mgapu9HOpQyT-eEf89ZSG_ow69uQl5Ea/view

SUMMARY

Evidence of Christian humanism in the biblical texts of Gjon Buzuku's ‘Missal’ (III)

– Reference models for Gjon Buzuku's ‘Missal’

This contribution is the last in our triad of studies on the intellectual and theological formation of Gjon Buzuku, as the author of the first book in the Albanian language known to us to date (Demiraj 2023a/2024; 2026a). As bold as this objective may seem – especially considering the lack of any documentation on the author and his work – it has nonetheless taken shape thanks to the effectiveness of the results obtained through the application of a new comparative method, developed by the author, applied to approximately

70+10 pericopes from the New and Old Testaments. The classification of the results from these three studies now makes it possible, within philological discourse, to offer positive – that is convincing – alternative solutions; particularly regarding the intellectual and theological formation of the author, who, according to our already strengthened conviction, aligned himself with Christian Humanism as a progressive and moderated current within the intellectual and theological milieu of the first half of the 16th century. This research method subsequently led to the successful identification of the original textual models from other languages that Gjon Buzuku referred in structuring the second part of his 'Missal'.

Aristotel Spiro

Parimi themelor i drejtshkrimit të gjuhës shqipe

Përmbledhje

Që nga Kongresi i Drejtshkrimit (1972), shqipja standarde është konsoliduar ndjeshëm, duke përballuar sfida shoqërore, kulturore dhe politiko-ideologjike. Megjithë qëndrueshmërinë e saj, diskutimet për rishikimin e drejtshkrimit kanë vijuar, shpesh të udhëhequra nga propozime të pjesshme dhe pa një bazë të re teorike. Ky studim argumenton se problemi themelor që ushqen konfuzionin dhe skepticizmin gjysmëshekullor qëndron në formulimin e pasaktë të parimeve të drejtshkrimit në Rezolutën e Kongresit dhe në bibliografinë që vijoi as tij. Konkretisht, përcaktimi i parimit «fonetik» si parim themelor dhe njohja e të ashtuquajturit parim «morfologjik» janë teorikisht të papërcaktuara dhe kontradiktore. Duke u mbështetur në studimet e grafematikës, autori argumenton se parimi themelor i çdo drejtshkrimi, përfshirë shqipen, është parimi fonologjik. Ndryshe nga parimi fonetik (që do të kërkonte shkrimin e tingujve ashtu siç shqiptohen në të folur), parimi fonologjik siguron qëndrueshmërinë duke lidhur grafemën me fonemën, e jo me realizimet e saj fonetike të ndryshueshme. Kjo rrëzon ekzistencën e një parimi të veçantë morfologjik në shqip, pasi ruajtja e pamjes së morfemave (p.sh., shkrimi i <ë>-së së patheksuar) nuk bëhet për hir të morfologjisë, por sepse ajo është pjesë e përbërjes fonematike të fjalës. Kuptimi i saktë i parimit fonologjik ka rëndësi praktike vendimtare: ai shërben si mburojë teorike kundër ndërhyrjeve arbitrare për reforma të pambështetura, duke siguruar kështu qëndrueshmërinë e kodit komunikativ të shqipes standarde.

Fjalë kyçe: *drejtshkrim, parim fonologjik, parim morfologjik, grafemë, logogramë, morfogramë, normë*

1. Hyrje

Që nga mbajtja e Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe (20-25 nëntor 1972) e deri në ditët e sotme ka kaluar më shumë se gjysmë shekulli. Gjuha letrare kombëtare shqipe, e quajtur gjithashtu gjuha e përbashkët shqipe ose, sipas terminologjisë ndërkombëtare, «shqipja standarde», është

konsoliduar ndjeshëm gjatë kësaj periudhe. Forca dhe vitaliteti i saj shfaqen në një kontekst të ri shoqëror e kulturor, në të cilin liria e shprehjes dhe shumëllojshmëria ligjërimore bashkëveprojnë shpesh në mënyra të pakontrolluara, duke krijuar herë pas here tensione midis individualizimit të shprehjes dhe nevojës për normë të përbashkët komunikimi.

Përveç sfidave të natyrës ligjërimore, pas viteve '90 të shek. XX shqipja e përbashkët ka kaluar edhe nëpër faza të vështira të shoqëruara me ndërhyrje të karakterit politik e ideologjik, që synonin rishikimin ose relativizimin e statusit të saj. Megjithatë, ajo e ka dëshmuar qëndrueshmërinë dhe funksionalitetin e vet, duke u shfaqur si forma më e konsoliduar e shprehjes gjuhësore në historinë e shqiptarëve. Përpjekjet për ta relativizuar këtë rol nuk kanë arritur të krijojnë ndikim të qëndrueshëm në ligjëratën shkencore mbi gjuhën standarde.

Diskutimet rreth rishikimit të drejtshkrimit nuk u kufizuan në nivelin e vlerësimit normativ të standardit, por u shtrinë edhe në analizën e përgjithshme të zhvillimit të sistemit gjuhësor të shqipes. Në këtë kuptim, shqyrtimi i gjendjes së brendshme të gjuhës u mbështet mbi parimin e ndryshueshmërisë së natyrshme të sistemeve gjuhësore, si dhe mbi vetë Rezolutën e Kongresit të Drejtshkrimit, e cila parashikonte mundësinë e një rishikimi të ardhshëm të normës drejtshkrimore (Drejtshkrimi 1973: 27). Në vijim të këtij parimi janë paraqitur një sërë propozimesh për përmirësime, të formuluar si nga individë jashtë fushës së gjuhësisë, ashtu edhe nga gjuhëtarë me përvojë në studimet shqiptare.

Propozimet për ndryshime në sistemin drejtshkrimor janë, në një farë mase, të pritshme dhe të kuptueshme, pasi vetë përdorimi i gjuhës në praktikë dhe zhvillimi kulturor i shoqërisë kanë sjellë përshtatje të vazhdueshme. Ndryshimet në jetën shoqërore e institucionale, si hapja e Shqipërisë ndaj botës, integrimi kulturor ndërkombëtar, krijimi i shtetit të Kosovës, rritja e statusit të shqipes në Maqedoninë e Veriut dhe komunikimi global i shqiptarëve, kanë ndikuar në zhvillimin e shqipes si mjet komunikimi me funksione gjithnjë e më të gjera. Megjithatë, çdo ndërhyrje në normën drejtshkrimore duhet të bëhet me kujdes të veçantë, në mënyrë që të mos vështirësohet komunikimi dhe të mos cenohet qëndrueshmëria e sistemit, edhe kur argumentimi morfologjik apo gramatikor i një propozimi duket fillimisht i arsyeshëm.

Kjo situatë mund të përkufizohet si një dinamikë sociolinguistike që ka gjetur një pjesë të studiuesve të papërgatitur për të përballuar ndryshimet në mënyrë sistematike. Në disa raste janë hedhur në qarkullim propozime të pjesshme, që synojnë ndryshime minimale, si heqja ose shtimi i grafemës <ë> në pozicione të caktuara morfemore, por që në praktikë rezultojnë të papërshtatshme për t'u zbatuar në shkallë të gjerë. Kjo ka krijuar një klimë pasigurie dhe skepticizmi, ku diskutimi për drejtshkrimin shpesh reduktohet në

përsëritjen e argumenteve tashmë të njohura, pa një bazë të re teorike ose empirike.

Reagimet e folësve ndaj ndryshimeve të mundshme në normë janë në përgjithësi konservuese dhe shprehin shqetësimin për ruajtjen e qëndrueshmërisë së kodit gjuhësor. Thirrja «Mos ma prek gjuhën!» reflekton nevojën për të mbrojtur kohezionin komunikativ dhe ndjenjën e përkatësisë në një bashkësi të përbashkët ligjërimore. Kjo qëndresë lidhet si me aspektin funksional të gjuhës, ashtu edhe me dimensionin identitar të saj në ndërgjegjen e folësve.

Për ruajtjen e kësaj qëndrueshmërie, thelbësore mbetet ngritja e nivelit të kulturës gjuhësore, veçanërisht përmes edukimit gjuhësor dhe zhvillimit të kulturës së të shkruarit. Drejtshkrimi, si aspekti më i dukshëm formal i gjuhës së shkruar, është tregues i disiplinës dhe i përgjegjësisë komunikative të folësve.

Në një situatë ku zotërimi i rregullave drejtshkrimore mbetet objektivi kryesor i edukimit gjuhësor, çdo ndërhyrje e re në normë duhet të udhëhiqet nga parimi i përgjithshëm i qëndrueshmërisë së komunikimit. Përndryshe, ekziston rreziku që të krijohen rregulla të reja po aq ose më pak funksionale se ato ekzistuese. Diskutimi mbi drejtshkrimin mund të vendoset mbi baza të forta vetëm nëse kuptohet funksionimi i tij si sistem dhe parimet që e përshkojnë atë.

Analiza e materialeve të Kongresit të Drejtshkrimit dhe e doracakut *Drejtshkrimi i gjuhës shqipe* (1973, 35–36) tregon se shumica e vendimeve konkrete të Kongresit kanë rezultuar të drejta dhe të zbatueshme. Mirëpo, për sa u përket parimeve themelore të drejtshkrimit, analiza dëshmon se ato janë formuluar në mënyrë jo plotësisht të saktë. Këto pasaktësi teorike kanë sjellë pasoja në interpretimin e drejtshkrimit dhe në mënyrën si konceptohen ndryshimet e mundshme në të ardhmen.

Paqartësitë dhe pasaktësitë në formulimin e parimeve kanë nxitur shpeshherë interpretime arbitrare dhe ndërhyrje të pambështetura teorikisht në sistemin e drejtshkrimit të shqipes.

Në këtë kontekst, rimarrja dhe trajtimi i çështjes së parimit themelor dhe e parimeve të tjera të drejtshkrimit synon në radhë të parë mbrojtjen e tij nga zelli i tepruar i rishikimit të standardit dhe i zgjidhjeve drejtshkrimore të Kongresit të Drejtshkrimit.

Diskutimi për parimet e drejtshkrimit duhet vendosur mbi një bazë shkencore, e cila të përfshijë objektivitetin. Këto parime është e pamundur të shihen si rrjedhojë e një marrëveshjeje zotërinjsh.

Parimet e drejtshkrimit të një gjuhe veprojnë objektivisht në një gjuhë (Çeliku 2014, 209) dhe nuk mund të jenë subjekt i ndonjë preference ideologjike apo çdo lloj preference tjetër. Aq më pak mund të konsiderohen tema tabu, trajtimi i të cilave të bëhet me leje nga autoritetet apo organizmat administrative, komisionet e përhershme apo komisionet ad hoc.

Diskutimi për parimet e drejtshkrimit të gjuhës shqipes dhe sidomos për parimin themelor të tij nuk mund të merret si një kontestim i Kongresit të Drejtshkrimit (1972) dhe i vendimeve të tij. Megjithatë, në çështje të formulimit të parimit themelor dhe të parimeve dytësore nuk ka asnjë dyshim se parimi themelor i drejtshkrimit shqip dhe parime të tjera janë formuluar në mënyrë të pasaktë.

Ja çfarë thuhet në Rregullat e Drejtshkrimit të gjuhës shqipe (1973):

«Parimi themelor i drejtshkrimit të shqipes është parimi fonetik: në përgjithësi fjalët dhe pjesët e tyre të kuptimshme shkruhen ashtu siç shqiptohen në ligjërimin letrar. Thelbi i parimit fonetik në drejtshkrimin e shqipes, që mbështetet në një sistem grafik ku ka një lidhje të drejtpërdrejtë midis shkronjës dhe tingullit-fonemë, është aspekti fonologjik, domethënë përdorimi social i tingujve të gjuhës në procesin e marrëdhënieve midis njerëzve» (Drejtshkrimi 1973, 35).

Mirëpo, ky formulim në dukje i drejtë, krijon paqartësi, sepse, megjithëse i referohet aspektit fonologjik, në praktikë e mohon duke e reduktuar drejtshkrimin në një transkriptim fonetik të ligjërimin.

Në vështrim drejtshkrimor, studiuesit e gjuhës vetëm formalisht e pranojnë lidhjen e fonit me fonemën, sepse praktikisht e shohin të ndarë, siç duket edhe nga ky pohim: «[P]arimi fonologjik, sido që të quhet, bart probleme në zbatimin e tij, pasi fonemat që nuk realizohen fonetikisht, si p.sh. ë-ja e patheksuar në rrokje të hapur ose në fund të fjalës (që përgjithësisht nuk shqiptohet), nuk do të shkruhen. Dhe kështu, duke shpallur këtë si parim themelor, do të rikthehem prapë te zgjidhjet e Këshillit Ndërkademi» (Memushaj 2025). Në të vërtetë, është e kundërta: parimi fonologjik nuk merr parasysh shqiptimin e ndikuar nga rrethanat ligjërimore dhe konteksti fonetik, por merr parasysh përbërjen fonematike dhe lejon të shkruhet një <ë> edhe aty ku ajo për arsye të ndryshme nuk shqiptohet.

Pasojat e njohjes së parimit fonetik të drejtshkrimit dhe kundërvënies së tij ndaj parimit fonologjik, gjejnë shprehje konkrete në pranimin e të ashtuquajturit parim «morfologjik» të drejtshkrimit shqip. Ky parim përshkruhet në këtë mënyrë:

«Krahas parimit fonetik, drejtshkrimi i njësuar i shqipes mbështetet gjerësisht edhe në parimin morfologjik, i cili kërkon që fjalët dhe pjesët e tyre përbërëse të sistemit trajtëformues e fjalëformues të shkruhen njësoj, pavarësisht nga ndryshimet tingullore të shkaktuara prej ligjeve fonetike që veprojnë sot në gjuhën tonë» (Drejtshkrimi 1973, 36).

Ky formulim ka karakter përshkruar, por nuk mund të quhet përkufizim. Përbën çudi që parimi morfologjik i drejtshkrimit nuk përkufizohet në botimin themelor të drejtshkrimit shqip! Në pikëpamje drejtshkrimore, marrëdhënia midis fonemave dhe grafemave (apo tingujve dhe shkronjave) nuk duhet përshkruar me terma gramatikorë, por me terma të grafematikës.

Duke qenë formuluar parimi fonetik si parimi themelor i drejtshkrimit shqip, ai pati që në fillim kontestimet e veta, madje qysh në punimet e atij kongresi. Kështu, Bahri Beci mendonte se parimi themelor i drejtshkrimit të shqipes është parimi fonematik (Beci 1973, 314). Mirëpo B. Beci me kalimin e kohës e ndryshoi mendimin e vet dhe anoi më shumë nga mendimi zyrtar, duke i mëshuar edhe rëndësisë së të ashtuquajturit parim morfologjik: «Kur zbatimi i veçuar i parimit fonetik do të çonte në errësimin ose në prishjen e strukturës morfologjike e fjalëformuese të fjalëve, në drejtshkrimin tonë zbatohet parimi morfologjik» (Beci 1984, 24). Nga ana tjetër, Fatmir Agalliu shprehte mendimin se parimi themelor i drejtshkrimit shqip ishte «parimi morfologjik»: «Drejtshkrimi i sotëm i shqipes, ashtu siç paraqitet në «Rregullat», bazohet më tepër në parimin morfologjik dhe tradicional» (Agalliu 1973, 8).

Ky moskuptim dhe keqkuptim i parimit themelor të drejtshkrimit shqip ka ndikuar negativisht në gjithë diskursin gjysmëshekullor për drejtshkrimin shqip. Është e shpjegueshme se, në qoftë se nuk kuptohet se si funksionon drejtshkrimi, edhe mendimet për të do të jenë të diskutueshme. Kështu shpjegohet edhe krijimi i një rrethi vicioz nga diskutimet pa mbarim për drejtshkrimin dhe rezultati negativ i këtij diskutimi. E gjitha kjo e ka burimin tek formulimi i gabuar i atyre dy parimeve kryesore të drejtshkrimit shqip: parimit «fonetik» dhe atij «morfologjik».

Duke konstatuar se ai formulim ka qenë përnjëmend i pasaktë, mund të shpjegojmë njëkohësisht pse ka ndodhur kjo. Për mendimin tonë kanë qenë katër arsye kryesore:

E para, studimet e grafematikës nuk kishin hyrë në Shqipëri, por as në rang botëror nuk kishin marrë zhvillimin e mjaftueshëm dhe shtrirjen e duhur. Shkolla e Pragës, me përfaqësues kryesor Vachek-un (1964, 1989) dhe Sgall-in (1987) i kishte shpallur prej kohësh idetë e veta, por ndërkohë udha e tyre për në Shqipëri ishte aq shumë e ngadaltë, sa edhe sot e kësaj dite janë të drojtura. Termi «shkrim fonetik» është përdorur në një kuptim të përgjithshëm përshkrues e klasifikues për ta dalluar nga shkrimi «ideografik» (Saussure 1983, 26). Në materialet e Kongresit të Drejtshkrimit, në referatin kryesor mbajtur nga Kostallari, ngatërrohen konceptet e fonologjisë dhe fonetikës, të parimit fonologjik dhe fonetik, ndërkohë që arsyetimi fonologjik përdoret për të përligjur një të ashtuquajtur parim «morfologjik» (Kostallari 1973, 80). Ka në përgjithësi një konfuzion me çka përfshihet tek parimi fonetik dhe arsyetimit fonologjik, për të cilin përdoren argumente morfologjike. Aq shumë ngatërrohen këto koncepte, saqë dikush paska shprehur mendimin se «parimi fonetik dhe morfologjik po barazohen në shqipe» (!) (*Shqipja në etapën e sotme* 2011, 388).

Në materialet e Kongresit të Drejtshkrimit nuk jepet asnjë përkufizim i parimit fonetik ose morfologjik ose historik apo etimologjik, ndërsa nuk përmendet aspak parimi fonologjik. Kjo ka bërë që të gjithë studiuesit dhe

autorët që kanë rimarrë çështjen e drejtshkrimit të gjuhës shqipe, parimet ose i kanë anashkaluar, sikur të bëhej fjalë për një çështje tabu, ose kanë përsëritur argumentet morfologjike për marrëdhënien fonemë-grafemë (Jorgaqi 2002; Memushaj 2005, 125; Topalli 2011, 251; Çeliku 2011, 330).

Karakteri problematik i një terminologjie kuptimisht të paqartë është vënë në dukje nga Dodi (2004). Ky autor vëren se «[I]dhur me emërtimin e parimit themelor të drejtshkrimit të gjuhës shqipe janë shprehur mendime se ndoshta më e drejtë do të ishte që ai të quhej jo parim fonetik, por parim fonematik ose fonemor» (Dodi 2004, 239). Megjithëse nuk heq dorë nga parimi fonetik, ai sqaron se ky term «është përdorur këtu me një kuptim të gjerë. Ortogramat fonetike, po të vështrohen fonologjikisht, janë edhe fonemore, sepse fonemat këtu jepen me shkronjat gjegjëse. Shkronjat këtu paraqitin fonemat, që realizohen nëpërmjet tingujve të ligjërit» (po aty). Dhe krejt papritur shton më tej: «Por termi fonematik përdoret shpesh si sinonim i termit parim morfologjik» (po aty)! Duket se Dodi e ka kapur thelbin e problemit, por zgjedhja pajtuese e njohjes së parimit fonetik dhe atij morfologjik nuk e zgjidhin praktikisht çështjen e parimit themelor. Ai vijon ta interpretojë drejtshkrimin në bazë të parimit fonetik dhe parimit morfologjik (Dodi 2004, 239-256). Arsyen e këtij ngatërrimi do ta shpjegojmë më poshtë (shih pjesën 5 të këtij artikulli).

Nga ana tjetër, nuk është përcaktuar njësia themelore e drejtshkrimit. Ajo është ngatërruar në të gjitha rastet. Mjaft herë është lënë në heshtje ky problem, ndërsa herë të tjera është përcaktuar sikur njësia themelore është fjala (Kostallari 1973, 110), dhe herë sikur është morfema (Dodi 2004, 250). Mirëpo, këto janë njësi themelore që nuk i përkasin drejtshkrimit, por gjuhës në përgjithësi ose morfologjisë. Në rastin më të mirë, njihet si njësi e drejtshkrimit ortograma. Mirëpo ortograma është vërtet njësi drejtshkrimore, por e një niveli më të lartë. Njësia themelore e shkrimit dhe e drejtshkrimit mbetet grafema (Chen & Cherng, 2013, 1, sipas Meletis 2019; Corvacho del Toro & Tome 2021: 170).

E dyta, studimet gjuhësore kanë qenë të orientuara përkrah dialektologjia, në perspektivën e përvijimit të gjuhës letrare kombëtare. Imperativi i zgjidhjeve praktike nuk lejoi kohën e nevojshme për trajtimin teorik të çështjes së parimit themelor të drejtshkrimit. Shpesh karakterizimet «fonetik» dhe «fonologjik» përdoren për njëri-tjetrin në mënyrë sinekdokike. Sidomos vërehet kjo në debatin shkencor për parimin themelor, kur dashur padashur disa duan të shmangin thelbin e problemit nga droja se mos përrlyhet emri dhe vepra e Kongresit të Drejtshkrimit (Dodi 2004, Dodi 2023). Në kritikën tona të mëparshme për përdorimin alternativ të këtyre koncepteve (Spiro 2023) kemi shprehur mendimin se ato kanë një ndikim të drejtpërdrejtë në konceptimin tonë mbi mënyrën e funksionimit të sistemit shkrimor dhe marrëdhënies së tij me sistemin fonologjik e fonetik të gjuhës. Ngatërrimi i këtyre dy koncepteve

sjell konfuzion të madh në diskutimet për shkrimin, drejtshkrimin dhe në propozimet e ndryshme që bëhen për ndryshime.

E treta, synimi për të ofruar zgjidhje të thjeshta dhe praktike solli si pasojë thjeshtëzimin e shpjegimit të marrëdhënieve midis tingullit dhe shkronjës duke shpallur parimin e përkatësisë së një tingulli me një shkronjë dhe të parimit «fonetik» si parimi që përshkon drejtshkrimin shqip. Përmendja e parimit «fonologjik» apo e parimit «fonematik» (Beci 1973) shihej me shumë dyshim, si shenjë e ndikimit të gjuhësisë dhe ideologjisë «borgjeze» perëndimore.

E katërta, tradita gjuhësore gramatikore dhe eventualisht trashëgimia më e re gjuhësore e gjuhësisë sovjetike ndikoi që çështjet e marrëdhënieve të fonemës me grafemën të kalonin nëpërmjet një filtri shpjegues gramatikor morfologjik. Kjo solli si pasojë që drejtshkrimit shqip, edhe pse shumë i ri në moshë, t'i njëhej veprimi i parimit «morfologjik». Por ky parim karakterizon drejtshkrimet e gjuhëve me histori shkrimi shumëshekullore, si frëngjishtja, anglishtja, greqishtja etj.

Të gjitha gjuhët në hapat e para të alfabetizimit të tyre, kur duhej të dilnin nga gjendja parake e shprehjes gojore të kulturës së tyre jolëndore kanë zbatuar parimin fonologjik të pasqyrimit shkrimor të gjuhës dhe kulturës së tyre. E njëjta gjë ka ndodhur edhe me shkrimin e shqipes. Që në fillimet e veta shkrimi shqip, në çdo përpjekje alfabetizimi e shkrimi, në themel ka qenë shkrimi fonologjik, në kuptimin që autorët e vjetër (Buzuku, Budi, Bardhi, Bogdani, Matrënga, por edhe Kuvendi i Arbnit, Veqilharxhi, Anonimi i Elbasanit, Gjyrokastri, Kristoforidhi) kanë perceptuar një sistem fonemash të shqipes, të cilave u kanë përshtatur një sistem shkrimor, që do të bënte të mundur nga njëra anë identifikimin e fonemave të shqipes dhe nga ana tjetër realizimin fonetik të këtyre fonemave në fjalë e tekste konkrete, kanë zbatuar me një fjalë një normë gjuhësore të bazuar mbi një kod alfabetik (Demiraj 2011, 68).

Këto sisteme shkrimore kanë organizimin e vet, i cili nga njëra anë i ngjan sistemit fonologjik të gjuhës, fonemave të saj, dhe nga ana tjetër ruan një pavarësi relative duke përdorur shenjat e veta shkrimore për të bërë pasqyrimin sa më të saktë të ligjërit të gjallë.

Ne jemi në gjendje që të lexojmë këto tekste të vjetra falë njohjes së alfabetit latin, grek, cirilik etj. dhe aftësisë sonë për të perceptuar tingujt e gjuhës jo thjesht si fakte akustike, por sidomos si imazhe akustike të një sistemi funksional, i cili ka pësuar ndryshimet e veta gjatë evolucionit historik të shqipes.

Në këtë kuptim, sistemi shkrimor i shqipes, ashtu si i gjithë gjuhëve të tjera të botës, është më saktë të përshkruhet si «fonologjik» dhe jo si «fonetik», që është më shumë një term empirik i përgjithshëm (Kostallari 1973, 80).

Paqartësitë teorike në fushën e grafematikës së përgjithshme, që kanë ekzistuar në të shkuarën, mund të shërbejnë si justifikim i vendimeve dhe formulimeve të diskutueshme të Kongresit të Drejtshkrimit. Po nëse vjen puna

për të ecur përpara këto pasaktësi dhe formulime të gabuara nuk mund të anashkalohen lehtë.

Asnjë propozim për ndryshime gramemash e ortogramash nuk ka vlerë nëse nuk kemi të qartë se si funksionon drejtshkrimi, nëse nuk kemi kuptuar se cili është parimi themelor i drejtshkrimit shqip. Asnjë autoritet nuk mund të deklarojë kompetencë duke imponuar ndryshime arbitrare me pretekstin se ka tagrin e ndryshimeve.

Ka ardhur koha që t'i japim fund konfuzionit dhe çdo autoritet ta nderojmë duke e kaluar në filtrin e një arsytimi kritik të shëndetshëm.

Duke rimarrë çështjen e parimit themelor të drejtshkrimit shqip në asnjë mënyrë ne nuk dalim kundër Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe. Dhe këtë dëshiroj ta theksoj në mënyrë të veçantë. Ndiej një respekt të thellë për gjithë ata gjuhëtarë që kishin fatin të jenë pjesë e atij kongresi, që për nga rëndësia është kulmi i historisë shumëshekullore të shqipes. Disa prej tyre i kemi midis nesh dhe gjithmonë do të gëzojnë nderimin e bashkësisë gjuhësore e kulturore shqiptare. Por pikërisht për këtë arsye ne nuk duhet të mistifikojmë parimet e drejtshkrimit në mënyrën se si u formuluan nga ky kongres.

Tani që teoria grafematike është më e konsoliduar se kurrë, e kemi për detyrë që ta forcojmë drejtshkrimin shqip me këtë mburojë të fuqishme teorike, e cila do t'u japë fund arbitrariteteve dhe entuziazmit protagonist për të kryer ndryshime. Në këtë kuptim, do të rimarrim çështje kaq të thjeshta si shkrimi e drejtshkrimi dhe marrëdhëniet e shkrimit me gjuhën e folur, marrëdhëniet midis fonemës dhe grafemës, dhe njësinë themelore të grafematikës. Të gjitha këto koncepte do të mundohemi t'i lidhim përmes një filli arsytues të vetëm, ku arsytimet nuk kundërshtojnë njëri-tjetrin.

2. Raportet e grafemës me fonemën dhe alofonin

Shkrimi dhe drejtshkrimi pasqyrojnë përfytyrimin grafik të përdoruesve për shenjat gjuhësore. Këto shenja gjuhësore përbëhen nga fonema dhe kanë përmbajtje leksikore dhe gramatikore. Kjo është një marrëdhënie semiologjike midis tingujve njerëzorë dhe koncepteve, e cila në të shkruar bartet si marrëdhënie midis shenjave grafike, përfaqësuese të tingujve njerëzorë (fonemave) dhe koncepteve.

Shkrimi është pasqyra grafematike e gjuhës së folur. Tingujt e gjuhës perceptohen nga folësit si fonema, dëshmi e të cilave bëhet shkrimi. Procesi i të shkruarit parakupton një analizë fonologjike të gjuhës, e cila kombinon përbërjen fonematike dhe realizimin fonetik të tingujve njerëzorë, fonemave. Është e rëndësishme të kuptojmë se folësit kanë një përfytyrim tingullor për tingujt e gjuhës të cilët shprehen në fonema. Mund të duket e çuditshme se si mund të analizojë një folës i rëndomtë tingujt e gjuhës së vet në fonema, por ky është realiteti: Fonemat ekzistojnë në gjuhë dhe ato perceptohen nga folësit si

të tilla, meqenëse njohja e sistemit fonologjik të gjuhës është pjesë e kompetencës gjuhësore të folësit.

Ky përfytyrim tingullor gjen në ndërgjegjen e përdoruesit përkatësin e vet pamor, që është grafema. Sigurisht, aftësia analizuese fonologjike është e ndryshme në përdorues të ndryshëm. Sa më i arsimuar të jetë një përdorues, aq më shumë sistematizim fonologjik sheh në gjuhë, gjë që pasqyrohet edhe në të shkruar.

Duke qenë se shkrimi përdoret për të paraqitur ligjërimin e gjallë, edhe shkrimi nuk është thjesht një inventar grafemash që vijnë në përkatësi me fonemat, por merr parasysh edhe realizimet tingullore të tyre, alofonet, të cilat mund të përkojnë me vlerën fonetike themelore të fonemës, ose mund të shmangen prej ndikimit të rrethanave fonetike në të cilat realizohet fonema.

Shkrimi i merr parasysh të dy këta faktorë. Prandaj në shkrimin e shqipes hasim edhe shenja diakritike, që pasqyrojnë anët e veçanta të shqiptimit. Disa grafema luajnë rolin shërbyes të shenjave diakritike. Grafema <h>, për shembull, duke u vendosur pas grafemave <t>, <d>, <s>, <z>, <x> shërben për të pasqyruar fonemat /θ/, /ð/, /ʃ/, /ʒ/, /dʒ/ nëpërmjet grupeve grafematike <th>, <dh>, <sh>, <zh>, <xh>. Grafema <j>, duke u vendosur pas grafemave <g>, <n>, shërben për të pasqyruar fonemat /j/, /ɲ/ nëpërmjet grupeve grafematike <gj>, <nj>. Dyfishimi i grafemës është një mënyrë tjetër në shqip për të pasqyruar fonemat fonetike të afërta (<rr>, <ll>). Në gjuhë të tjera, për shembull, pas grafemës <q>, shkruhet detyrimisht grafema <u> (<qu>).

Në këtë kuptim, shkrimi i gjuhës nuk mund të jetë vetëm fonetik ose vetëm fonematik.

Analiza fonetike dhe fonematike kryhet nga studiuesi, i cili zotëron aftësitë analizuese për të identifikuar fonemat e një fjale apo vijimësie ligjërimore (utterance). Për këtë përdoren simbole të caktuara. Për shembull:

Tek ortogramat <çlirim>, <shpall>, <zhbllokoj> parimi fonologjik i drejtshkrimit zbatohet fonetike, domethënë është zgjedhur si grafemë ajo shenjë që përkon me realizimin fonetik ([tʃliˈrim] [ʃpat] [ʒblɔkoj]) të morfemës njëfonemëshe /tʃ/ (/tʃliˈrim/ /tʃpat/ /tʃblɔkoj/). Në një ortogramë tjetër si /tʃdo/ [dʒdo] zbatohet drejtpërdrejt parimi fonologjik, meqenëse grafema <ç> përfaqëson shqiptimin themelor të fonemës /tʃ/, pavarësisht realizimit fonetik si [dʒ].

Në rastin e diftongjeve me gjysmëzanoren [i] / [j] herë zbatohet kriteri fonologjik e herë ai fonetik. Kështu shqiptimet [lulˈjeta], [eˈljona], [maˈɾjana], [tʃaˈbej], [θoˈmaj] të përbërjeve fonematike /luljeta/, /eliona/, /mariana/, /θomaj/ paraqiten grafematikisht <Luljeta>, <Eliona> / <Eljona>, <Mariana> / <Marjana>, <Thomaj> / <Thomai>.

Për të pasqyruar përbërjen fonematike në fjalë të tipit <idealist> dhe <idealizëm> përdorim këto simbole /idealist/ dhe /idealism/. Ndërsa për të

paraqitur përbërjen fonetike – realizimin fonetik të këtyre fonemave – përdorim këto simbole dhe i analizojmë në këtë mënyrë: [*idea* `list] dhe [*idea* `lizəm]. Siç shihet ka një ndryshim të dukshëm midis gramemave <idealist> dhe <idealizëm> dhe transkriptimit të tyre fonematik dhe fonetik. Nga ky arsytim duket sikur janë dhënë argumente për veprimin e parimit fonetik dhe jo fonematik në drejtshkrimin e gjuhës shqipe. Dhe, vërtet, nëse zgjedhim të shkruajmë <idealizëm>, që është më pranë realizimit fonetik sesa *<idealism>, duket sikur e kemi mohuar në heshtje veprimin e parimit fonematik. Në analizën e sotme fonologjike të kësaj kategorie fjalësh <s> dhe <z> konsiderohen si dy fonema më vete huazimesh të ndryshme në shqip. Mirëpo, ndjenja gjuhësore e përdoruesve të gjuhës i dallon qartë këto dy fjalë dhe marrëdhënia e tyre fjalëformuese nuk mund të injorohet. Le të shtojmë këtu edhe fjalët e tjera të së njëjtës çerdhe fjalësh: ideal, idealizoj, idealizim, idealisht. Analiza e tyre fonologjike dhe fonetike nxjerr në pah marrëdhënien e ndërlikuar fonemë – grafemë, e cila në disa raste përfaqëson realizimin fonetik të fonemës /s/ përfaqësuar nga grafema <s> dhe në raste të tjera realizimin fonetik të alofonit [z] të përfaqësuar nga grafema <z>.

Nëse nuk merret parasysh në radhë të parë kjo marrëdhënie e ndërlikuar, domethënë parimi fonologjik, dëmet janë të shumëfishta:

- Barazohet fonema me alofonin.
- Përthyeret në mënyrë të gabuar sistemi tingullor i gjuhës. Në çdo realizim fonetik shihet një fonemë.
- Krijohet një përfytyrim i pasaktë edhe për vetë sistemin gramatikor, për përbërjen morfematike.
- Pengohet perceptimi i gjuhës si një sistem i organizuar në mënyrë opozicionale.
- Pengohet aftësia krijuese e përdoruesve duke nxitur perceptimin e gjuhës thjesht si një performancë dhe jo si një strukturë e thellë.

Shembujt e mësipërm dhe shumë të tjerë, që mund të japë cilido studiues dhe përdorues i kualifikuar i gjuhës dëshmojnë se:

Në të vërtetë, nuk ka parim fonetik ose parim fonematik të zbatuar në mënyrë ekskluzive. Nuk mund të jetë vetëm njëri ose vetëm tjetri. Kjo ndodh sepse shkrimi ndërthur imazhin tingullor (fonemat) me realizimin e tyre në ligjërim (fonet ose alofonet). Ajo që na ndihmon të kuptojmë tingujt e shqiptuar është perceptimi ynë fonologjik për këta tinguj, meqenëse jemi të vetëdijshëm ose të nënvetëdijshëm se çdo tingull që shqiptojmë ka vendin e vet në sistemin fonologjik të gjuhës. Në këtë kuptim, për shembujt e sipërpërmendur dhe për të tjerë si këta themi se parimi fonetik përbën një rast të veçantë të parimit fonologjik ose ndryshe parimi fonologjik zbatohet në mënyrë fonetike. Arsytimi për zbatimin e parimit fonetik është se marrim gjithmonë si pikë referimi parimin fonologjik, në rastet kur grafematikisht

realizohet si shënues i një alofoni. Domethënë, themi se këtu shkruajmë përkatësin grafematik të alofonit dhe jo përkatësin grafematik të fonemës.

Duke vepruar kështu, jemi të ndërgjegjshëm se, edhe kur realizimi fonetik paraqitet si një tingull i ndryshëm nga ai që përfaqëson fonema, çdo shenjë përfaqësuese të realizimit fonetik e reduktojmë në fonemën përkatëse. Përkundrazi, nëse çdo realizim fonetik e barazojmë me një fonemë, atëherë realiteti fonologjik i gjuhës përthyeret në mënyrë të gabuar dhe nuk pasqyrohet saktë mënyra se si funksionon sistemi tingullor i gjuhës.

3. Parimi fonologjik si parim themelor i drejtshkrimit

Parimi fonologjik është parësor në qasjen e çështjeve drejtshkrimore, pasi marrëdhënia ndërmjet tingullit dhe shkronjës është në radhë të parë marrëdhënie midis fonemës dhe grafemës. Augst (1974, sipas Corvacho del Toro & Thomé 2021, 170). Këtë pohim nuk e anulon fakti që çdo tekst i shkruar është pasqyrim i një teksti të folur, pra, i një akti ligjërimor, i gjuhës në veprim.

Parimi fonologjik është në bazë të të gjitha drejtshkrimeve të botës, pavarësisht se përdorin shkrimin alfabetik ose jo. Kështu, mund të flitet për zbatim të parimit fonologjik edhe në gjuhë që përdorin sistemin hieroglifik të shkrimit, siç është gjuha kineze. Perfetti & Liu (2005) bëjnë fjalë për një Parim Fonologjik Universal (Universal Phonological Principle), që e kanë gjithë njerëzit që dinë shkrim e këndim dhe e aktivizojnë për të shqiptuar fjalët në të gjitha sistemet e shkrimit. Krahas këtij parimi universal ata dallojnë edhe një parim tjetër universal të quajtur Kufizim i Sistemit Universal të Shkrimit (Universal Writing System Constraint), sipas të cilit të gjitha sistemet shkrimore paraqesin kodifikim të gjuhëve që përfaqësojnë (Perfetti & Liu 2005, 193). Sipas tyre, leximi është aftësia për të kthyer shenjat grafike (shkrimin) në objekte gjuhësore (fjalë dhe morfema).

Kjo aftësi në gjuhët alfabetike kryen analizë dhe sintezë, domethënë dallon tek shkrimi elementet e veçanta, grafemat dhe i vë në marrëdhënie përkatësie me fonemat, por dallon njëkohësisht edhe fjalët dhe pjesët përbërëse të saj, morfemat, temat, mbaresat, ndajshesat.

Nëse leximi është fonologjik, i tillë është edhe shkrimi bazohet mbi një parim që prodhon leximin fonologjik. Shkrimi i të gjitha gjuhëve të botës bazohet në parimin fonologjik.

I njëjti inventar i tingujve gjuhësorë bëhet objekt i studimit të dy disiplinave të ndryshme, por plotësuese, fonetikës dhe fonologjisë. Fonetika (nyjëtimore, akustike dhe perceptive) studion organizimin e tyre në nivel fizik dhe biologjik; si prodhohen, si përhapen si valë zanore dhe si perceptohen nga veshi dhe truri. Edhe brenda këtij niveli ekziston një sistematikë e brendshme, e pavarur nga kuptimi. Fonologjia, nga ana tjetër, e shikon të njëjtin material tingullor nga këndvështrimi funksional; ajo studion se si këta tinguj

organizohen në fonema dhe alofone për të dalluar fjalët dhe kuptimet në një gjuhë të caktuar. Kështu, fonetika nuk e përfshin aspektin funksional (ai është fushë e fonologjisë), por as fonologjia nuk e përfshin tërë organizimin fizik të tingujve; secila ka organizimin e vet: fizik njëra, funksional tjetra.

4. Aspekti fonologjik është më i rëndësishëm se aspekti fonetik

Në vështrim analizues, fonologjia merret me funksionin e tingujve në sistemin gjuhësor – pra, me funksionin e tingujve si njësi minimale kuptimdalluese, me organizimin e tyre në sisteme fonologjike, por nuk lë pas dore aspektin e realizimit të tyre konkret (fonetik), pasi analizat fonologjike shpesh mbështeten në të dhënat e prodhimit dhe perceptimit akustik. Kjo është veçanërisht e dukshme në analizat e alofoneve: kur një fonemë realizohet ndryshe sipas kontekstit fonetik, kjo ndryshueshmëri kuptohet përmes analizës fonetike. Në të njëjtën mënyrë, kur grafema përfaqëson realizimin fonetik të fonemës, ky konstatim arrihet duke pasur si pikë referimi marrëdhënien fonemë – grafemë. Kjo marrëdhënie është baza e parimit fonologjik të drejtshkrimit.

Fonetika, edhe pse më e gjerë në kuptimin empirik (meqenëse përfshin të gjithë tingujt e mundshëm në të gjitha gjuhët), nuk merret me funksionin e këtyre tingujve në ndonjë gjuhë të caktuar. Ndërsa fonetika merret me përshkrimin fizik dhe akustik të tingujve të folurit si dukuri universale, fonologjia ndërton mbi këto të dhëna një sistem të brendshëm marrëdhëniesh që ka për qëllim të shpjegojë funksionin dallues dhe strukturor të tingujve në gjuhë të veçanta. Në këtë kuptim, fonologjia mund të kundrohej si më përfshirëse sesa fonetika, sepse jo vetëm që analizon realizimin konkret të tingujve, por edhe i organizon ato në një sistem abstrakt me vlera kuptimore, i cili vepron në mënyrë të ndërvarur me strukturat e tjera gjuhësore.

Kështu, fonologjia shkon përtej përshkrimit fonetik, duke e tejkaluar atë përmes analizës sistemore dhe funksionale të tingujve si njësi gjuhësore. Është për këtë arsye që në një grafemë ne shohim fonemën përkatëse, pavarësisht se grafema përfaqëson fonetikusht kryefonemën ose realizimin e saj të ndikuar nga mjedisi fonetik.

5. Problemi i parimit morfologjik të drejtshkrimit shqip

Parimi morfologjik i drejtshkrimit ka qenë ndër më të keqkuptuarit jo vetëm në gjuhësinë shqiptare, por edhe në atë botërore.

Shpesh aftësia e fonemave, të përfaqësuara nga grafemat, për të shprehur qartë morfemat e fjalëve është interpretuar gabimisht sikur në drejtshkrim vepron parimi morfologjik. Ky është një shembull tjetër ku kufijtë midis tingullit dhe shkronjës fshihen dhe tingulli barazohet me shkronjën.

Mirëpo, dhjetëvjeçarët e fundit studimet në grafematikë janë thelluar dhe vërehet një qartësi më e madhe në formulimin e këtyre koncepteve (khs., p.sh., Augst 1974, Augst 1986, Meletis 2019 etj.).

Megjithëse Kongresi i Drejtshkrimit bënte fjalë për një parim morfologjik, në asnjë rast nuk u dha një përkufizim i tij. Nuk gjendet asnjë përkufizim as tek autorët që i janë referuar drejtshkrimit shqip, as te A. Kostallari, as te M. Domi, as tek A. Dodi, Xh. Lloshi, R. Memushaj etj.

Të gjithë e përkrahajnë në mënyrë të tërthortë, veçse të paqartë se çfarë është parimi morfologjik. Ja ç'na thotë A. Kostallari: «[P]arimi morfologjik kërkon që fjalët dhe pjesët e tyre përbërëse të sistemit fjalëformues të shkruhen njësoj, pavarësisht nga ndryshimet tingullore që shkaktohen nga ligjet e gjalla fonetike që veprojnë sot në gjuhën tonë» (Kostallari 1973, 68). Ky përkshkrim është krejt i njëjtë me formulimin e Rezolutës së Kongresit (Drejtshkrimi 1973, 68). Duke mos qenë ky një përkufizim, por një shprehje konfuze, do lexuar dhe analizuar me vëmendje. Çfarë thotë në fakt këtu A. Kostallari?

Ai përdor një argumentim tërësisht fonologjik ose fonetik, për të shpjeguar një parim që e pagëzon morfologjik.

Termi «ligjet e gjalla fonetike» «që veprojnë sot në gjuhën tonë» përdoret në mënyrë të ekzagjeruar, por në fakt këtu fjala është për mjedisin fonetik të realizimit të fonemave.

Në fjalën *punë* dhe *punëtor* ka një prirje rrëgjimi në shqiptimin e ë-së së patheksuar.

Kjo prirje shqiptimore nuk ndikon në përbërjen fonematike të fjalës, e cila mbetet e pandryshueshme, por është realizim fonetik i fjalëve *punë* dhe *punëtor*.

Shkrimi është pasqyrim i asaj që ekziston në të folur. Fjalët *punë* dhe *punëtor* shkruhen më <ë>, sepse ajo /ë/ ekziston realisht si fonemë e patheksuar në mes dhe në fund të fjalës.

Raportet nuk duhen paraqitur të përmbysura. Fjalët *punë* dhe *punëtor* shkruhen me <ë> jo që të ruhet uniteti i morfemës, por sepse morfema tematike përbëhet nga një fonemë /ë/, e cila, kur ndodhet në pozicion të patheksuar në fund dhe në mes të fjalës, zakonisht shqiptohet e rrëgjuar. Realizimi fonetik i kësaj foneme ndryshon nga vlera fonetike e fonemës. Pra, në vend që të shkruajmë thjesht një shenjë grafike që përfaqëson realizimin fonetik të fonemës do të shkruajmë shkronjën (ose grafemën) që i korrespondon fonemës. Këtë e bëjmë sepse realizimet fonetike mund të ndryshojnë nga njëri individ tek tjetri, nga njëri grup shoqëror tek tjetri, nga njëra krahinë në tjetrën. Fonema dhe përkatësia e saj me grafemën janë mjeti më i sigurt për të ruajtur qëndrueshmërinë dhe unitetin semiotik.

Një nga dallimet kryesore midis toskërishtes dhe gegërishtes është pikërisht tek ë-ja e patheksuar, e cila në gegërishte ose nuk shqiptohet ose

shqiptohet shumë e rrëguar, krejt ndryshe nga shqiptimi i toskërishtes, ku ë-jaka prirje të jetë më e qëndrueshme dhe të ruhet më shumë.

Duhet të vendosim nëse ë-ja tek <punë> është një fonemë që ekziston me të vërtetë apo është një shenjë grafike që shkruhet për ndonjë arsye tjetër. Nëse nuk është fonemë, atëherë duhet të na argumentojnë çfarë është. Por një argumentim tjetër nuk kemi parë deri më sot. Nëpër gramatikat përshkruese thuhet qartë që {ë}-ja është pjesë e temës së fjalës. Nëse është kështu, atëherë nuk ka asnjë arsye që të përshkruajmë morfologjikisht një marrëdhënie midis fonemës dhe alofonit.

Nëse duke i qëndruar besnikë marrëdhënies fonemë – grafemë arrijmë të pasqyrojmë saktë përbërjen e fjalës, kjo nuk do të thotë se parimi i drejtshkrimit është leksikor. Në të njëjtën mënyrë, nëse duke i qëndruar besnikë marrëdhënies fonemë – grafemë arrijmë të pasqyrojmë saktë përbërjen e morfemës, nuk do të thotë se drejtshkrimi është morfologjik ose përshkohet nga parimi morfologjik.

Për ta përshkruar marrëdhënien e krijuar le t'i referohemi teorisë së shenjës gjuhësore. Siç dihet, shenja gjuhësore përbëhet nga shënjeshti dhe i shenjuari. Shenjeshti është tërësia e fonemave të shqiptuara në një rend të caktuar. I shenjuari është kuptimi që ka ky shenjeshti, është koncepti që shprehet nëpërmjet këtyre fonemave “tingujve gjuhësorë”. Pra, kemi lidhjen përkatëse:

shenjeshti → i shenjuar

ose

tërësi fonemash → kuptim

Lidhja e shenjeshtit me të shenjuarin përbën një unitet që quhet semiologjikisht shenjë, dhe gjuhësisht fjalë (Saussure 1983, 115). Shenja gjuhësore duke u përdorur në komunikim bart kuptime të larmishme: kuptim leksikor, të ndërthurur me kuptimin gramatikor. Një shenjë / fjalë mund të shprehë një nocion të caktuar konkret ose abstrakt, leksikor ose gramatikor. Të gjitha këto bëhen të qarta përmes analizës së shenjeshtit me të shenjuarin.

Shenja gjuhësore e ka selinë në trurin e njeriut si një kombinim i kuptimit dhe përfytyrimit dëgjimor, të cilit i korrespondon një element i botës materiale dhe konceptuale (njeri, kafshë, objekt, koncept). Aty ndodh edhe analiza ndërtimore dhe kuptimore e shenjës.

Tek shenjeshti analizohet përbërja e fonemave, si dhe mënyra e kombinimit të tyre. Kjo analizë nxjerr në pah kuptimin leksikor që shprehet nëpërmjet këtyre tingujve (fonemave).

Brenda shenjës gjuhësore, fjalës, përdoruesi mund të dallojë rrënjën, si dhe morfema të tjera, si parashtesa, prapashtesa apo mbaresa. Këtë aftësi për të dalluar përdoruesi e ka nga aftësia e tij si njohës i gjuhës të cilën flet. Aftësia e

tij për të identifikuar morfemat nuk kushtëzohet nga asnjë faktor tjetër përveç kompetencës së tij gjuhësore.

Gjuha është jo vetëm e folur, por edhe e shkruar. Madje, njohuritë tona për gjuhën e folur shprehen nëpërmjet shkrimit. Siç thotë Benveniste-i, «[m]e shkrimin ndodh shndërrimi i gjuhës në përfytyrim të gjuhës» (2019, 93).

Në rastin e gjuhës së shkruar imazhi akustik i shenjës kthehet në imazh pamor.

Pra, skema është:

imazh tingullor ↔ kuptim

↓↑

imazh pamor

Përndryshe, semiologjikisht:

shenjues tingullor ↔ i shenjuar

↓↑

shenjues shkrimor

Kjo skemë e thjeshtë dëshmon se shkrimi është një paraqitje skematike e shenjuesit tingullor që na çon tek i shenjuari, te kuptimi.

Në mënyrë të anasjelltë, skema mund të paraqitet kështu:

imazh pamor

↓↑

imazh tingullor ↔ kuptim

ose

shenjues shkrimor

↓↑

shenjues tingullor ↔ i shenjuar

Nëse shenjuesi tingullor përbëhet nga tingujt / fonemat, shenjuesi pamor përbëhet nga shkronjat / grafemat.

Marrëdhënia midis shenjuesit tingullor dhe shenjuesit shkrimor është marrëdhënie midis fonemës dhe grafemës.

Kjo marrëdhënie nuk lëkundet, pavarësisht nga përmbajtja e të shenjuarit, i cili mund të jetë një fjalë që përmban një kuptim leksikor ose mund të jetë një fjalë që përmban një kuptim leksikor por edhe një ndajshesë apo tregues gramatikor.

Edhe në rastin kur i shenjuari është morfemë me kuptim leksikor, edhe në rastin kur është morfemë me kuptim gramatikor, marrëdhënia midis shenjuesit tingullor dhe shenjuesit shkrimor nuk ndryshon. Ajo mbetet gjithmonë marrëdhënie midis fonemës dhe grafemës.

Në të dy këto raste parimi që përshkon drejtshkrimin është parimi fonologjik. Pra, nuk ka rëndësi përmbajtja leksikore apo gramatikore e morfemës, por marrëdhënia midis tingujve (fonemave) dhe shkronjave (grafemave).

Cili është kushti që të flasim për parim morfologjik? Paraqitja grafematike për t'u bërë të qarta morfemat e një fjale nuk mjafton si kusht që të themi se shkrimi ose drejtshkrimi përshkohet nga parimi morfologjik. Duhet që prej kësaj paraqitjeje grafematike të abstraktohet drejtpërdrejt tek morfema, pa ndërmjetësinë e fonemës, duhet pra që kjo paraqitje grafematike të mos ketë përkatës një tingull në përbërjen e fjalës. Kjo paraqitje grafematike emërtohet morfogramë. Morfogramat mund të krahasohen me ideogramat, të cilat nuk kanë referencë tingullore (Gallmann 1986, 62).

Në këtë rast skemat e mësipërme do të shndërroheshin kështu:

imazh pamor
↓↑
kuptim

ose

shenjues shkrimor
↓↑
i shenjuar (gjini, numër rasë, vetë)

Ka gjuhë si frëngjishtja, greqishtja, anglishtja, gjermanishtja, danishtja etj., me një traditë shkrimore të lashtë, që e përdorin parimin morfologjik. Por secila prej tyre e përdor këtë parim me mënyrën e vet.

Frëngjishtja na ofron raste të bollshme ku marrëdhënia e drejtpërdrejtë midis grafemës dhe morfemës shfaqet në mënyrë shumë të qartë.

Në frëngjisht:

<i>un chat</i>	[ʃa]	~	<i>des chats</i>	[ʃa]
<i>un doigt</i>	[dwa]	~	<i>des doigts</i>	[dwa]
<i>élève</i>	[e`lev]	~	<i>élèves</i>	[e`lev]
<i>professeur</i>	[pʁɔfɛ`sœʁ]	~	<i>professeurs</i>	[pʁɔfɛ`sœʁ]
<i>route</i>	[rut]	~	<i>routes</i>	[rut]
<i>lycé</i>	[li`se]	~	<i>lycéés</i>	[li`se]
<i>adresse</i>	[a`dʁɛs]	~	<i>adresses</i>	[a`dʁɛs]
<i>nom</i>	[nɔ̃]	~	<i>noms</i>	[nɔ̃]
<i>étoile</i>	[e`twal]	~	<i>étoiles</i>	[e`twal]

Në shembujt e mësipërm njëjësi dhe shumësi janë homofone, përbëhen nga të njëjtat fonema. Mirëpo, në të shkruar njëjësi dhe shumësi diferencohen nga një grafemë <s>, e cila shihet vetëm gjatë leximit dhe lexuesi kupton se ajo grafemë ndodhet aty për të dhënë informacionin morfologjik të numrit shumës.

E njëjta gjë vërehet edhe në zgjedhimin foljor, ku konstatohen mjaft morfograma që tregojnë vetën.

<i>je</i>	<i>chante</i>	[ʃāt]
<i>tu</i>	<i>chantes</i>	[ʃāt]
<i>il/elle</i>	<i>chante</i>	[ʃāt]
<i>nous</i>	<i>chantons</i>	[ʃātɔ̃]
<i>vous</i>	<i>chantez</i>	[ʃāte]
<i>ils/elles</i>	<i>chantent</i>	[ʃāt]

Morfogramat e së tashmes dëftore veprare, siç shihet nga shembulli i mësipërm janë <e> për vetën I dhe III njëjës, <es> për vetën II njëjës, <s> për vetën I shumës, <z> për vetën II shumës dhe <ent> për vetën III shumës.

<i>je</i>	<i>parlais</i>	[paʁlɛ]
<i>tu</i>	<i>parlais</i>	[paʁlɛ]
<i>il/elle</i>	<i>parlait</i>	[paʁlɛ]
<i>nous</i>	<i>parlions</i>	[paʁljɔ̃]
<i>vous</i>	<i>parliez</i>	[paʁlje]
<i>ils/elles</i>	<i>parlaient</i>	[paʁlɛ]

Morfogramat e së kryerës së thjeshtë dëftore veprare, siç shihet nga shembulli i mësipërm janë <s> për vetën I dhe II njëjës, <t> për vetën III njëjës, <s> për vetën I shumës, <z> për vetën II shumës dhe <ent> për vetën III shumës.

Mund të konkludohet, qoftë edhe me këta pak shembuj, se disa morfograma të shumësit të foljeve të frëngjishtes, si <s>, <z>, <ent> specializohen për të treguar vetat e shumësit, dhe kanë një zbatueshmëri mbikohore.

Në greqishten e lashtë dhe të re parimi morfologjik zbatohet në një mënyrë të tillë që paraqitja grafematike e fjalës jep informacion për morfemën. Në rastet e mëposhtme të greqishtes së lashtë

λύει ['lyi] 'ai/ajo zgjidh' 3 NJ.DËFT. VEP.

λύοι ['lyi] 'pastë zgjidhur' 3 NJ. DËSH.VEP.

dhe të greqishtes së re

εννοείτε [eno`ite] 'nënkuptoni' 2 SH. DËFT.VEP.

εννοείται [eno`ite] 'nënkuptohet' 3 NJ. DEFT. JOVP.

morfogramat <ει>, <οι>, <ε>, <αι> funksionojnë brenda një marrëdhënieje grafematike opozicionale ku prania e njërës nënkupton një kategori të caktuar gramatikore, të cilën fonema e përfaqësuar vetë nuk mund ta japë.

Në raste të tjera informacioni grafematik paraqitet si një pleonazëm drejtshkrimor:

λύω ['lyo] 'unë zgjidh' 1 NJ.DËFT. VEP.

Këtu <ω>-ja tregon se folja është në vetën I njëjës të dëftores veprare. Kjo mënyrë shkrimi në greqishten e lashtë interpretohet si zbatim vetëm i parimit fonologjik, meqenëse <ω>-ja është e specializuar si një grafemë që shënon o-në e gjatë. Mirëpo, në greqishten e re përdoret e njëjta ortogramë *λύω*, tek e

cila, për shkak të ndryshimeve fonetike që kanë ndodhur gjatë njëzet shekujve të fundit, ndërthuren parimi fonologjik (meqenëse <œ>-ja shqiptohet [o] ashtu si shkronja <o>), parimi morfologjik, meqenëse jep informacion për kategorinë gramatikore (nuk shkruhet me omikron <œ> por me omega <ω>), si dhe parimi etimologjik (meqenëse jep informacion se kjo <œ> shkruhet kështu për shkak se dikur në të kaluarën shqiptohej e zgjatur).

Në anglisht parimi morfologjik paraqitet në formën e një qëndrueshmërie grafematike të morfemës, e cila mbetet e tillë pavarësisht ndryshimeve fonetike që kanë ndodhur në rrjedhë të kohës. Rrjedhojë e këtyre ndryshimeve është edhe zhvillimi në anglishte i një leximi «morfematik» të fjalëve.

child	[ʧaɪld]	vs	children	[ˈʧɪldrən]
sign	[ˈsaɪn]	vs	signature	[ˈsɪgnɪʃə]
heal	[hi:l]	vs	health	[hælt̪]
read	[ri:d]	vs	read	[ræd]

Parimi morfologjik i drejtshkrimit në anglisht zbatohet si marrëdhënie grafematike e një ortograme me një tjetër. Megjithëse tek *child* [ʧaɪld] dhe *children* [ˈʧɪldrən] kemi dy lexime të ndryshme, tema {*child*} tek <*children*> shkruhet në mënyrë të njëjtë për të ruajtur identitetin morfematik, duke konfirmuar zbatimin e parimit morfologjik të drejtshkrimit.

Në danisht, parimi i qëndrueshmërisë së morfemës kërkon që drejtshkrimi i një morfeme të ruhet në kontekste të ndryshme edhe kur forma e saj fonetike ndryshon ndjeshëm. Një shfaqje tjetër e parimit morfologjik është që morfemat e ndryshme të duken të ndryshme edhe kur lexohen njësoj. Kështu, shumë homofone nuk janë homografe; për shembull, *løg* ‘qepë’ kundrejt *løj* ‘këngë’, të dyja lexohen [l̥i] (Coulmas 1996, 110).

Në gjermanisht, një rast i parimit morfologjik është ai kur dy fjalë homofone kuptimisht të ndryshme diferencohen grafematikisht. Kështu, për shembull, fjalët *heute* [hojte] ‘sot’ dhe *Häute* [hojte] ‘lëkura’ (në shumës), përveç përdorimit të shkronjës së madhe tek emrat, diferencohen edhe grafematikisht nëpërmjet paraqitjes së ndryshme të grupeve grafematike <eu> dhe <äu>. Në këtë rast opozicioni krijohet jo vetëm mes temave të dy fjalëve të ndryshme, por edhe midis temave të njëjësit dhe shumësit të emrit: nj. *Haut* sh. *Häute*. Shenjat diakritike shërbejnë këtu për dallimin morfologjik të temës së njëjësit nga ajo e shumësit. Identiteti i bazës grafematike të formave të kundërvëna shërben për të ruajtur bazën pamore të lirë nga ndryshimet grafematike të rrënjës (Vachek 1989, 182).

Ekziston përherë një rrezik i ngatërimit të parimit morfologjik me atë fonologjik. Prandaj, duhen parë me kujdes raportet që formohen midis grafemës dhe morfemës, të cilat duhet të ekzistojnë pavarësisht nga raporti grafemë – fonemë.

Parimi morfologjik zbatohet në mënyra të veçanta në gjuhë të ndryshme. Kjo varet nga tradita e gjatë shkrimore e secilës gjuhë. Thelbi i tij mbetet

marrëdhënia e drejtpërdrejtë e grafemës me morfemën dhe abstraktimi gramatikor që e përjashton fonemën. Sidoqoftë, ai zë një vend të kufizuar në tërësinë e sistemit grafematik të gjuhëve ku ky parim gjen zbatim.

6. A ekziston parimi morfologjik i drejtshkrimit në shqip?

Në drejtshkrimin e shqipes nuk gjen zbatim parimi morfologjik. Aq më pak mund të thuhet se mund të jetë parimi themelor i drejtshkrimit (!!!). Arsyeja është se shkronjat në shqip nuk tregojnë drejtpërdrejt morfemën, por tregojnë fonemën. Morfema shfaqet nëpërmjet fonemës. Duke qenë se ndërmjetëson fonema, atëherë është pa kuptim që të flasim për parim morfologjik të drejtshkrimit.

Në terma më teknikë themi se gjuha shqipe nuk ka morfograma. Le të shohim disa emra ku shumësi është i njëjtë me njëjësën dhe disa folje ku format vetore janë homofone, në të cilat nëse gjuha shqipe do të kishte ndonjë parim morfologjik të drejtshkrimit, do të na ndihmonte që vendosnim një lidhje të drejtpërdrejtë midis shkronjës dhe morfemës:

<i>mësues</i>	~	<i>mësues</i>	<i>laro</i>	~	<i>laro</i>	<i>hap</i>
<i>sy</i>	~	<i>sy</i>	<i>palaço</i>	~	<i>palaço</i>	<i>hap</i>
<i>lule</i>	~	<i>lule</i>	<i>ballë</i>	~	<i>ballë</i>	<i>hap</i>
<i>kafshë</i>	~	<i>kafshë</i>	<i>dukë</i>	~	<i>dukë</i>	<i>qe</i>
<i>lot</i>	~	<i>lot</i>	<i>muze</i>	~	<i>muze</i>	<i>qe</i>
<i>muaj</i>	~	<i>muaj</i>	<i>tru</i>	~	<i>tru</i>	<i>merr</i>
<i>thi</i>	~	<i>thi</i>				<i>merr</i>

Nëse vërtet do të vepronte një parim morfologjik në drejtshkrimin shqip, atëherë në formën e shumësit të këtyre fjalëve duhej të përfshiheshin edhe një ose disa shkronja të tjera, eventualisht në fund, të cilat edhe pa bërë pjesë në përbërjen fonematike të fjalës, do të na jepnin informacion se emri është në numrin shumës, folja do të ishte në vetën e parë, të dytë ose të tretë. Mirëpo, këta tregues grafematikë, që quhen morfograma, nuk ekzistojnë në gjuhën shqipe.

Mund të marrim, mandej, edhe shembuj nga eptimi emëror:

<i>dash</i>	~	<i>desh</i>	<i>plak</i>	~	<i>pleq</i>
<i>natë</i>	~	<i>net</i>	<i>zog</i>	~	<i>zogj</i>
<i>shteg</i>	~	<i>shtigje</i>	<i>pyll</i>	~	<i>pyje</i>
<i>breg</i>	~	<i>brigje</i>	<i>Koço</i>	~	<i>Koçua / Koçoja</i>

Sigurisht, nuk mund t'i kërkojmë një gjuhe t'u përshtatej argumenteve tona. Meqenëse mungesa e shembujve ilustrues të parimit drejtshkrimor morfologjik është aq e dukshme dhe me qëllim që mosqenien e tij t'ua dëshmojmë përdoruesve të pafamiljarizuar me drejtshkrimin e thellë, arsyetojmë që ky parim do të pritej të ishte zbatuar në shembuj si më sipër. Hipotetiku, nëse drejtshkrimi i këtyre fjalëve do të rregullohej sipas parimit

morfologjik të drejtshkrimit, do të duhej që grafematikisht të kishim ortograma si këto:

<i>dash</i>	~	* <i>däsh</i>	<i>plak</i>	~	* <i>pläki</i>
<i>natë</i>	~	* <i>nät</i>	<i>zog</i>	~	* <i>zogi</i>
<i>shteg</i>	~	* <i>shtege</i>	<i>pyll</i>	~	* <i>pylle</i>
<i>breg</i>	~	* <i>brege</i>	<i>Koço</i>	~	* <i>Koçoa</i>

Në këto gramema të hamendësuar janë bërë zgjedhje grafematike të cilat nuk kanë lidhje me shqiptimin, por do të funksiononin thjesht për të ruajtur vizualisht uniformitetin morfematik. Në qoftë se kjo do të ndodhte vërtet në drejtshkrimin e shqipes, atëherë mund të bënim fjalë për zbatim të parimit morfologjik.

7. A ka morfograma në shkrimin dhe drejtshkrimin shqip?

Kusht, pra, që të kemi drejtshkrim ku zbatohet (qoftë edhe pjesërisht!) parimi morfologjik duhet të jetë identifikimi i morfogramave.

Ç'janë morfogramat?

Morfogramat, sipas Arrivé-së (1993), janë shkronja që «shënojnë gjininë dhe numrin, [...] që japin gjatë leximit indikacione mbi kategoritë morfologjike në heshtje, në kuptimin më të rreptë të shprehjes» (f. 50). Domethënë kemi parim morfologjik atëherë kur në një ortogramë shohim një shkronjë ose grup shkronjash shkruar në atë mënyrë që na japin informacion për kategorinë gramatikore të gjinisë, numrit ose rasës, apo vetës etj. Ky informacion është i shkëputur nga leximi i fjalës.

Le të shqyrtojmë rastet kryesore të morfologjisë së shqipes ku pretendohet se zbatohet parimi morfologjik i drejtshkrimit. Për këtë mjafton të hapim tekstin e Gramatikës së Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, e cila e thotë qartë se ë-ja ka përmbajtje tingullore në këto raste:

Tek shumësi i emrave mashkullorë që mbarojnë më -ë. Ë-ja, sikundër Gramatika e Akademisë lë të nënkuptohet, është një morfemë shumësi, e cila përbëhet nga fonema /ë/.

Kështu Gramatika (Agalliu et al 1995) thotë:

«Sipas tingullit *fundor të temës*, në gjininë mashkullore hyjnë:

5. pak emra që mbarojnë me zanoren -ë të patheksuar: *atë, burrë, djalë, gjumë, kalë, lëmë, lumë*. Me rrudhjen e gjinisë asnjënjëse këtij grupi i janë shtuar edhe disa fjalë të tjera, si: *ballë, brumë, djathë, ujë* etj. (Agalliu et al 1995, 90)

»Në gjininë femërore hyjnë:

»1. Gjithë emrat tema e të cilëve mbaron me zanoren -ë të patheksuar, me përjashtim të atyre që u përmendën në pikën 5 tek emrat mashkullorë: *bukë, dorë, fushë, gjellë, kripë, lugë, punë* etj.

»Prapashtesën -ë e marrin vetëm emrat mashkullorë. Janë fjalë që përbëhen nga më shumë se një rrokje dhe theksohen në rrokjen e fundit

zakonisht shënojnë frymorë. Nga ndërtimi janë kryesisht fjalë të prejardhura me prapashtesa të tilla si: *-ac, -aç, -ak, -an (-jan), -ar, -tar, -esh, -er (-ier) -ist, -it, -iot, -or, -tor, -uk*, të cilat marrin mbi vete theksin e fjalës: *tullacë, gjëmbaçë, rrugaçë; durrsakë, fujakë, romakë, rosakë; dibranë, shkodranë lumjanë, matjanë; detarë, formularë, kolonjarë; anëtarë, arsimtarë, luftëtarë, larashë; rreshterë, togerë, karrocierë; artistë, sportistë; labovitë; mallakastriotë, suljotë; patokë; dasmorë, drejtorë, fjalorë, lakrorë, punëtorë; bishtukë* etj. Marrin *-ë* në shumës edhe emra të tjerë fonetakisht të ngjashëm me të mësipërmit, që në shumicën e tyre shënojnë frymorë: *kovaçë, dajakë, kapakë, aeroplanë, çobanë, gjermanë; beqarë, hambarë, mercenarë; berberë, fenerë, noterë, oficerë, shoferë, veterinerë, inxhinierë, kamerierë; afaristë; komitë, petritë; majorë, doktorë, ekskavatorë, traktorë; patriotë; buzukë, kolltukë* etj. E formojnë shumësin me prapashtesën *-ë* edhe emrat që dalin me fundoret *-af -al, -ap, -ec, -eç, -ek, -el, -en, -et, -ic, -ik, -il, -in, -ir, -om, -ot, -oz, -un*: *fotografë, paragrafë, kryeneçë, fishekë, dyshekë, mjekë, atletë, planetë, ibrikë, gjeneralë, dollapë, memecë, kriminelë, civilë, zinxhirë, marangozë, agronomë, hostenë, majmunë, pinguinë, policë, poliglotë* etj., që theksohen gjithashtu në fund dhe në pikëpamje fonetike ngjajnë me fjalët e mësipërme.

»1. Me *-ë* e formojnë temën e shumësit edhe disa emra njërrrokësh si: *dhëmbë, lekë, shokë*. 2. »Emrat *bri, dre, dru, fre, tra* në shumës e zgjerojnë temën me *-r* (ashtu sikurse edhe kur lakohen në njëjës) dhe marrin prapashtesën *-ë*: *brir-ë, drer-ë, drur-ë, frer-ë, trar-ë*. Po kështu edhe *krye - krer-ë* 3. Bashkë me disa fjalë kanë hyrë në gjuhën shqipe edhe prapashtesat e shumësit të turqishtes *-llar* e *-ler*, të cilat në analogji me shumësin e tipit fshatarë kanë marrë edhe një *-ë* në fund: *agallarë, atllarë, baballarë, subashllarë, ustallarë, xhaxhallarë, bejlerë, dervishlerë, efendilerë, kadilerë* etj.» (Agalliu et al 1995, 100). «Mbiemra të nyjshëm janë gjithë mbiemra të parmë me *-ë*: *i bardhë; i mirë, i verdhë, i parë* etj.; gjithë mbiemrat e formuar me prapashtesa *-(ë)m(ë), -shëm* dhe *-(ë)t(ë)*: *i fisëm, i mesëm, i nesëm, i parmë, i afrueshëm, i sjellshëm, i hapët, i hekurt, i ftohtë, i nxehtë* etj.» (Agalliu et al 1995, 158).

«Mbiemrat mashkullorë që janë fjalë të përbëra, e formojnë shumësin:

»c) duke marrë mbaresën *-ë*: *buzëgaz - buzëgazë, kokëtul - kokëtulë, sylësh - sylëshë* etj.» (Agalliu et al 1992, 165)

Edhe foljet *jam, kam* dhe *them* në vetën e dytë njëjës marrin mbaresën *-sh*, por në vetën e tretë njëjës ato marrin mbaresën *-të*: *të je-të, të ke-të, të tho-të*; të krahasohen me format përgjegjëse të dëftores *ësh-të, ka, tho-të*.

Në të gjitha përshkrimet e mësipërme thuhet qartë pa lënë asnjë ekuivok se morfemat emërore, mbiemërore, foljore etj. ose përbëhen nga fonema /ë/ ose kanë në përbërje të tyre fonemën /ë/. Prania e kësaj foneme nuk vihet në dyshim në asnjë formulim.

Ka arsye që Kongresi i Drejtshkrimit detyrimin për të shkruar grafemën ë e formuloi si nevojë të ruajtjes së përbërjes morfologjike. Këto arsye lidhen, me gjasë, nga njëra anë me historinë e drejtshkrimit të shqipes (përmendim këtu të gjitha projektet e drejtshkrimit, nga ai i Komisionit Letrar të Shkodrës e deri tek projektet e Shqipërisë të 1948, 1951, 1956, 1967 dhe të Kosovës të 1951, 1957 e 1964) dhe nga ana tjetër me studimet fonetike rreth shqiptimit të zanores së patheksuar [ë] në fund dhe në trup të fjalës. Megjithatë, tjetër gjë është analiza fonologjike, morfologjike, sintaksore, që merret për bazë në drejtshkrimin e fjalës dhe tjetër gjë marrëdhënia e grafemave me kategoritë gramatikore, marrëdhënie që do të lejonte karakterizimin e drejtshkrimit si të përshkruar nga parimi morfologjik.

Para se ta shpjegojmë më hollësisht këtë çështje, le të mundohemi të bëjmë analizën fonologjike të shembujve të mësipërm: domethënë të gjejmë përbërjen fonematike dhe fonetike të fjalëve.

Do të marrim për arsye praktike vetëm një pjesë të tyre.

Atëherë:

Logograma FonematRealizime fonetike

<kapakë>/kapakə/[ka`pakə] [ka`pa:k] [ka`pak]

<aeroplanë>/aeroplanə/[aero`planə] [aero`pla:n] [aero`plan]

<çobanë>/tşobanə/[tʃo`banə] [tʃo`ba:n] [tʃo`ban]

<gjermanë>/jermanə/[jer`manə] [jer`ma:n] [jer`man]

<beqarë>/becarə/[be`carə] [be`ca:r] [be`car]

<hambarë>/hambarə/[ha`mbarə] [ha`mba:r] [ha`ma:r] / [ha`mbar]

<mercenarë> /mertsenarə/[mertse`narə][mertse`na:r] [mertse`nar]

<të jetë>/təjetə/[tə`jetə] [tə`je:t] [tə`jet]

<të ketë>/təketə/[tə`ketə] [tə`ke:t] [tə`ket]

<të thotë>/təθotə/[tə`θotə] [tə`θo:t] [tə`θot]

Duket qartë se arsyeja qëndron pikërisht tek një pjesë realizimesh fonetike, në të cilat kjo morfemë {ë} ose pjesë morfeme me {ë} ose nuk shqiptohet ose shqiptohet shumë dobët. Është, me një fjalë, rrjedhojë e atij formulimi të gabuar të parimit themelor të drejtshkrimit, sipas të cilit shqiptimi, realizimi fonetik është parësor.

E njëjta gjë mund të thuhet edhe për rastin e shqiptimit të shurdhët të disa bashkëtingëlloreve në fund të fjalës, të cilat shkruhen me grafemë që përfaqëson bashkëtingëlloren përkatëse të zëshme.

Ekziston një arsyetim, sipas të cilit zbatohet parimi morfologjik në një kategori emrash, ku bashkëtingëllozja fundore e trajtës së pashquar mund të shqiptohet e shurdhët, ndërsa në trajtën e shquar shqiptohet e zëshme. Po sipas

këtij arsyetimi, për këtë arsye në të dyja rastet shkruhet grafema që përfaqëson fonemën e zëshme, në mënyrë që të ruhet njësia morfematike. Këto raste përfshijnë emra si [zok] ~ [ˈzogu], [shtok] ~ [ˈshtogu], [brek] ~ [ˈbregu], [rop] ~ [ˈrobi], [elp] ~ [ˈelbi], të cilat duhen shkruar përkatësisht <zog> ~ <zogu>, <shtog> ~ <shtogu>, <breg> ~ <bregu>, <rob> ~ <robi>, <elb> ~ <elbi>. Interpretimi i saktë i dukurisë këtu është ai që e sheh shkrimin e grafemës që përfaqëson bashkëtingëlloren e shurdhët si zbatim të parimit fonetik, ndërsa shkrimin e grafemës që përfaqëson bashkëtingëlloren e zëshme si zbatim të parimit fonologjik. Dukuria morfonologjike që ndodh këtu është realizimi fonetik i shurdhët i një foneme bashkëtingëllore të zëshme të temës në pozicion fundor. Nëse morfema tematike bëhet e qartë nëpërmjet zgjedhjes së grafemës që përfaqëson fonemën dhe jo realizimin e saj alofonik, këtu kemi një rast të pastër të mënyrës se si vepron parimi fonologjik i drejtshkrimit. Nuk ka, pra, as këtu arsye për të parë ndonjë parim morfologjik të drejtshkrimit. Kompetenca gjuhësore e folësve është e aftë të bëjë analizë dhe sintezë, të dallojë përbërjen fonematike të një fjale, por gjithashtu të dallojë edhe përbërjen morfematike të fjalës. Shkrimi nuk është gjë tjetër veçse pasqyrimi grafematik i kësaj kompetence.

Një dukuri e ngjashme ndodh edhe në gjermanishte, ku mjaft studiues, për hir të një tradite tashmë të tejkaluar, e interpretojnë si zbatim të parimit morfologjik. Mirëpo, siç është vënë re me të drejtë, «shurdhimi i bashkëtingëlloreve fundore kryhet morfofonemisht (= në mënyrë morfonologjike, A.S.), por nuk ka pasoja morfografike (=nuk mund të thuhet se zbatohet parimi morfologjik, A.S.)» (Augst 1981, 28).

Përparësia e pasojës në vend të shkakut, pra, shpërfillja e faktit fonologjik të përbërjes fonematike të morfemave dhe e pasqyrimin të morfemave përmes marrëdhënies fonemë – grafemë, është një nga lajthitjet ku ranë për fat të keq thujtja gjithë studiuesit tanë të respektuar. Mirëpo, për hir të një respekti fals, ne nuk mund të vazhdojmë me përfundime të gabuara, të cilat e çorientojnë dhe e devijojnë gjithë debatin për drejtshkrimin.

Parimi morfologjik, edhe kur vepron në gjuhë, vepron në një pjesë të kufizuar ortogramash dhe kursesi nuk përshkon gjithë drejtshkrimin e gjuhës. Prandaj, është krejt pa baza përfundimi ku ka arritur për shembull, Xh. Lloshi, thjesht nga konsiderata të jashtme, se gjoja në drejtshkrimin e shqipes ka vetëm dy parime: parimi morfologjik dhe parimi historik (Lloshi 2022, 35). Ky përfundim është tërësisht i gabuar dhe prandaj edhe i papranueshëm. Drejtshkrimi shqip nuk ka asnjë parim morfologjik dhe, ashtu siç zbatohet sot, nuk përshkohet as nga parimi historik.

8. Rëndësia praktike e njohjes së parimit themelor të drejtshkrimit të shqipes

Njohja e parimit themelor dhe e parimeve dytësore të drejtshkrimit të shqipes ka rëndësi jo vetëm teorike, por sidomos praktike, sepse lidhet drejtpërdrejt me analizën fonologjike dhe morfologjike të fjalëve të gjuhës shqipe. Në praktikën e përdoruesve të shqipes shpeshherë fashitet dallimi midis shkronjës dhe tingullit. Kjo gjë ndodh instinktivisht edhe me studiues të gjuhës, të cilët sillen në mënyrë të pashmangshme edhe si përdorues të zakonshëm të gjuhës dhe mishërues të ndjenjës së përgjithshme gjuhësore. Padashur, çdo graf (= realizim grafematik, shkronjë) barazohet me një fonemë, edhe në rastin kur grafi përfaqëson realizimin alofonik të fonemës. Është tipik rasti i parashtesës {ç}, e cila realizohet fonetikisht si [tʃ], [dʒ], [ʃ], ose i parashtesës {s}, e cila realizohet fonetikisht si [s], [z], [ts]. Analiza morfologjike që është kryer ka identifikuar paradoksalisht tri morfema të ndryshme, edhe pse duket qartë se është një morfemë që realizohet fonetikisht me tri mënyra të ndryshme, në varësi të mjedisit fonetik. Drejtshkrime të mëparshme të shqipes e kanë pasqyruar më drejt këtë marrëdhënie duke përzgjedhur grafematikisht atë graf që barazohet fonetikisht me fonemën. Prandaj gjejmë në të kaluarën ortograma të tilla si <çpërblim>, <çpoj>, <çkatërrim>, <sbulonj>. Logogramat <zdua> dhe <zbuloj> bazohen grafematikisht në të njëjtin parim, atë fonetik, por praktika shkrimore dhe rregulli drejtshkrimor e konsideron logogramën e parë të papranueshme, ndërsa të dytën të pranueshme.

Njohja e saktë e parimit themelor dhe e parimeve dytësore të drejtshkrimit të shqipes ka një rëndësi të madhe sidomos për vetëruajtjen e drejtshkrimit. Rëndësia është e dukshme në radhë të parë në drejtimin e diskutimeve që synojnë reformimin ose ndryshimin e tij. Kjo bëhet shumë e qartë nëse ndiqet dinamika e diskutimeve të këtij pesëdhjetëvjeçari të fundit për ndërhyrje në drejtshkrimin shqip, që kanë ardhur në formën e propozimeve për ortograma të veçanta ose për një reformë të gjerë drejtshkrimore. Si pasojë e formulimit të pasaktë të parimeve të drejtshkrimit shqip nga Kongresi i Drejtshkrimit (1973: 35-36), u përvijuan dy drejtime kryesore rishikuese:

Drejtimi i parë është ai që mbivlerëson parimin fonetik. Duke përdorur si shkas realizimet fonetike të fjalëve përkrahësit e këtij drejtimi propozojnë logograma të bazuara jo në përbërjen fonematike të fjalës, por në përbërjen fonetike që vërehet nëpër realizime fonetike (Bokshi 2022, 38; Hysa 2002; Topalli 2011, 264, 267). Në këtë interpretim ata nuk marrin parasysh faktin që morfema tematike ose mbaresa {ë} është e pranishme jo vetëm virtualisht, por edhe materialisht si element tingullor, gjë që njihet dhe formulohet qartë në të gjithë doracakët gramatikorë pa përjashtim (*Fonetika dhe gramatika* 1976, Agalliu et al 1995 etj.). Të pranosh se ë-ja, tematike ose mbaresë, nuk ekziston

fonetikusht dhe njëkohësisht të pranosh që ekziston morfologjikisht janë dy gjëra që nuk pajtohen midis tyre.

Drejtimi i dytë i diskutimit të gabuar është ai që mbivlerëson të ashtuquajturin parim «morfologjik». Në të vërtetë argumentet e përdorura në këtë diskutim janë e kundërta e drejtimit të parë. Argumentet nuk janë morfologjike, por mbështeten në përbërjen fonematike të fjalës, pra, janë argumente morfofonologjike. Në emër të një morfologjizimi të skajshëm propozohen logograma që e «sistematizojnë» drejtshkrimin duke tronditur lidhjen e vendosur midis përdoruesve dhe imazheve të qëndrueshme shenjore që përdoren si forma të rregullta shkrimore (Sulejmani 2002, Lloshi 2022, Memushaj 2022, 162v. etj.).

Duke qenë i kritikueshëm ky drejtim, njëkohësisht rrëzohet edhe mëtimi i ndonjë studiuesi për të «retushuar» qëndrimin teorik dhe për të njohur si parim themelor të drejtshkrimit shqip të ashtuquajturin parim «fonemik» ose «fonematik» (Spiro 2023). Fonema është sigurisht pika e referimit me të cilën grafema zhvillon një marrëdhënie dinamike duke u konkretizuar në praktikën shkrimore si graf (shkronjë) që përfaqëson herë vlerën fonetike të fonemës dhe herë vlerën fonetike të alofonit.

Një drejtim i tretë, jo rishikues, është ai që i sheh rregullat e drejtshkrimit si një hapësirë shumë të ndjeshme, që ndikon drejtpërdrejt praktikën komunikuese të përdoruesve të shqipes. Çdo ndërhyrje në to përbën cenim të kodit komunikues me pasoja të paparashikueshme. Kjo kategori studiuesish (Lafe 2022, 309; Çeliku 2022, 279; Bajçinca 2022, 319; Buxheli 2022, 298; Omari 2022, 325 e mjaft të tjerë) është kundër ndërhyrjeve të motivuara fonetikusht dhe gramatikisht. Në këtë kategori do të mund të bënte pjesë edhe autori i këtij studimi, nëse do të zhdukej papajtueshmëria e qëndrimit konservues me formulimin e pasaktë të parimit themelor të drejtshkrimit si parim «fonetik», që e zhvlerëson fuqinë e këtij qëndrimi.

9. Përfundime:

Parimi logografik si parim themelor për kodifikimin e ndryshimeve drejtshkrimore

Formulimi i saktë i parimit themelor të drejtshkrimit si parimi fonologjik ndihmon për të kuptuar se si funksionon drejtshkrimi shqip, ashtu si drejtshkrimi i çdo gjuhe natyrore në botë.

Qëndrimet e skajshme që mbivlerësojnë parimin fonetik (realizimin tingullor të fjalëve në mjediset fonetike që krijon ligjërimi i gjallë) ose parimin «fonematik», që emërtohet si parim «morfologjik» (përbërjen fonematike të fjalëve, ashtu siç rezulton nga analiza e fonemave), nuk çojnë në përfundime që pajtohen me perceptimin e shenjave gjuhësore dhe integritetin e tyre. Ato

prekin një element shumë të rëndësishëm të qarkut komunikativ, siç është shenja gjuhësore, lënda e parë e thurjes së kumtimit (mesazhit). Pajtimi me përfytyrimin e përgjithshëm të shenjës ndalon deformimin e saj, duke siguruar qëndrueshmërinë e qarkut komunikativ dhe suksesin e komunikimit.

Qarku i komunikimit është hapësira e përbashkët e bashkësisë folëse, e cila e kërkon këtë hapësirë të lirë nga çdo ndërhyrje e deformim. Kjo është arsyeja që çdo përpjekje për ndërhyrje në drejtshkrim perceptohet fillimisht si një përpjekje për të prekur një kod komunikativ të afirmuar e të ngulitur.

Nëse parimi fonologjik është çelësi për të kuptuar se si funksionon drejtshkrimi, ky parim nuk mund të bëhet mbështetje teorike për të propozuar kodifikimin e ndryshimeve në drejtshkrim. Mbështetja e çdo propozimi për kodifikimin e ndryshimeve në drejtshkrim, kur ato janë të pashmangshme, bëhet duke pasur parasysh qëndrueshmërinë e shenjës gjuhësore. Ky kriter nxjerr në plan të parë **parimin logografik**, i cili e trajton fjalën si një imazh, si një ideogramë të përbërë nga elemente më të vogla, grafemat, prania ose mungesa e të cilave ndikon në identifikimin e së tërës. Shumë nga propozimet që trajtojnë përdorimin ose mospërdorimin e një ë-je apo të realizimit fonetik ose grafematik të një diftongu (p.sh. <Evropë> ose <Europë>) kanë efekt të menjëhershëm tek logogramat e qëndrueshme dhe prekin integritetin e tyre. Kjo do të thotë se argumenti i përdorimit fonetik ose i përbërjes fonematike (i shfaqur si argument morfologjik) nuk kanë rëndësi përballë argumentit logografik. Kur një përdoruesi të gjuhës i propozohet ndryshimi i drejtshkrimit të një fjale, ai nuk sheh aty argumentin fonetik ose morfologjik, por cenimin e logogramës së një fjale.

Në këtë kuptim, kriter bëhet jo mënyra se si realizohen fonetikiisht fjalët, as aftësia e disa individëve për të kryer analizë fonematike ose morfologjike, por **praktika shkrimore** dhe logogramat që perceptohen si forma të rregullta, normative. Në këtë vlerësim duhet dalluar qartë kompetenca grafematike e përdoruesve nga rastet e mungesës së kompetencës, të cilat nuk mund të merren si argumente për kodifikim të ndryshimeve. Detyra e gjuhëtarit nuk është që të argumentojë fonetikiisht, fonematikisht ose morfologjikiisht futjen e një ndryshimi në drejtshkrim, por të hetojë se cilat logograma përfaqësojnë imazhet e qëndrueshme grafematike në ndërgjegjen e përdoruesve dhe t'i interpretojnë ato si normative. Në këtë kategori «ndryshimesh» do të hyjnë vetiu ato logograma që praktika e përdoruesve të kulturuar të shqipes i interpreton si të rregullta, normative, pavarësisht zgjidhjeve të dhëna në Rregullat e Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe (1973).

Ka disa ortograma fjalësh të cilat praktika e përdoruesve i ka shndërruar në normë drejtshkrimore (Lafe 2025), pavarësisht zgjidhjeve të dhëna në «Drejtshkrimin e gjuhës shqipe» (1973). Këtu, veprimi i parimit logografik i percepton këto logograma si normative. Mbi këtë bazë mund të diskutohet miratimi i disa prej këtyre ortogramave si normative. Në këtë rast do të

krijoheshin në mënyrë të pashmangshme dysorë normativë, të cilët do të duhej një kohë tjetër e mjaftueshme për të shfuqizuar përfundimisht formën e vjetra dhe për të pranuar format e reja si zgjedhjet e vetme normative. Parimi logografik afirmohet në këtë mënyrë si mjeti kryesor në duart e gjuhëtarëve për të diskutuar çdo nevojë për ripërshtatje ortogramash. Ngujimi brenda argumentimit fonetik, fonologjik dhe morfologjik apo sistematik e largon debatin nga zgjidhjet realiste dhe i shndërron gjuhëtarët në një sekt të izoluar, ndërsa ligjëratën e tyre në një oksimoron të ekzistencës së tyre profesionale.

Bibliografi

- Agalliu, Fatmir. 1973. «Rreth disa çështjeve të zbatimit të parimit morfologjik në drejtshkrimin e shqipes». *Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe 20-25 nëntor 1972, II*. Tiranë: Akademia e Shkencave e RP të Shqipërisë.
- Agalliu, Fatmir; Engjëll Angoni; Shaban Demiraj; Ali Dhrimo; Enver Hysa; Emil Lafe & Ethem Likaj. 1995. *Gramatika e gjuhës shqipe*. I. Botim i dytë. Tiranë: Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë.
- Arrivé, Michel. 1993. *Réformer l'orthographe ?* (Collection Linguistique nouvelle). Paris: PUF.
- Augst, Gerhard. 1974. *Rechtschreibung mangelhaft?* Heidelberg: Quelle & Meyer.
- . 1986. «Descriptively and explanatorily adequate models of orthography», 25-42. Në idem (ed.) *New trends in graphemics and orthography*. Berlin - New York: de Gruyter.
- Bajçinca, Isa. 2022. «Në 40-vjetorin e Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe». Në: *Propozime për drejtshkrimin (1976-2014)*. I, 318-319. Shkup: Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve – Shkup. Shoqata e Gjuhësisë Shqiptare.
- Beci, Bahri. 1973. «Rreth parimit tradicional historik në drejtshkrimin e shqipes». Në: *Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe (20-25 nëntor 1972)*. I. 313-321. Tiranë: Akademia e Shkencave e RP të Shqipërisë. Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë. 313-321; po ashtu në: *Studime filologjike*. I (1973). 155-160.

- _____. 1984. «Parimi morfologjik i drejtshkrimit të gjuhës shqipe». Në: *Gjuha jonë*. 2.
- Benveniste, Émile. 2019. *Last letter, Collège de France 1968 et 1969*. Edinburgh: Edinburgh University Press.
- Bokshi, Besim. 2022. «Çështje të drejtshkrimit (Diskutim në mbledhjen e KNGJSH-së)». Në *Propozime për drejtshkrimin (1976-2014)*. I, 37-41. Shkup: Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve – Shkup. Shoqata e Gjuhësisë Shqiptare.
- Buxheli, Ludmila. 2022. «Çfarë duhet të ruajmë nga gjuha dhe çfarë mund të ndryshojmë». Në *Propozime për drejtshkrimin (1976-2014)*. I, 297-299. Shkup: Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve – Shkup. Shoqata e Gjuhësisë Shqiptare.
- Chen, J.-Y., & Cherng, R.-J. 2013. «The proximate unit in Chinese handwritten character production». Në: *Frontiers in Psychology*, 4(517), doi: 10.3389/fpsyg.201300517.
- Corvacho del Toro, Irene & Günther Thomé. 2021. «Meilensteine im Erwerb der deutschen Orthografie». Në *Lernen und Lernstörungen*, 10 (3), 169–180 <https://doi.org/10.1024/2235-0977/a000341>.
- Coulmas, Florian. 1996. *The Blackwell Encyclopedia of Writing Systems*. Blackwell.
- Çeliku, Mehmet. 2011. «Për një përmirësim të mëtejshëm të shqipes standarde: mbi ndryshimin e disa rregullave të «Drejtshkrimit të gjuhës shqipe» (1973)», 327-337. Në *Shqipja në etapën e sotme*.
- _____. 2014. «Probleme të diskutueshme rreth Drejtshkrimit të gjuhës shqipe, 1973», 206-210. Në *Çështje të shqipes standarde*. Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë.
- _____. 2022. «Mos prekni drejtshkrimin, të ngrihet Këshilli Kombëtar». Në: *Propozime për drejtshkrimin (1976-2014)*. I, 278-280. Shkup: Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve – Shkup. Shoqata e Gjuhësisë Shqiptare.
- Demiraj, Bardhyl. 2011. «Norma gjuhësore dhe substandardi në një tekst shqip të shek. XVIII në arealin kulturor të Veriut», 65-83. Në: *Shqipja në etapën e sotme*. 65-83
- Dodi, Anastas. 2014. *Fonetika dhe fonologjia e gjuhës shqipe*. Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë.

- Dodi, Auron. 2023. «Rreth parimit fonetik në drejtshkrimin e shqipes». Në: *Peizazhe të fjalës*. 3 janar 2023. <https://peizazhe.com/2023/01/03/rreth-parimit-fonetik-ne-drejtshkrimin-e-shqipes/>; (vizituar së fundi më 14.10.2025).
- Drejtshkrimi i gjuhës shqipe*. 1973. Tiranë: Akademia e Shkencave e RP të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë.
- Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe*. II. 1976. Tiranë: Akademia e Shkencave e RP të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë.
- Gallmann, Peter. 1986. «The graphic elements of German written Language». Në Augst, Gerhard (ed.) *New trends in graphemics and orthography*, 43-79. Berlin - New York: de Gruyter.
- Hysa, Enver. 2002. «Probleme të drejtshkrimit të ë-së». Në: *Konferenca shkencore «Shqipja standarde dhe shoqëria shqiptare sot»*. Tiranë, 11-12 nëntor 2002. Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë. Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë.
- Jorgaqi, Kristina. 2002. «Vështrim retro-perspektiv mbi drejtshkrimin e fjalëve me prejardhje të huaj në shqipe». Në *Konferenca shkencore «Shqipja standarde dhe shoqëria shqiptare sot»*. Tiranë, 11-12 nëntor 2002. Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë. Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë.
- Kostallari, Androkli. 1973. «Gjuha e sotme letrare shqipe dhe disa probleme themelore të drejtshkrimit të saj». Në: *Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe 20-25 nëntor 1972*. I, 51-144. Tiranë: Akademia e Shkencave e RP të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë.
- Lafe, Emil. 2022. «Përsiatje dhe sqarime për drejtshkrimin». Në: *Propozime për drejtshkrimin (1976-2014)*. I. 300-309. Shkup: Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve – Shkup. Shoqata e Gjuhësisë Shqiptare.
- _____. 2025. «Rregulla drejtshkrimore që i ka shkëlur koha». Në *Studime Filologjike*, 2, 175–190.
- Lloshi, Xhevat. 2022. *E duam drejtshkrimin si gjithë Europa*. Shkup: Konica.
- Meletis, Dimitrios. 2019. «The grapheme as a universal basic unit of writing». Në *Writing Systems Research*, 11:1, 26-49, doi: 10.1080/17586801.2019.1697412.

- Memushaj, Rami. 2005. *Shqipja standarde – Si ta flasim dhe ta shkruajmë*. Tiranë: Toena.
- _____. 2022. «Vërejtje rreth përfundimeve të mbledhjes së datës 27.06.2012 të Këshillit Ndërkademi». Në: *Propozime për drejtshkrimin (1976-2014)*. I., 161-178. Shkup: Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve – Shkup. Shoqata e Gjuhësisë Shqiptare.
- _____. 2025. «Nga Akademia jonë e Shkencave dhe Instituti i Gjuhësisë pritet që të bëjnë më shumë për gjuhën shqipe». Online në: *Rami Memushaj: Nga Akademia jonë e Shkencave dhe Instituti i Gjuhësisë pritet që të bëjnë më shumë për gjuhën shqipe* (<https://sot.com.al/kultura/rami-memushaj-nga-akademia-jone-e-shkencave-dhe-instituti-i-gjuhesise-pritet-qe-te-bejne-me-shume-per-gjuhen-shqipe/> vizituar së fundi më 31.10.2025).
- Omari, Anila. 2022. «Disa mendime mbi propozimet për reformë drejtshkrimore». Në: *Propozime për drejtshkrimin (1976-2014)*. I, 320-325. Shkup: Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve – Shkup. Shoqata e Gjuhësisë Shqiptare.
- Perfetti, Charles A; Sulan Zhang & Iris Berent. 1992. «Reading in English and Chinese: Evidence for a «Universal» Phonological Principle». Në: R. Frost and L. Katz (eds.), *Orthography, Phonology, Morphology, and Meaning*, Amsterdam.
- de Saussure Ferdinand. 1983. *Course in General Linguistics*. Edited by Charles Bally and Albert Sechehaye with the Collaboration of Albert Riedlinger. Translated and Annotated by Roy Harris. La Salle, Illinois: Open Court.
- Sgall, Petr. 1987. «Towards a theory of phonemic orthography», 1-30. Në: Philip. A. Luelsdorff (ed.), *Orthography and Phonology*. Amsterdam/Philadelphia: John Benjamins Publishing Company.
- Spiro, Aristotel. 2009. «Mbi parimet e (drejt)shkrimit të shqipes standarde», 207-215. *Studime filologjike*, 1-2.
- _____. 2022a. *Për një drejtshkrim shqip modern*. Tiranë: UETPRESS.
- _____. 2022b. «Për një riformulim të parimeve të drejtshkrimit», 103-115. *Studime filologjike*. 3-4.

- _____. 2023. «Mungesë e alibisë semantike». Në: *Peizazhe të fjalës*. 7 janar 2023, <https://peizazhe.com/2023/01/07/mungese-e-alibise-semantike/>; vizituar së fundi më 14.10.2025.
- Sulejmani, Fadil. 2002. «Sa më pak përjashtime e më shumë përgjithësim». Në: *Konferenca shkencore «Shqipja standarde dhe shoqëria shqiptare sot»*. Tiranë, 11-12 nëntor 2002. Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë. Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë.
- Shqipja në etapën e sotme: Politikat e përmirësimit dhe të pasurimit të standardit*. 2011. Tiranë: Qendra e Studimeve Albanologjike. Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë.
- Topalli 2011 = Topalli, Kolec. 2011. «Drejtshkrimi i shqipes si sistem», 245-308. Në: *Shqipja në etapën e sotme*.
- Vachek, Josef. 1989. *Written language revisited*. Selected, edited, and introduced by Philip A. Luelsdorff. Amsterdam/Philadelphia: John Benjamins.
- _____. 1964. «On some basic principles of ‘classical phonology’», 409-431. Në *Zeitschrift für Phonetik, Sprachwissenschaft und Kommunikationsforschung* 17.

SUMMARY

The Fundamental Principle of the Albanian Orthography

More than half a century has passed since the Albanian Orthography Congress (November 20–25, 1972). During this period, the Albanian standard language has become significantly consolidated, demonstrating its strength and vitality despite various discursive, social, and political challenges. Nevertheless, discussions regarding a potential revision of orthographic rules have persisted, often based on partial proposals lacking solid theoretical or empirical grounding. This study argues that the enduring confusion and unproductive cycles of debate stem not from the Congress’s practical decisions, but from the inaccurate formulation of the fundamental principles of Albanian orthography as presented in its Spelling Rulebook (*Drejtshkrimi i gjuhës shqipe*, 1973).

The official documents designate the «phonetic principle» as the foundational principle of Albanian orthography, complemented by a so-called «morphological principle.» This paper critically re-examines these formulations through the lens of general graphematics. It demonstrates that the phonetic principle—which prescribes writing words as they are pronounced in literary discourse—is theoretically untenable and leads to inconsistencies.

Conversely, the alleged morphological principle, which aims to preserve the uniform spelling of morphemes despite phonetic changes, is shown to be a misinterpretation of basic phoneme-grapheme correspondences. The study argues that Albanian, like all natural languages with alphabetic writing systems, is fundamentally governed by the phonological principle. This principle prioritizes the phoneme over its variable phonetic realizations (allophones). The preservation of morphemic identity is not an independent morphological requirement, but a natural consequence of faithfully representing the phonemic composition of words.

The paper provides extensive empirical evidence from Albanian morphology (e.g., the writing of unstressed <ë>, final devoicing, plural formations) and contrasts it with genuine cases of morphological spelling in languages like French, German, Greek, and English, where morphograms (graphemes with no phonetic correspondence) are present. Since Albanian lacks morphograms, invoking a morphological principle is deemed superfluous and theoretically misleading. Recognizing the phonological principle as the true foundation of Albanian orthography has crucial practical implications: it provides a robust theoretical shield against arbitrary or ideologically motivated proposals for orthographic reform. By clarifying how the writing system actually functions, this principle ensures the stability of the communicative code, protects the integrity of the linguistic sign, and redirects scholarly debate from unfounded revisionism toward a scientifically grounded understanding of Albanian orthography. The paper concludes that any future discussion of orthographic changes must be guided by the need for communicative stability and by respect for the established logographic images of words, not by phonetic variability or morphological arguments.

Adelina Çerpja

Neologjizmat dhe planifikimi leksikografik në gjuhën shqipe

Përmbledhje

Neologjizmat janë një nga treguesit më të dukshëm të zhvillimit leksikor. Ky punim trajton rëndësinë e neologjizmave, duke u përqendruar në identifikimin, stabilizimin dhe institucionalizimin e tyre në burimet normative dhe leksikografike të shqipes. Studimi ndërthur trajtimin teorik me disa vëzhgime korpusore për të shqyrtuar marrëdhënien ndërmjet përdorimit real të gjuhës dhe planifikimit leksikografik.

Në punim shqyrtohen qasjet kryesore teorike mbi neologjizmat, duke përfshirë dallimin ndërmjet neologjizmave leksikorë dhe semantikë, si edhe modelet e leksikalizimit dhe institucionalizimit në literaturën bashkëkohore. Vëmendje u kushtohet kriterëve për vlerësimin e tyre, si nevoja komunikative, transparenca semantike, integrimi morfologjik, frekuenca dhe përhapja në ligjërime të ndryshme, si dhe sfidave metodologjike të identifikimit të neologjizmave, sidomos në kushtet e zhvillimeve në përpunimin e gjuhës natyrore.

Në korpusin *sqTenTen* (Sketch Engine) është kryer një vëzhgim mbi një neologjizëm leksikor dhe një semantik. Të dhënat e nxjerra mund të shërbejnë si tregues të rëndësishëm për vlerësimin e shkallës së institucionalizimit të njërive të reja dhe përfshirjen e tyre në fjalorët bashkëkohorë të shqipes.

Punimi nxjerr në pah se shqipja ende nuk ka struktura të qëndrueshme për monitorimin sistematik të neologjizmave. Zhvillimi i korpusëve kombëtare, i burimeve digjitale dhe i metodave të përpunimit të gjuhës natyrore paraqitet si një hap i rëndësishëm drejt një modeli më të mbështetur në të dhëna empirike për planifikimin leksikografik. Në përfundim, theksohet nevoja për një qasje më sistematike ndaj vëzhgimit, vlerësimit dhe trajtimit të neologjizmave në gjuhën shqipe.

Fjalë kyçe: *neologjizma, institucionalizim, planifikim leksikografik, korpus, gjuha shqipe, përpunimi i gjuhës natyrore.*

1. Hyrje

Gjuha si sistem i hapur pasqyron sidomos në nivel leksikor ndryshimet e realitetit shoqëror e konceptual, veçanërisht ato që vijnë si rezultat i zhvillimeve në shkencë, teknologji, media dhe kulturë. Neologjizmat, si njësi të reja leksikore të krijuara për të emërtuar nocione, dukuri apo objekte të reja, përfaqësojnë një nga shfaqjet më të dukshme të këtij dinamizmi. Ato lindin për të mbushur boshllëqe në hapësirën semantike ose për të përcaktuar më saktë realitete të reja (Mattiello 2017, 25). Në këtë mënyrë, neologjizmat kontribuojnë jo vetëm në zgjerimin e mundësive shprehëse të gjuhës, por edhe në ruajtjen e funksionalitetit të saj si mjet komunikimi gjithmonë në zhvillim. Në rastin e gjuhës shqipe, kjo nevojë është veçanërisht e theksuar për shkak të zhvillimit të terminologjisë shkencore dhe ndikimit gjithnjë në rritje sidomos të anglishtes.

Ndryshe nga shumë gjuhë evropiane që mbështeten në korpuse të zhvilluara dhe në struktura të specializuara për ndjekjen e fjalëve të reja, në shqipe mungon ende një sistem i qëndrueshëm për monitorimin, dokumentimin dhe vlerësimin e tyre. Përfshirja e njësive të reja në burimet normative mbështetet kryesisht në stabilizimin paraprak në përdorim, ndërsa vëzhgimi sistematik i zhvillimeve leksikore dhe përdorimi i metodave bashkëkohore të analizës mbeten ende të kufizuara. Pikërisht kjo e bën të nevojshëm shqyrtimin e neologjizmave jo vetëm si dukuri leksikore, por edhe si çështje të planifikimit leksikografik dhe të zhvillimit të burimeve leksikografike për shqipen.

Në këtë punim synohet të shqyrtohet roli i neologjizmave në zhvillimin e gjuhës, e konkretisht të shqipes, duke ndërthurur trajtimin teorik me çështjet që lidhen me identifikimin, përdorimin dhe përfshirjen e tyre në burimet normative. Punimi synon të analizojë trajtimin e neologjizmave në shqipe, të evidentojë sfidat e institucionalizimit të tyre dhe, nëpërmjet krahasimit me përvoja ndërkombëtare, të diskutojë mundësitë për një qasje më sistematike ndaj vëzhgimit dhe dokumentimit të njësive të reja leksikore.

Objektivat e këtij punimi janë shqyrtimi i përkufizimeve dhe i klasifikimeve ekzistuese të neologjizmave si një kategori në zhvillim, analiza e mekanizmave të formimit dhe leksikalizimit të tyre, si dhe evidentimi i sfidave që lidhen me identifikimin dhe institucionalizimin e fjalëve të reja edhe në gjuhën shqipe.

Për këtë janë shqyrtuar burime teorike dhe empirike nga literatura shqiptare dhe ndërkombëtare, si dhe janë marrë parasysh përvoja konkrete nga projekte aktuale për vëzhgimin e fjalëve të reja në gjuhë të ndryshme.

2. Neologjizmat

Neologjia studion fjalët dhe kuptimet e reja leksikore (neologjizmat), si edhe proceset që lidhen me krijimin, përhapjen dhe integrimin e tyre në

sistemin leksikor të një gjuhe. Hohenhaus (2005, 374) ka vënë në dukje se neologjizmat duhet të shihen si njësi të reja në kuptim relativ, sepse nuk mjafton vetëm krijimi i një fjale të re, por edhe shkalla e pranimit të saj nga përdoruesit e gjuhës. Si fushë studimi, neologjia ndërthur koncepte nga leksikologjia, morfologjia, semantika, sociolinguistika dhe analiza e diskursit, në funksion të identifikimit dhe vlerësimit të njësive të reja leksikore.

Ndonëse termi “neologji” ka qenë i pranishëm prej kohësh në literaturën gjuhësore, konsolidimi i saj si fushë studimore më vete është relativisht i vonë, çka pasqyrohet edhe në paqartësitë që hasen shpesh në përkufizimin dhe në kufijtë e saj. A. Rey thekson se neologjia qëndron ndërmjet risisë dhe normës, ndërmjet gjuhës së përdoruesve dhe gjuhës së institucioneve (Rey 2005, 312), pra neologjizmat nuk shihen vetëm si dukuri gjuhësore, por edhe si rezultat i ndërveprimit të faktorëve gjuhësorë dhe jashtëgjuhësorë. Si fushë ndërdisiplinore, neologjia ndihmon në kuptimin e mënyrës se si gjuha përshtatet ndaj zhvillimeve shoqërore, kulturore dhe teknologjike. Për këtë arsye, neologjizmat mund të shqyrtohen si në aspektin sinkronik, për të evidentuar përdorimin e tyre në një periudhë të caktuar, ashtu edhe në aspektin diakronik, për të ndjekur zhvillimin e tyre në kohë (Renouf 2013, 5).

Ndryshe nga fjalët e zakonshme të gjuhës, neologjizmat kanë një status të ndërmjetëm midis risive leksikore dhe njësive të pranuara, çka e bën më të vështirë përcaktimin e kufijve të tyre. Mattiello (2017, 4) i përkufizon neologjizmat si “njësi të reja leksikore të krijuara për të emërtuar koncepte të reja ose për të shprehur kuptime të reja në përgjigje të nevojave të reja komunikative”. Temmerman (2000, 17) i sheh si tregues të gjallërisë gjuhësore dhe i ndan në dy lloje kryesore: neologjizma leksikore, pra fjalë tërësisht të reja, dhe neologjizma semantikë, domethënë kuptime të reja të fjalëve ekzistuese. Një ndarje e ngjashme vihet re edhe te Thomai (2006, 285), i cili dallon neologjizma fjalësh, d.m.th. fjalë të reja si nga forma, ashtu edhe nga përmbajtja, dhe neologjizma kuptimesh, pra fjalë të njohura më parë që kanë fituar një kuptim të ri.

Ndërsa në Oxford English Dictionary – OED3 (<https://www.oed.com>) neologjizmi përkufizohet kryesisht mbi bazën e risisë kohore dhe formale, Dressler (1993, 5028) thekson edhe aspektin funksional dhe institucional, duke e parë si një njësi të re me potencial për t’u pranuar nga komuniteti folës.

Në praktikën leksikografike, një fjalë nuk konsiderohet më neologjizëm pasi bëhet pjesë e përdorimit të qëndrueshëm dhe sistematik në ligjërim. Megjithatë është e rëndësishme të bëhet dallimi i neologjizmave nga fjalët e çastit, të cilat si njësi të përkohshme, krijohen për një rast të vetëm, shpesh me funksion stilistik, pa synimin për t’u bërë pjesë e qëndrueshme e leksikut (Brinton & Traugott 2005, 45), kurse neologjizmat janë potencialisht të institucionalizueshëm (Bauer 2001, 41).

Për të kuptuar dinamikën e neologjizmave në sistemin gjuhësor, sipas Schmid-it (2020, 69), dallohen tri faza kryesore nëpër të cilat njësitë e reja leksikore kalojnë gjatë procesit të ngulitjes:

-Faza e krijimit, e cila përfshin kohën kur një fjalë e re nis të përdoret për të emërtuar një realitet të ri. Në këtë fazë fjala ende nuk është pjesë e sistemit gjuhësor të përbashkët dhe përdorimi i saj është i kufizuar.

-Faza e konsolidimit, e cila lidhet me përhapjen e njësisë së re në përdorim dhe me pranimin gradual të saj nga përdoruesit. Në këtë fazë zhvillohet procesi i leksikalizimit, përmes të cilit një njësi fillimisht e paqëndrueshme fiton statusin e një lekseme të qëndrueshme në sistemin e gjuhës (Lipka 1992, 17). Sipas Schmid (2008, 4), leksikalizimi nis me krijimin e një forme të re, e cila përmes përdorimit të përsëritur stabilizohet gradualisht në formë dhe kuptim, përhapet në diskursin publik dhe mund të arrijë një nivel njohjeje kolektive. Ky proces përbën një hallkë të rëndësishme në kalimin nga neologjizmi drejt institucionalizimit dhe përfshirjes në burime leksikografike. Kohëzgjatja e këtij procesi ndryshon në varësi të frekuencës së përdorimit dhe të shkallës së përhapjes së njësisë së re (Jamet – Terry 2018, 2). Në të kundërt, njësia mund të mbetet në nivelin e një okazionalizmi ose të një përdorimi të kufizuar.

-Faza e ngulitjes, e cila ka të bëjë me përdorimin dhe përfshirjen e plotë të njësisë së re në strukturën gjuhësore dhe njohjen e saj si pjesë e normës gjuhësore. Kjo ndodh kur fjala arrin të ngulitet semantikisht, që do të thotë se ajo përvetësohet në mënyrë të qëndrueshme nga përdoruesit dhe aktivizohet automatikisht në komunikim pa krijuar ndonjë ndjesi të “ririsë”.

Modeli i Schmid-it tregon se fjala e re nuk është vetëm një risi e çastit, por një njësi që kërkon kohë dhe përdorim të rregullt për t’u bërë pjesë e gjuhës standarde apo e normës. Kjo fazë mund të shpjegohet edhe përmes konceptit të ngulitjes kognitive të zhvilluar nga Langacker (1991, 46), sipas të cilit përdorimi i përsëritur bën që njësi të caktuara gjuhësore të bëhen pjesë e kompetencës së brendshme gjuhësore dhe të aktivizohen automatikisht në situata të zakonshme komunikimi. Kështu, ndërveprimi mes përdorimit të vazhdueshëm, përhapjes në ligjërim dhe mbështetjes institucionale krijon kushtet për stabilizimin e kuptimit dhe integrimin e njësisë së re në sistemin gjuhësor.

Përkufizimi i neologjizmave nuk është vetëm çështje e ririsë formale apo kohore, por duhet parë e lidhur ngushtë me funksionalitetin, përhapjen dhe potencialin për normim në bazë të vlerës sistimore që kanë për gjuhën standarde. Nisur nga funksioni që fjalët e reja kanë në ndërtimin e kuptimeve dhe në pasurimin e regjistrave të ndryshëm gjuhësorë, dallohen dy grupe kryesore: neologjizmat stilistikë, të cilët përdoren për efekte shprehëse në letërsinë artistike, dhe neologjizmat referencialë (Mattiello 2017, 24) ose me funksione të përgjithshme, të cilët shërbejnë për të emërtuar realitete të reja. Lidhur me terminologjinë, studiuesit theksojnë funksionin standardizues dhe

normativ të neologjizmave, duke i parë neologjizmat terminologjikë si të domosdoshëm për strukturimin e dijes dhe sistemin terminologjik të gjuhës (Temmerman 2000, 16).

Një nga çështjet kryesore të planifikimit leksikografik lidhet me kriteret mbi të cilat një njësi e re leksikore mund të përfshihet në burime të ndryshme normative. Duke u mbështetur në përvojën e gjuhëve të tjera (Metcalf 2002, 152–164), si edhe në përvojën e gjuhës shqipe (Thomai 2006, 284–286), për vlerësimin e neologjizmave duhen mbajtur parasysh disa kriterë kryesore.

Neologjizmi duhet të lidhet me një nevojë reale komunikative ose me emërtimin e një koncepti që nuk ka njësi përkatëse në leksikun ekzistues. Njësia e re duhet të ketë qartësi semantike dhe transparencë morfemike, në mënyrë që kuptimi dhe struktura e saj të perceptohen lehtësisht nga përdoruesit, si edhe të jetë në përputhje me sistemin fonetik dhe morfologjik të gjuhës, duke pasur aftësinë të integrohet në paradigmen fjalëformuese të shqipes. Po aq e rëndësishme është edhe shkalla e përdorimit të neologjizmit në ligjërime dhe burime të ndryshme, pasi frekuenca e përdorimit dhe shpërndarja në regjistra të ndryshëm përbëjnë tregues të rëndësishëm për vlerësimin e qëndrueshmërisë së njësive në përdorim.

Identifikimi i neologjizmave në një gjuhë mund të duket si një proces i thjeshtë, por në të vërtetë vendosja e kufirit midis njësive të reja dhe atyre ekzistuese, si edhe dallimi ndërmjet risive të qëndrueshme dhe atyre kalimtare, shoqërohet me një sërë vështirësish metodologjike, teknologjike dhe konceptuale. Një nga sfidat kryesore lidhet me faktin se “risia” është relativisht subjektive: një fjalë që për një grup përdoruesish perceptohet si e re, mund të jetë e zakonshme për një grup tjetër, sidomos kur bëhet fjalë për dallime brezash, regjistrash ose përdorimesh të specializuara. Një nga vështirësitë në përcaktimin e neologjizmave lidhet me ngatërresën e tyre me njësi të tjera leksikore, si me arkaizma të rikthyer në përdorim, dialektizma të përhapur përmes medias ose krijimtarisë artistike, krijime individuale me funksion stilistik, përdorime metaforike apo ironike të fjalëve ekzistuese, si edhe me forma që lidhen me gabime drejtshkrimore. Për këtë arsye, identifikimi i neologjizmave nuk mund të mbështetet vetëm në perceptimin intuitiv, por kërkon verifikim të përdorimit në burime të shkruara dhe digjitale, si edhe analizë të kujdesshme të kontekstit, frekuencës dhe shkallës së përhapjes së njësive të reja.

Gjatë viteve të fundit, për monitorimin sistematik të neologjizmave po përdoren gjithnjë e më shumë metoda automatike dhe modele të inteligjencës artificiale, të cilat analizojnë frekuencën, bashkëlidhjet leksikore, devijimet morfologjike dhe mungesën e njësive në fjalorë ose në programe korrigjimi drejtshkrimor. Megjithatë, edhe këto metoda kanë kufizime të rëndësishme, sepse mungesa e ndjeshmërisë semantike bën që sistemet automatike të identifikojnë ose të gjenerojnë forma morfologjike të rregullta, por pa

përdorim real në praktikën gjuhësore. Po kështu, edhe në gjuhët me korpuse të pasura, veglat automatike hasin vështirësi në dallimin ndërmjet fjalëve të reja dhe gabimeve drejtshkrimore, në identifikimin e njësive shumëfjalëshe, si edhe në interpretimin stilistik dhe pragmatik të përdorimit. Megjithatë, përvoja ndërkombëtare ka treguar se dokumentimi dhe analizimi i neologjizmave mund të mbështetet me sukses në bashkëpunimin ndërdisiplinor dhe në përdorimin e teknologjive të përparuara të përpunimit të gjuhës natyrore. Për këtë arsye, në shumë vende janë zhvilluar projekte njëgjuhëshe¹ dhe shumëgjuhëshe² që synojnë vëzhgimin sistematik të njësive të reja leksikore dhe ndihmojnë procesin e dokumentimit dhe standardizimit të tyre. Ajo çka vihet re nga arritjet e këtyre projekteve, të cilët janë në zhvillim e sipër, është se zhvillimi i inteligjencës artificiale dhe përdorimi në rritje i modeleve të mëdha gjuhësore (Large Language Models) kanë sjellë një këndvështrim krejtësisht të ri në studimin e neologjisë.

Krahas krijimit të neologjizmave për nevoja komunikative ose si krijimtari njerëzore, zhvillimet e fundit në inteligjencën artificiale kanë krijuar mundësi edhe për identifikimin dhe gjenerimin automatik të njësive të reja leksikore. Modele të tilla nxjerrin forma të reja që ndjekin rregullat morfologjike dhe semantike të një gjuhe të caktuar, duke ndihmuar në analizën e fjalëve potenciale për neologjizma. Për më tepër, algoritmet e mbështetura në analiza të korpuseve digjitale dhe të përdorimit real të gjuhës ndihmojnë në

¹ Ndër projektet njëgjuhëshe më të njohura janë NEORÉ – Observatoire des néologismes (www.neologismes.org) në Université de Lorraine për frëngjishten, OBNEO – Osservatorio dei neologismi pranë Accademia della Crusca (<https://accademiadellacrusca.it/>) për italishten dhe Observatorio de Neologismos në Universitat Pompeu Fabra (<https://www.upf.edu/en/web/obneo>) për spanjishten, të cilat analizojnë fjalët e reja në media, rrjete sociale dhe diskursin publik. Për gjermanishten, Instituti për Gjuhën Gjermane (IDS) ka ndërtuar Neologismenbank (<https://www.owid.de/docs/neo/start.jsp>), një bazë të dhënash për neologjizmat e gjermanishtes bashkëkohore, ndërsa Oxford English Dictionary (<https://www.oed.com/information/updates/>) dokumenton vazhdimisht njësitë e reja leksikore mbi bazën e korpuseve të anglishtes dhe të përdorimit real të gjuhës.

² Ndër projektet shumëgjuhëshe më të njohura është NEOVEILLE (www.neoveille.org), platformë e zhvilluar nga INALCO (Institut National des Langues et Civilisations Orientales), e cila përdor teknika të përpunimit të gjuhës natyrore (NLP) për identifikimin dhe analizën e neologjizmave në disa gjuhë. Një tjetër nismë është Globalex Neologism Working Group (GLNWG - <https://globalex.link>), grup pune i Global Alliance for Lexicography, që synon zhvillimin e kuadrit metodologjik për studimin ndërkombëtar të fjalëve të reja. Po ashtu, COST Action – ENEOLI (European Network on Lexical Innovation – <https://eneoli.eu/grants/>) përbën një rrjet evropian studiuesish të përqendruar në analizën krahasuese të neologjizmave dhe në zhvillimin e metodave për ndjekjen sistematike të tyre.

identifikimin automatik të njësive të reja leksikore, duke dëshmuar se ndërthurja e gjenerimit dhe e identifikimit automatik të fjalëve të reja është një hap drejt neologjisë së ndihmuar nga AI (Tomaszewska et al. 2025).

3. Neologjizmat dhe planifikimi leksikografik

Planifikimi leksikografik, si pjesë e rëndësishme e planifikimit gjuhësor, lidhet me përzgjedhjen, përshkrimin dhe standardizimin e njësive leksikore. Në këtë proces, një rol të rëndësishëm luajnë institucionet normativizuese me veprat leksikografike, veçanërisht fjalorët shpjegues dhe drejtshkrimorë, të cilët jo vetëm pasqyrojnë përdorimin e gjuhës, por shërbejnë edhe si instrumente të formësimit të normës. Për këtë arsye, në leksikografinë bashkëkohore është thelbësor dallimi ndërmjet qasjes preskriptive dhe asaj deskriptive. Fjalorët normativë synojnë të përcaktojnë formën e saktë të njësive gjuhësore, kuptimet dhe përdorimin e tyre, ndërsa fjalorët deskriptivë dokumentojnë dhe shpjegojnë leksikun ashtu si përdoret realisht, pa vendosur domosdoshmërisht rregulla detyruese. Megjithatë, statusi i fjalorëve shpjegues ndryshon sipas traditave gjuhësore: në disa raste ata kanë funksion të drejtpërdrejtë normativ dhe lidhen me institucione standardizuese, si Académie française ose Accademia della Crusca, ndërsa në traditën bashkëkohore anglofone mbizotëron një qasje më deskriptive, e mbështetur në korpuset dhe në dokumentimin e përdorimit, si në rastin e Oxford University Press apo Merriam-Webster. Edhe kur nuk kanë status zyrtarisht normativ, fjalorët e mëdhenj shpjegues ndikojnë në mënyrë të tërthortë në normë, sepse përdoren si burime reference në arsim, administratë dhe botime shkencore. Në këtë kuptim, pranimi i njësive të reja leksikore mund të mbështetet ose në vendime institucionale dhe në përputhjen me sistemin e gjuhës, ose në frekuencën, përhapjen dhe qëndrueshmërinë e përdorimit. Në praktikë, shumica e fjalorëve bashkëkohorë ndjekin një qasje të ndërmjetme, duke ndikuar në standardizimin e leksikut përmes përzgjedhjes dhe mënyrës së paraqitjes së njësive të reja.

Institucionalizimi leksikografik nuk është një veprim thjesht teknik, por pjesë e planifikimit gjuhësor. Në studimin për terminologjinë, Temmerman (2000, 11–18) e lidh përzgjedhjen dhe trajtimin e tyre me procese standardizuese, me nevojat e komunikimit dhe me faktorë më të gjerë institucionalë. Fjalori nuk kufizohet vetëm në pasqyrimin e përdorimit, por ndikon edhe në formësimin gradual të normës përmes përzgjedhjes së materialit leksikor dhe mënyrës së paraqitjes së tij. Dhe Thomai (2006, 352) e vë në dukje këtë rol të *Fjalorit të gjuhës shqipe*: “Në shumë drejtime ai ka edhe prirje normative ose i ndihmoi mjaft ngulitjes së normës gjuhësore, si në zgjedhjen e fjalëve e të frazeologjisë, në zbërthimin kuptimor, në shpjegimet, në disa vlerësime stilistike dhe, në një shkallë më të madhe, në trajtat gramatikore e në theksin e fjalëve.”

Për përfshirjen ose jo të njësive të reja në burimet normative nevojitet një vlerësim i kujdesshëm, i mbështetur në vëzhgimin e përdorimit dhe në parime të qarta metodologjike. Statusi i tyre nuk është i njëjtë: disa njësi stabilizohen shpejt dhe bëhen pjesë e përdorimit të përgjithshëm, ndërsa të tjera mbeten për një kohë të gjatë në një gjendje të ndërmjetme, me variante të ndryshme formale dhe me shkallë të ndryshme integrimi në sistemin gramatikor dhe stilistik të shqipes. Pikërisht kjo gjendje e ndërmjetme e bën trajtimin e neologjizmave një çështje të rëndësishme për planifikimin leksikografik.

Në kushtet e zhvillimit të korpuseve dhe të teknologjisë gjuhësore, këto kriteret mund të mbështeten gjithnjë e më shumë në të dhëna empirike, që do të mundësonte kalimin nga një vlerësim kryesisht intuitiv në një model më të standardizuar të planifikimit leksikografik.

Ndonëse zbatimi i këtyre kriterëve nuk është gjithmonë i lehtë në kushtet e shqipes, e cila vijon të konsiderohet gjuhë me burime të pakta (Low Resource Language – LRL), zhvillimet e fundit në teknologjinë gjuhësore dhe krijimi i burimeve elektronike po hapin mundësi të reja për analizën e përdorimit real të gjuhës (Kabashi 2018; Kastrati & Biba 2022; Kote et al. 2024; Kote et al. 2025; Çepani & Çerpja 2026), edhe pse ky zhvillim mbetet ende i kufizuar në krahasim me gjuhët me burime të pasura. Prandaj planifikimi leksikografik duhet të shihet si një proces i vazhdueshëm, i mbështetur në ndjekjen sistematike të zhvillimit të leksikut dhe në ndërtimin e burimeve gjuhësore digjitale. Një rol veçanërisht i rëndësishëm në këtë drejtim i takon Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë, i cili, në bashkëpunim me institucione të tjera mund të luajë një rol të rëndësishëm për ndërtimin dhe pasurimin e burimeve gjuhësore digjitale, në veçanti për krijimin e një korpusi shqipes, të strukturuar sipas kriterëve bashkëkohorë. Ky korpus do të mundësonte nxjerrjen të dhënave konkrete për përdorimin e njësive leksikore, përfshirë edhe neologjizmat, si frekuenca, shpërndarja në ligjërime të ndryshme, shkalla e stabilizimit të tyre në përdorim etj.

Frekuenca e përdorimit dhe distribucioni i varianteve të ndryshme në ligjërim mund të shërbejnë si tregues të rëndësishëm për vlerësimin e stabilizimit dhe të institucionalizimit të tyre në sistemin e shqipes.

Për të ilustruar më konkretisht procesin e institucionalizimit në shqipen bashkëkohore, janë kryer disa vëzhgime në korpusin *sqTenTen* (korpus i madh elektronik i shqipes bashkëkohore në platformën Sketch Engine (<https://www.sketchengine.eu/>), i cili përmban tekste nga media online, portale informative, blogje dhe burime të tjera të komunikimit publik në gjuhën shqipe. Analiza është mbështetur në të dhëna korpusore që lidhen me frekuencën e përdorimit, bashkëlidhjet leksikore, shpërndarjen në kontekste të ndryshme ligjërimore dhe stabilitetin e përdorimit të njësive të caktuara leksikore.

Për analizën janë zgjedhur dy shembuj: DIGJITALIZIM si neologjizëm leksikor dhe PROFIL si neologjizëm semantik. Zgjedhja e tyre lidhet me

përhapjen e gjerë në ligjërimin bashkëkohor, praninë në fusha të ndryshme të komunikimit publik dhe mundësinë për të vëzhguar dy mekanizma të ndryshëm të zhvillimit neologjik: krijimin e një njësie të re leksikore dhe zgjerimin semantik të një fjale ekzistuese.

5/14/26, 10:05 AM

Concordance



CQL [tempo="digjitalizim-n"] • 950

1.54 per million tokens • 0.00015%




Details	Left context	KWIC	Right context
1 drejtesia.org	inamenteve fetare dhe kulturore-historike; dhe	digjitalizimi	i institucioneve kulturore.</s><s>Partia angaz
2 oemvp.org	ansimi i gruas sipërmarrëse, modernizimi dhe	digjitalizimi	i proceseve të kompanive me të vetmin mision
3 upt.al	ke udhëhequr pjesëmarrësit në tema të tilla si:	digjitalizimi	i proceseve, menaxhimi i të dhënave, rrjedhat
4 xella.com	sumatorëve në Revit® dhe ArchiCAD.</s><s>	Digjitalizimi	në ndërtim vazhdon të zhvillohet.</s><s>Të d
5 dpshttr.al	mujori i parë i 2020-ës një kthesë historike për	digjitalizimin	, thjeshtimin e kalimin online, pa radhe e pa ar
6 zaman.com.mk	im, tregon hulumtimi në kuadër të projektit për	digjitalizim	tëarsimit i zbatuar në periudhën prej 6 deri më
7 km.gov.al	dit.</s><s>Projekti i tretë i rëndësishëm është	digjitalizimi	i administratës publike, që siç thashe po kalon
8 prpchanel.com	ino - Inxhinier dhe Shef i Observatorit Aidr për	Digjitalizimi	i mjedisit dhe energjisë) Masat e miratuara në
9 vertetmates.mk	rinovueshme të energjisë në objektet publike,	digjitalizimin	e dokumentacionit të planifikimit urban dhe krij
10 respublica.edu...	odhur ato ndryshime themelore që priteshin si	digjitalizimi	i administratës dhe administrimit me procesin
11 biblioteka-ks.o...	e Kombëtare të Kosovës, qëllimi i të cilit është	digjitalizimi	i dokumenteve në letër që janë në fondin e bib
12 biblioteka-ks.o...	rqendrua sidomos në koleksionet digjitale dhe	digjitalizimin	e materialeve të kësaj biblioteke.</s><s>si: ko
13 eurospeak.al	i e Kujdesit Shëndetësor Digital synon të risë	digjitalizimin	e sektorëve të shëndetësisë.</s><s>Komuniki
14 dw.com	ku midis tregut të punës dhe imignimit</s><s>	Digjitalizimi	kërkon punëtorë të kualifikuar, por në tregun e
15 dw.com	ë Gjermani nuk është i përgatitur sa duhet për	digjitalizimin	.</s><s>Ky është në thelb mesazhi i studimit t
16 dw.com	it të Fondacioni Bertelsmann "Imigracioni dhe	digjitalizimi	", i cili sapo është publikuar.</s><s>Aty thuhet

Fjala *digjitalizim*, e cila është përfshirë në *Fjalorin e madh të gjuhës shqipe* të vitit 2026 (<https://fjalori.online/?search=digjitalizim&mode=exact>), përfaqëson një shembull tipik të një njësie leksikore që ka kaluar gradualisht drejt institucionalizimit në gjuhën standarde. Frekuenca e lartë e përdorimit të saj në ligjërimin administrativ, teknologjik, mediatik dhe arsimor, si edhe përhapja në kontekste të ndryshme tregojnë se kjo njësi tashmë është element i stabilizuar i leksikut bashkëkohor. Drejtshkrimi i formës *digjitalizim* dhe jo *dixhitalizim* mbështetet jo vetëm në zbatimin e rregullës drejtshkrimore të shqipes për huazime të tilla (Kostallari 1973, &36), por edhe në përdorimin real të dokumentuar në korpus. E njëjta prirje vërehet në gjithë çerdhen e fjalës, që nga tema *digjital* te fjalët e prejardhura *digjitalizoj*, *digjitalizim*, *i digjitalizuar*,

ku variantet me temën *digjital*- dalin dukshëm më të shpeshta dhe më të stabilizuara në ligjërime se variantet me temën *dixhital*-.

Të dhënat nga Sketch Engine tregojnë gjithashtu një rrjet të gjerë bashkëlidhesh leksikore, si *digjitalizimi i transmetimeve*, *digjitalizimi i imazheve*, *digjitalizimi i arkivave*, *digjitalizimi i arsimit*, *digjitalizimi i dokumentacionit*, *digjitalizimi i shërbimeve*, *digjitalizimi i bibliotekave*, *digjitalizimi i teksteve*, *digjitalizimi i sistemit bankar*, *digjitalizimi i plotë*, *digjitalizim i tërësishëm* etj., çka dëshmon integrimin e saj në fusha të ndryshme tematike dhe aftësinë për t'u bërë pjesë e strukturave të qëndrueshme të ligjërimit.

Nga të dhënat e nxjerra prej korpusit të shqipes në Sketch Engine për fjalën *profil* shihet se përdorimet më të shpeshta në shqipen e sotme nuk lidhen me tri kuptimet e pasqyruara në fjalorë të shqipes ("Pamja e fytyrës së një njeriu ...", "Paraqitja e një sipërfaqeje, e një sendi ...", "Drejtimi kryesor i veprimtarisë së dikuajt ...", por me informacionin, përmbajtjen dhe paraqitjen



digjitale të dikuajt apo të diçkaje në internet, kryesisht përmes platformave në ueb dhe aplikacioneve të rrjeteve sociale, një kuptim që duhet plotësuar. Fjala *profil* shfaqet në bashkëlidhje të shpeshta me njësi si *Facebook*, *Instagram*, *postim*, *rrjet*, *status*, *foto*, *zyrtar*, *personal* etj., çka dëshmon zgjerimin e kuptimit të saj drejt një përdorimi të ri semantik të lidhur me

komunikimin digjital. Në këtë rast kemi të bëjmë me një neologjizëm semantik, pasi fjala *profil*, e përdorur më herët në kuptime të tjera të njohura në gjuhën shqipe dhe të pasqyruara në burimet leksikografike, ka fituar një kuptim të ri të specializuar në kontekstin e teknologjisë dhe të rrjeteve sociale. Përhapja e gjerë e këtij përdorimi në ligjërimitin mediatik, institucional dhe të përditshëm tregon se ky kuptim i ri është tashmë i stabilizuar dhe i integruar në leksikun aktiv të shqipes bashkëkohore. Pikërisht frekuenca, distribucioni dhe konsolidimi i këtij përdorimi tregojnë se ky zhvillim semantik e motivon përfshirjen e këtij kuptimi në fjalorët bashkëkohorë të shqipes. Për më tepër, të dhënat korpusore sugjerojnë se ky kuptim nuk mund të trajtohet si përdorim

periferik ose dytësor, por duhet të marrë një vend më të dukshëm edhe në renditjen e kuptimeve të fjalës *profil*.

Këto raste tregojnë se korpuset elektronike mund të shërbejnë si një ndër mjetet më të rëndësishme për vlerësimin e stabilizimit dhe institucionalizimit të neologjizmave, duke ofruar të dhëna konkrete mbi frekuencën, shpërndarjen dhe përdorimin e tyre në ligjërimi të ndryshme, si edhe duke ndihmuar orientimin e praktikës leksikografike dhe drejtshkrimore drejt një modeli më të mbështetur në të dhëna empirike.

4. Zhvillimi historik i leksikut të gjuhës shqipe

Pasurimi i leksikut përmes krijimeve të reja dhe huazimeve nuk është një dukuri e veçantë e periudhës së sotme, por një proces i vazhdueshëm në historinë e gjuhës shqipe. Në këtë proces, neologjizmat kanë luajtur një rol të rëndësishëm si mjete për emërtimin e realiteteve të reja dhe për zgjerimin e funksioneve të shqipes në fusha të ndryshme të dijeve dhe komunikimit, ndërsa stabilizimi i tyre ka qenë i lidhur me përdorimin dhe me zhvillimin e normës gjuhësore. Që nga periudha e autorëve të vjetër, në vijim me rilindësit e deri në kohët moderne, shqipja është pasuruar përmes formimit të brendshëm të fjalëve, kalkimit dhe huazimit.

Në periudhën e shkrimeve të vjetra (shek. XVI–XVII), autorë si Buzuku, Budi, Bardhi e Bogdani u përpoqën të ruanin pastërtinë e gjuhës dhe të rigjallëronin njësi leksikore të hershme ose me përdorim dialektor. Krahas huazimeve nga latinishtja, greqishtja, sllavishtja e turqishtja, ata krijuan edhe shumë neologjizma me brumin e shqipes. Edhe pse një pjesë e këtyre krijimeve nuk gjetën përdorim të gjerë, ato dëshmojnë potencialin krijues të shqipes dhe pasurinë e mjeteve të saj fjalëformuese³.

Në shekullin XIX, gjatë Rilindjes Kombëtare, puna për zhvillimin e shqipes dhe përhapjen e shkrimit shqip u lidh ngushtë me ruajtjen e identitetit kombëtar dhe kulturor. Në këtë periudhë u shtuan neologjizma dhe terma të rinj, si përmes rikuptimësimit të fjalëve ekzistuese, ashtu edhe përmes formimeve të reja sipas modeleve të shqipes. Siç vëren Ashta (1990, 114), rilindësit u përpoqën jo vetëm të krijonin fjalë të reja, por edhe të rikthenin në përdorim krijime të autorëve të vjetër, ndërsa Lafe (1995, 55) thekson se në shtypin dhe botimet e Rilindjes vihet re një punë e dendur neologjike.

Në shekullin XX, krahas ndikimeve të reja nga gjuhët perëndimore, vijuan përpjekjet për pastrimin e leksikut nga huazimet e panevojshme dhe për krijimin e njësive të reja me mjetet e shqipes. Kontribute të rëndësishme në këtë drejtim dhanë figura si A. Xhuvani, me krijime si *ndërgjegje*, *vetëdije*,

³ Për më shumë shih: Anila Omari, *Studime rreth shqipes së vjetër (shek. XV–XVIII)*. (Tiranë, Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, 2022).

sasi, cilësi etj. (Vehbiu 1986, 54), si edhe shkrimtarë të ndryshëm, ndër të cilët veçohen F. Konica dhe I. Kadareja (Dodibiba 1991; Lafe 1995; Lloshi 2005, 55). Konsolidimi i normës së shqipes në gjysmën e dytë të shekullit XX u shoqërua me përpjekje të mëdha për fjalët e reja, që kulmuan me botimin e *Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe* më 1980, në hyrjen e të cilit shprehet qartë orientimi zyrtar i kohës ndaj fjalëve të huaja dhe neologjizmave: “Zëvendësimi i fjalëve të huaja kryhet ose duke përshtatur kuptimisht fjalë që janë në gjuhën e popullit, ose duke krijuar fjalë të reja nga brumi i shqipes” (FGJSSH, 1980). Në këtë kontekst, neologjizmat trajtoheshin si mjet për pastrimin e gjuhës nga huazimet dhe për përfaqësimin e realiteteve të reja.

Pas viteve 1990, me rritjen e komunikimit global dhe të ndikimit të anglishtes, ritmi i hyrjes së fjalëve të reja në shqipe u rrit ndjeshëm, sidomos në teknologji, marketing, media dhe kulturë. Siç vëren Thomai (2006, 268), krahas termave të nevojshëm për emërtimin e realiteteve të reja, u shtuan edhe huazime të panevojshme, të lidhura shpesh me prestigjin social dhe me përdorimin publik të gjuhës. Në këto kushte, çështja e institucionalizimit dhe e trajtimit leksikografik të neologjizmave merr një rëndësi të veçantë për shqipen bashkëkohore.

5. Neologjizmat në gjuhën shqipe

Procesi i institucionalizimit të neologjizmave në gjuhën shqipe ka qenë i lidhur ngushtë me përpjekjet për standardizimin dhe pasurimin e leksikut në përputhje me zhvillimet shoqërore, shkencore dhe kulturore. Në praktikën leksikografike shqiptare, përfshirja e njësive të reja në fjalorë, veçanërisht në ata shpjegues është mbështetur kryesisht në stabilizimin e tyre paraprak në përdorim. Një nga mjetet kryesore për institucionalizimin e fjalëve të reja është përfshirja e tyre në fjalorët shpjegues dhe terminologjikë të gjuhës shqipe. Vehbiu ka përmbledhur disa mjete e mënyra që kanë dhënë një ndihmesë në vitet ‘80-‘90 në mënyrë që neologjizmi të gjente vend në rrethana sa më të larmishme ligjërimore, siç janë: artikujt e rubrikat e revistës “Gjuha jonë”, rubrikat e hapura në faqet e shtypit të përditshëm nga “Shërbimi i këshillimeve gjuhësore”, zgjidhjet e dhëna në “Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe” (1980) dhe në “Fjalorin e shqipes së sotme” (1984) etj. (Vehbiu 1986, 59).

Botimi i *Fjalorit të gjuhës shqipe* (1980) shënoi një hap të rëndësishëm në drejtim të kodifikimit të fjalëve dhe të kuptimeve të reja që kishin hyrë në përdorim gjatë dekadave të mëparshme. Puna leksikografike gjatë kësaj periudhe orientohet nga synimi për të ruajtur “pastërtinë gjuhësore” dhe për të zëvendësuar sa më shumë huazime me forma vendëse. Në këtë pasurim të leksikut një rol të veçantë kanë luajtur termat dhe zgjerimi i terminologjisë së specializuar. Siç vëren Duro (2009, 96), “me zgjerimin e vëllimit të fjalorit, si p.sh. në një fjalor të tipit të mesëm, siç është ‘Fj. 1980’, shtohet numri i kuptimeve dhe i koncepteve të shprehura nga terma të veçuar ..., si edhe

zbërthehen më me hollësi kuptimet e konceptet speciale në strukturën semantike të fjalës.”

Periodha pas viteve 2000 përkon me një intensitet zhvillimi politik, administrativ, kulturor dhe tekniko-shkencor, si dhe ndikimi të vazhdueshëm veçanërisht nga anglishtja. Por për shqipen ka munguar një mënyrë ndëraktive që të mundësonte ndjekjen sistematike të prurjeve të reja leksikore në diskurse të ndryshme, që ka çuar në krijimin e një hendeku ndërmjet gjuhës në përdorim dhe asaj të përfshirë në burimet zyrtare normuese.

Në fillim të vitit 2026 u publikua në formë elektronike *Fjalori i madh i gjuhës shqipe* (projekt i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë). Autorët e konsiderojnë këtë fjalor “... si një ‘arkiv’ përherë të hapur për shfrytëzim ...”, puna për hartimin e të cilit është mbështetur në “parimet leksikografike të traditës dhe ato bashkëkohore, vendëse e ndërkombëtare, për fjalorët e tipit të madh, shpjegues, të përgjithshëm e normativ” (<https://fjalori.online/parathenie#parathenie>). Sipas autorëve, përfshirja e fjalëve dhe e kuptimeve të reja në këtë fjalor është mbështetur në parimet e neologjisë leksiko-semantike, si përmes krijimit të njësive të reja me mjetet e brendshme të shqipes, ashtu edhe përmes zgjerimit dhe zhvillimit të kuptimeve leksikore sipas modeleve fjalëformuese dhe semantike të gjuhës shqipe.

Vendosja e kriterëve të qarta për përfshirjen e neologjizmave në burimet normative është thelbësore për një trajtim të qëndrueshëm dhe sistematik të tyre. Një pjesë e njësive të reja leksikore që krijohen në një gjuhë arrijnë të konsolidohen dhe të fitojnë statusin e një lekseme të pranuar, ndërsa shumë prej tyre mbeten të kufizuara, përdoren për një periudhë të shkurtër dhe më pas zhduken nga përdorimi. Në gjuhën e sotme shqipe ka plot raste neologjizmesh që nga një status fillestar i pasigurt kanë kaluar me sukses procesin e leksikalizimit, duke u konsoliduar si njësi të qëndrueshme në përdorimin gjuhësor. Por institucionalizimi nuk është i vetmi faktor që përcakton suksesin e një njësie të re leksikore. Funksionaliteti komunikativ, denduria e përdorimit, ekspresiviteti dhe aftësitë e saj për t’iu përshtatur nevojave të reja të gjuhës janë elemente thelbësore për mbijetesën dhe përhapjen e një fjale të re.

Burimet e neologjizmave në gjuhën shqipe janë të shumta e të larmishme dhe një nga më të zakonshmit është huazimi nga gjuhët e huaja, veçanërisht nga anglishtja, për shkak të mbizotërimit të padiskutueshëm e global të kësaj gjuhe në teknologji dhe media. Neologjizmat mund të lindin gjithashtu nëpërmjet krijimtarisë letrare si krijime të brendshme gjuhësore, përmes gjedheve të njohura e produktive fjalëformuese të shqipes, ndonjëherë dhe nga autorë të veçantë e me status të mirëpranuar nga shoqëria (p.sh. *përditësim*, *floknajë*, *ikës*, *penglënës* etj.), po kështu dhe kalket e ndryshme (p.sh. *hekurudhë*, *vetëpunësim*, *motor kërkimi* etj.). Një tjetër burim i rëndësishëm janë institucionet që kanë objekt të punës terminologjinë, të cilat krijojnë njësi të reja për të përkthyer ose standardizuar koncepte të reja (p.sh. *kartëmonedhë*, *ndërfaqe*).

Ashtu si në literaturën e huaj gjuhësore (Jamet and Terry 2018), edhe në atë shqiptare, studiuesit kanë dalluar procesin e krijimit të fjalëve të reja nga ai i lindjes së kuptimeve të reja (Thomai 1999, 89), dallim që pasqyrohet në neologjizmat leksikorë dhe në ata semantikë. Neologjizmat leksikorë janë njësi tërësisht të reja si në formë, ashtu edhe në përmbajtje, të krijuara përmes mënyrave të zakonshme të fjalëformimit, si derivimi, përbërja ose përngjitja, për të plotësuar hapësira semantike në gjuhë; p.sh. janë *lejeqëndrim*, *dakordësi* etj. Krahas tyre, një vend të rëndësishëm zënë neologjizmat semantikë, fjalë ekzistuese që pësojnë ndryshime kuptimore, shpesh i zgjerojnë me kuptime të reja, pa e ndryshuar formën e tyre, zakonisht përmes procesit të polisemisë. Ky proces shpesh bazohet në shtrirjen metaforike, metonimike apo në riemërtime funksionale të fjalëve. Për shembull, fjala *mur* në gjuhën e rrjeteve sociale nuk i referohet më një strukture ndarëse fizike, por një hapësire digjitale ku postohen përmbajtje personale (në *Facebook*). Po ashtu, *ndjekës* ka kaluar nga kuptimi tradicional i një personi që ndjek fizikisht dikë, në një tregues të numrit të personave që ndjekin llogaritë në platformat *online*.

Një nga kriteret kryesore për kategorizimin e neologjizmave lidhet pikërisht me shkallën e qëndrueshmërisë së tyre në përdorim dhe me aftësinë për t'u integruar në sistemin leksikor të gjuhës. Në këtë kuptim, dallohen neologjizma të qëndrueshëm, të cilët arrijnë të hyjnë në përdorim të përgjithshëm, të bëhen pjesë e leksikut bazë dhe të përfshihen në fjalorët normativë. Vehbiu (1986, 54) ka sjellë disa shembuj neologjizmash të përfshirë në *FGJSSH* 1980, të cilët kanë qenë neologjizma të suksesshëm dhe nuk mund të quhen më të tillë: *ndërthur* për *kombinoj*, *asnjanës* për *neutral*, *pushtim* për *okupacion*, *ngurroj* për *hezitoj*, *i skajshëm* për *ekstrem*, *risi* për *novacion*, *përmendore* për *monument*, *gojëtar* për *orator*, *padituri* për *inJORANCË*, *pamjaftueshmëri* për *insuficiencë*, *ndërresë* për *turn*, *përligj* për *justifikoj*, *miratoj* për *aprovoj*, *shmang* për *evitoj*, *përzgjedh* për *seleksionoj*, *përfundimtar* për *final*, *i përhershëm* për *permanent*, *i përkohshëm* për *provizor*, *përkufizim* për *definicion* etj.

Një grup tjetër janë neologjizmat e stilit të kufizuar, të cilët lindin në ligjërimin individual të autorëve të caktuar dhe mbeten të lidhur me kontekstin krijues ku janë formuar. Këta përdoren kryesisht si mjete stilistike dhe janë karakteristike për gjuhën e letërsisë artistike, si p.sh. fjalët *mosdashuri*, *zhurmëri*, *zymtan* etj. të krijuara nga Kadareja. Ndërkaq, një kategori tjetër përbëhet nga neologjizmat “e dështuar”, pra fjalë të reja që, megjithëse mund të jenë morfologjikisht të rregullta, mbeten përdorime të izoluara, nuk arrijnë të përvetësohen nga folësit dhe dalin nga përdorimi, si *dheshkronjë* për *gjeografi* etj. (Lloshi 2001, 55).

6. Planifikimi leksikografik i neologjizmave në gjuhën shqipe

Përballë ritmit të shpejtë të zhvillimeve teknologjike, shkencore dhe kulturore, shqipja përballët me nevojën për ndjekjen dhe vlerësimin sistematik të njësive të reja leksikore. Ndryshe nga shumë gjuhë evropiane që mbështeten në gjurmime sistematike dhe baza të dhënash të specializuara për neologjizmat, shqipja ende nuk ka një strukturë të qëndrueshme institucionale për dokumentimin dhe trajtimin e tyre. Në këto kushte, planifikimi leksikografik mund të shihet si një proces i vazhdueshëm, i lidhur me monitorimin e zhvillimeve të leksikut dhe me përfshirjen graduale të njësive të reja në burimet normative. Roli i institucioneve shkencore dhe i bashkëpunimit ndërmjet gjuhëtarëve, terminologëve dhe specialistëve të fushave të ndryshme, krijimi i strukturave të specializuara dhe zhvillimi i korpuseve dhe i burimeve digjitale për analizën e përdorimit të gjuhës janë të rëndësishme për ndërtimin e një sistemi leksikor të qëndrueshëm.

Duke u mbështetur në përvojën e gjuhëve të tjera, edhe për shqipen do të ishte i dobishëm krijimi i strukturave të përhershme ndër-institucionale që ndjekin zhvillimet leksikore dhe propozojnë trajtimet e duhura për njësitë e reja. Një nismë e tillë do të kërkonte jo vetëm vijimin e punës së pavarur që kryejnë institucionet shkencore dhe akademike në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut, por edhe bashkërendimin sistematik të veprimtarisë së tyre në fushën e leksikografisë, terminologjisë dhe planifikimit gjuhësor. Paralelisht me këtë mund të ndërtohet një platformë digjitale, ku përkthyesit, gazetarët, redaktorët, mësuesit, specialistët e profesioneve të ndryshme dhe përdoruesit e zakonshëm të mund të sugjerojnë, diskutojnë dhe vlerësojnë njësi të reja leksikore nën mbikëqyrjen e institucioneve gjuhësore. Integrimi i këtyre kontributeve do të krijonte kushte për një sistem më të qëndrueshëm të dokumentimit, vlerësimit dhe përfshirjes së fjalëve të reja në gjuhën standarde.

Një rol të rëndësishëm ka edhe ngritja e një korpusi kombëtar të gjuhës shqipe me tekste nga media, rrjetet sociale, botime shkencore, letërsi, ligjërime politik, përkthime dhe komunikim të përditshëm. Një korpus i tillë, i hapur për kërkuesit, i përditësuar rregullisht dhe i ndërtuar sipas standardeve bashkëkohore të anotimit morfosintaktik dhe semantik, do të shërbente si bazë empirike për identifikimin dhe monitorimin e neologjizmave në përdorim. Në këtë drejtim, përdorimi i metodave të përparuara të përpunimit të gjuhës natyrore (NLP) dhe i modeleve të mësimi të makinës do të mundësonte identifikimin dhe analizën automatike të njësive të reja leksikore mbi bazën e frekuencës, kontekstit të përdorimit dhe shmangieje nga normat ekzistuese.

Përfshirja e shqipes në projekte ndërkombëtare për studimin e neologjizmave do të mundësonte përfitimin nga praktikatat më të mira dhe pjesëmarrjen në analiza krahasuese ndërgjuhësore. Kjo do të kërkonte

përgatitjen e burimeve digjitale në formate të përputhshme me standardet ndërkombëtare, përkthimin e dokumentacionit të nevojshëm dhe angazhimin e studiuesve shqiptarë në nisma terminologjike dhe leksikografike ndërkombëtare. Në të njëjtën kohë, do të ishte i dobishëm dhe publikimi periodik i një fjalori të fjalëve të reja në gjuhën shqipe, si pasqyrim i zhvillimeve bashkëkohore të leksikut dhe si instrument referimi. Njësi të tilla mund të shoqëroheshin me të dhëna mbi dokumentimin në tekstet bashkëkohore, kuptimin, burimin dhe statusin e përdorimit të tyre.

Këto mund të kontribuonin për zhvillimin e shqipes në epokën digjitale, duke krijuar kushte për një monitorim më të qëndrueshëm dhe më sistematik të zhvillimeve leksikore. Kjo qasje do të ndihmonte jo vetëm në dokumentimin dhe standardizimin e njësive të reja, por edhe në ndërtimin e një baze të dhënash dinamike për risitë leksikore, e cila do të mbështeste përzgjedhjen dhe vlerësimin shkencor të njësive potencialisht të qëndrueshme në përdorim.

Sfidat që lidhen me identifikimin dhe trajtimin e neologjizmave nuk varen vetëm nga vetë fjalët e reja, por edhe nga mënyra sesi një gjuhë organizon mekanizmat për t'i dokumentuar, vlerësuar dhe integruar ato në burimet leksikografike dhe normative të shqipes.

7. Përfundime

Ky punim synon të tregojë se neologjizmat janë një nga treguesit më të dukshëm të zhvillimit të gjuhës dhe të përshtatjes së saj ndaj ndryshimeve shoqërore, teknologjike dhe kulturore. Në gjuhën shqipe, procesi i krijimit dhe i përhapjes së njësive të reja leksikore është i vazhdueshëm, por ritmi i zhvillimeve bashkëkohore, sidomos nën ndikimin e teknologjisë digjitale dhe të anglishtes, e bën sot këtë proces shumë më të shpejtë dhe më kompleks. Në këto kushte, trajtimi i neologjizmave nuk kufizohet vetëm në përshkrimin e tyre si dukuri leksikore, por lidhet drejtpërdrejt edhe me planifikimin leksikografik dhe me mënyrën sesi burimet normative pasqyrojnë zhvillimet reale të gjuhës.

Analiza teorike tregon se statusi i neologjizmave përcaktohet jo vetëm nga risia formale ose semantike, por edhe nga shkalla e përdorimit, përhapjes dhe integritetit të tyre në sistemin gjuhësor. Modelet teorike të trajtuara në punim e shpjegojnë institucionalizimin si një proces gradual, që lidhet me përdorimin e përsëritur, stabilizimin e formës dhe të kuptimit, si edhe me pranimin e njësisë nga komuniteti gjuhësor dhe nga burimet normative. Në këtë kuptim, institucionalizimi nuk është vetëm çështje e vendimeve leksikografike, por rezultat i ndërveprimit të përdorimit real me mekanizmat e standardizimit.

Vëzhgimet e kryera në korpusin *sqTenTen* tregojnë se të dhënat korpusore mund të ofrojnë tregues të rëndësishëm për vlerësimin e stabilizimit të neologjizmave dhe të varianteve të tyre. Shembulli i fjalës *digjitalizim* dëshmon se frekuenca e lartë e përdorimit, përhapja në fusha të ndryshme ligjërimore dhe konsolidimi i një forme të caktuar drejtshkrimore mund të

shërbejnë si argumente të rëndësishme për institucionalizimin leksikografik të saj. Nga ana tjetër, analiza e fjalës *profil* tregon se ndryshimet semantike mund të jenë po aq të rëndësishme sa krijimi i njësive të reja leksikore, duke nxjerrë në pah nevojën për përditësimin e kuptimeve dhe të renditjes së tyre në fjalorët bashkëkohorë të shqipes. Këto raste dëshmojnë se korpuset elektronike mund të ndihmojnë jo vetëm në identifikimin e njësive të reja, por edhe në vlerësimin e statusit të tyre në përdorim.

Punimi evidenton gjithashtu se, ndryshe nga shumë gjuhë evropiane, shqipja ende nuk ka struktura të qëndrueshme për monitorimin sistematik të neologjizmave dhe për mbështetjen empirike të vendimeve leksikografike. Për këtë arsye, zhvillimi i korpusëve kombëtare, ndërtimi i platformave për dokumentimin e njësive të reja dhe përdorimi i metodave të përpunimit të gjuhës natyrore paraqiten si hapa të rëndësishëm për trajtimin më sistematik të zhvillimeve leksikore. Përvoja e projekteve ndërkombëtare tregon se ndërthurja e analizës gjuhësore me teknologjinë krijon mundësi të reja për ndjekjen dhe vlerësimin e neologjizmave edhe në gjuhë me burime më të kufizuara, si shqipja.

Në tërësi, studimi nxjerr në pah nevojën që planifikimi leksikografik në gjuhën shqipe të mbështetet më shumë në të dhëna empirike dhe në vëzhgimin sistematik të përdorimit real të gjuhës. Një qasje e tillë mundëson dokumentimin më të qëndrueshëm të zhvillimeve leksikore dhe krijon kushte për përfshirjen më të argumentuar të njësive të reja në burimet normative të shqipes.

Bibliografi

- Ashta, Kostandin. 1990. "Neologjizmat e Kostandin Kristoforidhit". *Studime Filologjike*, 44(27)/1990, nr. 2, 113–142. Tiranë: Akademia e Shkencave.
Tekst f. 222-223 (dorëshkrim)

Shën e 3-m

Beatricë: Oh, t'e serposij njëherë e të qetij.

Baruni: Mos nënk mbrazën gjith, si mund serposinjë, ka t'fjas edhe ka floqeri, ka zjemori... E ashtu!

Tiberi: Sa më shpëlqenë se somenat kam vete të hā mbë tries të Prinçips Qimenqitherit, e dhuronjë i zakonurë me timin trëmirë ziemorë parixhinë, cilit i jap gjashtëmbëdhjet zakine ndë muoj. Dhuronjë! Kam zakon të kem ka dita njëzet e katër talurë të ngrohta e dimbëdhjet mbitriesa. E cado herë më bënë talurë vëljemi shtatë o tet copjesh njerin; dje më suolli mbë not, një talurë njëzet e shtat cop, di tarinje, e trembëdhjet tures.

Baruni: Bu.. shkrehu a nënk shkrehu. Më qëntroi me gjith [tundoren?] ndë stomah e s' do t'vej jo përpara, jo prapa.

Santori era affascinato dal teatro. Una sorta di teatralità è presente in tutta la sua opera. La traduzione della commedia di Cerlone non reca data, come è per quasi tutta la sua opera. È lecito supporre che ne sia rimasto affascinato in età giovanile. L'influenza di questi è evidente nella caratterizzazione e denominazione dei personaggi, nel linguaggio tratto direttamente dai parlanti, nella semplicità della trama, nel messaggio morale che traspare dalla vicenda. Un'analisi filologica e dell'alfabeto del manoscritto potrebbe aiutare alla datazione della traduzione.

Bibliografi

- Adamesteanu, Dinu. 1987. *Magna Grecia. Lo sviluppo politico, sociale ed economico*. Electa Ed.
- Apollonio, Mario. 1930. *Storia della Commedia dell'Arte*. Sansoni.
- Arabia, Francesco Saverio. 1903. *I tempi, la vita, i costumi, gli amici, le prose e poesie scelte di Francesco Saverio: studio sulla Napoli letteraria dal 1820 al 1860*. Le Monnier.
- Armino, Pino Ippolito. *Il fantastico regno delle Due Sicilie. Breve catalogo delle imposture neoborboniche*. Giuseppe Laterza e Figli, Bari.
- Baldry, Harold Caparne. 1971. *I Greci a teatro*. Editori Laterza.
- Barbina, Alfredo. 1989. *Giangurgolo e la Commedia dell'Arte*. Rubbettino Editore.
- Bergson, André. 1961. *Il riso. Saggio sul significato del comico*. A cura di F. Stella. Rizzoli.
- Bianconi, Lorenzo, e Bossa, Renato a c. di. 1983. *Musica e cultura a Napoli dal XV al XIX secolo*. Leo Olschki Editore. Quaderni della Rivista Italiana di Musicologia 9. Leo Olschki.
- Boindin, Nicolas. 1717. *Lettres historiques a Monsieur D. sur la Nouvelle Comedie Italienne - Première lettre*. Chez Pierre Prault.
- Buonaiuti, Serafino. 1806. *Italian Scenery; Representing the Manners, Customs, and Amusements of the Different States of Italy*. Edward Orme.
- Castaldo, Antonin. 1768. «Istoria di Notar Antonino Castaldo, libri quattro, né quali si descrivono gli avvenimenti più memorabili succeduti nel Regno di Napoli sotto il Governo del Vicerè D. Pietro di Toledo, e degli altri Vicerè suoi successori fino al Card. di Granvela. Opera manoscritta, ora

- messa pur in luce la prima volta.» In *Raccolta di tutti i più rinomati scrittori dell'istoria generale del regno di Napoli, principiando dal tempo che queste provincie hanno preso forma di Regno, Tomo VI, Napoli, VI*, a cura di Giovanni Gravier. Nella Stamperia di Giovanni Gravier.
- Cerlone, Francesco. 1826. «Il commediante onorato o sia il Sigismondo». In *Commedie*, VIII. Francesco Masi.
- Cimaglia, Vincenzo Maria. 1810. *Saggi di diverse rappresentazioni teatrali*. Vol. 2. Presso Domenico Sangiacomo.
- Cione, Edmondo. 1944. *Napoli romantica 1830-1848*. Gruppo Editoriale Domus.
- Costantino, Vincenzo. 2003. «Teatro senza scena». In *Teatro in Calabria 1870-1970. Drammaturgia, repertori, compagnie a cura di V. Costantino e C. Fanelli*. Edizioni Monteleone.
- Croce, Benedetto. 1891. *I teatri di Napoli, secolo XV-XVIII*. Presso Luigi Pierro.
- _____. 1899. *Pulcinella e il personaggio del napoletano in commedia, ricerca ed osservazioni*. Ermanno Loescher.
- Dalbono, Carlo Tito. 1865. *Arte letteratura e politica dugento pagine*. S.n.!
- De Gregorio, Giacomo. 1930. *La Grecità del dialetto calabrese*. S.E.
- De Marinis, Errico. 1892. *La società greca sino all'epoca delle guerre persiane studiata dal punto di vista della sociologia nella proprietà, nella famiglia, nelle istituzioni sacerdotali e nella città*. Tipografia di Filinto Cosmi.
- De Rose, Luigi. 2013. *Tradizioni popolari in terra di Calabria*. Nuova Santelli Edizioni.
- De Rosi, Luca. 1838. *Cenno storico della città di Rossano e delle sue nobili famiglie*, Nicola Mosca, Napoli.
- Di Bella, Saverio. 1980. *Eros e Priapo nelle classi subalterne italiane: la Calabria. Materiali per una analisi*. Rubettino Editore.
- Dorsa, Vincenzo. 1884. *La tradizione greco-latina negli usi e credenze della Calabria Citeriore*. Tipografia Municipale di F. Principe.
- _____. 1847. *Su gli albanesi. Ricerche e pensieri*. Dalla Tipografia Trani. Su_gli_Albanesi. Google Books.

- Fanelli, Carlo. 2003. «La cultura teatrale a Cosenza tra Ottocento e Novecento». In *Teatro in Calabria 1870-1970. Drammaturgia, repertori, compagnie a cura di V. Costantino e C. Fanelli*. Edizioni Monteleone.
- Ferrari, Giuseppe. 1978. «L'Albania e la musica liturgica bizantina». *Oriente Cristiano, Palermo* Anno XVIII n. 4: 118–40.
- Furfaro, Amedeo. 2008. *I teatri di Cosenza*. Biblioteca Fonoteca CJC Editore.
- Gerlach, Oliver. 2015. «Il mondo subalterno del Sud. Introduzione alla sua storia musicale sconosciuta». *Palaver 4* Università di Salerno, fasc. n.s. 1: 53–64.
<https://doi.org/10.1285/i22804250v4i1p53>.
- Giordano, Emanuele. 2000. *Fjalor. Dizionario Arbëresh—Italiano, Italiano—Arbëreshë*. Edizioni «Il Coscile».
- Giovanardi, Claudio e Trifone, Pietro. 2015. *La lingua del teatro*. Il Mulino.
- Gravina, Gian Vincenzo. 1731. *Della tragedia. Libro uno*. Nella Stamperia di Felice Mosca.
- Hill, Brian. 1792. *Observations and Remarks in a Journey through Sicily and Calabria in the Year 1791: With a Postscript Containing Some Accounts of the Ceremonies of the Last Holy Week at Rome, and a Short Excurtions to Tivoli*. John Stockdale. *Observations_and_Remarks_in_a_Journey_Th*. Google Books.
- Imbriani, Vittorio. 1866. *Dell'organismo poetico e della poesia popolare italiana*. S.E.
- Inama, Virgilio. 1910. *Il teatro antico greco e romano*. Ulrico Hoepli.
- Kodra, Klara. 2025. *Santori poeta e drammaturgo*. Tradotto da Oreste Parise. Edizioni Alimena - Orizzonti Meridionali.
- Lumini, Apollo. 1888. *Le farse di Carnevale in Calabria e in Sicilia*. Tip. Nicotera.
- Maddaloni, Giovanni. 2013. *La lingua dell'opera teatrale di Francesco Cerlone*. Università degli Studi di Napoli «Federico II».
- Magaudda, Ausilia. 1983. «Feste e cerimonie con musica in Calabria nella prima metà del Settecento». *Musica e Cultura*, n. 9.

- Mandalà, Matteo. 2011. «Për botimin e veprës letrare të Françesk Anton Santorit. Disa probleme ekdotike paraprake». *Hylli i Dritës* XXXI, fasc. 1: 51–78.
- Martirano, Coriolano. 1973. *Il teatro calabrese*. Frama Sud.
- Martorana, Pietro. 1874. *Notizie biografiche e bibliografiche degli scrittori del dialetto napolitano*. Presso Chiurazzi editore.
- Marzano, Giovan Battista. 1928. *Dizionario Etimologico Del Dialetto Calabrese*. Stabilimento Tipografico Il Progresso.
- Masci, Angelo. 1847. *Sull'origine, i costumi e lo stato attuale degli albanesi del Regno di Napoli*. Ristampa a cura di Francesco Masci. Stabilimento Tipografico di Gaetano Nobile.
- Matarrese, Fortunato. 1984. *Croce e la Calabria*. Rubettino Editore.
- Napoli Signorelli, Pietro. 1777. *Storia critica de' teatri antichi et moderni*. Nella Stamperia Simoniana.
- _____. 1786. *Vicende della coltura nelle Due Sicilie o sia storia ragionata della loro legislazione e polizia, delle lettere, del commercio, delle arti e degli spettacoli dalle colonie straniere insino a noi*. Tomo Quinto. Presso Vincenzo Flauto. *Vicende_della_coltura_nelle_due_Sicilie*.
- Padula, Vincenzo. *Antonello capobrigante calabrese: dramma in cinque atti*. s.d. *Padula/antone_p*.
- _____. 1978. «Il Bruzio», *giornale politico-letterario, 1 marzo 1864 - 28 luglio 1865*, *Tipografia Migliaccio, Cosenza*. Arnaldo Forni Editore.
- _____. *Monastero di Sambucina: novella calabrese*. s.d. *Padula/il_mon_p*.
- _____. *Persone in Calabria*. s.d. *Padula/person_p*.
- Palange, Giulio. 1989. *Storia del teatro dialettale calabrese*. MIT.
- Pandolfi, Vito. 1964. *Storia universale del teatro drammatico*. UTET.
- Parise, Oreste. 2025. *Italian translation of the first monograph on Franciscantonio Santori by Klara Kodra*.
- _____. «Sulla monografia “Santori poeta e drammaturgo” di Klara Kodra». s.d.
- Perrucci, Andrea. 1699. *Dell'arte rappresentativa premeditata e all'improvviso*. Nella nuova Stampa di Michele Luigi Mutio.
- Pesce, Anita, e Stazio, Marialuisa. 2013. *La canzone napoletana. Tra memoria e innovazione*. CNR–ISSM.

- Piromalli, Antonio. 2000. *Antologia della letteratura calabrese*. Terza. Luigi Pellegrini Editore.
- _____. 1996. *La letteratura calabrese*. Terza. I-Dalle origini al positivismo. Luigi Pellegrini Editore.
- Proko Jazexhiu, Vilma. 2021. «Bota arbëreshe në të dy fjalorët enciklopedikë të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë». *Revistë e studimeve arbëreshe*, fasc. 1: 138–52.
- _____. 2021. «Santori në dritën e zbulimit e botimit të veprave të reja». *Continuum. Revistë e studimeve arbëreshe* Anno IV-2025, fasc. 4: 53–81.
- Riccoboni, Luigi. 1728. *Histoire du théâtre Italien depuis la decadence de la Comedie Latine; avec un catalogue del Tragedies et Comedie italiennes imprimées depuis l'an 150 jusqu'à l'an 166, et une dissertation sul la Tragedie Moderne*. Chaubert à la Renommée.
- Rocco, Emmanuele. 1859. *Scritti varii di Emmanuele Rocco*. Stab. tip.
- Rodotà, Pietro Pompilio. 1760. *Dell'origine progresso, e stato presente del rito greco in Italia osservato dai greci, monaci basiliani, e albanesi*. Voll. 2-Monaci basiliani. Per Giovanni Generoso Salomoni.
- _____. 1760. *Dell'origine progresso, e stato presente del rito greco in Italia osservato dai greci, monaci basiliani, e albanesi*. Voll. 3-Ortodossi albanesi. Per Giovanni Generoso Salomoni.
- Ruscelli, Girolamo. *Le imprese illustri : con espositioni et discorsi*. In Venetia : Appresso Comina da Trino di Monserrato, 1572.
- Sabbatini, Giovanni. 1864. *Drammi storici e memorie concernenti la storia segreta del teatro italiano contemporaneo*. Vol. I. M. Caffaretti.
- Santori, Francesco Antonio. 2011. *Sofia e Kominiatëve – Editio Princeps, Studio introduttivo di Italo Costante Fortino, Prolegomeni, trascrizione e apparato critico di Merita Sauku-Bruci*. Vol. I. Università degli Studi di Napoli – «L'Orientale», Dipartimento di Studi dell'Europa Orientale.
- _____. 1985. *Tre novelle*. A cura di Italo Costante Fortino, Carmine Stamile, e Ernesto Tocci Brenner.
- Santori, Francesco Paolo. 2014. *La figlia maledetta*. Ediz. critica. A cura di Oreste Parise. Aracne Ed.

- _____. 2021. *Il soldato albanese per l'Impero ottomano del 1420 Il soldato albanese per l'Impero ottomano del 1420 di Francesco Paolo Santori*, a cura di Merita Sauku Bruci, e Oreste Parise. Aracne (Genzano di Roma).
- Sauku Bruci, Merita. 2022. «F. A. Santori mes njohjes e mosnjohjes» in *Franqisk A. Santori dhe trashëgimia gjuhësore e letrare shqipe: aktet e konferencës shkencore ndërkombëtare*. Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë.
- Scerbo, Francesco. 1886. *Sul dialetto calabro. Studio*. Tipografia Coppini e Bocconi.
<https://archive.org/details/ScerboDialettoCalabro>.
- Scherillo, Michele. 1884. *La commedia dell'arte in Italia. Studi e profili*. Ermanno Loescher.
- _____. 1883. *Storia letteraria dell'opera buffa napoletana dalle origini al principio del secolo XIX*. Tipografia e Stereotipia della Regia Università.
- Scialo, Pasquale. 1997. *La canzone napoletana. Dalle origini ai giorni nostri*. Newton Compton Editori.
- Seddio, Pietro. 1998. *La bellezza della morte nel teatro di F. Garcia Lorca*. Edizioni Grafica Anselmi.
- Sharp, Samuel. 1911. *Lettere dall'Italia 1765-1766 : a descrizione di quelli usi e costumi in quelli anni*. Napoli. R. Carabba.
- Sirago, Maria. «Il Sanseverino principi di Bisignano nel Cinquecento e le attività commerciali dei feudi marittimi». *Dialoghi Mediterranei*, fasc. 75 (settembre 2021): 76 e segg.
- Sirri, Raffaele, e De Giacomo Giovanni, a c. di. 1972. *La farchinoria. Eros e magia in Calabria*. De Simone.
- Solano, Francesco. 1977. *Francescantonio Santori e il teatro albanese*. Zëri i Arbëreshvet.
- Sommario, Giuseppe. 2016. «Dalla piazza al palcoscenico: il teatro dialettale in Calabria». *Humanities* Anno V, n° 10: 147–56.
<https://doi.org/10.6092/2240-7715/2016.2.147-156>.
- Stancati, Enzo. 1988. *Cosenza e la sua provincia dall'Unità al Fascismo*. Luigi Pellegrini Editore.
- Storino, Giuseppe. 1898. *La sommossa cosentina del 15 marzo 1844*. Luigi Aprea Editore.
- Tajani, Francesco. 1886. *Le istorie albanesi*. Tipi dei Fratelli Jovane.

- Taviani, Ferdinando. 2009. «Il volo dello sciancato - scene del teatro italiano». In *La Cultura italiana*, volume IX. "Musica, Spettacolo, Fotografia, Design", a cura di Ugo Volli. UTET.
- Teti, Vito. 2003. «Teatro, cultura popolare e letteratura d'élite». In *Teatro in Calabria 1870-1970. Drammaturgia, repertori, compagnie a cura di V. Costantino e C. Fanelli*. Edizioni Monteleone.
- Torraca, Francesco. 1877. *Notizie su la vita e gli scritti di Luigi Settembrini*. Presso A. Morano. Notiziesulavitaef00torruoft. Google Books.
- Trumper, John. 2003. «Volgare, letteratura, teatro: problemi attuali e loro origine storica». In *Costantino V./Fanelli C. (a cura di), Teatro in Calabria 1870-1970. Drammaturgie Repertori Compagnie, Vibo Valentia, Monteleone*,. Monteleone.
- Valentini, Francesco. 1826. *Trattato sulla Commedia dell'Arte, ossia improvvisa. Maschere italiane ed alcune scene del Carnevale di Roma*. Presso Luigi Guglielmo Wittich.
- Valentini, Valentina. 2003. «La regola e le eccezioni del teatro in Calabria». In *Teatro in Calabria 1870-1970. Drammaturgia, repertori, compagnie a cura di V. Costantino e C. Fanelli*. Edizioni Monteleone.
- Vanni Desideri, Andrea. 2018. *Canto, musica e danza nel teatro greco antico*.
- Vittorioso, Domenico. 1997. «Il teatro del Santori». *Quaderni del Dipartimento di Linguistica - Unical, Rende* 14.
- Volpe, Francesco. 1922. *Calabria: storia e cultura (1815–1922)*. Laruffa Editore.

SUMMARY

The Santori Theatre in the context of Calabrian and Neapolitan theatre

Francescantonio Santori experimented with various literary genres, striving to harness the technique, imagination, and lexical and syntactic potential of Arbëresh to provide it with the expressive capacity necessary to formulate ideas, concepts, and constructs in areas far removed from everyday life. This was a constant challenge for him, which allowed for a vibrant use of a humble language in the construction of poems, stories, fables, novels,

comedies, tragedies, and satires. His passion, perhaps, was the theater. He missed the stage, but he sought to compensate for this with the theatricality of his literary productions, which draw inspiration from “Opera Sacra”, the novel in dialogue form, comedy, and melodrama. His best-known work, *Emira*, is a melodramatic tragicomedy with an uplifting finale, featuring music in every scene. His source of inspiration is the folk musical tradition, which he uses to connect with the soul of the Arbëresh community. He even dedicated himself to translating a play by Cerlone, a very popular playwright in Enlightenment Naples, which constitutes an example of literary invention, drawing on the great variety and imagination of Neapolitan lazzari, who employ imaginative jokes and gags in their daily conversations. The challenge is to attempt to reproduce Cerlone's method in the Arbëresh world.

Kristina Jorgaqi

Interesat gjuhësorë të poliedrikut Peter Prifti (1924-2010)*

Përmbledhje

Shkrimi shqyrton interesat gjuhësorë të Peter Priftit (1924-2010) duke i konsideruar ato një anë të rëndësishme të veprimtarisë së tij intelektuale në diasporën shqiptaro-amerikane. Duke u mbështetur në veprën didaktike, publicistike e studimore të Peter Priftit, vihet në pah kontributi i tij për mësimdhënien e shqipes si gjuhë e huaj në SHBA, përgatitjen e teksteve përkatëse për anglishtfolësit, përhapjen e njohurive për shqipen, konsolidimin e studimeve shqiptare në universitetet amerikane si dhe përkrahjen e normës standarde të shqipes. Peter Prifti, përveç se një studiues i historisë dhe kulturës shqiptare, mbetet një promovues shumë i rëndësishëm i ruajtjes dhe njohjes së gjuhës shqipe në diasporë.

Fjalë kyçe: *Peter Prifti, studime për shqipen në SHBA, historia e gjuhës shqipe në SHBA, mësimi i shqipes në diasporë*

Në morinë e interesave kërkimorë të Peter Priftit për Shqipërinë e shqiptarët – ato historike, sociologjike, kulturore, kritiko-letrare, politike etj. – dallohen edhe interesat e tij për shqipen, gjuhën amtare. Ndonëse ai nuk mori një formim akademik në gjuhësi – u diplomua për Arte e Letërsi dhe më pas bëri një master në Filozofi –, e tërë puna e tij reflekton njohje të mirë të çështjeve gjuhësore. Peter Prifti, njësoj si edhe figura të tjera në historinë e kulturës shqiptare në diasporë, i zhvilloi këta interesa krahas ruajtjes shembullore e lëvrimit të pandërprerë të shqipes. Arsimimi i plotë e cilësor në anglisht, në gjuhën e vendit pritës, jo vetëm nuk ia zbehu dashurinë ndaj shqipes, por i nxiti përkushtimin ndaj saj. Nuk mund të ketë qenë rastësi që, fill pas diplomimit në mesin e viteve '50 të shekullit të kaluar, Peter Prifti do të angazhohej në një radio në Filadelfia, – shteti ku ishte vendosur me të atin dhe vëllain më të madh, – si lexues e përgatitës i programeve në gjuhën shqipe të

* Kumtesë e mbajtur në veprimtarinë përkujtimore shkencore *Peter Prifti në 100-vjetorin e lindjes*, organizuar nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Seksioni i Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike në bashkëpunim me Komisionin e përhershëm të Gjuhësisë dhe të Letërsisë, 17 dhjetor, 2025.

destinuara për bashkësinë shqiptare. Shqipja, krahas anglishtes, do të bëhej instrumenti i veprimtarisë së tij të përditshme, kur ai do të niste punë në 1958-n si redaktor i gazetës *Dielli*, tribunë e çështjeve kombëtare shqiptare në Amerikë. Përkthimet dhe publicistika e Priftit, megjithatë, nuk do të kufizoheshin në faqet e *Diellit*. Ato do të vijonin përgjatë gjithë jetës së tij në periodikë të shumtë për të trajtuar tema të rëndësishme mbi Shqipërinë, Kosovën, shqiptarët e shqipen.

Karrierën e mirëfilltë kërkimore Peter Prifti nuk do ta zhvillonte në fushën e gjuhësisë, por në atë të historisë, ku u mor me çështje të zhvillimeve historiko-politike të Shqipërisë dhe Kosovës. Fryt i punës kërkimore që ai kreu përgjatë viteve '60 dhe fillimit të viteve '70, qe monografia *Shqipëria socialiste që prej 1944-ës: Zhvillime të brendshme e të jashtme* (1978) si dhe një numër artikujsh e kapitujsh në vepra studimore në këtë lëmë të botuara në SHBA dhe jashtë tyre. Këtë veprimtari të pasur e cilësore ai e kreu në një nga institucionet shkencore amerikane me më shumë prestigj si MIT (Massachusetts Institute of Technology) në Cambridge, Massachusetts.

Periodha e qëndrimit në MIT për Peter Priftin nuk do të përbëhej, sidoqoftë, vetëm nga punë studimore. Ai do të angazhohej fort edhe për institucionalizimin e studimeve shqiptare në SHBA duke propozuar krijimin e një Katedre të Studimeve Shqiptare në *Boston College*. Për fat të keq, me gjithë përpjekjet e shumta që bëri, nuk ia doli ta realizonte. Ka të ngjarë që, thellë-thellë, ky zhgënjim, por, natyrisht edhe faktorë të tjerë, ta kenë shtyrë Peter Priftin të përfshihej në një ndërmarrje të re lidhur me shqipen, gjuhën e tij të origjinës, po aq të rëndësishme sa ajo për historinë. Kjo ndërmarrje do të përbënte pikërisht kontributin kryesor e më të rëndësishëm të Peter Priftit për shqipen.

Menjëherë pas përfundimit të projektit të tij pranë MIT në fushën e studimeve historike, Peter Prifti nuk vonoi të përfshihej në një tjetër projekt, por këtë herë një projekt i karakterit gjuhësor. Kjo zhvendosje e interesave kërkimorë do të shoqërohej edhe me zhvendosjen e tij fizike: nga MIT në Bregun Lindor të SHBA në Bregun Perëndimor, në skajin tjetër të Amerikës, në Universitetin e Kalifornisë në San Diego. Peter Prifti kishte pranuar të bëhej pjesë e një ekipi, që merrte përsipër hartimin e teksteve për mësimdhënien e shqipes për anglishtfolësit. Projekti zgjati tre vjet (1976-1979) dhe produkti i tij ishte një trilogji, pra, tri tekste për mësimin e shqipes.

Paralelisht me hartimin e teksteve, Peter Prifti u angazhua edhe në mësimdhënien e shqipes në auditor, pasi në Universitetin e Kalifornisë në San Diego, për herë të parë në 1976-n, u hap një kurs i shqipes falë përpjekjeve të Leonard Newmark-ut, profesor i shquar i gjuhësisë në Fakultetin e Gjuhësisë të këtij universiteti, njohës dhe studiues i shqipes, njëherësh bashkautor i teksteve të mësipërme. Këto do ta radhisnin Universitetin e Kalifornisë të San Diegos

krahas Universitetit Kolumbia të Nju Jorkut dhe Universitetit të Çikagos në Illinois, ku mësimdhënia dhe studimi i shqipes kish kohë që kish nisur.

Po çfarë përfaqëson trilogjia e lartpërmendur dhe cili është kontributi i Peter Priftit si bashkautor?

Trilogjia përbëhet nga tri tekste: një tekst a metodë për mësimin e shqipes, *Spoken Albanian* (1980) (Newmark, Leonard, Haznedari, Ismail, Prifti, Peter & Hubbard, Philip, Ithaca, New York, 348 f.); një gramatikë referuese e shqipes, *Standard Albanian. Reference Grammar for Students* (1982) (Newmark, Leonard, Hubbard, Philip, Prifti, Peter Stanford University Press, Stanford, California, 368 f.); dhe një antologji me tekste leximi në gjuhën shqipe, *Readings in Albanian* (1979) (Newmark, Leonard, Prifti, Peter, Hubbard, Philip, Ithaca, New York, 1167 f.). (Nuk e dimë arsyen pse antologjia me tekstet e leximit u botua e para dhe vetëm pas saj panë dritën e botimit metoda e mësimi dhe gramatika e shqipes).

Readings in Albanian (1979), kronologjikisht e para vepër e botuar në kuadër të projektit, përbënte antologjinë e dytë me lexime në gjuhën shqipe të botuar deri atëherë në SHBA, por të parën e atyre përmasave (1167 f.) dhe me atë larmi tekstesh (folklorike, publicistike, letrare, historike, biografike, shkencore etj.), që mbulonin gjithë harkun kohor të shkrimit të shqipes (e para antologji ishte *Reader*, U.S. Army Language School, Monterey, 1950, 183 f.). Vetëm një njohës shumë i mirë i letërsisë shqipe dhe i kulturës shqiptare si Peter Prifti mund të bënte një përzgjedhje aq të goditur sa ç’rezulton të jetë ajo e antologjisë në fjalë. Peter Prifti, megjithatë, nuk bëri vetëm përzgjedhjen e teksteve të leximit, por, siç i pohon biografes së tij Eleni Karamitri në një letër të botuar prej saj, “Unë redaktova të gjithë lëndën shqipe në librat *Shqipja e folur* dhe *Lexime në shqip*, me qëllim që lënda të ishte dakord me kriteret e gjuhës së njësuar letrare...” (Karamitri 1997, 61).

Antologjisë ia ka rritur së tepërmi vlerën ekzistenca e një aparati shkencor, pjesë e të cilit janë: një *gramatikë* e shkurtër referuese (*reference grammar*), që përfshin çështjet themelore të gramatikës shqipe; *ffjalorthët* pas çdo teksti, që ndihmojnë në kuptimin sa më të mirë të tyre; si dhe një *ffjalor invers* i mbaresave të shqipes “si një mjet ndihmës për individët që sapo kanë filluar të lexojnë tekste shqip, për t’u kursyer atyre kohë, që, ndërsa lexojnë, të mos i drejtohen vazhdimisht gramatikës”.

Readings in Albanian ngelet deri më sot, me sa dimë, antologjia më e plotë për përdorim nga të huajt që mësojnë shqipen, e botuar jo vetëm në SHBA, por edhe jashtë tyre.

Një vit pas botimit të antologjisë me pjesë leximi në shqipe doli *Spoken Albanian* (1980), metodë për mësimin e shqipes prej të huajve, kryesisht studentëve, ku Peter Prifti ishte një nga 4 autorët e tij. “...punova si specialist i

gjuhës së folur dhe shqipes idiomatike. Shërbeva si këshilltar për shqiptimin e fjalëve dhe fjalive”, i pohonte ai biografes së tij lidhur me kontributin që kish dhënë aty si bashkautor.

Ndihmesa më e rëndësishme e Priftit në këtë vepër mbetet, sidoqoftë, puna që ai bëri për përdorimin e “gjuhës së njësuar letrare”, çka ndodhte për herë të parë, duke shënuar një kthesë të madhe në historinë e botimit të metodave të mësimin të shqipes në SHBA. Metodën e botuar deri atëherë, por edhe fjalorët dygjuhësh (shqip-anglisht dhe anglisht-shqip), ishin hartuar në dialekt, kryesisht në toskërishte, në vernakularin e hartuesve të tyre (edhe vepra e Newmark-ut *Spoken Albanian* (1954), mbi bazën e të cilit u përgatit kjo metodë, ishte hartuar në toskërisht). Përdorimi i varietetit standard të shqipes në një metodë të mësimdhënies së saj, shumë shpejt pas botimit në Tiranë të tri veprave kodifikuese të shqipes (*Drejtshkrimi i gjuhës shqipe* (1973), *Fjalori drejtshkrimor i gjuhës shqipe* (1976) dhe *Morfologjia* (1976), pjesë e *Fonetika dhe Gramatika e Gjuhës së Sotme Letrare Shqipe*), duhet lexuar pa mëdyshje si një përkrahje publike e vlerësimi i padiskutueshëm për të. Përkrahja dhe mbrojtja e shqipes standarde do të përshkonte gjithë veprimtarinë shkencore, letrare dhe publicistike të Peter Priftit, deri në fund të jetës.

Trilogjia e botimeve për mësimin e shqipes, me Peter Priftin si bashkautor, do të përmbylej me një gramatikë të saj, *Standard Albanian, Reference Grammar for Students* (1982). Libri është në pjesën më të madhe të tij një përkthim nga shqipja në anglishte i veprës *Fonetika dhe Gramatika e Gjuhës së Sotme Letrare Shqipe, Morfologjia* (1976), botim i Akademisë së Shkencave, Institutit të Gjuhësisë e të Letërsisë, i riparë për t’iu përshtatur kërkesave e modelit të një gramatike referuese.

Po ç’ ishte një gramatikë referuese, term i papërdorur deri atëherë nga gjuhëtarët në Shqipëri? Ishte një gramatikë e konceptuar në thelb si një mjet a instrument reference, pra, një vepër për t’u konsultuar për çështje të ndryshme, krejt tjetër nga një gramatikë shkollore apo pedagogjike, e ideuar për t’u lexuar e studiuar nga fillimi në fund e ku përshkruhet në mënyrë të plotë e sistematike struktura gramatikore e një gjuhe. Kujtojmë që një skicë a variant shumë i shkurtër i një gramatike referuese (rreth 20 faqe) ishte botuar si pjesë e aparatit shkencor edhe në antologjinë *Readings in Albanian*, ku përfshiheshin çështje të fonologjisë, morfologjisë, sintaksës e semantikës.

Ç’ mund të thuhet lidhur me kontributin vetjak të Peter Priftit si bashkautor i kësaj gramatike referuese të shqipes standarde?

Referuar fjalëve të tij në komunikimin privat me studiuesen Karamitri, ndihmesa e tij kryesore ka të bëjë me përkthimin: “... puna më e madhe që bëra, ishte si përkthyes. Unë përktheva të gjithë materialin, që gjendet në të tre librat që përpiluam brenda kornizës së projektit. Për këtë punë m’u desh shumë kohë, shumë vëmendje, shumë kujdes”.

Referuar hetimit të hollësishëm të veprës *Standard Albanian*, ndihmesa e tij është më e gjerë. Në kapitullin I të saj, përveç një skice mbi Shqipërinë e shqiptarët të nxjerrë nga libri *Shqipëria socialiste që prej 1944-ës: Zhvillime të brendshme e të jashtme* (1978), ka dhe një nënkapitull mbi gjuhën shqipe: origjinën, historinë, dialektet dhe historikun e “shqipes letrare standarde” (term që del në përdorim që tek antologjia *Readings in Albanian*). Gjasat janë që nënkapitulli të jetë hartuar prej Peter Priftit jo thjesht si folës amtar i shqipes e lëvrues shumë i mirë i saj, por edhe si njohës i thellë i historisë, kulturës, letërsisë dhe botës shqiptare në përgjithësi.

Ajo çka bie në sy e tërheq menjëherë vëmendjen në këtë libër të tretë, është përdorimi që në titull i termit “shqipe standarde” (*standard Albanian*) për atë që asokohe në Shqipëri njihej e cilësohej si “shqipe letrare” (*literary language*). Termi “gjuhë letrare” shpjegohet e saktësohet që në hyrje të veprës si një term i ngushtë, që nënkupton vetëm gjuhën e përdorur për shkrimin e letërsisë, kurse “gjuhë standarde” konsiderohet i duhuri për të emërtuar varietetin e standardizuar të shqipes. Ky përdorim terminologjik ishte i kuptueshëm, po të mbajmë parasysh se në SHBA kishte lindur e po zhvillohej një disiplinë gjuhësore si *sociolinguistika*, por dhe një drejtim shumë i rëndësishëm i saj si *planifikimi gjuhësor*, ku termat *gjuhë standarde* apo *standard-i* kishin zëvendësuar tashmë termin tradicional *gjuhë letrare*. Tre vite më parë (1979), në antologjinë me pjesë leximi shqip, ishte përdorur, megjithatë, një tjetër term, “shqipja letrare standarde” (*standard literary Albanian*), që dukej si një lloj “zgjidhjeje kompromisi”, me qëllim për të mos i rënë krejtësisht ndesh zgjedhjes së gjuhëtarëve në Shqipëri (term që del përsëri te gramatika referuese, por jo në mënyrë sistematike). Kurse në vitin 1995, në shkrimin e tij kritik për veprën e Arshi Pipës *Politika e gjuhës në Shqipërinë socialiste ...* Peter Prifti i kthehet terminologjisë së gjuhëtarëve shqiptarë të para viteve '90 duke e quajtur tashmë “shqipen standarde” “gjuhë e njësuar letrare”. Është e qartë që nuk kemi të bëjmë thjesht dhe vetëm me një zgjedhje e parapëlqim gjuhësor, por me një qëndrim të hapur në mbrojtje të varietetit standard të shqipes.

Krahas saktësimeve terminologjike, në hyrjen e gramatikës referuese paraqitet edhe një skicë e historisë së përpjekjeve për krijimin e një varieteti të përbashkët të shqipes, duke nisur që nga Komisia letrare e Shkodrës. Jepen po ashtu vlerësime për nivelin aktual të standardizimit të shqipes (“është arritur një shkallë e konsiderueshme e normimit drejtshkrimor të shqipes”) si dhe përdorimin e saj në sfera zyrtare e publike (shtypi, shkolla, radioja, teatri etj.) duke arritur në përfundimin e “krijimit të një gjuhe shqipe standarde moderne”.

Përfundimi i projektit të trilogjisë për mësimin e shqipes prej anglishtfolësve nuk shënoi natyrisht fundin e interesave të Peter Priftit për shqipen. Ai do të vijonte të kontribuonte duke shkruar herë pas here recensione

mbi vepra gjuhësore autorësh shqiptarë e të huaj (*Gramatika shqipe* e Camajt, *Basic Albanian Etymologies* e Martin E. Huld, *The Politics of Language in Socialist Albania* e Arshi Pipës, *Prejardhja e shqiptarëve nën dritën e dëshmive të gjuhës shqipe* të Shaban Demirajt etj.), duke dëshmuar në këto shkrime një përgatitje serioze gjuhësore dhe një përkushtim të pandërprerë ndaj shqipes.

Në periudhën e sprasme të jetës kontributi më i rëndësishëm i Peter Priftit do të ishte punimi “Mësimi i gjuhës shqipe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës”, botuar në Shqipëri në dy numra të revistës *Gjuha jonë* (-4,1997, -4,1998). Pjesa e parë e tij është një vështrim i hollësishëm mbi mësimin e gjuhës shqipe brenda vetë bashkësisë shqiptare në SHBA, ku për herë të parë evidentoheshin shtetet e qytetet ku u hapën klasat e mësimin të shqipes, kronologjia e hapjes së tyre, emrat e mësuesve të shqipes si dhe institucionet pranë të cilave u zhvilluan mësimet. Pjesa e dytë i rezervohet njohjes së studimit të shqipes nëpër institucionet amerikane, kryesisht institucione arsimore-shkencore, si universitete e kolegje, por edhe institucione qeveritare, më së shumti institute e shkolla ushtarake dhe të zbulimit të jashtëm. Me shumë interes janë këtu, veç të tjerash, emrat e pedagogëve të shqipes, kryesisht shqiptarë, por edhe ata që u morën me studime rreth saj, shqiptarë dhe amerikanë së bashku.

Pjesë të historikut të shqipes në Amerikë Peter Prifti konsideronte, krahas mësimdhënies e studimit të saj, edhe botimet lidhur me të: fjalorë, tekste mësimore, vepra studimore etj. Për këtë arsye ai e kish parë të nevojshme të bashkëngjiste në fund të punimit për të cilin po flasim, edhe një bibliografi thuajse shteruese të botimeve të mësipërme. Pikërisht të dhënat e kësaj bibliografie duhet të ketë pasur parasysh studiuesi amerikan Victor Friedman kur bënte një përgjithësim interesant se “Para fundit të Luftës së Parë Botërore botimet për gjuhën shqipe në SHBA ishin për mërgimtarët. Midis dy luftave botërore filluan edhe botimet akademike”. “...botimet qeveritare në SHBA fillojnë me Luftën e Dytë Botërore ...” (Friedman 2016, 39).

Peter Prifti, ndonëse nuk u mor posaçërisht e mirëfilli me studime gjuhësore, u angazhua e kontribuoi fort për ruajtjen dhe njohjen e gjuhës shqipe në SHBA, për përhapjen e njohurive mbi historinë e saj të lashtë e të re, si dhe për mbështetjen e përkrahjen koherente të shqipes standarde. Për të gjitha kontributet që dha dhe interesat që tregoi për shqiptarët, shqipen, Shqipërinë e Kosovën, ai do të mbetet modeli i një dijetari serioz, të guximshëm e të përkushtuar, që radhitet denjësisht ndër personalitetet e botës kulturore-shkencore shqiptare të diasporës.

Bibliografi

- Friedman, Victor A. 2016. "Historia e shqipes standarde në Shtetet e Bashkuara", në *Studimet albanistike në Amerikë*, Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës, Prishtinë, 37-48.
- Karamitri, Eleni. 1997. *Peter R. Prifti në botën e dijetarëve shqiptaro-amerikanë*, Universiteti i Shkodrës, Shkodër.
- Newmark, Leonard (1954), *Spoken Albanian*, Bloomington, Indiana (e riprodhuar me mimeograf).
- Newmark, Leonard, Peter Prifti, Philip Hubbard. 1979. *Readings in Albanian*, Ithaca, New York, 1167 f.
- Newmark, Leonard, Ismail Haznedari, Peter Prifti, & Philip Hubbard. 1980. *Spoken Albanian*, Ithaca, New York, 348 f.
- Newmark, Leonard, Philip Hubbard, Peter Prifti. 1982. *Standard Albanian. Reference Grammar for Students*, Stanford University Press, Stanford, California, 368 f.
- Pipa, Arshi. 1989. *The Politics of Language in Socialist Albania*, Columbia University Press, New York.
- Prifti, Peter. 1978. *Socialist Albania Since 1944: Domestic and Foreign Developments*, M.I.T. The Massachusetts Institute of Technology Press, Cambridge, Massachusetts and London, England, 1978, USA, 312 p.
- Prifti, Peter. 1984. "Albanian Grammar (nga Martin Camaj)", në *Albanian Catholic Bulletin*, Santa Clara, Cal., Vol. V, f.36-37.
- Prifti, Peter. 1984. "Basic Albanian Etymologies (nga Martin E. Huld)", në *Albanian Catholic Bulletin*, Santa Clara, Cal., Vol. V, f. 85-86.
- Prifti, Peter. 1995. *Gjuha letrare është organizëm i gjallë (Koment mbi kritikën që i bëhet gjuhës së njësuar letrare nga prof. Arshi Pipa)*, Shtëpia botuese Lilo, Tiranë (Bot. I, "A Commentary on Prof. Pipa's Critique of Unified Literary Albanian", në *South Slav Journal*, London, vol.13, n. 3-4, 1992).
- Prifti, Peter. 1997. "Mësimi i gjuhës shqipe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (I)", në *Gjuha jonë*, nr. 1-4, Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, f. 93-100.
- Prifti, Peter. 1998. "Mësimi i gjuhës shqipe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (II)", në *Gjuha jonë*, nr. 1-4, Akademia e

Shkencave e Republikës së Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, f. 116-127.

Prifti, Peter. 2001. "Prejardhja e shqiptarëve nën dritën e dëshmive të gjuhës shqipe të Shaban Demirajt", në *Zëri i së vërtetës*, Ridgely, New Jersey, dhjetor, f. 1-4.

SUMMARY

The linguistic interests of the polymath Peter Prifti (1924-2010)

The paper explores the linguistic interests of Peter Prifti (1924-2010), presenting them as an important dimension of his intellectual profile. Although he is better known for his writings on Albanian history, culture, and politics, Prifti also showed a strong and lasting commitment to the Albanian language. The paper therefore brings to light a less discussed aspect of his legacy.

Particular attention is given in this paper to his contribution to the teaching of Albanian in the United States. Even if he was not a linguist in the narrow technical sense, he made a substantial contribution to the recognition and transmission of Albanian. His work helped preserve the language among Albanian communities in the United States. At the same time, it introduced Albanian to non-Albanian learners and scholars. Prifti became involved in projects aimed at preparing instructional materials for English-speaking learners of Albanian. In this context, he contributed to three important works: *Spoken Albanian* (1980), *Standard Albanian: A Reference Grammar for Students* (1982), and *Readings in Albanian* (1979). These publications are presented as major tools for the teaching and diffusion of Albanian abroad. The paper underlines Prifti's role not only as co-author, translator, and editor, but also as a promoter of accurate and high-quality language instruction. It also stresses his support for Standard Albanian and his conscious defense of its use in pedagogical and scholarly contexts.

Another important point is his effort to strengthen Albanian studies institutionally in American academic life. The author shows that Prifti viewed language teaching, textbooks, dictionaries, and scholarly publications as essential parts of the history of Albanian in America. For Prifti, Albanian was not only a means of communication, but also a key element of national identity and cultural continuity.

Abdurrahim Maxhuni

Prirje të zhvillimit të terminologjisë shqipe pas Luftës së Dytë Botërore

Përmbledhje

Terminologjia shqipe pas LDB-së mori kahe të duhura shkencore. Jo vetëm se, si çështje mori vëmendje edhe më të madhe nga gjuhëtarë, por edhe u krijuan kushte më të mira për përdhjen e saj. Filluan të botoheshin revista shkencore, në të cilat zinin vend probleme të ndryshme të kësaj fushe, u themelua Instituti i Studimeve (1947), u thellua në çështje teorike, ndërsa pak më vonë u themelua edhe Sektori i Terminologjisë (1955), i cili luajti rol të rëndësishëm në mbledhjen, sistemimin e studimin e termave dhe botimin e tyre në fjalorë terminologjikë. Pothuajse menjëherë pas luftës së dytë, u identifikuan problemet e u caktuan kriteret kryesore të punës me terminologjinë. U hartua fjalori i parë normativ i gjuhës shqipe (1954), ndonëse puna për hartimin e tij kishte filluar shumë më herët, si dhe u botuan një varg fjalorësh terminologjikë. Në këtë punim do të ndalemi te prirjet e zhvillimit të terminologjisë së kësaj kohe.

Fjalë kyçe: *terminologjia e shqipes, prirje zhvillimi, periudha e pasluftës II Botërore, fjalorë terminologjikë, fjalorë normativë, fjalor shpjegues*

Hyrje

Pas Luftës së Dytë Botërore, ndodhën zhvillime të mëdha politike, ekonomike, arsimore, administrative etj. Në këtë kohë filloi edhe botimi i revistave profesionale, me ç'rast kërkoheshin terma të drejtë e të qartë. Botimet e shumta e përktimet nga gjuhë të huaja kërkonin sistemësi e qartësi. Gjatë kësaj kohe u identifikuan problemet me të cilat përballej terminologjia, se si duhet të organizohet e të njësohet ajo, sepse tashmë terminologjia kishte kaluar caqet e njohjes e të përdorimit vetëm të një rrethi të ngushtë dhe ishte përhapur e zgjeruar edhe në rrethe të tjera shoqërore dhe njëkohësisht u shtruan kërkesat e u përcaktuan kriteret kryesore në fushën e terminologjisë. Kriteret që u parashtruan gjatë viteve '50, zunë vend e i përcollën gjatë gjithë rrugës studimet teorike e praktike të terminologjisë, deri në ditët tona. Në rend të parë

terminologjia nuk ishte e qëndrueshme për t'i bërë ballë zhvillimit të madh nëpër të cilin po kalonte shoqëria shqiptare dhe ishte e mbytur me fjalë të huaja, problem që edhe sot e kësaj dite e karakterizon këtë fushë, pastaj ishte mungesa e njësimit të saj, sepse termi përcillej me sinonimi e nuk ndiqte një linjë të përdorimit e të zhvillimit. Vetëm me rastin e themelimit të Institutit të Studimeve, më 1947, filloi interesimi për përpunimin e njësimin e terminologjisë në mënyrë të organizuar. Aleksandër Xhuvanit theksonte mungesën e njësimit të plotë të termave për lëndët e ndryshme shkollore si dhe për degët e administratës, duke bërë thirrje për t'i rishikuar termat e fushave të ndryshme, për t'i ripunuar e për t'i zëvendësuar ata që nuk janë të drejtë, e duke shtruar kërkesën e bashkëpunimit të specialistëve me gjuhëtarë, për të pasur një terminologji sa më të saktë shkencore. Tek detyrat që i kishte vënë vetes Instituti, në referatin e tij, në pikën IX Xhuvani thekson se “*Deri sot nuk kemi një unifikim të plotë të termave të lëndëve të ndryshme shkollore, si edhe t’atyeve që përdoren nëpër degët e ndryshme t’administratës shtetnore. Shumë prej termave që janë caktue në kohët e kalueme dhe janë përdorë nëpër shkollat e nëpër zyrat nuk kanë gjetë pëlqimin e përgjithshëm, se nuk i përgjigjen me të plotë idesë, që asht për t’u shfaqë me këtë a me atë termë. Prandaj është nevoja që të mirren nëpër durr gjithë termat e dishiplinave të ndryshme dhe ato t’administratës të studijohen e të shohiten dhe të zavendësohen me tjera të përshtatshme ose ato që janë të marrin një sanksionim definitiv.*¹ Për këtë punë, parashihej bashkëpunimi me mësimdhënësin e lëndës dhe me zyrën përgjegjëse të administratës, ndërsa realizimi i kësaj pune me terminologjinë të përfundonte në mesin e vitit 1948, të përmbledheshin të gjithë termat e të botoheshin në një broshurë. Në vitin 1949, në Buletin e Institutit të Shkencave u botua një terminologji e shkurtër e matematikës frëngjisht-shqip, me rreth 500 terma, e cila është përpjekja e parë serioze për njësimin e një terminologjie shkollore.² Aty thuhet se po botojmë terminologjinë e lëndëve shkollore, duke filluar me atë të matematikës, andaj “*Seksioni i Gjuhësisë e i letërsisë me anë komisionesh prej profesorësh të posaçëm të çdo lende mësimi i është vù punës së terminologjisë shkollore si edhe asaj administrative qysh në vitin e kaluem. Për caktimin e çdo termi është marrë para sysh përdorimi i maparshëm i tij nëpër shkollat, por aty ku nuk dukej i posaçëm ndonji term është krijuar një tjetër më i përshtatshëm. Termat me origjinë greke, latine, si termat hyperbole, symetrie, aksiome, postulat, etj., që janë bërë, si me thanë ndërkombëtare, janë mbajtur edhe në*

¹ Aleksandër Xhuvani, “Referat i shefit të Seksionit të Gjuhësisë dhe letërsisë”, *Buletin i Institutit të Shkencave*, nr. 1, Tiranë, 1947, f. 40.

² Ferdinand Leka, Sofika Morcka, “Zhvillimi dhe pasurimi i terminologjisë pas çlirimit”, *Studime filologjike*, Tiranë, nr. 4, 1969, f. 85-95. Tiranë: Universiteti Shtetëror i Tiranës, Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë.

*gjuhët tona, por tue i u-përshtatë fonetikës së saj. Gjithashtu janë mbajtur edhe ato terma origjine latine, si ekuacion, tangjente, inversion, etj. që nuk mund të përktheheshin nga brumi i gjuhës sonë e që janë rrujtë edhe në gjuhët e tjera të pasuna, si në rusishtet e në gjermanishtet.”*³ Për këta terma që hidheshin këtu, profesorët që nuk ishin pjesë e komisioneve e që ligjëronin matematikën, luteshin t’i shfaqnin me shkrim mendimet e tyre për rishikimin e ndonjë termi, ose edhe për shtimin e ndonjë termi që është lënë pa u përfshirë, sepse “*me një të tillë bashkëpunim terminologjia do të caktohet e do të zâjë vend mâ mirë.*”. Shumë nga termat e propozuar këtu i kanë qëndruar kohës, ose siç janë paraqitur, ose duke u modifikuar, si: *shtesë* për *accroissement*, *klapë* e *përdredhme* për *accollade*, *syprinë-a* për *aire*, *lidhje* për *alliage*, *kand-i* për *angle*, *zbatim* për *application*, *bosht-i* për *axe*, *themel* për *base*, *binom-i* për *binome*, *krah-u* (i lakores) për *branche*, *njehsim* për *calcul*, *njehsoj* për *calculer*, *qindshe* për *centaines*, *shifër-a* për *chiffre*, *klasë* për *classe*, *puqe* për *coincidence*, *koordinatë* për *coordonnées*, *lakesë-a* për *courbure*, *lakore-ja* për *courbe*, *klapë katrore* për *crochet*, *shkallë* për *degré*, *përcaktim-i* për *détermination*, *ndryshim-i* për *différence*, *shoshitje* për *discussion*, *ndarje*, *pjesëtim* për *division*, *dhjetshe* për *dizaines*, *barazi* për *égalité*, *gabim* për *erreur*, *ushtrim* për *exercice*, *thyesë-a* për *fraction*, *hipotenuzë-a* për *hypothénuse*, *i pakufi* për *illimité*, *vijë-a* për *ligne*, *zbritje-a* për *rabat*, *rrëxim* për *rabattement*, *rranjë* për *racine* etj.

Përveç botimit të këtyre termave, në pikën I të referatit të tij Xhuvani flet për Fjalorin serbokroatisht-shqip dhe shqip-serbokroatisht, i cili sipas tij u hartua një vit më herët, e i cili po rimerret edhe njëherë në duar për t’u shkruar edhe në trajtat toskërisht e për t’u dhënë fjalëve kuptim më të përshtatshëm. Ai shprehet se në dorën e parë si dhe në këtë të dytën është konstatuar se “*nuk është punë e lehtë me bamë një Fjalor për të qenë prej një gjuhe të huej në shqipet e me u dhanë fjalëvet kuptimin e volitshëm e të vërtetë. Prandaj për këte punë u është dashë Komisioneve një kohë e gjatë e një punë plot me munxë.*”⁴

Në një linjë me punën e Institutit të Studimeve për terminologjinë ishte edhe hartimi i Fjalorit shpjegues të shqipes, brenda të cilit me rastin e botimit të Fjalorit të Gjuhës shqipe (1954) u bë një hap më cilësor e më përfshirës, i cili me gjasë kishte filluar të hartohet më 1948. Ishte fjalori i parë i botuar në gjuhën shqipe me shpjegime që përgjithësoi të arriturat e fjalorëve të mëparshëm, si ata të Frang Bardhit (1635), të Rossit (1875), të Kristoforidhit (1904), të Bashkimit (1910), të Kordinjanos (1930), të Leotit (1937), por edhe Buzetit e të Godinit, si dhe të Tases e të Gazullit, me fjalë shqipe të krahinës së

³ “Terminologjia e matematikës”, *Buletin i Institutit të Shkencave*, nr. 1, 1949, Tiranë, f. 58.

⁴ Aleksandër Xhuvani, “Referat i shefit të Seksionit të Gjuhësisë dhe letërsisë”, *Buletin i Institutit të Shkencave*, nr. 1, Tiranë, 1947, f. 32.

Përmetit e malësisë së Shkodrës. Këtu zuri vend materiali i mbledhur deri në atë kohë nga gjuha e popullit, nga letërsia artistike, nga periodiku e nga botimet shkencore, ku terminologjia ishte pjesë e saj. Në parathënien e fjalorit thuhet se “*Gjuhës sonë i ka munguar gjer tani një fjalor përshkrues e normativ që të përfshinte pjesën më të rëndësishme të leksikut të saj e t’i jepet çfarëdo fjale spjegimin shqip e jo përkthimin në një gjuhë tjetër.*”⁵

Duhet të kemi parasysh se Fjalori shpjegues nuk është fjalor terminologjik dhe vendi që zë terminologjia këtu lidhet në rend të parë me dendurinë e përdorimit, me përhapjen e termit, pra përfshirja ose jo e termave në fjalor shpjegues varet nga roli i tij shoqëror, e jo rëndësia që ka ai në sistemin e nocioneve të fushave të ndryshme shkencore e teknike. Po në ç’masë u përfshi terminologjia në këtë fjalor shpjegues dhe çfarë ndikimi pati në përvijimin e rrugës së terminologjisë? Nga shkurtimet që dalin në fillim të fjalorit mund të vërehet se janë përfshirë 26 fusha tematike: anatomi, antinomi, arkitekturë, astronomi, botanik, drejtësi, ekonomi, filozofi, financa, fizikë, gramatikë, gjeologji, gjeometri, kimi, matematikë, mekanikë, mineralogji, mjekësi, muzikë, politikë, sport, tregti, ushtri, veterinari e zoologji. Sigurisht se fushat tematike të përfshira nuk përkthehen me dendurinë e përdorimit të terminologjisë të asaj kohe. Sipas hartuesve të fjalorit⁶ vetë natyra e fjalorit vinte disa kufizime në numrin e fjalëve që do të përsihej, sidomos për fjalët krahinore e për termat e shkencave të ndryshme. Në terminologjinë shkencore e teknike u futën termat më të përdorur, duke u lënë jashtë ato që kishin karakter special dhe profesional të ngushtë. Kostaq Cipo shprehej “*Çdo fjalë ka definicionin e saj të punuar e të stilizuar bashkë me shprehjen e frazeologjinë, kur e ka dashur puna. Fjalës i është dhënë kuptimi konkret, kuptimi abstrakt dhe ai i fytyruar kur e ka pasur. Brenda gjendet terminologjia e lëndëve të mësimi dhe ajo e disa Dikastereve. Kemi shtënë aty fjalët e gjuhës letrare dhe ato të gojës popullore, qofshin edhe prej origjine të huaj siç janë p.sh., fjalët turqisht të folklorit. Aty do të gjejnë zyrtarët dhe nxënësit fjalë me kuptim të zgjeruar dhe asosh me kuptim të kufizuar, shprehje të asaj ose të kësaj krahine. Dy-treqind fjalë të fushës politiko-shoqërore do të pajisen me definicione që do të merren nga fjalorët më të rinj sovjetikë.*”⁷ Ndonëse shtrirja e përdorimi i terminologjisë kishin marrë përmasa të mëdha, të ndikuara nga zhvillimet e mëdha politike, ekonomike, arsimore e kulturore, mundësitë e zgjerimit të fushave terminologjike me rastin e hartimit të këtij fjalori ishin shumë më të mëdha se sa ato që janë pasqyruar. Nga

⁵ Kostaq Cipo et al., *Fjalor i Gjuhës Shqipe*, Tiranë: Instituti i Shkencave, 1954, f. III.

⁶ Po aty, f. III.

⁷ Kostaq Cipo, BISH, nr. 2, 1950, Tiranë, f. 161, cituar sipas V. Memishës, “Kostaq Cipo dhe Fjalori i Gjuhës Shqipe 1954”, *Studime filologjike*, nr. 3-4, Tiranë, 2012, f. 23.

vëzhgimet e bëra del se në shqipen janë përdorur, që nga 1942 edhe fjalë të tjera, terma, emërtime ose togfjalësja të qëndrueshëm që mungojnë në fjalorin e vitit 1954, si *grevëthyes, këshillim ligjvënës, ballist, djathtëzim, pronë (private), tatim i jashtëzakonshëm* etj.⁸ Edhe Kostallari në punimin *Në rrugën e hartimit të fjalorit normativ të shqipes së sotme*⁹, përmend se në fjalor nuk gjen shumë fjalë, shprehje e kuptime fjalësh që i gjen në dokumentet dhe në letërsinë artistike, fjalë e terma që përdoren zakonisht në shkollat e që përbëjnë fondin aktiv të leksikut të çdo njeriu me arsim të mesëm, fjalë e shprehje që takohen shpesh në letërsinë politiko-publicistike, e shkencore-popullore si edhe në shtypin tonë me karakter të përgjithshëm, si: *aeroplanmbajtës, agrorregulllore, agrume, autoambulancë, basketbollist, breshëri, duhanor, endje, ëmbëlsirë, farkëtar, fletë-anketë, grevëthyes, gjysmëproletar, hekurthyes, këshillim (masë disiplinore), kolektivë, kryemjeshtër, kryeqendër, kryeinxhinier, kryekomandant, kryemjek, plehrishtë, plugim, shtatzënë, urdhër, vetëqeverisje, voleiboll, voleibollist* etj., sikurse nuk i gjen as toget e qëndrueshme të fjalëve që kanë një unitet organik kuptimi dhe përdoren gjerësisht: *aeroplan gjuajtës, aeroplan vëzhgimi, arësim i lartë, arte të aplikuara, arte figurative, drithë buke, fletë lavdërimi, fletë kampi, fletë nderi, fond i paprekshëm, forcat prodhuese, fshatar individual, fuqi punëtore, gjyqtar anësor, gjyqtar loje, kafshë pune, kënd sportiv, kopsht fëmijësh, korrëse bari, makinë lidhëse, paginë kositëse, mjetet e prodhimit, pakica kombëtare, shtëpi kulture, shtëpi pushimi* etj. Në anën tjetër, u kritikua edhe fondi i fjalëve të huaja të përfshira në këtë fjalor, duke u arsyetuar se ishin përfshirë shumë të tilla, me ç'rast fjalët shqipe qëndronin nën hijen e tyre. Kur shqyrtohet përbërja e glosarit nga pikëpamja e normës letrare sotme, pa dyshim, del edhe problemi i fjalëve të huaja në shqipen e sotme. Kjo ka rrjedhur ndoshta edhe nga mungesa e një fjalori të fjalëve të huaja në gjuhën shqipe ose nga fakti se terminologjia tekniko-shkencore, e cila në një përqindje të madhe përbëhet nga fjalë të huaja, nuk është përpunuar dhe njësuar akoma mbi bazën e shfrytëzimit të mundësive reale të gjuhës sonë.¹⁰

Përgjithësisht, mund të themi se nga kritikrat që i janë bërë fondit të Fjalorit normativ të 1954-ës, shumë syresh ishin të qëndrueshme, sepse del se fjalori përveç që ka pasur mundësi të pasurohej edhe më tepër, aty janë përfshirë variante fonetike që nuk e kanë vendin në një fjalor të tillë, si *abetar-i* dhe *abetare-ja, boboreshë* dhe *buboricë, buburrecë, bagëti* dhe *bakti, bartje*

⁸ Miço Samara, *Rreth leksikut politik e shoqëror në gjuhën shqipe*, Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 2008, f. 48.

⁹ Androkli Kostallari, "Në rrugën e hartimit të fjalorit normativ të shqipes së sotme", në: *Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe II*, Tiranë: Universiteti Shtetëror i Tiranës, 1972, f. 85-114.

¹⁰ Po aty, f. 95.

dhe *mbartje*, *milingonë* dhe *melingonë* etj., si dhe ka përfshirë fjalë të huaja të panevojshme *adet*, *mynafik*, *namus*, *sebep* etj., gjithashtu mendohej se u teprua edhe me fjalë teknike-shkencore. Përfshirjen e një fjale në dy variante e ka paraparë Xhuvani¹¹ në punën e hartimit të tij në rast se trajtat e fjalëve kanë dallime në dialektet e shqipes, në referatin e tij lidhur me hartimin e një fjalori të gjuhës shqipe, *trajtat e fjalëve, aty ku dallohen këto në mes tyre, do të vihen gegënisht e toskënisht; p.sh. bana e bëra; shkruar e shkruar; vënë e vumë, vû; emër e emën; karp e kërp; i vorfën e i varfër etj.* Në mesin e këtyre fjalëve të huaja janë në shumicën dërrmuese fjalë tekniko-shkencore, si dhe barbarizma (turqizma, sllavizma, italianizma). Të ndikuar nga fjalori i Xhuvanit, ka autorë që mendonin se shumë terma do të duhej të liheshin jashtë, si: *halucinacion*, *hemofili*, *hidrometri*, *iktiologji*, *imperativ*, *imperfekt*, *labiale* etj.¹²

Vështirësi në hartimin e fjalorit nuk përbënte vetëm përfshirja e terminologjisë, vështirësi përbënte edhe përfshirja e leksikut të përgjithshëm. Pavarësisht se në Parathënien e Fjalorit pohohet se “*për hartimin e fjalorit u muarën nëpër duar fjalorët e botuar gjer më sot, materialet leksikologjike t’Arkivës së Sekcionit të Gjuhësisë e të Letërsisë, u kërkuar burimet popullore, veprat e klasikëve të letërsisë sonë nga Rilindja e këtej, tekste shkencore të tjera, të përkohshme e gazeta. Gjithë materiali u shoshit nëpërmjet një shqyrtimi kritik dhe u muar ç’ ishte më e saktë dhe më e mirë. S’u vu asnjë fjalë, pa u siguruar për përdorimin e kuptimin saj*”¹³, hartimi i tij nuk ishte mbështetur në një kartotekë të leksikut, siç ishte mbështetur fjala vjen ai i vitit 1980, me ç’rast kartoteka e leksikut të shqipes ishte pasuruar me miliona skeda të mbledhura e të sistemuara në kuadër të Institutit të Gjuhësisë. Në të njëjtën kohë, pavarësisht punës që ishte bërë, sidomos në kohën e Rilindjes, lidhur me mbledhjen e leksikut dialektor, që është burim kryesor i pasurimit të Fjalorit normativ, shumë pjesë të këtij leksiku akoma gjallonin në të folme të ndryshme, duke pritur studiuesit të merrnin rrugën e terreneve për ta mbledhur, për ta sistemuar e për të parë mundësitë e futjes në fjalor, sikurse nuk ishte gjurmuar e skeduar fondi leksikor që përdorej në shtyp. Në anën tjetër, hartimit të Fjalorit nuk i kishin paraprirë studimet teorike për leksikologjinë e leksikografinë, pra akoma nuk ishin vënë themelet e këtyre dy fushave, shqetësim që e vinte në dukje edhe Kostallari, 20 vjet pas hartimit të fjalorit. Ai theksonte se teoria leksikografike tek ne ka mbetur shumë prapa nga praktika leksikografike, e që për fjalorin normativ të shqipes së sotme nevojitet patjetër një bazë e shëndoshë teorike. Sipas tij, fjalori është një vepër e arrirë dhe

¹¹ Po aty, f. 34.

¹² Filip Ndocaj, “Mbi fondin e fjalëve dhe kuptimet e tyre në Fjalorin e Gjuhës Shqipe”, në: *Studime mbi leksikon dhe formimin e fjalëve në gjuhën shqipe II*, Tiranë, 1972, f. 167-184.

¹³ Kostaq Cipo, et. al., *Fjalor i Gjuhës Shqipe*, f. V.

qëndron më lart se çdo fjalor tjetër që është botuar përpara në Shqipëri dhe se përfshin një numër shumë të madh fjalësh që tregojnë forcën e madhe, me të cilën gjuha shqipe i ka qëndruar asimilimit të saj, megjithatë fjalori nuk e plotëson detyrën kryesore që i shtron zhvillimi ekonomik-shoqëror dhe kultural i vendit në kohën tonë.¹⁴ Nëse përkthehet në gjuhën terminologjike nënkupton që nuk është pasqyruar mjaftueshëm as zhvillimi terminologjik.

Kur është fjala për zhvillimin e terminologjisë, tashmë kjo fushë specifike në atë kohë, mund të themi se kishte arritur zhvillimin më të madh, krahasuar më kohën e mëhershme, dhe kërkesa praktike për terma të njësuar, të standardizuar e të shpjeguar qartë ishte më se e nevojshme. Rreth domosdoshmërisë dhe rëndësisë së madhe për punë të organizuar për terminologjinë u trajtuan edhe në Buletin për Shkencat Shoqërore si dhe në Sesionin II shkencor të Institutit të shkencave më 1952, në kuadër të të cilit u diskutuan nga Domi e Reso edhe problemi i terminologjisë shqipe.¹⁵ Problemet me të cilat ballafaqohej terminologjia shqipe, e që ishin pjesë e shqetësimeve të gjuhëtarëve e të specialistëve të fushave, gjithnjë morën formë dhe u kurorëzuan me formimin e Sektorit të Terminologjisë, sektor i cili i dha kah të mirëfilltë shkencor terminologjisë praktike e teorike, duke përcaktuar parimet kryesore për hartimin e fjalorëve terminologjikë dhe më pas duke u botuar dhjetëra fjalorë të fushave të ndryshme tekniko-shkencore. Një ndër tiparet themelore, që e karakterizoi punën e bërë për njësimin, pastrimin e pasurimin e terminologjisë ishte fryma kolektive, bashkëpunimi i ngushtë ndërmjet gjuhëtarëve e specialistëve të çdo dege, duke pasur parasysh se terminologjia tekniko-shkencore zhvillohet në dy drejtime: njëri është spontan dhe pasqyrohet çdo ditë në gjuhën e folur e të shkruar, tjetri bëhet me përpjekjet e vetëdijshme për normalizimin e mjeteve gjuhësore, e sidomos, për pasurimin e fjalorit, përpjekje që është e domosdoshme në terminologji.¹⁶ Ky sektor, përveç që shfrytëzoi fondin e grumbulluar të termave nga Instituti i Shkencave, e që ishin rreth 10000 të tillë nga fusha të ndryshme shkencore, ai vazhdoi mbledhjen e sistemit të mijëra termave të tjerë që tashmë ishin në përdorim. Në të njëjtën kohë, Sektorit i dilte punë e madhe edhe për pastrimin e terminologjisë së huaj dhe pasurimin e shqipes me terma të rinj, qofshin neologjizma, qofshin fjalë të ngritura në terma, qofshin fjalë dialektore e që kishin potencial terminologjik, me të cilët synohej t'u bëhej ballë kërkesave në rritje të vazhdueshme për fushat e veprimtarisë tekniko-shkencore.

¹⁴ Androkli Kostallari, "Në rrugën e hartimit të fjalorit normativ të shqipes së sotme", f. 85-114.

¹⁵ Shih diskutimin e M. Domit në *Buletin për Shkencat Shoqërore*, Tiranë. nr. 1, 1952 f. 82, f. 102-107 dhe diskutimin e M. Resos, nr. 4, 1952, f. 89-92.

¹⁶ Ferdinand Leka, Sofika Morcka, "Zhvillimi dhe pasurimi i terminologjisë pas çlirimit", *Studime filologjike*, Tiranë, nr. 4, 1969, f. 85-95.

Bashkërendimi i punëve solli edhe rezultatet e para, kur nisi puna për hartimin e fjalorëve të shkencave, që kishin karakter më të përgjithshëm, si matematika dhe mekanika. Krahas mungesës së studimeve teorike në fushën e leksikut të përgjithshëm, edhe fushës së terminologjisë i mungonin studimet teorike, ndonëse është e kuptueshme se terminologjia funksionon në kuadër të leksikut.

Por a kishte shqipja aftësi t'u bënte ballë problemeve që i dilnin përpara kësaj fushe dhe cila ishte prirja e zhvillimit? Nevoja për të punuar me terminologjinë, pra, për ta përpunuar atë, lind atëherë kur terminologjia ekzistuese, e zhvilluar në mënyrë të vetvetishme, nuk i plotëson nevojat e praktikës për shkak të një varg pasaktësish që lidhen si me zhvillimin e ndryshimin e përmbajtjes së koncepteve, ashtu edhe me ndërtimin apo përdorimin jo të drejtë të termave. Kjo gjendje bën të domosdoshëm studimin e problemeve teorike dhe hartimin e parimeve si të përgjithshme, edhe konkrete, si për ndërtimin e termave të veçantë, edhe për ndërtimin e sistemeve terminologjike.¹⁷ Dodbiba më 1956, një vit pas themelimit të Sektorit të terminologjisë, në punimin *Vërejtje rreth pastrimit të terminologjisë*¹⁸ i përgjigjet kësaj pyetjeje, e që mund të konsiderohet si punimi i parë teorik në fushën e terminologjisë shqipe. Ai i formuloi parimet e punës me terminologjinë shqipe, të cilat koha ka treguar se ishin të qëndrueshme e frytdhënëse. Ai në këtë punim ka renditur pesë parime: 1. të shfrytëzohen sa më shumë mundësitë e mëdha që ka gjuha jonë për fjalë terma, duke u dhënë edhe kuptime terminologjike disa fjalëve qofshin të mbarë gjuhës, qofshin krahinore; 2. të shfrytëzohen sa më shumë e sa më mirë mënyrat dhe tipat prodhimtarë të formimit të fjalëve në gjuhën e sotme shqipe; 3) të shqipërohen termat shkencorë jondërkombëtarë, duke quajtur ndërkombëtarë ata terma që i kanë të përbashkët jo vetëm dy a më shumë gjuhë neolatine, por edhe gjuhë të tjera (rusishtja, gjermanishtja etj.); 4) të rivlerësohen disa terma të përdorur që në kohën e Rilindjes dhe të mbetur në harresë; 5) të mbahet kurdoherë parasysh përhapja e një termi në kohën tonë si në shkollë, ashtu edhe në degët e ndryshme të prodhimit.

Sa u përket parimeve të caktuara, me rastin e hartimit të fjalorëve terminologjikë, u shfrytëzuan mundësitë e shqipes në masë të konsiderueshme, duke përfshirë terma të shqipes ose terma që tashmë ishin bërë pjesë e saj kohë më parë dhe ndiheshin si të tilla; fjalë të leksikut të përgjithshëm që morën kuptime terminologjike, si dhe fjalë dialektore: *barasi*, *ballë*, *daltë*, *faqe*, *gur*, *lakesë*, *lakore*, *çmim*, *gjuhë*, *palcë*, *pasuri*, *rrënjë*, *bosht*, *mëngë*, *bulë*, *cungal*,

¹⁷ Hëna Pasho, Agron Duro, "Terminologjia shqipe – probleme dhe detyra", në Gjendja dhe zhvillimi i terminologjisë *shqipe - probleme dhe detyra*. Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 2009, f. 21-41.

¹⁸ Lirak Dodbiba, "Vërejtje rreth pastrimit të terminologjisë", në *Buletin i Shkencave Shqërore*, vëll. II, Tiranë, 1956, f. 134-143.

rizë, thukje, zanafillë etj. Në disa fjalorë fjala shqipe shkon në rreth 55% të korpusit të përgjithshëm. Në fjalorin e botanikës nga 1202 terma që përmban fjalori, 871 janë fjalë shqipe. U shfrytëzuan mjetet fjalëformuese të shqipes për të krijuar terma të rinj, si ndajshtimi e kompozimi *dyfaqësh, drejtkëndor, hundorësim, jetësi, ligjësim, ligjësor, përvijim, i depërtueshëm, i tejdukshëm, fletëngarkesë, gjethembajtës, gjysmërruzull, shumëfaqësh*. Po ashtu, për të shfrytëzuar sa më mirë e sa më shumë pasuritë e shqipes për fjalë-terma është zgjeruar dhe është shtrirë kuptimi përtej sferës së ngushtë, ose duke u përshtatur për të shprehur koncepte të përpikta dhe abstrakte të fushave të ndryshme. Kështu në sistemin terminologjik ruhet vetëm fjala si strukturë, ndërsa ndryshon përmbajtja e saj, sepse fjala tashmë emërton një ose disa koncepte në fusha të tjera, si fjalës *rrënjë*- pjesa kryesisht nën dhe e një bime, e një shkurreje a e një druri ... *rrënjë boshtore* etj., i janë shtuar kuptime terminologjike, si në **anatomi**: *pjesa e flokut, e dhëmbit, e thoit* etj., e zgjatur dhe e kapur ose e ngulur në një ind, *rrënja e gjuhës* etj., në **gjuhësi**: pjesa kryesore e fjalës, që nuk mund të ndahet më tej në morfema, mbart kuptimin themelor dhe ruhet gjatë formimit të fjalëve të reja, *rrënja emërore* etj., në **matematikë**: numër a shprehje algjebrike, që, kur ngrihet në fuqi, jep madhësinë e dhënë më parë; numër që shërben si zgjidhje e një barazimi *rrënja katrore, rrënja e një thyese* etj., në **kimi**: grup atomesh, në molekulat e lëndëve kimike, që merr pjesë në reaksionet si një njësi dhe pa u ndryshuar: *rrënjë acide* etj.

Problem tjetër, të cilin është synuar ta zgjidhnin ka qenë sinonimia. Shpesh për një koncept përdorehin dy ose më tepër terma, të cilët ishin krijuar në kohë të ndryshme dhe kishin hyrë në përdorim në mungesë të njësimi të terminologjisë, shumë nga ta me burim të huaj. Kështu që komisionet e hartimit të fjalorëve u është dashur të orientojnë punën edhe për njësimin e terminologjisë dhe pasurimin e saj nga fjalët e huaja, si *anasjellë* për *inversion*, *памје* për *tablo*, *рикујтесë* për *reminishencë*, *парашtrim* për *ekspozicion*, nga fusha e letërsisë, *пërthithје* për *absorbim*, *lakore* për *kurbë*, *njehsor* për *kontator* nga fusha e elektroteknikës etj., ose shqipërimin e termave aty ku kuptimi ka dalë më i qartë, si *izolim, izolant, izolator* për *veçim, veçues, veçor, enëzor* për *vaskulare, gyp* për *tub* etj.

Fondi leksikor i përgjithshëm është burim kryesor i formimit të termave, duke u ndërtuar sipas modeleve fjalëformuese që funksionojnë në gjuhën shqipe në të njëjtën kohë u nënshtrohen normave të gjuhës standarde. Prandaj termat që hyjnë në këtë sistem, në një shkallë të caktuar, duhet të pasqyrojnë ato lidhje objektive që ekzistojnë ndërmjet koncepteve dhe në shkallën më të mundshme të saktësisë, ta japin sa më të plotë përmbajtjen e tyre.¹⁹ Kështu, sa i përket mbledhjes së fjalëve-terma e të shprehjeve nga populli, Sektori i

¹⁹ Hëna Pasho, Agron Duro, “Terminologjia shqipe-probleme dhe detyra”, në *Gjendja dhe zhvillimi i terminologjisë...*, Tiranë, 2009, f. 21-41.

Terminologjisë në Institutin e Gjuhësisë dhe të Letërsisë përgatiti një Udhëzues²⁰ për mbledhjen e fjalëve-termave të mjeteve të punës, të veglave, të zejtarisë popullore e të profesioneve të ndryshme, që të shiheshin pasuritë e shqipes dhe mundësitë e saj për të krijuar terma nga fondi i leksikut të përgjithshëm.

Pas caktimit të kriterëve, mbledhjes, sistemimit e analizimit të termave, filloi botimi i fjalorëve të parë, më 1963, duke bërë një hap cilësor në fushën e terminologjisë. Në këtë vit u botuan 4 fjalorë terminologjikë: Fjalori i terminologjisë së botanikës me 1202 terma; Terminologjia e matematikës me 3467 terma; Terminologjia e fizikës, që përfshinte 7 fjalorë të veçantë: Termodinamika me 565 terma, Optika me 733 terma, Akustika me 338 terma, Elektromagnetizmi me 1047 terma, Mekanika me 743 terma, Elektroteknika me 2291 terma; Terminologjia e kimisë me 3231 terma. Botimi i fjalorëve terminologjikë vijoi edhe vitin pasues, me ç'rast u botuan 3 fjalorë: Terminologjia e gjeologjisë me 1440 terma; Terminologjia e minierave me 1534 terma; Terminologjia e arkitekturës me 1597 terma. Në dy vitet pasuese u botuan Terminologjia e letërsisë me 897 terma, ndërsa më 1966 u botuan Terminologjia e hidraulikës me 759 terma. Gjatë hartimit të këtyre fjalorëve, u bë përpjekje që të përfshihej terminologjia shqipe, aty ku kishte mundësi, një pjesë tjetër u shqipërua, ndërsa pjesa tjetër, që nuk përbënte përgjindje të madhe, u mor nga termat ndërkombëtarë. Shumica e fjalorëve të botuar nga Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë në Tiranë, si gjuhë të dytë kishin rusishten, ndërsa si të tretë frëngjishten, sepse shumë nga studiuesit e asaj kohe, për shkak të marrëdhënieve të mira politike e ekonomike që kishin me ish-Bashkimin Sovjetik, studiuan ose u specializuan në Moskë, ndërsa rusishtja kishte marrë status të rëndësishëm në Shqipëri. Kjo bëri që rusishtja të merrte status të parë nga gjuhët e huaja, ndërsa frëngjishtja e asaj kohe, shërbente si *lingua franca*, si gjuhë e rëndësishme botërore, status që sot e ka anglishtja. Përveç këtyre gjuhëve, në disa fjalorë u shtua edhe gjuha latine, angleze e gjermane, ndërsa në Kosovë u shtua edhe gjuha serbokroate.

Zhvillimi i shkencës e i teknikës së bashku me zhvillimet politike, ekonomike e kulturore në përgjithësi, ka ndikuar që edhe terminologjia e tyre të përhapet e të zërë vend të rëndësishëm në diskutimet e komunikimet ndërmjet specialistëve të fushave, në mesin e shkollarëve të arsimit të mesëm e të lartë, në shtypin e kohës dhe në komunikimet e përditshme të njerëzve, duke bërë që denduria e përdorimit të termave të rritet ndjeshëm. Është e natyrshme që me rastin e rritjes së përdorimit të termave për nevoja të ndryshme, rriten edhe problemet, të cilat kërkojnë zgjidhje shkencore, të drejta e të qarta. Këtu hyjnë

²⁰ Udhëzues për mbledhjen e fjalëve-terma të mjeteve të punës, të veglave të zejtarive popullore e të profesioneve të ndryshme, Universiteti Shtetëror i Tiranës, Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, Tiranë, 1967, f. 13.

përdorimi i sinonimisë terminologjike, përdorimi i dy ose më tepër termave për një koncept të vetëm, veçori që nuk e duron terminologjia; si dhe shtimi i përdorimit të termave të huaj. Meqë nuk ishin parë të gjitha pasuritë e visarit të shqipes, e mundësitë e termave për të marrë karakter të përgjithshëm, të cilat do të mund ta pasuronin fushën e terminologjisë dhe si rezultat nuk njiheshin pasuri të tilla, preferohej zgjidhja më e lehtë, marrja e gatshme e termit nga gjuhë të huaj. Problem tjetër që kishte krijuar pështjelli në përdorim ishte ndërtimi i tyre jo i drejtë, dhe shpjegimi shpeshherë jo i qartë i konceptit që shprehet termi. Kështu kërkesat e marrëdhënieve ekonomike, politike, kulturore, tregtare, shkencore etj., që gjithnjë vinin e shtoheshin, shtrinin nevojë parësore hartimin e fjalorëve praktikë, që do t'u shërbenin këtyre marrëdhënieve, do t'u shërbenin specialistëve të fushave, do t'u shërbenin studentëve e të gjithë të interesuarve që i lidhte ose puna ose dëshira për të pasur një terminologji të qartë e të drejtë.

Dalja në dritë e fjalorit të parë shpjegues në shqipe si dhe dalja në dritë e një serie fjalorësh terminologjikë, ishin dëshmi se leksikografia shqipe kishte hyrë në një etapë të rëndësishme të zhvillimit, të përpunimit e normëzimit të saj. Andaj, përballë problemeve që dilnin përpara komisioneve hartuese të fjalorëve terminologjikë, shtruan rrugën që duhej ndjekur për ta vënë në binarë një problem serioz. Ndonëse vërehej një prirje e përgjithshme për të shfrytëzuar sa më tepër mundësitë e mëdha që kishte shqipja për terma, ajo nuk ishte e njësuar. Siç thuhet në parathënie të Fjalorit të terminologjisë së botanikës ajo “ndryshon shpesh nga një qendër pune në tjetrën, specialistë të së njëjtës degë, për të njëjtin koncept, dukuri ose send (vegël, aparat) përdorin terma të ndryshëm. Përveç kësaj, terminologjia e sotme ka tepër fjalë të huaja të trashëguara dhe të reja. Shpesh herë termat shqip janë sajuar pa kritere të shëndosha gjuhësore.”²¹ Përveç detyrave që i kishte vendosur Komisioni i Sektorit të Terminologjisë, gjatë hartimit të fjalorëve terminologjikë tri gjuhësh për degë të ndryshme të shkencës e të teknikës, si dhe gjatë përpunimit të këtyre terminologjive komisioni ka punuar me disa kritere që i kishte vënë vetes në rrugën e përdhjes së terminologjisë shkencore, që lidheshin me kriteret e Dodbibës, të përmendura më lart: “1. Të çfrytëzoheshin sa më shumë mundësitë e mëdha që ka gjuha jonë për fjalë-terma dhe prirja që ka marrë vetiu zhvillimi i gjuhës letrare në kohën tonë. Për të bërë këtë është dashur në disa raste që kuptimi i fjalëve të fondit të gjuhës sonë të zgjerohet, duke u shtrirë përtej sferës së ngushtë të jetës praktike dhe zejtare, gjer te konceptet e përpikta dhe abstrakte të shkencës...

2. Të çfrytëzoheshin sa më shumë e sa më mirë mënyrat dhe tipat më produktivë të formimit të fjalëve në gjuhën e sotme shqipe.

²¹ Ilia Mitrushë, Mahir Domi et al., *Fjalor i terminologjisë tekniko-shkencore* 1, Terminologjia e botanikës, Tiranë, 1963, f. 6.

3. Të shqipëroheshin termat shkencore jo ndërkombëtare, duke quajtur ndërkombëtare ata terma që i kanë të përbashkët jo vetëm dy ose më shumë gjuhë neolatine, siç është vepruar kryesisht në të kaluarën, por që i kanë edhe gjuhët e tjera.

4. Të rivlerësoheshin sa qe e mundur disa terma të vjetër të përdorur qysh në kohën të Rilindjes dhe të braktisur më vonë.

5. Të kihej kurdoherë para sysh përhapja dhe përdorimi i një termi në kohën tonë si në shkollë, ashtu edhe në degët e ndryshme të prodhimit.

Zbatimi i këtyre kriterëve ka bërë të mundur hartimin e fjalorëve terminologjikë me baza shkencore.”²²

Në vend të përfundimit

Botimi në seri i fjalorëve të terminologjisë tekniko-shkencore, shprehet Samara, *është një ngjarje me rëndësi për jetën shkencore në vendin tonë. Dalja e tyre në dritë është një tregues i qartë i sukseseve të arritura deri tani në gjuhësinë shqiptare, suksese që mund të arriheshin vetë nga një punë këmbëngulëse me të vërtetë shkencore në lëmin e terminologjisë të mbështetur në realitetin ekonomik e shoqëror të kohës.*²³ Ky sukses prek disa fusha të rëndësishme, që ndihmuan në rrugën e përpunimit e të njësimtimit të terminologjisë. Së pari, u fjalorët hartuan nga një institucion shkencor, nga Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë; së dyti, në hartimin e tyre mori pjesë një komision i përbërë nga njerëz të shquar të shkencës, filologë të arrirë, si A. Xhuvani, A. Kostallari, E. Çabej, L. Dodbibë, M. Domi; së treti, u realizuan në bashkëpunim ndërmjet gjuhëtarëve e specialistëve të fushave; së katërti, ndihmuan në ngritjen e fjalës shqipe dhe shfrytëzimin e pasurisë së shqipes, me fjalë të gatshme, me fjalë të ngritur në terma, ose duke shfrytëzuar mundësinë fjalëformuese të shqipes. Së këndejmi, terminologjia u mbështet gjerësisht në leksikun e shqipes e në mjetet e saj fjalëformuese, sidomos ajo në tekstet shkollore dhe përgjithësisht terminologjia tekniko-shkencore dhe u dëshmuan bindjet e gjuhëtarëve se shqipja i kishte mundësitë për të përballuar në shkallë të lartë, nevojat e praktikës për emërtime terminologjike, me mjetet e veta leksikore e fjalëformuese. Për shembull, në *Fjalor i terminologjisë së matematikës dhe mekanikës*, nga fjalësi i përgjithshëm u përfshin rreth 55% fjalë shqipe, ose huazime të vjetra e të reja, por që kanë hyrë në fjalorin aktiv të masave, si *(i,e) afërishëm, anasjellë, barasi, element, forcë, lakesë, lakore, ndryshor, rikumbim, veçim* etj. 23% të fjalësit të përgjithshëm janë terma togfjalësh, nga të cilat njëra nga gjymtyrët është fjalë shqipe, *abshisë vijëdrejtë*,

²² Po aty, 7.

²³ Miço Samara, “Fjalor i terminologjisë tekniko-shkencore, 12. Terminologjia e Arkitekturës (shqip-rusisht-frengjisht)”, *Studime filologjike*, nr. 2, 1965, Tiranë, f. 219-222.

afërsirë homeomorfe, bosht i kosinuseve etj., ndërsa pjesa tjetër prej 22% janë terma të huaj, disa ndërkombëtarë, si: *abak, formulë, identik* etj.²⁴. Ndërsa korpusi në *Fjalor i terminologjisë së arkitekturës*²⁵ është mbështetur në gjuhën popullore dhe veçanërisht në atë të zejës popullore të muratorit, si *ballë, brez, daltë, deltinë, faqe, gërshtëz, gur* etj., mbi bazën e tyre pastaj janë sajuar edhe një varg termash, duke shfrytëzuar mënyrat e formimit të fjalëve në gjuhën shqipe, nga *ballë-ballëz, ballëzinë*, nga *daltë-daltari*, nga *lule-lulim*, duke çuar në rreth 55% përdorimin e fjalë-termave shqip në këtë fjalor. Së pesti, shfrytëzuan kalkimin, si për fjalët *instrument, bërthamë, bërryl, cak-limite, fikat, fuqi, rrafsh, rrënjë, varg, vatër*, etj.; së gjashti, ndihmuan në normëzimin e terminologjisë; së shtati, shpjeguan qartë e drejtë termat; së teti, pastruan shqipen nga terma të huaj, duke shqipëruar ose duke zëvendësuar, si *veçim, veçues, veçor* për *izolim, izolant, izolator, enëzor* për *vaskulare, gyp* për *tub*; së nënti, ndihmuan në qartësimin e komunikimit; së dhjeti, treguan se shqipja ka aftësi të zhvillohet e të pasqyrohet edhe në fjalorë të tillë, si çdo gjuhë tjetër e zhvilluar.

Hartimi i fjalorëve nga fusha të ndryshme të terminologjisë tekniko-shkencore vijoi edhe në vitet pasuese. Së këndejmi deri më sot, janë botuar dhjetëra fjalorë terminologjikë, si Terminologjia e së drejtës ndërkombëtare, Fjalor i gjuhësisë, i gjeografisë, i anatomisë, i histologjisë dhe i embrionologjisë, i ekonomisë politike, i statistikës, i financave dhe i kontabilitetit, i së drejtës, i obstetrikës dhe i gjinekologjisë, i tregtisë së jashtme, i planifikimit e tregtisë së brendshme, i ekonomisë së transportit, i stomatologjisë, i termave themelorë të mekanikës, i patologjisë, i fiziologjisë, i termave themelorë të bujqësisë. Këtu hyjnë edhe 38 fjalorët të termave ushtarakë, 103 fjalorë të fushave të ndryshme terminologjike, duke përfshirë edhe ribotimin e fjalorëve tekniko-shkencorë në Prishtinë.

Bibliografi

- Cipo Kostaq, BISH, nr. 2, 1950, Tiranë, f. 161, cituar sipas V. Memishës, “Kostaq Cipo dhe Fjalori i Gjuhës Shqipe 1954”. *Studime Filologjike*, nr. 3-4, Tiranë: Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, 2012, f. 21-30.
- Cipo Kostaq, Eqrem Çabej, Mahir Domi, Anton Krajni, Osman Myderrizi. 1954. *Fjalor i Gjuhës Shqipe*. Tiranë: Instituti i Shkencave, Seksioni i Gjuhës e i Letërsisë.

²⁴ Shih: Emil Lafe, “Fjalor i terminologjisë tekniko-shkencore, 2. Terminologjia e Matematikës dhe Mekanikës teorike (shqip-rusisht-frëngjisht)”, *Studime filologjike*, nr. 2, 1965, Tiranë, f. 211-217.

²⁵ Miço Samara, “Fjalor i terminologjisë tekniko-shkencore, 12. f. 219-222.

- Kostallari, Androkli. 1972. "Në rrugën e hartimit të fjalorit normativ të shqipes së sotme". Në: *Studime mbi leksikun dhe formimin e fjalëve në gjuhën shqipe* II. Tiranë: Instituti i Gjuhësisë e i Letërsisë, f. 81-114.
- Lafe, Emil. 1965. "Fjalor i terminologjisë tekniko-shkencore, 2. Terminologjia e Matematikës dhe Mekanikës teorike (shqip-rusisht-frëngjisht)". *Studime filologjike*, nr. 2. Tiranë: Universiteti Shtetëror i Tiranës, Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, f. 211-217.
- Leka, Ferdinand, Sofika Morcka. 1969. "Zhvillimi dhe pasurimi i terminologjisë pas çlirimit". *Studime filologjike*, nr. 4, Tiranë: Universiteti Shtetëror i Tiranës, Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, f. 85-95.
- Dodbiba, Lirak. 1956. "Vërejtje rreth pastrimit të terminologjisë". *Buletin i shkencave shoqërore*, vëll. II, Tiranë, f. 134-143.
- Mitrushi, Ilia, Mahir Domi, Androkli Kostallari, Eqrem Çabej. 1963. *Fjalor i terminologjisë tekniko-shkencore* 1, Terminologjia e botanikës, Tiranë: Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë.
- Ndocaj, Filip. 1972. "Mbi fondin e fjalëve dhe kuptimet e tyre në Fjalorin e Gjuhës Shqipe". Në: *Studime mbi leksikun dhe formimin e fjalëve në gjuhën shqipe* II. Tiranë: Instituti i Gjuhësisë dhe i letërsisë, f. 167-184.
- Pasho, Hëna, Agron Duro. 2009. "Terminologjia shqipe – probleme dhe detyra". Në: *Gjendja dhe zhvillimi i terminologjisë shqipe - probleme dhe detyra*. Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, f. 21-41.
- Samara, Miço. 1965. "Fjalor i terminologjisë tekniko-shkencore, 12. Terminologjia e Arkitekturës (shqip-rusisht-frëngjisht)". *Studime Filologjike*, nr. 2. Tiranë: Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, f. 219-222.
- Samara, Miço. 2008. *Rreth leksikut politik e shoqëror në gjuhën shqipe: vështrim leksikologjik e leksikografik*. Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë.
- "Terminologjia e matematikës". *Buletin i Institutit të Shkencave*, nr.1, Tiranë, 1949, f. 58-71.
- Xhuvani, Aleksandër. 1947. "Referat i shefit të Seksionit të Gjuhësisë dhe letërsisë", *Buletin i Institutit të Studimeve*, nr. 1, Tiranë, f. 31-41.
- Udhëzues për mbledhjen e fjalëve-terma të mjeteve të punës, të veglave të zejtarive popullore e të profesioneve të ndryshme.*

Tiranë: Universiteti Shtetëror i Tiranës, Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, 1967.

SUMMARY

Development Trends in Albanian Terminology after World War II

The serial publication of dictionaries of technical and scientific terminology, as noted by Samara, represents an event of considerable importance for the scientific life of our country. Their appearance constitutes a clear indicator of the achievements attained thus far in Albanian linguistics – achievements made possible only through persistent and genuinely scientific work in the field of terminology, grounded in the economic and social reality of the time. This success encompasses several important dimensions that contributed to the development and standardization of terminology. First, the dictionaries were compiled by a scientific institution, namely the Institute of History and Linguistics. Second, their preparation involved a commission composed of distinguished scholars and accomplished philologists, such as Aleksandër Xhuvani, Androkli Kostallari, Eqrem Çabej, Lirak Dodbiba, and Mahir Domi. Third, they were realized through collaboration between linguists and specialists of respective fields. Fourth, they contributed to the elevation of the Albanian lexicon and the utilization of its linguistic wealth, employing existing words, elevating them to terminological status, or exploiting the word-formation capacities of the language. Consequently, terminology came to rely extensively on the Albanian lexicon and its word-formation mechanisms, particularly in school textbooks and, more broadly, in technical and scientific terminology. This development substantiated the conviction of linguists that Albanian possesses the capacity to meet, to a high degree, the practical demands for terminological naming through its own lexical and derivational resources. Fifth, these works made use of calquing, as in terms such as *instrument*, *bërthamë* (core), *bërryl* (elbow), *cak* (limit), *fikat*, *fuqi* (force), *rrafsh* (plane), *rrënjë* (root), *varg* (sequence), *vatër* (focus), and others. Sixth, they contributed to the standardization of terminology. Seventh, they provided clear and accurate explanations of terms. Eighth, they helped purify Albanian from foreign terms by adapting or replacing them, for example, *veçim*, *veçues*, *veçor* in place of *izolim*, *izolant*, *izolator*; *enëzor* for *vaskulare*; and *gyp* for *tub*. Ninth, they facilitated clearer communication. Tenth, they demonstrated that Albanian, like any other developed language, has the capacity to evolve and to be reflected in such lexicographical works. The compilation of dictionaries

from various fields of technical and scientific terminology continued in the subsequent years. Consequently, up to the present day, dozens of terminological dictionaries have been published.

PROBLEME DHE DISKUTIME

Bardhyl Demiraj

**Vëzhgime në librin e restauruar të ‘Mesharit’ të Don
Gjon Buzukut –
II. Shqimëzat në fund të tekstit**

Përmbledhje

Ky studim është i dyti i radhës në triptikun tonë të studimeve mbi librin e restauruar të ‘Mesharit’ të Don Gjon Buzukut si produkt tipografik. Këtu jemi përqendruar te shqyrtimi i katër fletëve-shqimëza që përmbyllin ekzemplarin e vetëm të librit të parë të botuar në gjuhën shqipe, siç e njohim deri sot. Materiali liturgjik që rroket në to është aq pak i ruajtur, sa është vështirë të trajtohet njëllor si pjesa tjetër e korpusit kryesor me tekst të lidhur (§1). Megjithatë edhe ato si pjesë e së tërës gëzojnë të drejtën që të rroket në studimin ballor të ‘Mesharit’. Prandaj brenda mundësive të kufizuara që disponojmë u përpoqëm, që krahas paraqitjes tabelare të materialit në fjalë, t’i përcjellim lexuesit zgjidhje të ndryshme alternative që kanë të bëjnë me studimin e këtyre fletëve shqimëza në vetvete (§2), sikurse në tërësinë tyre e në marrëdhënie me korpusin kryesor të librit (§3). Për çdo rast jemi përpjekur të sistematizojmë e të krehim prurjet në studimin e tyre të derisotëm, duke i mundësuar studiuesit dhe lexuesit të interesuar ndërmarrje të suksesshme në të ardhmen.

Fjalë kyçe: *‘Meshari’ i Gjon Buzukut, fletë-shqimëzat në ‘Mesharin’ e Gjon Buzukut, humanizmi kristian, humanizmi dhe katolicizmi, Missale Romanum Mediolani (1474), Biblia Sacra Vulgata.*

1. Objekti i studimit

Ky shkrim është i dyti i radhës në triptikun tonë të vëzhgimeve në librin e restauruar të ‘Mesharit’ të Don Gjon Buzukut. Këtu jemi fokusuar në katër fletë-shqimëza si folie me tekst burimor të cunguar keqas, të cilat i janë bashkëlidhur të gjitha në fund korpusit kryesor me tekst të rrjedhshëm të ‘Mesharit’ (= BUM). Teksti burimor, i rrokur në këto folie, pas gjase, si material liturgjik-baritor, rezulton të jetë, me ndonjë përjashtim të rastit, thuajse gjithkund i pazbërthyes për një studiues filolog. Dhe është pikërisht kjo rrethanë që ka bërë që edhe interesimi ndaj sosh të ketë qenë e të jetë tejet modest. Prashtu, në studimet e derisotme buzukiane numërohen me gishtat e njërës dorë ata studiues që rreken të japin informacion qoftë edhe sipërfaqësor, kryesisht lidhur me pozicionin e tyre të dikurshëm në libër (Schirò & Petrotta 1932: 41vv.; Roques 1932: 42; Shuteriqi 1976: 43; 2005: 107; e ndonjë tjetër). Mëngojmë të shtojmë gjithashtu ndonjë ndërhyrje të Eqrem Çabejt (1968 I: 8) në hyrjen e botimit kritik të kësaj vepre, ku ai mendon, se në faqet e parme (recto) dhe të prapme (verso) të shqimëzës së katërt, në të cilat arrijmë të lexojmë së paku deri pesë-gjashtë rreshta teksti të padëmtuar në njërën kolonë. Kështu, në faqen recto kemi një episod biblik që i referohet librit të Gjenezës mbi fatet e Arkës së Noes, e cila pas Përmbytjes së Madhe (*Diluvio universale*) u ndal në malësinë e *Armenisë* (Gjen 8 4 – shqim. IVra = BUM *CXIVvb), bash në (varg)malin e *Araratit* (BUM *CXIV/1vb); ndërsa b) e dyta mund të jetë sipas tij një homili për një episod tjetër tjetër nga Gjeneza mbi dëbimin e Adamit prej Parajsës (Gjen 3 23-24 – shqim. IVvb = BUM *CXIVvb). Për më tepër Philologus Albaniae, me akribinë e tij të zakonshme, u shton në fund të dy blenjeve të tij editorialë të ‘Mesharit’ edhe tejshkrimin dhe transliterimin e atyre pak rreshtave dhe sekuencave grafike të lexueshme në këto shqimëza (1968 I: 293vv.; II: 388vv.). Diskursin shkencor bashkëkohor e ka pasuruar ndërkohë me një ndërhyrje jo të parëndësishme Vinçens Marku (2026: 52vv.), i cili ka marrë në analizë cepin e ruajtur të një gravure (ksilografie) që ndodhet në faqen recto të shqimëzës së parë (shqim. Ir = BUM *CXIr – shih §2.1), duke gjurmuar e gjetur në plotësinë e vet gjegjësen përkatëse në botime të ndryshme të realizuara në Italinë e Veriut në fund të shek. XV deri në dhjetëvjeçarët e parë të shek. XVI. *Last but not least* përmendim këtu edhe një shkrim të natyrës më fort divulgative, anipse me pretendim të mirëfilltë shkencor, që ka për autor Xhevat Lloshin e që është botuar kohët e fundit në gazetën shqiptare “Dita” (16 mars 2026)¹. Meqë në studimin tonë do të na duhet t’u referohemi

¹ Ky shkrim i Lloshit është i dyti i radhës në atë gazetë. I pari daton rreth gjashtë vjet me parë, duke u pagëzuar me titullin mbresëlënës: “Një vështrim tjetër për librin e parë shqip: Meshari i Buzukut dhe Meshari kroat” (“Dita” më 18 dhjetor 2020). Shtojmë këtu që të gjitha mendimet e autorit të shprehura në të nuk i qëndrojnë kritikës shkencore-filologjike; së fundi Demiraj 2026a: 309vv.

shpesh e më shpesh prurjeve të tij në këtë shkrim, po mjaftohemi në këtë rubrikë hyrëse t'i kumtojmë lexuesit fillimisht që Lloshi rreket të fiksojë në këtë shkrim sfondin kulturor-liturgjik të episodit biblik me Arkën e Noes (shqim. IVra = BUM *CXIVra), si edhe me përmendjen krejt të izoluar të emrit të Adamit (shqim. IIbv = BUM *CXIIbv), çka e nxit atë në vijim të përsiasë konkretisht e si gjithmonë prerazi e në formë rezultative pamje nga më të ndryshmet që kanë të bëjnë me krijimtarinë e Buzukut në përgjithësi, me organizimin e librit të tij, si edhe me do çështje të natyrës tipografike gjatë procesit të përgatitjes për shtyp të 'Mesharit' në shtypshkronjë.

Gjithë sa parashtruam më sipër përbën pak a shumë edhe objektin e studimit të shkrimit tonë. Pra do të mjaftohemi që të nxjerrim në pah atë qerthull problematik që ngërthen njohja dhe shqyrtimi i katër fletëve-shqimëza të 'Mesharit' si të tilla, duke shtjelluar nga afër së pari atë çka mund të mësojmë lidhur me përmbajtjen e tekstit të ruajtur në to, pasuar kjo me pozicionin e tyre burimor në libër. Trajtimi i këtyre dy çështjeve e bën të pashmangshme prekjen e një të trete, e cila nxit diskutim të mëtejshëm lidhur me organizimin e tekstit dhe sendërtimin e tij si produkt tipografik. Shtojmë gjithashtu, veçse kjo vetëm si sinor orientues për lexuesin që është dashamir ndaj mundit të çdo studiuesi modest, që është marrë e merret në mënyrë intensive me Buzukun dhe 'Mesharin' e tij, se fokusimi në këtë qerthull problematik mbështetet në një material tekstual tejet të rrudhur e shumëkund të pazbërthyeshtë e që, pas gjase, i është nënshtuar procesit të një restaurimi tërësor të librit, para se ai të bëhej pronë e diskursit shkencor-filologjik. Andaj edhe rezultatet e arritura në këtë shkrim duan parë e vështruar në disa raste më fort si nxitje që mundëson kërkime të mëtejshme në të ardhmen.

2. Fletë-shqimëzat në vetvete

Në vijim do t'i përcjellim lexuesit atë material liturgjik të gjymtuar që mbartin shqimëzat në vetvete, duke u përqendruar sidomos në përshkrimin e tyre fizik në këtë ekzemplar unik e brenda mundësive edhe në përmbajtjen që lejon ngjërimi i tekstit në ndonjë syresh.

2.1 Paraqitje tabelare e shqimëzave

Tabelat e mëposhtme përcjellin informacion sado të mangët për ato pjesë që i kanë shpëtuar gjymtimit në ato katër folie (= fletë), të cilat i bashkëngjiten në fund librit të restauruar, e që janë tejshkruar e transliteruar më parë nga Çabej (1968 I: 293-299; II: 388-403). Meqë materiali tekstual i ruajtur në tri foliet e para është fare i pakët, i kemi rrokur të tria në një tabelë të përbashkët, duke përdorur numërimin imagjinar sipas folieve dhe faqeve para e mbrapa (r/v = recto/verso) që vijnë menjëherë pas korpusit kryesor të librit me material liturgjik. Aty kemi mbajtur parasysh edhe kolonat përkatëse në secilën faqe (a/b = majtas/djathtas), ku i kemi mbetur besnikë pozicionit të tyre ekzistues në

ekzemplarin e restauruar: fol *CXIr/vb, *CXIIra/vb dhe *CXIIIra/vb (= *111ra/vb, 112ra/vb, *113ra/vb – Demiraj 2026b). Ndryshe nga to për folien e katërt janë parashikuar dy tabela të tjera që përcjellin atë pjesë teksti të ruajtur në dy kolonat e secilës faqe: fol *CXIVr/v (= *114r/v) me nga dy kolona secila (a/b).

Sa u përket parametrave të tjerë teknikë, që janë mbajtur parasysht në paraqitjen tabelare, shtojmë këtu, se kemi përdorur në to:

- rrethin para ose mbrapa një fjale, apo sekuence shkronjash të pazbërthyeshme, i cili tregon këputjen e rreshtit përkatës para (djathtas) dhe prapa (majtas) asaj pjese teksti që i ka shpëtuar gjymtimit të plotë;
- kllapat katrore me viza lidhëse ndërmjet: [---], që sinjalizojnë vështirësi leximi të shkronjave dhe fjalëve;
- shenjën e asterikut: *XXX, që shënon numërimin e rindërtuar të shqimëzave përkatëse;
- vizën lidhëse pa kllapa për markimin e rreshtave të rrëgjuar njëherë e përgjithmonë.

Tabela nr. 1: BUM *CXI – *CXIII (= *111r/v - *113r/v)

Shqimëza I – BUM *CXI		Shqimëza II: BUM *CXII		Shqimëza III: BUM *CXIV	
Ir[a]	Iv[b]	Iir[a]	Iiv[b]	IIir[a]	IIiv[b]
	°qi kish kri- °unë ëmbë- °unë gurë °birë se °o@ ëm- °e ma- °u lu- °i: e °ba- °tere °i tī °ëm °a- °qi °e - - - - -	në: pat b° në: ashtu° paç: a° dheut k° trat e° tyne° një° Ajo° *[---] tu° p° p° *[---] g° v° n° b° f° e° t° -	°ti ata °enjënë °adamnë °pā të °le të °vër- °të- °pa- °rse- °ē °u *[---] °h °s *[---] °e - - - - - -	ert° e aj° klenë° nj° të° pe° e ° g° - - - - - - - - - - -	°Zotynë °e shkru- °që fort °qie- °uie- °dja- °e °e °er °e - - - - - - - - - -

Tabela nr. 2: BUM *CXIVr (= *114r)

Shqimëza IVr	
Ivra	Ivrb
mitë tem t u ap, e për bij ata të ëmbā. Ëndë Armeniet arka u gjet, po- si u ënde e shkruom vgjanj, ëndër dý mal qitunë. E tha Noeq: Gjithëkush jashtë vete. E ju gjegjitë, qish Zotynë foli:	të vetëmë Zot ju kin° as pr emënë të tī° bātë fes° atënë° e°

Djerie mos na venë ëmbë ligj të rë.	-
Gjithëkush dëreq ecnjë e jashtë°	-
patnë Tenëzonë tue lëvduom°	-
qi aj shëlbuam i kish. End°	-
erdh e madhe qartë sã vel°	-
vetëhenë u muorë. E°	-
duoj me klenë u°	-
do ën sish pjesën°	-
të madh të de°	-
kish, dha bi°	-
rie ën baq°	-
Ëmbas°	-
dihe se°	-
mase a°	-
ditënë°	-
pat v°	-
ni e°	-
vde°	-
të°	-
b°	-
f°	-
-	-
-	-

Tabela nr. 3: BUM *CXIV_v (= *114_v)

Shqimëza Iv	
IVva	Ivvb
°regjëninë tande ti më	vuna të madh të dashunë. E u atë ën-
°kambë tajtë	dë Parisit shtina e porsi vetëveti afi
°ëm	dhae ëndër. E ën gjithësej u atë bana
-	me ditunë, e u atë e paçë bëtë zot
-	përëmbi gjithë shekullinë. E prashtu aj gjã
-	s më pat qyrë e për despjek tem aj
-	°se gjarpënit. E ëmbassi ka-
-	°atë u ëmbeçë një copë të
-	°[u]e pritunë, e aj tek u s erdh
-	°ita u e u atë ëm zã
-	°[nj]ë copë të madhe mu
-	°erdh aj desh më qi-
-	°të shoqt tue thashunë
-	°e më bani ëm
-	°të kish tha-
-	°në pëlqen
-	°u nukë
-	°ma ti
-	°o mos
-	°gjithë faj
-	°ven
-	°tash e për
-	°e
-	-

2.2 Përmbajtja e shqimëzave

Falë paraqitjes tabelare më lart (§2,1) lexuesi nuk e ka të vështirë të vijë në përfundimin se në tri foliet e para, përpos cepit të ksilografisë që del në faqen recto të shqimëzës së parë (Ir = BUM *CXIra – shih §2.1), të gjitha ato pjesë teksti që i kanë shpëtuar rrëgjimit të plotë nuk lejojnë në asnjë rast të arrihet në ndonjë përfundim të sigurt, sa i përket përmbajtjes së materialit liturgjik që fshihet në to. Veçojmë këtu vetëm një rast në shqimëzën e dytë, ku ngjërëjmë, edhe pse krejt të izoluar, emrin biblik të Adamit (fol IIv[b] = BUM *CXIIvb: <adamne> = /Adamnë/ – shih §2.1). Ky emër lejon së paku të deduktojmë me afërsi ndonjë histori biblike që ka të bëjë drejtpërdrejt ose tërthorazi me librin e Gjenezës, siç përsiat edhe Lloshi (2026), anipse atë e hasim edhe gjetkë në Besëlidhjen e Vjetër (khs. 1 Kron 1 1). Gjithsesi, për mungesë të mjedisit tekstual nuk jemi assesi në gjendje të fiksojmë dot, nëse bëhet fjalë aty për personin e Adamit si krijesa e parë njerëzore (Gjen 4 25; Gjen 5 1-5; etj.), apo për ‘Njeriun’ (= hebr. אָדָם /ádam/) si qenie njerëzore e dallueshme prej qeniesh dhe llojesh të tjera biologjike në botën përreth (Gjen 4 25), në mos edhe për emrin e toponimit përkatës (Ozea 6 7)².

Diçka më shumë, edhe pse jo mjaftueshëm, mësojmë në dy tabelat ndjekëse, përkatësisht në ato pjesë teksti të ruajtur në dy kolona të faqeve recto dhe verso në folien e katërt: IVra dhe IVvb (= BUM *CXIVr/v – shih §2.1). E për to i jemi së pari mirënjohës Çabejt (1968 I: 8), që pikasi po i pari, se: “Vetëm njëra [shqimëz – B.D.] shihet se përmban një copë nga historia e Noeut (Gjeneza, kap 8 10), e cila përndryshe na jepet më e plotë në f. LXv, që në të vërtetë është *LXXv [e Mesharit – B.D] . Një tjetër shkimëz (tek ne shënuar me Nr. 7), duket të përmbajë një homili rreth dëbimit të Adamit prej parajsës.”

Këto dy copëza teksti, të cunguara keqas, së bashku me informacionin e çmueshëm të Çabejt mbi to, sidomos sa i përket episodit biblik mbi Noen, i cili i kujton edhe gjegjësin përkatës të zhvilluar hollësisht në korpusin kryesor të

² Lloshi në shkrimin e cituar (2026) mëton se bëhet fjalë këtu për Adamin si krijesa e parë njerëzore në tokë, duke siguruar njëherësh lexuesin, se: “Nga faqja 1 e Shtojcës nuk ka shpëtuar asnjë fjalë. Në faqen 2 janë fjalë të plota vetëm: *kish, qi, gurë, se, i ti*; në faqen 3 janë: *pat, ashtu, paç, dheut, atyne, një, ajo*. Në faqen 4: *ata, Adamnë*. Këtu është e detyrueshme ndalesa. Është emri i njeriut të parë, Adamit dhe del për herë të parë në Bibël në kreun e dytë të librit të parë: Gjenezës (K. Kristoforidhi e ka quajtur Kriesa dhe sot e përkthejnë Zanafilla). Është tregues i qartë, se pikënisja ka qenë Gjeneza dhe tri faqet e para kanë qenë për krijimin e dheut, të qiellit, të ditës e të natës dhe të kafshëve, të bimëve e të njeriut. Edhe te faqja 5 lexohen vetëm dy fjalë, te e gjashta katër-pesë fjalë...”. Nga ky paragraf lexuesi nuk e ka vështirë të kuptojë se përfundime të tilla imponuese janë të barazvlefshme me parashikimet (e dikurshme) të fatit, kur (lexohej e) lexohet shputa e dorës apo llumi i mbetur në filxhanët e kafes.

‘Mesharit’, na krijon tash një mundësi sado të brishtë me ndërmarrë paraprakisht përjasje mes emrash të përveçëm me të njëjtin funksion brenda përbrenda ‘Mesharit’, çka lejon më tej edhe kërkimin dhe njohjen nga afër të atyre modeleve, ku është mbështetur Buzuku në librin e tij. Andaj le të vendosim fillimisht përballë njëri-tjetrit këto dy vende në ‘Meshar’, ku përmendet emri i Noes me Arkën e tij, pikërisht në ndalesën e saj të parë dhe të fundit sipas episodit biblik të Përmbytjes së Madhe, si vijon:

Tabela nr. 4: Episodi biblik i Noes

Historia e Noes: Gjen 8	
BUM *CXIVra	BUM LX/1vb (= *LXXvb) [Sabbato Sancto: E dyta lektion e Gjenezit – Gjen 8]
... [fë]mitë tem t u ap, e për bij ata të ëmbā. Ēndē Armeniet arka u gjet, po-si u ěnde e shkruom vgjanj, ěndēr dŷ mal qitunē. E tha Noeŷ: Gjithēkush jashtë vete. E ju gjegjtē, qish Zotynē foli: Djerie mos na venē ěmbē ligj tē rē. Gjithēkush dēreq ecnjē e jashtë° patnē Tenēzonē tue lēvduom° qī aj shēlbuam i kish. End° erdh e madhe qartē sā vel° 	... 4 E u pushuo barka ěndē tē shtatēt muoj, tē shtatēnēěmbēdhjetē ditē tē muojt, pērēmbi malt tē Araratit. 5 E ěmbas katērdhjetē diçç ěmbassi u panē majēnatē, ěnçeli Noe fēnjeshtērē e barkēsē, e dērgoi korbņē, qī mā nukē ktheu, djeri sā u thanē ujēnatē pērmbi dhēt..... ... 15 E foli Zotynē Noeut, tue i thashunē: 16 Del jashtë ti e gruoja jote, e bijtē e tū, e gratē e d bijet tuve. ...

Një lexim sado i përciptë i këtyre dy copëzave të leximit në dy vende të ndryshme të ‘Mesharit’ na qartëson për nga këndvështrimi i analizës së tekstit se ato, përpos kumtit të përbashkët mbi historinë e Noes me Arkën e tij, nuk lejojnë mirëfilli asnjë përjasje ndërtekstuale me njëra-tjetrën. Dhe arsyeja është e thjeshtë, pra bindëse: Ndërsa në copëzën e dytë (djathtas) kemi të bëjmë me një përkthim prej dorës së Buzukut të një numri versësh si pjesë e një perikopeje që i referohet Besëlidhjes së Vjetër (E Shtuna e Madhe, profecia e dytë = BUM LX/1vb: Sabbato Sancto: E dyta lektion e Gjenezit: Gjen 5 31; 6 1-22; 7 1-24; 8 1-21), në të parën (majtas) Buzuku kumton me stil të lirë: a) fillimisht të njëjtin episod biblik, veçse duke e riprodhuar atë në vetën e parë të autorit, bash ashtu siç e ka gjetur e lexuar ai vetë në Shkrimin e Shenjtë: /si u ěnde e shkruom vgjanj/, duke vendosur më pas b) në vetën e tretë dhe në

personin e Noes pak a shumë ato fjalë që ai vetë, sipas Shkrimit të Shenjtë, i merr në formë urdhërese prej Hyjit³.

Meqë të gjitha perikopetë në ‘Mesharin’ e Buzukut që i referohen librit të Gjenezës i kemi rrokur si të tilla në një studim të ardhshëm mbi çështje të përkthimit në tekstin e lidhur të ‘Mesharit’, do të ndalemi në vijim vetëm te një anomali në dukje, sa i përket ballafaqimit të dy toponimeve që na shfaqen në këto dy pjesë teksti, por që mbartin të njëjtin funksion. Bëjmë fjalë këtu për emrin e *Armenisë* (BUM fol *CXIVra = shqim. IVra) që rezulton i barasvlershëm me atë të (varg)malit të *Araratit* (BUM fol LX/1vb = *LXXvb). Këtë detaj e ka vënë në dukje i pari studiuesi Xhevat Lloshi d.v. në shkrimin në fjalë (2026), duke mëtuar se i ka dalë çështjes në themel. Është pikërisht kjo rrethanë një arsye më shumë që pikërisht ky shkrim fiton edhe për ne përparësi në hulumtimin, si vijon:

2.2.1 Përsiatjet e Lloshit

Me dëshirën dhe synimin për të qenë sa më të saktë në atë çka shkruan dhe kumton Lloshi në këtë shkrim, le të përcjellim tash me thonjëza përsiatjet përkatëse:

“Mirëpo Buzuku i ka fjalitë me këtë përmbajtje edhe në faqen LXXb pikërisht te Gjenezë 8:4: “E u pushuo barka nd të shtatët muoj, të shtatënëmbëdhjetë ditë të muojit, përmbi malt të Araratit.” Bie në sy se janë dy variante mjaft të ndryshme. Jo pak herë variante ka në veprën e Buzukut, por këtu shfaqet një dallim i mprehtë: *te Meshari emri i vendit është “mali i Araratit” dhe kështu është në origjinalin latinisht; te Shtojca është Armenia dhe ky emër nuk ndeshet në Bibël* [vendosja në kursiv prej nesh – B.D.]. Vetë Buzuku ka qenë i ndërgjegjshëm për këtë dallim, sepse thotë: “Ndë Armeniet arka u gjet, por si u nde e shkruom vgjanj, ndër dy mal qitunë.” Kjo pjesë e rrëfimit është në kreun 8 të Gjenezës, rrjedhimisht **përmbajtja e Shtojcës është nga Gjenezë.**

Kjo mospërputhje ndihmon për të rrokur natyrën e kësaj përmbajtjeje: *Shtojca nuk është përkthim nga Bibla, meqë te Gjenezë është mali i Araratit.* Shpjegimi është ky: me kalimin e kohës, ndonëse mali i *Araratit* është sot në Turqinë lindore, është bërë sinonim i *Armenisë* në kuptimin simbolik, aq sa sot ka edhe një raki të njohur armene me emrin e *Araratit*. Emrin e *Armenisë* Buzuku e ka ndeshur për këtë shtojcë në ndonjë tekst popullarizues për historinë e Shkrimit të shënjtë [...] Detyrimisht lind pyetja: në cilën gjuhë ka

³ Ndoshta kemi të bëjmë edhe në këtë rast me një homili në ‘Mesharin’ e Gjon Buzukut, njëlloj siç supozon Çabej (1968 I: 8) për atë pjesë teksti të gjymtuar keqas në faqen verso të së njëjtës fletë-shqimëz? Shih edhe §2.3.

qenë teksti, te i cili është mbështetur Buzuku? Nuk mund të ishte latinisht, sepse njerëzit e zakonshëm nuk e njohin latinishten. Mbetet të ketë qenë një burim italisht dhe prej andej është marrë emri i *Armenisë*. Ndër argumentet gjuhësore po sjell një fjalë: "Gjithë kush jashtë vete. Gjithë kush dëreq ecnjë jashtë". Është një ndërtim nga ana semantike dhe sintaksore jo sipas natyrës së shqipes. Drejt do të ishte "Gjithkush të dalë jashtë. Gjithkush të dalë drejt e jashtë". Janë fjalë, që Perëndia ia thotë Noeut te Gjenezë 8:16 herën e parë për veten "egredere de arca tu et uxor tua", ndërsa herën e dytë i thotë për kafshët "ato të dalën jashtë me ty" (LXXI). Shihet qartë, që krejt ndryshe ishte në tekstin latinisht dhe madje në vetë përkthimin që kishte bërë Buzuku, prandaj mbetet vetëm mundësia që burimi të ishte prej italishtes.

Në kohën e Buzukut libri më i përhapur italisht për Gjenezën ka qenë "Il Genesi" i autorit Pietro Aretino (1492-1556), botuar më 1539. Nga krahasimi që kam bërë, më del se nuk ka qenë burim për Buzukun, madje emrin e vendit e ka "Harmania", kështu që duhet bërë një kërkim i mëtejshëm⁴.

[...]

Shkurt, Shtojca është me dorën e Buzukut, ka përmbajtje nga dhjetë krerët e parë të Gjenezës, nuk është përkthim nga latinishtja, ndonëse autori thotë se e gjen në Shkrimin e shenjtë, por ose është përpunim i tij, ose është mbështetur në ndonjë tekst italisht."

Prej gjithë sa ngjerojmë prej Lloshit në këtë kumt me ndërhyrje rezultative dhe të fiksuara njëherë e mirë, lejohe mi të përmbledhim, sa vijon:

- Lloshi përjashton me një të rënë lapsi konsultimin e Biblës latinisht, që vjen me thënë të Vulgata-s, nga ana e Buzukut së paku atë mot, kur i është dashur të hedhë në letër për të dytën herë episodin e Noes, përkatësisht ndalesën e Arkës së tij në malet e *Armenisë* (fol *CXIVra = shqimëza IVra). Ky përfundim është sipas tij rrjedhojë e thjeshtë logjike, që mbështetet thellësisht në faktin, se në Biblën latinisht përdoret toponimi tjetër, bash mali i *Araratit* si përdorim i barasvlershëm me atë të *Armenisë*, pikërisht ashtu siç e mësojmë në plotësinë e tij në 'Meshar' (fol LXbv = *LXXbv) në perikopenë përkatëse, që është sipas tij përkthim prej "origjinalit latinisht". Lloshi madje nuk mungon ta dyllosë me siglën e vet këtë përfundim

⁴ Kërkimi i mëtejshëm në këtë rast i ndonjë teksti të përafërt italisht ose latinisht në letërsinë liturgjike-baritore të gjysmës së parë të shek. XVI është njëlloj si të kërkosh gjilpërën në kashtë.

po të vetin, duke përmendur edhe emrin e një rakie të mirënjohur armene që qenkësh pagëzuar me emrin e *Araratit*. Por jo vetëm kaq:

- Operacionin logjik Lloshi e vijon më tej, duke futur në lojë për rastin e *Armenisë* tekste liturgjike-pastorale italisht. Këtë përsiatje ai e mbështet me një argument për mendimin tonë alogjik dhe krejt të pabazë, duke shtuar se njerëzit e zakonshëm atëherë nuk e njihnin latinishten. Por cilët ishin atëbotë ata njerëz të zakonshëm e me shkollë që blinin dhe lexonin libra italisht, sikurse edhe ‘Mesharin’ shqip? Gjithsesi Lloshi këmbëngul fort në këtë përfundim, anipse lundrimet që paska kryer në burimet italisht të kohës, ndër to edhe në librin e Gjenezës prej kompiluesit të njohur, Pietro Aretino (1536)⁵ d.v., siç kumton edhe vetë, kanë ngecur, me sa duket, të gjitha në malet e *Armenisë*, njëlloj si Arka e Noes.

- Një detaj i fundit, më saktë mungesa e tij në rrugëtimin sa alogjik, aq edhe të gabuar të Lloshit është edhe heshtja në këtë rast ndaj materialeve liturgjike kroatish, sidomos e Mesharit Glagolit kroat (1483), të cilin Lloshi nuk lë rast e sebep pa e përmendur (Lloshi 2020), duke ngulmar të bindë mjedisin kulturor-intelektual se është pikërisht ky modeli burimor që Buzuku e ka përkthyer fjalë për fjalë e rresht për rresht gjatë sendërtimit në letër të ‘Mesharit’.

2.2.2 Lajthitjet e Lloshit

Ja që gurin që hedh Lloshi ynë në lumë nuk ka nevojë të rreken 100 studiues për ta nxjerrë. Falë autopsisë që u detyruam t’ia nënshtonim këtij kumti, bash në këtë shkrim të tij të dytë (2026), vijmë tani natyrshëm në përfundimin se Lloshi e ka bjerrë ndërkohë sensin kritik sikurse seriozitetin shkencor sa të detyrueshëm, aq edhe të nevojshëm, qoftë në sjelljen korrekte ndaj lëvruesit më të hershëm në kulturën e shkrimit shqip, ashtu edhe, madje sidomos, ndaj studiuesit filolog dhe lexuesit të interesuar për këtë kulturë. Dhe është fakt që shqyrtimi i hollësishëm i materialit që disponojmë, i vatërzuar ky në lupën e analizës përqasëse

⁵ Lidhur me librin e Aretino-s kemi mundur të konsultojmë dy ribotime të tij të viteve 1538 dhe 1551 (f. [11v-] 12r). Episodi në fjalë përshkruhet aty në fakt me stil të lirë, veçse si gjithmonë sipas radhës së versëve në librin e Gjenezës në variantin e kanonizuar të Vulgata-s, ndërkohë që bashkëpërkimet me tekstin e shqimëzës të Buzuku janë minimale, më saktë rrudhen vetëm në ndalesën e Arkës së Noes në male (dhe jo si Buzuku / ëndër dy mal qitunë /) të *Armenisë*, khs.: “...passati i cento quaranta di, il rimescolamento de gli humori dolci, & salsi cominciarono à scemare: onde l’arca si rimase in su i monti di Harmenia nel settimo mese, a i uentisette di. & il primo del decimo apparirono le pùte de i monti, & isminuendo del continuo l’acque...” (Aretino 1551: 11v-12r)

ndërtëkstuale, të shpie natyrshëm në përfundime diametralisht të kundërta, të cilat po i rreshtojmë, si më poshtë:

a) Emrin e maleve të *Armenisë*, si vendi biblik ku përjetoi ndalesën e parë dhe të fundit Arka e Noes, e ngjerojmë të vetëm, pra pa kurrfarë konkurrence prej toponimit tjetër biblik të (varg)malit të *Araratit*, në burimin origjinal të Biblës latinisht (= *Biblia Sacra Vulgata* – BSV), e cila përdoret si tekst i kanonizuar në Kishën Katolike Romake prej shek. VII (AD) dhe mbart me sigël autorësie të parë përkthimin nga hebraishtja dhe greqishtja e vjetër të Shën Hieronimit (fundi i shek. IV AD). Të njëjtën rrethanë përjetojmë edhe në përkthimin italisht të Vulgata-s prej Niccolò Malermi-t si në botimin e saj të parë (*Biblia Italica*. Venedik 1481 – BI), ashtu edhe në ribotimet e radhës, së paku deri në motet e Buzukut. Andaj nuk kemi përse bëjmë aspak çudi që këtë toponim e ndeshim njëlloj edhe në librin e Aretino-s (1536), i cili mbështetet kryekëput në Vulgata-n dhe përkthimin italisht të Malermi-t.

b) Por jo vetëm kaq. Nuk dimë, nëse e ka konsultuar dhe gjetur këtë emër Lloshi në Mesharin Glagolit kroat (1483), të cilin nuk lë rast pa e vënë në dukje dhe cituar si model i 'Mesharit' të Buzukut. Le të kërkojë edhe në këtë drejtim, veçse vështirë se do të qullasë gjë. E kjo për një arsye po aq të thjeshtë, më saktë triviale: asnjë ndër të dyja toponimet biblike në fjalë nuk e ndeshim në Mesharin Romak të Milanos (1474 – MRM), i cili pranohej gjithkund në historinë ekleziastike si Meshari Romak me tekst të kanonizuar në Kishën Katolike Romake, duke shërbyer kështu si model burimor në variantet e shumta latinisht deri para botimit të Mesharit Romak Tridentin (Romë 1570), pra edhe në të famshmin variant kroat të Mesharit Glagolit (1483), të cilin e valëvit lart e më lart Lloshi (hollësisht së fundi Demiraj 2026: 309vv.). Arsyeja, përse asnjë nga dy emrat toponime në shqyrtim nuk na shfaqet në MRM është po aq e thjeshtë dhe po aq triviale: versët 4 dhe 5 në kreun e tetë të librit të Gjenezës nuk janë rrokur kurrkund në atë perikope që lexohet e këndohet me atë rast, kur çohet mesha përkatëse sipas Ritit Katolik Romak, khs. MRM 179-181: *Sabbato Sancto, prophetia secunda: Gen ...8 1-3, 6-12, 15-21*).

Lajthitjet e Lloshit, i cili me sa duket nuk i ka futur ende këmbët siç duhet në ujë kur bëhet fjalë për letërsi liturgjike katolike, i bëhen edhe më të qarta, më saktë edhe më flagrante, lexuesit, në rast se analizën tonë kritike ndaj shkrimit të Lloshit e ilustrujmë tash me përfundimet tona në tabelën e mëposhtme, ku kemi rreshtuar tekstin burimor të Vulgata-s latinisht (BSV), përkthimin e saj italisht

prej Malermit (BI), përkatësisht mungesën e saj në Mesharin Romak të Milanos (MRM), si vijon:

Tabela 5: Shembuj prej librit të Gjenezës (kreu 8) në BSV, MRM dhe BI

Versi	Besëlidhja e Vjetër: Libri i Gjenezës, kreu 8		
	BSV	MRM 180	BI
2	...	...	...
3	reuerseque aque de terra euntet et redeuntet et coeperunt minui post centum quinquaginta dies	Reuerseque sunt aque de terra euntet et redeuntet. et ceperunt minui: post centum quinquaginta dies.	Et le aque retornorono nela terra: andante: & retornante. & cominciorono a sminuire doppo cêto & quarâta di.
4	requieuitque arca mense septimo uicesima septima die mensis super montes Armenie	[mungon]	Et l'archa se riposo sopra gli monti de armenia nel septimo mese: nel uigesimo septimo di del mese.
5	at uero aque ibant et decrescebant usque ad decimum mensem decimo enim mense prima die mensis apparuerunt cacumina montium	[mungon]	& le aque andauano & discesce uano infino al decimo mese. Et nel decio nel primo di del mese: apparseno le cime di monti.
6	cumque transissent quadraginta dies aperiens Noe fenestram arce quam fecerat	Cumque transissent quadraginta dies aperiens noe fenestram arche quam fecerat.	Passati li quaranta giorni Noe aprendo la fenestra de l'archa che hauea facta l'asso
7		...	...

Kjo tabelë dëshmon qartë dhe saktë se si faktet flasin me një gjuhë krejt tjetër, ndërkohë që ato që i sjell Lloshi lexuesit të thjeshtë gazetës “Dita” dëshmojnë krejt të kundërtën, më saktë ato përcjellin mosnjohje që shpie natyrshëm në manipulimin e tyre, çka ndikon vetëm negativisht për lexuesin e interesuar që nuk ka patjetër formim filologjik-teologjik.

c) Për më tepër, teksti liturgjik i asaj perikopeje në ‘Meshar’ ku ngjërojmë emrin e malit të *Araratit* nuk ndeshet gjëkund në burimin origjinal të Vulgata-s (BSV). Përkundrazi këtë toponim si emër biblike e ngjërojmë në variantin burimor të mëhershëm greqisht të Septuaginta-s (= SEPT) e që këtej – falë ndikimit të rrymës së Humanizmit Kristian në Europën e gjysmës së parë të shek. XVI – ai erdhi dhe u përkthye, krahas varianteve burimore në hebraisht, në gjuhët e gjalla të kohës, ndër to edhe në italisht prej humanistit të

mirënjohur Antonio Brucioli (1932-1934 – BRU). Për formimin intelektual-teologjik humanist të Buzukut, si edhe për ato modele me karakter të theksuar humanist-kristian që ka shfrytëzuar Buzuku, së paku në sendërtimin e pjesës së dytë të librit të tij, kemi shkruar gjerë e gjatë edhe në monografinë tonë të fundit (Demiraj 2026a: 165vv.). Tash na mbetet vetëm të shtojmë, që malin e *Araratit* si emër biblik e lexojmë natyrshëm edhe në pjesën e dytë, atë të mesharit, shi në ‘Mesharin’ e Gjon Buzukut. E kjo për një arsye po aq të thjeshtë, madje njëlloj si më lart në pikën (a): Siç kemi vënë në dukje më parë në monografinë tonë, Buzuku ka shfrytëzuar për pjesën e mesharit (= pjesën e dytë) në librin e tij letërsinë baritore-liturgjike humaniste të kohës. Andaj nuk bëjmë aspak çudi që këtë emër e lexojmë në perikopenë përkatëse në një leksionar (= libër perikopes) latinisht-italisht si botim anonim i vitit 1551 në Venedik (= LEE 1551 lat/it). Gjithsesi edhe te ky leksionar toponimin në fjalë e ndeshim vetëm në variantin e tij (humanist) italisht, ndërkohë që varianti i tij (klasik) latinisht ndjek fjalë për fjalë e rresht për rresht tekstin e perikopeve që ngjerojmë në Mesharin Romak të Milanos, ku versët 4 dhe 5 mungojnë plotësisht.

Këtë rrethanë në dukje të pazakonshme, lexuesi mund ta konsultojë vetë më poshtë në tabelën që po i përcjellim si për ilustrim:

Tabela nr. 6: Shembuj prej librit të Gjenezës (kreu 8) në BUM, LEE it/lat

Versi	Besëlidhja e Vjetër: Libri i Gjenezës, kreu 8		
	BUM LX/lvb	LEE 1551 it	LEE 1551 lat
2	...	...	...
3	E mënguonë ujënatë tue votë e tue ardhunë, ëndë krye të njëqindë e pesëdhjetë dite.	& mǎcorno le acque nel fine di cento & cinquanta di,	Reuersæq; sunt aquæ de terra euntes & redeuntes: et cœperunt minui post centum quinquaginta dies.
4	E u pushuo barka ëndë të shtatët muoj, të shtatën-ëmbëdhjetë ditë të muojt, përëmbi malt të Araratit.	& riposossi l’arca nel mese settimo, a diecesette di del mese sopra i mōti di Ararath.	[mungon]
5	E ujënatë por kthenjinë tue mënguom, djerie të dhjetëtë muoj; e ënde e dhjetët, të parënë ditë ëndë muojt, u panë majënatë e malet.	Et le acque andauano, & mancauano infin’al mese decimo, & nel decimo, nel primo di del mese furno uedute le cime de i monti,	[mungon]

6	E ëmbas katërdhjetë diçç ëmbassi u panë majënatë, ënçeli Noe fënjeshtërë e barkësë,	& ne la fine di quaranta di, aperse Noe la fenestra de l'arca.	Cūq; transissent quad- raginta dies, aperiens Noe fenestrā arcæ quā fecerat.
7		...	...

Vëzhgime:

- Kjo tabelë qartëson si drita e diellit prirjet e Buzukut së paku në realizimin e pjesës së dytë të librit të tij, pikërisht në atë të mesharit brenda 'Mesharit', duke parapëlqyer në përkthim variante humaniste të Shkrimit të Shenjtë, në rastin konkret të Besëlidhjes së Vjetër, burimi të cilave është pa dyshim Septuaginta në greqishten e vjetër, sikurse tekstet burimore përkatëse në hebraishte. Andaj le të citojmë në vazhdim si pjesë të analizës përqasëse ndërtekstuale edhe versët gjegjës (4-5) nga libri i Gjenezës në variantin e Septuaginta-s si edhe në variantin italisht (si përkthim prej hebraishtes) nga Brucioli (1532-1534), khs.: Sept: <...(4:) καὶ ἐκάθισεν ἡ κιβωτὸς ἐν μηνὶ τῷ ἑβδόμῳ, ἑβδόμῃ καὶ εἰκάδι τοῦ μηνός, ἐπὶ τὰ ὄρη τὰ Αἰμαθ. (5:) τὸ δὲ ὕδωρ πορευόμενον ἤλαττονοῦτο ἕως τοῦ δεκάτου μηνός· ἐν δὲ τῷ ἑνδεκάτῳ μηνί, τῇ πρώτῃ τοῦ μηνός, ὤφθησαν αἱ κεφαλαὶ τῶν ὀρέων....>; BRU: <...(4) & riposossi l'arca nel mese settimo, à diecesette di del mese sopra **i monti di Ararath**. (5) Et le acque andauano, & mancauano infino al mese decimo, et nel decimo, nel primo di del mese furno vedute le sōmita de monti....>.

Të dyja tekstet shtesë të marra në analizë përkohë pikë për pikë me tekstin e Buzukut, sikurse me atë të variantit italisht të leksionarit anonim të vitit 1551, që regjistruam më lart në tabelë (hollësisht së fundi Demiraj 2026a: 303vv.). Që varianti latinisht i këtij teksti nuk i rrok fare këta versë, kjo rrethanë shpjegohet thjesht, pra bindshëm, me faktin ndërkohë të mirënjohur, se ky variant me mungesat në fjalë është një transponim i pandërmjetshëm i të njëjtit mjedis tekstual që ngjërojmë në Mesharin Romak të Milanos e ndërmjetshëm edhe në Mesharin Glagolit kroat.

- Fakt është gjithashtu që edhe në letërsisë liturgjike të mëvonshme latinisht, siç është p.sh. Meshari Romak i reformuar Tridentin (Romë 1570) këta dy versë nuk janë të pranishëm në perikopenë përkatëse.
- Nga gjithë sa u tha më lart, i kemi mbetur borxh tani lexuesit vetëm përgjigjen e një pyetjeje të fundit: Përse del në tekstin e gjymtuar të shqimëzës së katërt (IVra) emri i *Armenisë*? Për mungesat dhe mangësitë e mëdha që mbartin fletët-shqimëza në tërësinë e vet, pra jo vetëm lidhur me këtë episod biblik, duhet të pranojmë që kësaj pyetjeje sot për sot nuk jemi në gjendje t'i japim një përgjigje të

drejtpërdrejtë. Prashtu do të mjaftohemi paraprakisht të orientojmë lexuesin e interesuar në larminë e materialit liturgjik që përcjell 'Meshari', çka kushtëzonte shfrytëzimin e një letërsie liturgjike-baritore gjithfarëshe nga ana e Gjon Buzukut gjatë punës së tij të vështirë e të lodhshme për sendërtimin në letër të bardhë të kësaj ndërmarrjeje madhore.

Nga gjithë sa u tha më lart, nuk e kemi tash aspak të vështirë të mbyllim këtu çështjen mbi shfaqjen e episodit biblik të Noes me Arkën e tij në dy vende të ndryshme të 'Mesharit', duke ardhur natyrshëm në përfundimin se rezultatet e kërkimeve tona, së bashku me ilustrimet më lart provojnë vetëm të kundërtën e asaj që mëton Lloshi në shkrimin e vet. Lajthitjet e rënda dhe në vazhdimësi të këtij studiuesi në studime të kësaj natyre ndikojnë vetëm negativisht (edhe) te lexuesi i thjeshtë dhe modest i gazetës "Dita", sepse i japin atij një orientim krejt të gabuar në akumulimin e dijes mbi Buzukun dhe 'Mesharin' e tij. Por jo vetëm kaq, Lloshi i mbetet diçka borxh edhe studiuesve dhe specialistëve filologë shqiptarë e të huaj, meqë në këtë rast askush nuk mëson dot prej tij, nëse ai ka kërkuar e gjetur dikur tekste të ngjashme në Mesharin Glagolit apo në letërsinë liturgjike kroate të kohës, të cilat i trumbeton gjithherë me hosana si modele burimore, që i paskan shërbyer Buzukut në realizimin e librit të tij.

2.3 Faqja verso e shqimëzës së fundit: IVva/b

Siç përmendëm që në hyrje të studimit tonë (§1), në kolonën e djathtë të faqes verso në shqimëzën e fundit kemi në pesë-gjashtë rreshtat e parë një pjesë të ruajtur teksti të rrjedhshëm (shih §2.1: Tabela nr. 3), i cili pas gjithë gjasash përcjell pamje prej episodit biblik të dëbimit të Adamit nga Parajsa (Gjen 3 23-24). Çabej (1968 I: 8) shkruan jo pa mëdyshje se mos kemi të bëjmë këtu ndoshta me një homili, si formë predikimi e priftit, i cili, kur çon meshë e pasi ka lexuar më parë një tekst nga Bibla (perikope), e shpjegon atë me fjalët e tij, duke mënguar që ta bashkëlidhë me pamje të ndryshme të jetës aktuale, në të cilën gjëllin grigja e tij. Është pikërisht kjo rrethanë që e bën të pamundur, në mos krejt të kotë kërkimin dhe qëmtimin e ndonjë teksti, të ashtuquajtur burimor (në gjuhë të huaj), që mund të ketë orientuar Buzukun në hartimin e saj shqip (shih §2.2: shën. 3)⁶.

⁶ Lidhur me përmbajtjen e kësaj faqeje, Lloshi (2026) mjaftohet t'i kumtojë lexuesit njohuritë e tij të thella të natyrës enciklopedike mbi Parajsën në traditën katolike dhe atë ortodokse shqiptare, duke laboruar me fjalëformën /parisi/ në këtë copëz teksti të 'Mesharit'.

2.4. Copëza e gravurës në faqen recto të shqimëzës së parë

Për hir të plotësisë së paraqitjes së shqimëzave në ekzemplarën e restauruar le ndalemi tani shkurt edhe në përshkrimin e faqes recto të shqimëzës së parë (BUM *CXIr), prej së cilës ka shpëtuar majtas lart cepi i një gravure (ksilografie). Siç kemi vënë dukje edhe më parë (Demiraj 2026a: 21v.), këtë gravurë, që Roques-u (1932a: 10) e cilëson si frontespici i ‘Mesharit’, ka mundur ta fiksojë së fundi Marku (2025: 52vv.) si kornizë balline në tërësinë e saj, pikërisht duke e përqsaur atë me gjegjëse përkatëse në botime të ndryshme kryesisht në Venedik përgjatë periudhës ndërmjet fundit të shek. XV dhe fillimit të shek. XVI. Botimi më i hershëm, ku shfaqet kjo gravurë, daton sipas Markut vitin 1491 në bleun e dytë të Komedisë Hyjnore të Dantes (“La Divina Commedia: Inferno”) e që mban siglën e botuesit të njohur Bernardino Benali (~ Benaglio). Kjo gravurë shfaqet po sipas Markut në ribotimet e radhës të Komedisë Hyjnore e më vonë – në bashkëpunim me botues të tjerë ose prej botuesish të tjerë në veçanti –, edhe në botime të tjera të natyrës laike, veçse duke i humbur gjurmët pas vitit 1525. Nëse kemi të bëjmë këtu vërtet me një fragment të frontespicit të librit të Buzukut, ky pohim është plotësisht i mundur, anipse nuk mund të mëtohet patjetër me siguri absolute, sa kohë që mungojnë të dhënat mbi pozicionin e kësaj folieje në libër, pozicion i cili do shqyrtuar si çështje më vete e në bashkëlidhje me atë pak tekst që trashëgojmë prej faqes përkatëse në verso sikurse edhe me tri foliet-shqimëza të tjera të vendosura në fund të këtij ekzemplari unikat, të restauruar, çka përbën edhe çështjen e fundit që përmbyll këtë studim tonin (§3.1).

3. Fletë-shqimëzat në tërësinë e tyre

Ndërsa studimi i secilës fletë-shqimëz në veçanti ka zënë pak vend në historikun e studimeve të ‘Mesharit’ (§1), shqyrtimi i tyre në tërësinë e vet, d.m.th. si njësi e veçantë brenda materialit liturgjik që rrok të gjithë botimin e librit, rrudhet vetëm në ndonjë konstatim ase përsiatje të rastit që shkon deri aty nga fundi i viteve 70’ të shekullit të kaluar. Kemi të bëjmë pra me një problem që në kohën tonë jet e gjëllin në shpërgënjtë e diskursit albanologjik. Në këta shpërgënj feks në kohën tonë vetëm prania e një studiuesi, të cilin na është dashur ta përmendim shpesh e më shpesh në këtë punim të dytë të triptikun tonë të studimeve plotësuese mbi librin e restauruar të Gjon Buzukut: bëjmë fjalë rishtas për Lloshin dhe shkrimin e tij divulgativ në gazetën “Dita” (16 mars 2026). Aty Lloshi shpalos gjithçka që zotëron me kohë dhe ndërkohë, pikërisht erudicionin e fituar në rreth 70 vjet të jetës së tij aktive si studiues i shumanshëm në shkencat albanologjike. Gjithsesi janë pikërisht erudicioni dhe ndjesia e seriozitetit në të shkruar dy premisat kryesore që i premtojnë atij sigurinë dhe guximin e të qenit esëll, sidomos kur syzon të rindërtojë situata dhe episode të ndryshme lidhur me praninë e këtyre fletëve-shqimëza në libër,

duke i parë ato thjesht si *Shtojcë* e ‘Mesharit’ e duke përfunduar me shkronja të zeza se: “...rrjedhimisht **përmbajtja e Shtojcës është nga Gjeneza** [= libri i Gjenezës – B.D.]”; për më tepër: “Kjo Shtojcë prej 8 faqesh jo të bardha por me tekst të shtypur, është prova bindëse, se Buzuku kishte edhe shkrime të tjera në duar, siç e ka shkruar vetë. Çfarë ka ndodhur? Kur është mbaruar e gjithë radhitja e tekstit deri në fund të Mesharit, është parë se kanë ngelur 8 faqe të bardha. Për t’i mbushur Buzuku ka përgatitur një shkrim nga ata që i kishte nëpër duar.” Por jo vetëm kaq; ky përfundim si pjesë e parashtrimit të tri hipotezave të ndryshme lidhur me ‘Mesharin’ si produkt tipografik i kohës së tij, e inkurajojnë Lloshin të depërtojë deri në thelbin e qenësisë së librit në vetvete, duke mëtuar në mbyllje të shkrimit të vet, po me të zeza, se: **“Buzuku në mesin e shek. XVI ka nxjerrë nga shtypi dy punime shqip, ai është autori i dy botimeve shqip.”**

Sigurisht që synimi ynë në këtë rubrikë nuk është të merremi patjetër me atë çka i servir Lloshi lexuesit të gazetës “Dita” në atë shkrim e duke ndërkëmbyer sipas rastit nocionet ‘Shtojcë’ dhe ‘botim’ më vete, sesa me parashtrimin e atij qerthulli çështjesh që feksin më shumë, kur duam të shqyrtojmë më nga afër katër fletë-shqimëzat në tërësinë e tyre. Ndër këto çështje lejohe mi të përmendim paraprakisht vetëm dy: a) pozicioni i tyre burimor në libër e në bashkëlidhje me këtë edhe b) përmbajtja e tyre në përqasje me materialin liturgjik në korpusin kryesor të ‘Mesharit’.

3.1 Pozicioni burimor i fletëve-shqimëza

Pozicioni burimor i shqimëzave në këtë ekzemplar unikat që disponojmë është një çështje që nuk mund të anashkalohet lehtë, sa kohë që në ato pak konstatime që disponojmë – sidomos prej studiuesve që e kanë kaluar nëpër duar këtë ekzemplar – nuk kemi qëndrime të njëjta.

3.1.1 Këtë pasiguri e lejon në kohën tonë edhe skeda e tij me informacion minimal në Bibliotekën Apostolike të Vatikanit, prej së cilës mësojmë së paku se lidhja, më saktë restaurimi i librit i takon shekullit XX⁷. Megjithatë nuk jemi larg së vërtetës në rast përsiasim tash, që gjendja e sotme fizike e librit të restauruar mund dhe duhet të ketë qenë e tillë para vitit 1909, kur e kaloi nëpër duar rizbuluesi i tij, Imz. Pal Skiro (Msgr. Paolo Schirò). Lidhur më çështjen që po shqyrtojmë, këtë përfundim e tumir së paku kumti i tij në artikullin e botuar vite më vonë në bashkëautorësi, kur shkruan mbi gjendjen fizike të mesharit,

⁷ Cituar nga kjo skedë: “Legatura novecentesca in pelle nocciola. Sul verso della IV guardia anteriore e sul recto di carta xcv sono stati incollati due frammenti cartacei recanti note ms. di difficile lettura e prove di penna. Sul verso della IV guardia anteriore e sul recto di carta xcv sono stati incollati due frammenti cartacei recanti note ms. di difficile lettura e prove di penna.”

se: “Tashmë na mbeten 188 faqe, si edhe katër fragmente të faqeve të para të lidhura në fund të vëllimit.” (Schirò-Petrotta 1932: 42⁸).

Skiro, pas gjase, nuk është i vetmi që këto fletë-shqimëza, në mos së paku ndonjë syresh, i vendos në zanafillë përpara dhe jo pas korpusit kryesor me tekst të lidhur të ‘Mesharit’. Një qëndrim të ngjashëm mësojmë edhe prej bashkëkohësit të tij Mario Roques-ut, sipas të cilit: “Ekzemplari që ka mbijetuar është i cunguar: sidomos faqja e parë është e rrëgjuar, përjashtoj një fragment shumë të vogël në këndin e sipërm të majtë, e bashkë me këtë faqe të parë të gjitha të dhënat e titullit, qytetit dhe shtypshkronjës...Në gjendjen e tij aktuale, vëllimi ka 100 fletë, ndër to: një faqe të parë, 94 fletë teksti [të rrjedhshëm – B.D.], një faqe të parë [= folie, frontespici – B.D.] dhe 4 fragmente me qoshet e sipërme të fletëve të grisura. Fillimisht duhet të ketë pasur 110 fletë tekst, anipse faqja [= folia – B.D.] e fundit është e numëruar lxxx [= XC = 90 – B.D.]. Ka në fakt gabime që e bëjnë hulumtimin e këtij vëllimi mjaft të vështirë...”⁹ Në hullinë e Skiroit e jo të Roques-ut ecën, me sa duket, edhe Shuteriqi (1976: 43), sipas të cilit: “Prej f[o][ieve] 1-8 kanë mbetur 4 fragmente të vogla”.¹⁰ Shtojmë këtu së fundi edhe rindërtimin bindës së gravurës (ksilografisë) prej Markut (2025: 52vv.), që fshihet pas cepit të ruajtur majtas lart në faqen recto të shqimëzës së parë, duke e parë atë gjithsesi si pjesë e frontespicit të librit.

⁸ Citati original: “Ora ne rimangono 188 pagine, più 4 frammenti delle prime pagine legati alla fine del volume.”

⁶ Citati original: “L'exemplaire conservé est mutilé: en particulier, le frontespice a disparu, à l'exception d'un très petit fragment du coin supérieur gauche (numéroté aujourd'hui f. 97, et avec ce premier feuillet toute indication de titre, de ville et d'imprimeur... Dans son état actuel le volume compte 100 feuillets, savoir: un feuillet de garde, 94 feuillets de texte, un feuillet de garde et 4 fragments, coins supérieurs de feuillets arrachés; il devait y avoir primitivement 110 feuillets de texte, bien que le dernier feuillet soit numéroté lxxx [= 90 – B.D.]; il y a eu en effet des erreurs qui rendent le maniement de ce volume assez difficile pour qu'il y ait intérêt à en préciser la disposition: je le fais en reproduisant, quand il y a lieu, les titres mêmes donnés par Buzuku aux diverses parties de son livre.” (Roques 1932: 10-11)

¹⁰ Në një ribotim të zgjeruar të librit të tij, Shuteriqi (2005: 107) mjaftohet vetëm me përshtypshkrimin fizik të librit të restauruar, khs.: “Përpara fl. VIII të librit, ashtu si ky është lidhur nuk dimë se kur, janë 5 fl[etë] të panumëruara, nga të cilat e para mund të jetë një fletë e bardhë e librit, ku në kohë të ndryshme, janë shkruar fjalë, fjali etj., prej të cilave mund të kuptojmë vetëm ndonjë gjë. Edhe mbi 4 fletët e tjera, të shtuara gjatë lidhjes së librit, ka të shkruara të ndryshme, po që shumica janë të lexueshme. Pas fl. LXXXX, vinë 8 fletë të shkatërruara, me një fragment teksti që ka mbetur. Në një fletë të fundit, e cila mund të jetë edhe ajo një fletë e bardhë e panumëruar e librit, ka prova të shumta shkrimi, ndonjë e lexueshme dhe me shumë interes.”

Asgjëmangut, nuk mund të lëmë këtu pa përmendur këtu as gjykimin e moderuar të Eqrem Çabejt, i cili ka punuar vetëm me fotot-faksimile të librit, të sjella në Shqipëri nga Justin Rrota në vitin 1929¹¹, andaj vë vetëm në dukje që: “...Nga faqet e humbura e të grisura kanë mbetur nëndë copë shkimëza. Këto nuk është e mundur të vendohen në vendet që kanë pasur.”.

3.1.2 Studiuesit që nuk e kanë pasur deri sot atë fat fanmirë të prekin dhe të shfletojnë ekzemplarin unikat të këtij botimi, gëzojnë ndërkohë një orientim të parë për të si produkt tipografik, meqë prej vitit 2014 atyre u vihet në dispozicion ajo kopje po aq unicate – dhuratë e çmuar prej Papë Françeskut, gjatë vizitës së tij apostolike në Shqipëri (21. Shtator 2026) –, si botim në letër në raportin 1 : 1 me ekzemplarin origjinal, përkatësisht si kopje digjitale me rezolucion të lartë (në formatin PDF) nga specialistët përkatës në Bibliotekën Apostolike të Vatikanit. Shkruesi i këtyre radhëve është njëri ndër ata që iu desh të orientohej e të ndërmerre kërkime paraprake pikërisht në këto rrethana, duke formëzuar një mendim sado modest, të cilin po ia rendisim në vazhdim lexuesit potencial të këtij shkrimi.

Prashtu, po të mbajmë parasysh së pari gjurmët anësore të katër fletëve-shqimëza në shqyrtim, bash ashtu siç i shohim në gjendjen e tyre si pjesë e fletëve të restauruara në plotësinë e vet, e më tej, domethënë në mënyrë të veçantë pikërisht ato gjurmë të skajeve në secilën syresh në lidhjet me njëra tjetrën, si edhe me folien e fundit të korpusit kryesor të materialit liturgjik të ruajtur (fol *CX), atëherë e kemi disi më të lehtë të pranojmë – qoftë edhe përkohësisht (!) – që këto fletë-shqimëza të kenë qenë të vendosura mirëfilli njëra pas tjetrës dhe të katërta së bashku t’i kenë qenë bashkangjitur qysh në zanafillë në fund korpusit kryesor me material liturgjik të ‘Mesharit’, bash ashtu siç e njohim në gjendjen e sotme të restauruar.

Argumente, sado të pjesshme e sipërfaqësore qofshin, mund dhe duhen kërkuar së pari në këndvështrimin e ‘Mesharit’ si produkt tipografik. Prashtu përsiatjen në fjalë e mbështesin disa detaje të kësaj natyre, si vijon:

- Folia e parë me gjurmët e gravurës në recto vështirë të ketë qenë frontespici i librit, anipse kemi edhe studiues të thelluar në studimet buzukiane që janë shprehur për këtë zgjidhje (§2.4). Këto vështirësi i bën më se të qarta pozicioni i asaj copëze teksti që ruhet në faqen verso të kësaj folieje të parë. Teksti i saj, jo vetëm që të krijon përshtypjen e parë se kemi të bëjmë me tekst të rrjedhshëm të organizuar në kolona, por edhe se këto kolona janë të vendosura në një pozicion brenda faqes përkatëse, sa e bën të pazakonshëm statusin e kësaj folieje si frontespici i dikurshëm i librit, meqë në shumësinë e botimeve të kësaj natyre, madje jo vetëm në sosh të shek. XVI, pritët që në rastin më të mirë faqja verso të jetë pa tekst,

¹¹ Shih Rrota 1930: 1vv.

në mos me shumë më pak tekst, i cili fillon i pozicionuar shumë më poshtë, përkatësisht kumton më fort të dhëna gjithfarëshe lidhur me botimin, përkushtimin, hyrjen, tabelën e lëndës a diçka tjetër.

- Një vazhdimësi të hershme, e pse jo edhe zanafillëse (?), ndërmjet faqes verso të shqimëzës së parë me atë recto të folies së dytë (Ivb ~ IIra), parakupton edhe vijimësia e një anëshkrimi nga e njëjta dorë që ka rrokur të dyja margjinalet horizontale lart ndërmjet sosh (Demiraj 2026d: *passim*).
- Një tregues tjetër e bën disi të vështirë edhe përsiatjen e radhës, pikërisht se mos ndoshta gravura në folien e parë (së bashku me tri foliet e tjera pas saj) i printe në zanafillë fillimit të së ashtuquajturës pjesë e dytë e 'Mesharit', e cila, siç dihet përkon në strukturimin e saj me Mesharin Romak (së fundi Demiraj 2026a: 116vv.). Edhe në këtë rast arsyeja është e thjeshtë: Ndërmjet fillimit të kësaj pjese dhe fundit të gjymtuar të pjesës së ashtuquajtur të parë mungojnë gjithë-gjithë tri folie dhe jo katër.
- Po ashtu kjo folie e parë (së bashku me tri foliet e tjera që e pasojnë) vështirë të vendoset në fillim të korpusit liturgjik të 'Mesharit', bash të pjesës së saj të parë, që hapet pas gjithë gjasash me Uratoren e Shën Mërisë së Virgjër. Ato gjurmë teksti që janë ruajtur në katër foliet-shqimëza, ndër to sidomos shqimëza e katërt (IVr/v = fol *CXIV), nuk ngjan të kenë diçka të përbashkët me organizimin e kësaj uratoreje, ku sundojnë lutjet, himnet e sidomos psalmet (së fundi Demiraj 2026a: 81vv.).
- Një argument të fundit të natyrës negative përcjell në sytë tonë faqja e fundit e korpusit kryesor të tekstit të lidhur që mbyllet me pasthënien, po që jo patjetër duhet të ketë shënuar edhe fundin e librit si të tillë. Për këtë jemi të detyruar t'u referohemi rishtas botimeve nga më të ndryshmet në motin e Buzukut, ku faqja e fundit e një botimi mbart zakonisht të dhënat tipografike mbi vendin dhe vitin e botimit, përkatësisht të daljes së tij në treg, së bashku me kumtin e detyrueshëm mbi signaturën e tabakëve (= fashikujve) dhe formatin e tyre si (bi)folio, quart, oktav, etj. (Demiraj 2026d: *pasim*) Këto të dhëna nuk ia përcjell lexuesit faqja e fundit e tekstit të 'Mesharit' së bashku me pasthënien e autorit në të.

Këto argumente të natyrës më fort negative që parashtruan më lart nuk parakuptojnë assesit që dy pjesët e ashtuquajtura kryesore të korpusit liturgjik me tekst të rrjedhshëm të mos kenë pasur në foliet hyrëse përkatëse nga një ksilografi të veçantë. Përkundrazi, mungesa e faqeve të para në secilën syresh nga njëra anë dhe prania e cepit të një gravure te foliet-shqimëza nga ana tjetër lejojnë së paku si zgjidhje alternative, mundësinë që 'Meshari' i Gjon Buzukut,

si produkt tipografik, të ketë qenë pajisur në zanafillë me më shumë se një gravurë (ksilografi). Veçse jemi të detyruar të theksojmë këtu se kjo përsiatje do parë thjesht si një argument *ex silentio*, sa kohë që nuk disponojmë një ekzemplar të dytë e të pagjymtuar të këtij libri.

3.2. Ç’mund të kenë qenë shqimëzat si tërësi më vete?

Edhe këtë pyetje do ta zgjidhte me siguri gjetja ase zbulimi e një ekzemplari të dytë të këtij libri të amshuar në kulturën e hershme të shkrimit shqip, në mos jo tërësisht i plotë, por së paku me ato pjesë, fletë a fashikuj që plotësojnë mungesat e ekzemplarit ekzistues. Përndryshe materiali tejet i cunguar në shqimëzat që i bashkohen ‘Mesharit’ në fund, në kushtet e sotme të studimit lejojnë vetëm të përsiatet me siguri thjesht dhe vetëm ndonjë episod biblik siç është rasti i Arkës së Noes që përfundoi /ëndë Armeniet...ëndër dy mal qitunë/ (BUM LXvb = *LXXvb), pikërisht /përëmbi malt të Araratit/ (BUM *CXIVra), apo përzënia e Adamit prej Parajsës (BUM *CXIVvb).

Si gjithmonë shumë i rezervuar – e falë kësaj sjelljeje ky personalitet i filologjisë shqiptare ka fituar dhe fiton në vite vetëm admirim dhe respekt prej botës shkencore albanologjike – sillet profesor Eqrem Çabej d.v. (1968: 8), kur shprehet jo pa dyshime të rastit se tek episodi biblik i Adamit ndoshta kemi të bëjmë me një homili. Kjo përsiatje meriton të mbahet vath në vesh prej nesh si adepte shpirtërore të tij, për katër shqimëzat në tërësinë e tyre, duke e parë këtë pjesë – anipse shumë e gjymtuar edhe sa u përket përmasave të saj burimore (!) – si paketë homilish, shi si pjesë predikimi në gjuhën e vendit që lejohej të mbante meshtari kur çonte meshë, duke i shpjeguar grigjës së tij Shkrimin e Shenjtë, pasi kishte lexuar ndërkohë perikopenë përkatëse. Vetë pozicioni i tyre menjëherë pas pjesës së dytë, asaj të mesharit me lutjet kryesore dhe perikopetë përkatëse në festat e Eukaristisë përgjatë gjithë vitit kalendarik, mund të vështrohet qoftë edhe përkohësisht si argument pozitiv në këtë hulli gjykimi.

Nga ana tjetër, si gjithmonë çoroditës – sikurse, madje jo rrallë, penalizues ndaj kolegëve – sillet Lloshi në shkrimin e tij të fundit, ku prej emrit të izoluar të Adamit (IIvb = BUM *CXIIvb) kërcen tek episodi i Arkës së Noes (IVra = BUM *CXIVra), për të ardhur në përfundimin se “rrjedhimisht **përmbajtja e Shtojcës** [= e katër shqimëzave – B.D.] **është nga Gjeneza.**” Por jo vetëm kaq. Kjo zgjidhje rezultative tejet e guximshme dhe pa alternativë e shtyn atë më tej, duke kumtuar po ashtu me të zeza *нѡрѡка*-n e tij të radhës: “**Buzuku në mesin e shek. XVI ka nxjerrë nga shtypi dy punime shqip, ai është autori i dy botimeve shqip**”, të cilat në bazë të dhënave faktike rezultojnë të jenë: a) botimi i parë me plot 224 f. (= 112 folie), përkatësisht me katër libra, b) ndërsa i dyti me plot 8 faqe (= 4 folie). Këto përfundime mund të jenë çdo gjë, por vetëm përsiatje të natyrës së rreptë filologjike nuk mund të jenë. Ato nuk kanë asnjë bazë shkencore dhe i kundërvihen çdo argumenti filologjik, duke ndikuar vetëm negativisht në formimin intelektual të brezave të rinj që kanë interes të

mësojnë shumë më shumë mbi kulturën e shkrimit shqip në kohë dhe hapësirë. Këtë funksion nuk e plotëson në asnjë parametër metodik shkrimi në fjalë¹².

4. Mbyllje

Përfundojmë këtu punimin tonë, të vetëdijshëm që lamë hapur një numër çështjesh që ngre shqyrtimi i katër fletëve-shqimëza që përmbyllin ekzemplarën e restauruar të librit të parë të botuar në gjuhën shqipe, siç e njohim deri sot. Materiali liturgjik që rroket në to është aq i pakët, sa është vështirë të trajtohet njëllë si pjesa tjetër e korpusit kryesor (§1). Megjithatë edhe ato si pjesë e së tërës gëzojnë të drejtën që të rroket në studimet ballore të ‘Mesharit’. Prashtu, brenda mundësive të kufizuara që disponojmë u përpoqëm që krahas paraqitjes tabelare të materialit në fjalë, t’i përcjellim lexuesit zgjidhje të ndryshme alternative që kanë të bëjnë me studimin e këtyre fletëve shqimëza në vetvete (§2), sikurse në tërësinë tyre e në marrëdhënie me korpusin kryesor të librit (§3). Për çdo rast u përpoqëm të sistematizojmë e të krehim prurjet në studimin e tyre të derisotëm, duke i mundësuar studiuesit dhe lexuesit të interesuar ndërmarrje të suksesshme në të ardhmen.

Bibliografi e cituar

- Aretino, Pietro. 1538. *Il Genesi di M. Pietro Aretino con la visione di Noe nella quale vedi i misterii del Testamento Vecchio e del Nuovo, diviso in tre libri*. Impr. per Francesco Marcolini. Venetia
- _____. 1551: *Il Genesi, l’Humanita di Christo, & i Salmi* : Opere di M. Pietro Aretino Del Sacrosanto Monte humil germe, & per divina gratia Huomo libero. Aldus. Vinegia.
- Çabej, Eqrem (ed.). 1968. “*Meshari*” i *Gjon Buzukut (1555)*, I-II. Tiranë: Universiteti Shtetëror i Tiranës, Instituti i Historisë e i Gjuhësisë.
- Demiraj, Bardhyl. 2026a. *Don Gjon Buzuku dhe ‘Meshari’ i tij*. Shkodër: Botime Françeskane.

¹² Përfundimet dhe hipotezat e pambështetura të Lloshit (edhe) në këtë shkrim as nuk fillojnë dhe as nuk mbarojnë këtu. Në një tjetër punim, të zhvilluar brenda kuadrit të këtij triptiku studimesh, u kemi kushtuar rëndësi pagjinimeve burimore dhe numërimeve plotësuese të mëvonshme të ‘Mesharit’, ku është dashur të merremi konkretisht edhe me strukturën e fashikujve (= të tabakëve) dhe tipare të tjera të librit si produkt tipografik (Demiraj 2026b: *passim*). Aty na është dashur të merremi edhe me pamje të tjera të këtij shkrimi divulgativ të Lloshit, i cili në tërësinë e tij nuk përkon me asnjë nga parametrat shkencorë dhe me metodën rigorozë e punës në studimet filologjike bashkëkohore.

- _____. 2026b. Vëzhgime në librin e restauruar të 'Mesharit' të Don Gjon Buzukut – I. Numërimet në libër dhe ndonjë çështje që lidhet me to. (dërguar në shtyp)
- _____. 2026c. Vëzhgime në librin e restauruar të 'Mesharit' të Don Gjon Buzukut – III. Shkrime dore në dhe përreth korpusit kryesor me material liturgjik. (dërguar në shtyp)
- Lloshi, Xhevat. 2020. "Një vështrim tjetër për librin e parë shqip: Meshari i Buzukut dhe Meshari kroat". *Gazeta Dita* (18 dhjetor)
- _____. 2026. "Çfarë ishin shkimëzat në veprën e Gjon Buzukut më 1555". *Gazeta Dita* (16 mars).
- Marku, Vincens. 2025. "Frontespici i *Mesharit* të Gjon Buzukut". *Hylli i Dritës* 2, 52-69.
- Roques, Mario. 1932. *Recherches sur les anciens textes albanais*. Paris: Librairie Orientaliste Paul Geuthner.
- Rrota, Justin. 1930. *Monumenti më i vjetri i gjuhës shqype. D. Gjon Buzuku (1555), Copa të zgjedhura e të komentuese për Shkolla të Mjesme*. Shkodër: Shtypshkronja Françeskane.
- Schirò, Paolo & Petrotta, Gaetano. 1932. "Il più antico testo di Lingua Albanese". *Rivista indo – greco – italica di filologia – lingua – antichità* 16, 41-67.
- Shuteriqi, Dhimitër. 1975. "Në fillimet e njohura të shkrimit të shqipes, – Anëshkrimet mbi librin e Gjon Buzukut". Në *Studime Filologjike* 4, 87-95.

SUMMARY

Observations on the restored copy of Don Gjon Buzuku's 'Missal' – II. The fragments at the end of the text

This study is the second in our triptych of studies on the restored book of Don Gjon Buzuku's 'Missal' as a typographical product. Here we have focused on examining the fragments of four paper scraps that conclude the only copy of the first book published in the Albanian language, as it is known today. The liturgical material contained in them is so poorly preserved that it is difficult to treat them in the same way as the rest of the main corpus with running text (§1). Nevertheless, as parts of the whole book, they deserve to be included in the comprehensive study of the 'Missal'. Therefore, within the limits of the

available evidence, we have tried, in addition to the tabular presentation of the material in question, to convey to the reader various alternative solutions concerning the study of these fragments in themselves (§2), as well as in their entirety and in relation to the main corpus of the book (§3). In every case, we have sought to systematize and improve the findings of their study to date, enabling researchers and interested readers to undertake successful endeavours in the future.

KRITIKË DHE BIBLIOGRAFI

Veprimtari kremtuese-shkencore

Më 27 mars 2026, në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, u zhvillua veprimtaria promovuese e botimit shkencor Festschrift “Studime albanologjike në indoeuropianistikë, filologji dhe gjuhësi kontakti”, kushtuar prof. dr. Bardhyl Demiraj. Aktiviteti u organizua nga Seksioni i Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike, në bashkëpunim me Komisionin e përhershëm të gjuhësisë dhe të letërsisë.

Në emër të Kryesisë së Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, përshëndeti akad. Gëzim Hoxha, Kryetar i Seksionit të Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike, i cili e vlerësoi prof. dr. Bardhyl Demirajn si një ndër përfaqësuesit më të spikatur të studimeve albanologjike në hapësirën akademike europiane. Ai vuri në dukje veprimtarinë e tij të rëndësishme si gjuhëtar dhe filolog në Universitetin “Ludwig Maximilian” të Mynihut, si dhe rolin e tij në drejtimin e njësisë së shqipes në një prej qendrave më të rëndësishme të albanologjisë në Europë.

Akad. Hoxha nënvizoi se vëllimi i botuar përbën jo vetëm një nderim për figurën e prof. Demirajt, por edhe një pasqyrë të zhvillimeve bashkëkohore të studimeve albanologjike në kontekstin europian. Ai vlerësoi gjithashtu kontributin e tij si një urë lidhëse midis albanologjisë shqiptare dhe asaj ndërkombëtare, duke theksuar se është nder për Akademinë që ai është pjesë e saj si akademik i jashtëm.

Në përfundim, ai përgëzoi përgatitësit e vëllimit: prof. dr. Anila Omari, akad. Shaban Sinani dhe Ledio Hala, si dhe të gjithë autorët pjesëmarrës, duke e cilësuar botimin si një dëshmi të qëndrueshme të vlerësimit të komunitetit shkencor për veprën dhe personalitetin e prof. Bardhyl Demiraj.

Në vijim, prof. Seit Mansaku e cilësoi vëllimin si një arritje të rëndësishme shkencore, duke vlerësuar njëherazi bashkëpunimin e tij shumëvjeçar me prof. dr. Demiraj dhe kontributin e hartuesve të botimit.

Bashkëhartuesja e vëllimit prof. dr. Anila Omari vlerësoi botimin kremtues, i cili nderon një nga figurat më të spikatura të albanologjisë bashkëkohore. Ajo vuri në dukje se vëllimi është realizuar me pjesëmarrjen e studiuesve nga fusha të ndryshme, brenda dhe jashtë vendit, duke përbërë një

dëshmi të gjerë të ndikimit shkencor të prof. dr. Demirajt. Po ashtu, ajo nënvizoi se botimi pasqyron zhvillimet më të fundit në studimet albanologjike dhe indoeuropiane, përmes një game të larmishme qasjesh teorike dhe metodologjike. Më tej, prof. dr. Omari vlerësoi fjalën hyrëse të kryetarit të Akademisë së Shkencave, akad. Skënder Gjinushi dhe një shkrim laudativ nga akad. Shaban Sinani, kushtuar veprimtarisë shkencore të prof. Demiraj. Në përmbajtjen e veprës përfshihen 25 artikuj shkencorë, të strukturuar sipas fushave kryesore të albanologjisë.

Akad. Shaban Sinani foli për traditën e Akademisë së Shkencave për botime të këtij formati, duke e vlerësuar veprën si një ndër kontributet më të rëndësishme të viteve të fundit në nderim të figurave të shquara të albanologjisë. Ai theksoi se botimi pasqyron në mënyrë dinjitoze veprën dhe ndikimin shkencor të prof. dr. Bardhyl Demiraj në studimet gjuhësore dhe filologjike. Ky Festschrift, që i kushtohet Bardhyl Demirajt, profesor universiteti, anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë; historian i gjuhës dhe etimolog, historian i shkrimit dhe alfabetizimit të shqipes, përfaqësues i shquar i filologjisë së tekstit me kërkimet dhe botimet që ka realizuar ndër vite; organizator tubimesh shkencore ndërkombëtare të suksesshme; nyje ndërlidhëse e albanologjisë në Europë; është nëntitulluar në shërbim të dijes sonë të shenjtë, nënkuptuar më të shenjtën albanologjinë, së cilës, sikurse nënshkruan shpesh në letrat shoqërore, i qëndroi besnik gjatë gjithë veprimtarisë së tij studimore.

Në vijim të veprimtarisë, mbi vëllimin referuan edhe studiueset: prof. as. dr. Evalda Paci, e cila mbajti kumtesën “Filologjia e teksteve të vjetra në vëllimin kushtuar prof. Bardhyl Demirajt”; prof. dr. Mimoza Kore, e cila mbajti kumtesën “Historia e gjuhës shqipe dhe e trevave shqiptare në librin dedikuar prof. Bardhyl Demirajt”, si dhe prof. dr. Mimoza Priku, e cila mbajti kumtesën “Gjuhësi variantesh dhe shqipja në kontakt në vëllimin festiv për nder të prof. Bardhyl Demirajt”.

Në përmbyllje të aktivitetit, prof. dr. Bardhyl Demiraj shprehu mirënjohjen e tij për vlerësimin dhe përkushtimin e kolegëve, duke theksuar se ky botim zë një vend të veçantë në punën dhe kujtesën e tij. Ai nënvizoi rëndësinë e lidhjeve të qëndrueshme me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, institucionet akademike dhe kolegët, si dhe rolin e përvojës së tij akademike në Shqipëri dhe jashtë saj në formësimin e rrugëtimit të tij shkencor.

Në këtë numër të revistës kemi zgjedhur të botojmë dy nga prezantimet e vëllimit kremtues kushtuar prof. Bardhyl Demirajt, që paraqesin përmbajtjen e dy tematikave të para të vëllimit: atë të gjuhësisë indoeuropiane, nga A. Omari, dhe të filologjisë së teksteve të vjetra nga E. Paci. Në numrin e ardhshëm do të botohen dy prezantimet e tjera, që plotësojnë trajtimin e tematikave të vëllimit.

Anila Omari

**Gjuhësia indoeuropiane në vëllimin kremtues për
nder të prof. Bardhyl Demirajt *Studime albanologjike
në indoeuropianistikë, filologji dhe gjuhësi kontakti*,
Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë 2026**

Vëllimi festiv për nder të profesor Bardhyl Demirajt, akademik i jashtëm i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe një nga shtyllat mbajtëse të albanologjisë së shekullit 21, kontributi i të cilit në gjuhësinë shqiptare ka shënuar tashmë një gur kilometrik në historinë e saj, u organizua me nismën dhe vullnetin e kolegëve të tij të afërt, që në mënyra të ndryshme kanë bashkëpunuar ngushtë me të dhe kanë çmuar kontributin e tij të jashtëzakonshëm në albanologji dhe prej më se 20 vjetësh edhe në mësimdhënien dhe drejtimin e Degës së Albanologjisë në Universitetin LM të Mynihut. Thirrjes për kontribut iu përgjigjën me gatishmëri e kënaqësi një numër i madh studiuesish nga fusha të ndryshme të albanologjisë dhe indoeuropianistikës, kolegë të nderuar të prof. Demirajt por edhe ish studentë të tij, brenda e jashtë vendit, dhe për një kohë relativisht të shkurtër u përgatit dhe një vëllim cilësor, i denjë për të nderuar të festuarin tonë.

Pavarësisht nga disa vonesa burokratike që nuk vareshin nga vullneti i Akademisë si ent botues i vëllimit, libri doli nga shtypi dhe u publikua edhe në rrjet, ku pati jehonë pozitive dhe vazhdon të ketë klikime dhe lexime. Për ta bërë të njohur më nga afër përmbajtjen e tij, e cila është botuar në gjuhë të ndryshme, libri u prezantua edhe në mjediset e Akademisë së Shkencave para një publiku të zgjedhur dhe specialistëve të fushës.

Kush ka pasur rastin ta shfletojë vëllimin, mund t'i ketë rënë në sy një fjali-kushtim në faqen e parë të librit: *Në shërbim të dijes sonë të shenjtë*. Është një fjali që haset në shkrimet hyrëse të Bardhyl Demirajt në botimet e tij kritike të veprave të shkrimtarëve tanë të vjetër, të cilët i kushtuan jetën e tyre përhapjes dhe forcimit të dijes e të fesë së të parëve. Fjalja paraqet një metaforë të këtij përkushtimi të autorit tonë ndaj dijes albanologjike, e cila për të është po aq e shenjtë dhe e çmuar.

Vëllimi hapet me fjalën hyrëse të kryetarit të Akademisë së Shkencave, akad. Skënder Gjinushit, ndjekur nga shkrimi laudativ i akad. Shaban Sinanit

për karrierën shkencore në albanologji të Bardhyl Demirajt. Vijnë 25 artikuj shkencorë të ndarë sipas rubrikave nga fushat kryesore të albanologjisë që ka lëvruar Autori ynë, dhe mbyllet me përshtypjet nga bashkëpunimi i zonjës Epple, sekretares së Institutit të Indogjermanistikës dhe Albanologjisë pranë LMU, me prof. Demirajn. Një paraqitje të përmbledhur të vëllimit mund ta ngjetojmë në shkrimin e Evalda Pacit, botuar në rubrikën e recensioneve në numrin 2, 2025 të kësaj reviste.

Në promovimin e tanishëm kumtueset kanë bërë një ndarje sipas rubrikave tematike të vëllimit, ku zgjedha të paraqes kapitullin e Gjuhësisë indoeuropiane, me kontribute nga studiues të shquar indoeuropeanistë dhe albanologë, në një kohë kur gjuhësia krahasuese-historike dhe indoeuropiane ka ecur përpara me hapa gjigante.

Ky kapitull hapet me artikullin e prof. Olav Hackstein, profesor titullar i Katedrës së gjuhësisë historike dhe indogjermane në Universitetin Ludwig-Maximilian të Mynihut dhe drejtues projektesh në gjuhësi të krahasuar të gjuhëve indoeuropiane, një nga të cilët është projekti i Fjalorit Digjital Filologjik-Etimologjik të Shqipërisë së Vjetër (shek. 15-18) i këtij Universiteti, i ideuar dhe bashkëdrejtuar nga prof. Bardhyl Demiraj, i cili është dhe kontribuesi kryesor në këtë projekt madhor.

Artikulli i prof. Hacksteinit i kushtohet një dukurie që shfaq tipare të ngjashme në dy gjuhë indoeuropiane, analiza diakronike e së cilës përfshin qasje fonologjike, morfologjike e semantike. Ai trajton karakterin rrokjesor apo jorrokjesor të onsetit të preverbave në gjermanisht dhe në shqip. Siç shihet, që në titull ka një varg konceptesh me terminologjinë përkatëse që na duhet ta shpjegojmë. Preverbat janë parashtesa foljore që sidomos në gjermanisht janë shumë të pranishme dhe, kur i paravendosen një rrënjë foljore, i japin asaj një kuptim të ndryshëm nga ai i foljes bazë. Në zhvillimin e tyre diakronik këta preverba paraqesin shkallë të ndryshme integrimi me foljen ndjekëse. Ata mund të ruajnë statusin e tyre si rrokje të pavarura ose të shkrihen me onsetin apo tingujt nistorë të foljes ndjekëse. Ka raste që i njëjti prefiks shfaq zhvillime divergjente, si në rastet e ndarjes leksikore, pra kur krijohen fjalë të ndryshme edhe nga e njëjta rrënjë foljore: ai mund të jetë rrokje ose jorrokje, p.sh. në gjermanisht preverbi *er-* në gjerm. *er-lauben* 'lejoj' është rrokje përkundërt *g-jorrokje* në *glauben* 'besoj'; *ge-* është rrokje në *ge-leiten* 'shoqëroj, përcjell' përkundërt *g-jorrokje* në *gleiten* 'rëshqas'; *Ge-* në gjerm. *Ge-leise* 'shina' është rrokje përkundërt *G-jorrokje* në *Gleise* 'id.'. Divergjenca vihen re edhe mes preverbave dhe përbërjes semantike të tyre: për shembull, një parashtesë mund të rezistojë si rrokje edhe nëse përbërja e saj semantike zbehet ose humbet. Në gjuhën shqipe në pikëpamje sinkronike nuk kemi preverba, pasi ato janë shkrire me tingujt nistorë të foljes gjatë zhvillimit gjuhësor, por ato zbulohen nga gjuhëtarët diakronistë gjatë rindërtimit të paraformave të protoshqipes dhe të paraprotoshqipes në krahasim me gjuhët e tjera simotra

indoeuropiane. Autori i studimit përqendrohet te gjuha shqipe, duke vënë re se dukuria që konstatohet në rastin e preverbave gjermanë, domethënë, që statusi rrokje ose jorrokje i preverbave mund të mos jetë në një gjatësi vale me shfaqjen e alomorfisë dhe me zbehjen e tyre semantike, ndeshet edhe në shqipe. Për këtë dukuri ai merr si shembull preverbin shqip *sh-1* ‘jashtë (nga)’, nga protoshqipja **s-* para një bashkëtingëlloreje, që vjen nga < PIE **s-* < **ks-* < **g^hs*. (Shënohet si *sh-1* për t’u dalluar nga një preverb tjetër *sh-2* dhe nga një parashtesë alomorfe *sh-3* ‘përveç, ç-, jo-’). Gjatë zhvillimit të tij gjuhësor, për shkak të përngjitjes me bazën foljore, preverbi *sh-1* ‘jashtë (nga)’ në shqip paraqiti një zhvillim të ndarë. Ai ose u bashkua me segmentin vijues që i përkiste rrënjës foljore, duke dhënë një fërkimore të vetme, ose mbeti si një *sh-fërkimore* e pavarur segmentalisht në të njëjtin mjedis. Autori dallon disa faktorë që kontribuan në rezistencën sporadike të preverbit *sh-1* të shqipes ndaj bashkimit me bazën e tij foljore, duke veçuar faktorë fonologjikë, morfologjikë dhe analogjikë të kushtëzimit, të cilëve u kushton secilit argumentimet përkatëse. Shembujt e shumtë nga shqipja me të cilët operon ai në studimin e tij janë marrë nga rezultatet etimologjike të arritura në fjalorin DPEWA të Universitetit të Mynihut, dhe veçanërisht nga puna e prof. Bardhyl Demirajt në fushë të etimologjisë, të cilën ai e vlerëson si një hop cilësor në studimet etimologjike të shqipes. Po citoj fjalët e tij: “Etimologjia e shqipes ka bërë përparim të madh gjatë tre dekadave të fundit. Pikat kryesore përfshijnë *Albanische Etymologien* të Profesor Demirajt të vitit 1997 dhe monografinë e Schumacher dhe Matzinger të vitit 2013, *Die Verben des Altalbanischen*, e cila përmban një fonologji historike, morfologji dhe një fjalor etimologjik të përditësuar të shqipes (së vjetër). [Projekti] DPEWA (2017–2025) synon të përballojë sfidat e epokës së re të leksikografisë digjitale dhe të shfaqë përparimet e etimologjisë indoeuropiane. Ky fjalor ka kështu privilegjin të shërbejë si një pikënisje e re për etimologjinë dhe fonologjinë historike të shqipes.”.

Stefan Schumacher, profesor i gjuhësisë indoeuropiane dhe i gramatikës historike të disa gjuhëve indoeuropiane në Universitetin e Vjenës, njëkohësisht dhe albanolog i shquar, me kontribute të rëndësishme në rindërtimet indoeuropiane të shqipes, në historinë e gjuhës shqipe, në etimologjinë dhe gramatikën e shqipes së vjetër, kontribuon në vëllim me një artikull të gjerë për rrënjën protoindoeuropiane **keh₂p* në shqipe, që ka kuptimet “kap, mbërthej”. Autori që në fillim vlerëson punën e madhe, të mundimshme e skrupuloze të Bardhyl Demirajt për botimin e teksteve të vjetra shqipe, sidomos të Akteve të Kuvendit të Arbënit që është një korpus tekstori pak i shfrytëzuar, pa të cilin nuk do të ishte mundur të shkruhej artikulli. Në këtë punim ai analizon leksemat emërore e foljore të shqipes që rrjedhin drejtpërdrejt nga kjo rrënjë protoindoeuropiane. Ai diskuton problemet e vështirësitë që lidhen me

rindërtimin e saktë të rrënjës PIE dhe të derivateve të saj në shqipe, së pari duke argumentuar si më të saktë trajtën **keh₂p* përmes krahasimit me fjalën e greqishtes homerike κόπη ‘dorezë (e një shpate etj.)’ dhe me emrin ‘kopsht’ në greqishten e vjetër dhe paralelet e tij indoevropiane në gjuhën shqipe. Emri ‘kopsht’ është dhe një derivat emëror i rrënjës **keh₂p* në shqipe, në të cilin ai ndalet në një analizë të thelluar. Në format paralele geg. vj. *kopështë*, gr. vj. κῆπος dor. κᾶπος kemi të bëjmë me një barazim të pjesshëm të shqipes me greqishten që është i njohur prej kohësh në gjuhësinë i.-e, por që nuk është pa vështirësi të mënyrës së ndërtimit si në pjesën greqishte ashtu dhe në atë shqipe, e cila paraqitet si fjalëformim asnjës (te Buzuku) me prapashtesën - (ë)shtë që në raste të tjera të ngjashme del në emra femërorë (*ashtë*, *breshtë*, *vëneshtë*). Zgjidhjet alternative që jepen për të shpjeguar këto vështirësi flasin për një njohje të thelluar të lëndës dhe problematikës së gjuhëve në shqyrtim. Me të njëjtën akribi analizohen edhe derivatët foljorë të rrënjës **keh₂p* në shqipe, siç janë foljet *kap* dhe *qep*, për të cilat jepet një kuadër i plotë i trajtave morfologjike dhe i spektrit semantik sipas fjalorëve të shqipes, teksteve të vjetra dhe dialekteve arkaike, të cilat ndihmojnë për të rindërtuar rrugën e formimit të këtyre foljeve dhe për të përcaktuar formën morfologjike të rrënjës **keh₂p* nga e cila ato rrjedhin. Folja *kap* në shqipen e vjetër dëshmohej për herë të parë te Kuvendi i Arbënit, botuar nga Bardhyl Demiraj me konkordancat kompjuterike.

Sergio Neri, kërkues shkencor në Universitetin e Baselit, studiues i gramatikës historike dhe etimologjisë së gjuhëve të lashta indoevropiane, një nga anëtarët e projektit DPEWA që ka punuar mbi leksikun e trashëguar të shqipes së vjetër dhe tani vazhdon punën në një tjetër projekt për shqipen në antikitet, i ka kushtuar një studim shterues prej 20 faqesh prejardhjes së fjalës shqipe *e ve* ‘vejushë’. Punimi zbaton qasjen metodologjike të gjuhësisë bashkëkohore historike-krahasuese, që kërkon të rindërtojë jo thjesht etimonin e fjalës, por edhe secilën nga fazat e zhvillimit të saj të shkallëshkallshëm nga më e vjetra deri në gjendjen e sotme. Një model të ngjashëm e gjejmë, p. sh. në studimin e B. Demirajt të vitit 2008 për shq. *rrush*. Në qendër të rindërtimit diakronik të leksemës *e ve* është një ligj i quajtur ligji i Meyerit për rënien e okluziveve ndërzanore në fjalët e trashëguara dhe ato me origjinë latine, të cilin e ka trajtuar i festuari ynë në një studim të posaçëm me shembuj të shumtë nga shqipja në vitin 2001. Mbasi ka trajtuar shtjellueshëm gjendjen e studimeve dhe të diskutimeve në problematikën në shqyrtim, dëshmitë e gjallesës së fjalës në tekstet e vjetra e në fjalorë, çerdhen fjalëformuese dhe format morfologjike të saj në hapësirë e në kohë, autori ndalet gjatë në analizën etimologjike të fjalës, duke paraqitur opinionet e Joklit e të Çabejt lidhur me prejardhjen e fjalës *e ve*, geg. vj. *e vejë*, e cila vijon të debatohet nëse është fjalë vendi e trashëguar nga periodha indoevropiane apo rrjedh nga një lat. vulgare *vidua*. Në rindërtimin

historik të fjalës luan rol edhe pozicioni i theksit i rrënjës bazë, i diskutueshëm mes një paraforme i.-e. me theks parafundor **vidhévā* (Jokl) apo me theks nistor **vidhevā* (Çabej). Autori merr në shqyrtim në mënyrë të detajuar të gjitha problematikat e vështirësitë që paraqet rindërtimi i secilës prej hipotezave të shtruara nga studiuesit, duke paraqitur rrugën e zhvillimit për secilin rast. Në këto analiza implikohen dhe përfundimet e ligjit të lartpërmendur të Meyerit dhe ato të Eric Hampit për një të ashtuquajtur rregull metafonie të paraprotoshqipes *i* në *e* kur në rrokjen pasuese gjendet një **ā*. Mirëpo këto përfundime janë vënë në diskutim nga gjuhëtarët dhe nuk mund të merren si të sigurta. Vetë autori i peshon argumentet pro e kundër tezës së Hampit, nga të cilat nuk rezulton e mbështetur një paraformë e trashëguar me theks nistor, pra **uidauā* që do të jepte **ūédauā* (>geg. vj. *vejë*). Kështu ai rindërton një paraformë me theks fundor **Huid^huáh₂* bashkë me shkallët e zhvillimit të saj në fazat e ndryshme të shqipes, që do të jepte një përfundim të rregullt në shqipe, por që parakupton që rregulla e Hampit të jetë e drejtë dhe me kusht që ligji i Meyerit të vlejë edhe për fjalët e trashëguara.

Një qasje të ngjashme gjithëpërfshirëse paraqet edhe artikulli i Giulio Imberciadorit, kërkues shkencor në gjuhësi historike pranë Universitetit LMU dhe pjesëmarrës në projektin DPEWA, mbi fjalën shqipe *nder*. Për sa i përket etimologjisë së kësaj fjale, mendimet e studiuesve janë ndarë mes një huazimi latin, nga lat. *honōrem* (Meyer, Jokl, Tagliavini etj.) dhe një fjale vendi të trashëguar (Bopp, Klingenschmitt, Matzinger e më parë Çabej). Argumentet e dhëna gjithsesi lënë pa shpjeguar shkaqet e disa dukurive fonetike që shfaqen në faza të ndryshme të evolucionit të fjalës. Autori propozon një etimologji të re të fjalës, duke u nisur nga arsyetimi i argumentuar dhe bindës i Çabejt për një kuptim fillestar të fjalës *nder* si ‘fytyrë; pamje’ që më pas pësoi një zhvillim semantik të bartur ‘honor’. Sipas kësaj linje arsyetimi, ai e lidh shq. vj. *(ë)ndër* f. me rrënjën emërore PIE **h₂ént-* / **h₂nt-* ‘ballë’, e cila ka dhënë një zhvillim të drejtpërdrejtë në het. *hant-* ‘ballë, pjesa e përparme e diçkaje’. Konkretisht ai niset nga trajta e lokativit PIE **h₂ent-ér* ‘në ballë’, e cila me disa procese derivacioni, leksikalizimi e risemantizimi kaloi nga njëra anë në kuptimin ‘tjetër, tjetri’ (që e gjejmë në sanskritishten e Vedave *ántara-* ‘tjetri’, avestishte *antara-*, got. *anþar*, etj.) dhe në anën tjetër, me kuptimin ‘ballë’ me funksion emri femëror abstrakt PIE **h₂ent-ór-i-* ‘pjesa e përparme, balli i diçkaje’ ~ (e konkretizuar) ‘ballë, fytyrë’, dha në shqipe rregullisht *nder* me kuptimin ‘fytyrë’, sipas këtij procesi fonetik e semantik: PIE **h₂ent-ór-i-* f. ‘fytyrë’ > paraprotoshq. **andári-* > (me metafoini *i*-umlaut) protoshq. **andéri-* > shq. e përbashkët **andër* > shq. vj. *(ë)ndër* f. ‘honor’ >> shq. e sotme *nder* m. ‘id.’. Ky zhvillim semantik ‘fytyrë’ ⇒ ‘nder’ duhet të ketë ndodhur vetëm pasi lat. *facies* apo lat. vulg. **facia* u huazua në shqipe si *faqe* me kuptimin kryesor

‘faqe, fytyrë’. Leksema e vjetër (*ëndër*) u specializua në kuptimin metaforik ‘honor’.

Edhe ky punim është konceptuar si një dhuratë modeste që autori i bën të nderuarit të këtij vëllimi, për meritat e veçanta në zhvillimin e përparimin e filologjisë dhe etimologjisë shqipe. Këto merita bënë që të fitoheshin përkrahës të rinj të albanologjisë nga rrethet elitare të gjuhësisë indoeuropiane gjermanofone e më gjerë, siç janë disa nga kontribuesit në këtë vëllim festiv, të cilët sot po vazhdojnë me sukses punën e tyre kërkimore në fushë të historisë së gjuhës shqipe, gramatikës historike dhe etimologjisë së saj.

Një nga këta studiues të rinj të suksesshëm me formim indoeuropianistik, që i është afruar albanologjisë edhe falë aktiviteteve shkencore ndërkombëtare të organizuara nga Bardhyl Demiraj është Marek Majer, nga Universiteti i Lodzit në Poloni, i cili në këtë vëllim merr pjesë me një studim të plotë shterues mbi një fjalë shqipe me prejardhje të diskutuar sllave – foljen *prondit* “prodhoj”, duke dhënë një alternativë të re të modelit të gjuhës dhënëse.

Plator Gashi është një tjetër studiues i ri që i ka hyrë me pasion rrugës së albanologjisë, ish student i masterit mbaruar me rezultat të shkëlqyer në udhëheqjen shkencore të prof. Demirajt dhe më pas lektor i degës së shqipes në Universitetin e Mynihut, bashkëpunëtor edhe në Fjalorin DPEWA. Ai kontribuon në vëllim me një studim mbi Huazimet orientale dhe disa çështje të tjera leksikologjike të Kodiku Beratas (shek. XVIII), ku merr në shqyrtim 27 turqizma që dalin për herë të parë në letërsinë shqipe në këtë kodik si dhe dy leksema të diskutueshme si turqizma.

Vëllimi përmban edhe dy artikuj që kanë tema specifike që nuk përfshiheshin në ndonjë nga rubrikat e konceptuara nga editorët, prandaj janë paraqitur në rubrika të veçanta, siç është artikulli i prof. Christian Voss nga Universiteti i Berlinit, i cili përpiket të trajtojë nga ana historike zhvillimin kulturor të shqiptarëve të Kosovës në Jugosllavinë e Titos, duke ndriçuar dhe frymëzimin postkolonializues të Jugosllavisë në këtë zhvillim. Ndërsa Ardian Vehbiu, intelektual i shquar dhe akademik i jashtëm i ASH, paraqet një aspekt jo më pak të rëndësishëm të veprimtarisë shkencore të Bardhyl Demirajt, atë të komunikimit edhe me publikun jospecialist, siç është publiku gjithsesi intelektual dhe elitë i revistës kulturore-shkencore online *Peizazhe të fjalës*, në të cilën autori ynë ka kontribuar me një numër të rëndësishëm esesh dhe artikujsh shkencorë popullarizues, për t’ia sjellë më pranë lexuesit kërkimet e tij shkencore në fushë të albanologjisë, duke afirmuar njëkohësisht dijen shkencore përballë amatorizmit.

Evalda Paci

**Rreth studimeve filologjike në vëllimin studimor
në nderim të prof. Bardhyl Demirajt (Akademia
e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2025)**

Një kapitull i rëndësishëm në përbërje të vëllimit studimor *ad honorem* kushtuar profesor Bardhyl Demirajt mbetet dhe ai i filologjisë, me një sërë trajtesash të natyrës analitike, shtjelluese dhe njëherësh të lidhura me çështje aktuale të njohjes së traditës së gjurmimeve filologjike dhe tekstore si një orientim i mirëfilltë në studimet albanologjike. Kapitulli hapet me një trajtesë të gjerë e mjaft të detajuar të profesore Anila Omarit, njëherësh recensente e lektore shkencore në proces të përgatitjes së këtij vëllimi studimor.

A. Omari: Tekstet e vjetra shqipe (shek. XV-XIX) në shqyrtimin filologjik të Bardhyl Demirajt¹

Puna me tekstet e vjetra shqipe mbetet një linjë themelore në gjurmimet shumëvjeçare të studiuesit Bardhyl Demiraj, madje një orientim tashmë karakterizues sa herë flitet për shkollat e filologjisë të adaptuara në përafrimin e studiuesit me letërsinë e vjetër shqipe dhe veprat përfaqësuese të saj.² Sjellja në një format të përshtatshëm për t'u konsultuar, lexuar e brendësuar, por dhe respektimi i kriterëve të shëndosha shkencore, kritike dhe filologjike kanë qenë në qendër të vëmendjes së tij, duke bërë të mundur të dallohen nga një fizionomi e veçantë veprat e Kazazit, Frang Bardhit, aktet e Kuvendit të Arbënit (1706), bashkë me krahasimet e mundshme mes variantesh që bëjnë të mundur të dallohen dhe veçori nga një botim në tjetrin. Sjellja në një botim të mirëfilltë kritik e filologjik e veprës së Gjon Nikollë Kazazit në vitin 2006 përbën një ngjarje që shënon dhe inicimin e një serie realizimesh të kësaj natyre, që do të vijohen në kohë me përpilime që janë mbështetur nga Botimet Françeskane (Shkodër), të pajisura me parathënie shteruese, me shtojca në të cilat shpjegohen hollësisht aspekte të interpretimit fonologjik e grafematik të elementeve të teksteve, me konkordanca që shoqërojnë riprodhimin diplomatik, transliterimin dhe transkribimin përkatës të tyre. Në trajtesën e profesore Anila

¹ A. Omari, Tekstet e vjetra shqipe (shek. XV-XIX) në shqyrtimin filologjik të Bardhyl Demirajt, *Studime albanologjike në indoeuropianistikë, filologji dhe gjuhësi kontakti*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2026, f. 87-119.

² A. Omari, po aty, f. 87.

Omarit një punë e tillë jo vetëm që shtjellohet në një hierarki kronologjike, me shpjegime të metodës dhe të pasurimit të studimeve filologjike në kuadër të panoramës së arritjeve më të rëndësishme në fushë të albanologjisë, por dhe trajtohet në një vështrim që rrok dhe studimin e veprave të mëhershme të realizuara në areale si trevat arbëreshe, të dhënat prej të cilave Demiraj i ka studiuar me hollësi, por dhe duke i lidhur me historinë e shkrimit shqip dhe dëshmimin më të hershëm të tij. Pjesë e rëndësishme e kësaj trajtese mbetet dhe kreu me titull “Studime filologjike të arealit jugor me alfabetin grek”, në të cilin evidentohen kontribute të viteve të fundit të Bardhyl Demirajt në lidhje me tekste që janë sjellë të përafëruara mbi kritere të mirëfillta filologjike, duke u shoqëruar dhe me botimin anastatik të materialit (në rastin e kodikut të Beratit) dhe me riprodhimin diplomatik të teksteve të përmbajtura, me vërejtje kritike të domosdoshme dhe si dhe me një punë përgatitore që paraqitet një domosdoshmëri për studiuesit dhe të interesuarit për këtë pasuri tekstore që përfaqëson një traditë të shkrimit. Vlen për t’u përmendur këtu dhe “Fjalori katërgjuhësh i Dhanil Voskopojarit (1802)”, i sjellë gjithashtu në përmasa të një botimi ekdotik (2022), i cilësuar si “teksti i dytë solid i arealit jugor që ndjek në kohë Kodikun e Beratit”.³ Puna me tekstet e kësaj veprë, të trajtuara dhe në pikëpamje të të dhënave autoriale nga ana e B. Demirajt, e gradualizuar në hapat metodikë të punës përgatitore-kritike, është komplekse dhe me një prirje të qartë për të shpjeguar sa më shumë të jetë e mundur nga brendia përkatëse, e pasuruar me shpjegime, interpretime, por dhe me facsimile të vendosura në përmbyllje të vëllimit. Puna dhe kujdesimi filologjik i Bardhyl Demirajt në lidhje me tekstet e arealit jugor të shekullit XVIII përmbillet me botimin kritik të fjalësit shqip të veprës së Teodor Kavaliotit “Protopeiria” (1770), duke reflektuar kritere e parime të mirëfillta ekdotike të përafrimit me tekstin, me aspektet grafematike dhe kritike të interpretimit të tij.

Ina Arapi: “Lutja Ati ynë te Buzuku dhe Matrënga - një vështrim krahasues”⁴

³ A. Omari, po aty, *vëllim i cituar*, f. 111: Fjalori në formë teksti në katër gjuhë i Mjeshtër Dhanilit, kopja në qarkullim e të cilit nuk mban vend botimi dhe emër botuesi, sipas argumenteve më të besueshme, është botuar për herë të parë në Venecie në vitin 1802. Kjo është një nga çështjet e diskutueshme që autori i botimit kritik trajton në pjesën hyrëse të punimit të tij ku shtjellohen probleme peri- dhe paratekstuale të tekstit burimor, siç janë disa të dhëna koncize mbi Mjeshtër Dhanilin, të dhëna mbi librin e tij “Eisagogiki Didaskalia” (Mësim hyrës), ribotimet e fjalorit të tij katërgjuhësh, shoqëruar edhe me një *stemma codicum* (pema gjenealogjike) e botimeve të derisotme të tij, e çështje të tjera të kësaj natyre, disa nga të cilat meritojnë të vihen në dukje më në veçanti.

⁴ I. Arapi, “Lutja “Ati ynë” te Buzuku dhe Matrënga - një vështrim krahasues”, *vëllim i cituar*, f. 120-132.

Në artikullin studimor me titull “Lutja Ati ynë te Buzuku dhe Matrënga – një vështrim krahasues” të Ina Arapit trajtohet një çështje me perspektivë përqasëse që merr në analizë trajta e përdorime në një lutje themelore në liturgji, me një përqendrim në dy autorë të traditës më të hershme të dëshmuar me shkrim, përkatësisht të shekullit XVI, Gjon Buzukut dhe Lukë Matrangës.

Lutja “Ati ynë” ka një evidentim të gjurmueshëm dhe në pasazhe ungjillore, siç dhe referohet vazhdimisht nga vetë tradita e transmetimit përkatës të saj, fakt që nënvizohet dhe nga vetë citimet e autores Arapi, por ndërkohë në *Mesharin* e Gjon Buzukut në lidhje me të gjendet më shumë se një variant, mjaft me vlerë për arsye të trajtave që përmbahen në to dhe të vetë vendit që zënë në pjesët më të rëndësishme të ndërtimit të kësaj vepre. Prania e teksteve të lutjeve që rimerren në pasazhet e saj është një veçori e vënë në dukje dhe në trajtesat shpjeguese të Eqrem Çabejt dhe shërben njëherësh për të kuptuar më mirë dhe shtrirjen e pjesëve që e ndërtojnë një libër kompleks të përbërë nga tekste me përkatësi nga Oficja, Psalmet, Litanitë, Breviari, Rituali dhe Meshari. Si një veçori që në lidhje me pjesët biblike është vënë në dukje dhe nga Martin Camaj në veprën e tij kushtuar *Mesharit* të Buzukut, rimarrja e teksteve shërben dhe për të gjurmuar variantet të cilave u është referuar autori/përpiluesi, njëherësh dhe diferencimet në trajtëforma apo sintagma që janë dhe dëshmi e ndikimeve të mundshme nga gjuhë të tjera, të kontaktuara dhe në rrethana shkëmbimesh të vazhdueshme mes përdoruesve. Autorja është ndalur në analizën e elementeve të përveçme që janë njëherësh dhe veçanësi sa i përket përmbajtjes dhe plotësimit semantik që marrin në përbërje të tekstit në të cilin janë ngërthyer (përdorimi i dëshirores; i fjalëve që me vështirësi ndeshen në variantet gjegjëse në gjuhë të tjera). Për këtë arsye, dhe vetë zbërthimi në pjesët përbërëse e bëjnë tekstin e kësaj lutjeje një burim deduktiv dhe nënvizimesh të tipareve që jo shpesh ndeshen dhe në kuadrin variantistik gjegjës. Një argument i tillë mbart një interes të veçantë për studimet tekstore që duhet të kenë në konsideratë dhe trajtime e interpretime nga studiues që të tilla vëzhgime i ndërmarrin dhe në proces të hulumtimeve mbi praninë dhe tiparet e reflektimit të kulturës së latinitetit të krishterë dhe të romanitetit në areale të caktuara.

Evalda Paci: Çështje të njohjes së historikut të veprave të letërsisë së vjetër shqipe në gjurmimet e Bardhyl Demirajt⁵

Në artikullin e Evalda Pacit vjen në shqyrtim një tipologji e veçantë kontributesh studimore të Bardhyl Demirajt, të lidhura me saktësimin apo hulumtimin e domosdoshëm në pikëpamje të njohjes së elementeve biografike të rrugëtimit jetësor të autorëve të letërsisë kishtare shqipe, mungesa e të cilave

⁵ E. Paci, “Çështje të njohjes së historikut të veprave të letërsisë së vjetër shqipe në gjurmimet e Bardhyl Demirajt”, *vëllim i cituar*, f. 133-149.

ka kushtëzuar dhe shtjellimin e plotë të trajtesave në studimet mbi letërsinë e shkruar shqipe (veçanërisht atë të shekujve XVI-XVII).

Vijnë në analizë dhe trajtime mbi historikun e institucioneve të edukimit kolegjial dhe shkollor të rishtarëve që lanë gjurmë në jetën kishtarë të vendit tonë në shekuj të mëhershëm, si fakte dhe pjesë përpilimesh që janë botuar më herët në revistat “Hylli i Dritës”, “Shëjzat”, por më vonë dhe në përbërje të një vëllimi të plotë tematik, të pasur dhe të bashkërenduar në pikëpamje tematike. Shtjellimet mbi aktet e Kuvendit të Arbënit (1703), në vijimësi të punës së hollësishme për të sjellë në dritë të shtypit një botim të mirëfilltë kritik e filologjik të dekreteve të botuara në vitin 1706, analizat mbi ribotime të mëvona që hedhin dritë mbi sprova për të nënvizuar jo vetëm rëndësinë e një sinodi të tillë kishtar, por dhe lehtësimin e konsultimit të tij sidomos në variantin në gjuhën shqipe janë përmendur në këtë kontribut tonin, bashkë me përpilime të tjera që lidhen me prelatë të botës arbërore, kontribues në pasurimin e traditës së shkrimit shqip dhe në një kontekst reformash të rëndësishme kishtarë, që lidhen me viset ballkanike, në të cilat një klimë ndryshimesh ndihej qartë që mbas përmbylljes së Konkilit të Trentit. Spektri i rrokjes së këtyre trajtesave përfshin një shumësi të domosdoshme argumentesh, aq më tepër me përqendrimin e vëmendjes në areale specifike të lëvrimit të kulturës së shkrimit, në lidhje me të cilat mund të gjurmohet dhe prania e librit shqip dhe njëherësh e vënies në përdorim të tij.

Joachim Matzinger: *Writing Albanian*⁶

Një artikull mirëfilli analitik është ai i studiuesit Joachim Matzinger, paraqitur nën titullin “Writing Albanian”, bazuar mbi një vështrim të gjerë diakronik që cek çështje të kulturës së shkrimit në kohët më të hershme, në rang trajtesash që kapërcejnë sinorët e zakonshëm në studimet e kësaj natyre, por dhe probleme që kanë të bëjnë me leximin e teksteve më të vjetra shqipe, për të arritur te një vepër mjaft e përmendur, e trajtuar dhe që ka qenë shtysë dhe për rikthim të vëmendjes në dekadat e fundit (Meshari). Ky artikull i një gjatësie të konsiderueshme përmban shqyrtime me vlerë sa i përket rimarrjes së dëshmimeve shkrimore të shqipes të vështruara në pikëpamje të kodeve alfabetike të vëna në përdorim, ndërlidhjes së mundshme mes tyre nëse bëhet fjalë për ndikime nga tradita shkrimore të ngjashme (b.f., alfabeti latin dhe stilet e shkrimit venecian), por dhe nënvizimit të veçanësisë që disa prej tyre paraqesin duke u lidhur një fakt i tillë dhe me formimin e përpiluesit të tekstit në shqip.

Autori dallon qartësisht mes të tjerash Formulën e Pagëzimit (1462), vështirësitë eventuale që shkruesi i letrës baritore Pal Engjëlli mund të ketë pasur në adaptimin e alfabetit latin në fjalinë monumentale që përtej vetë brendisë që lidhet me aplikimin e një sakramendi themelor në jetën liturgjike përbën një sprovë të mirëfilltë për ta shkruar atë në përbërje të një vëllimi

⁶ J. Matzinger, “Writing Albanian”, *vëllim i cituar*, f. 150-181.

qarkoreje në gjuhën latine. Vëmendja ndaj historikut të librit të Buzukut, të cilësuar si “i ashtuquajtur Meshar” shprehet në mënyrë të konsiderueshme në këtë artikull, që ndër të tjera është mjaft i vyer dhe për kujtesën e përpiktë në ecurinë e dijes dhe të kërkimeve mbi një vepër të tillë, me një mungesë fizike të konstatuar tashmë të elementeve përfaqësuese (me përjashtim të kolofonit me të cilin përmbyllet kjo e fundit), përmbajtja dhe çështjet e njohjes së të cilit mbeten objekt kureshtjeje dhe gjurmimesh të vazhdueshme. Një tematikë e tillë, e shtrirë në disa orientime bën të mundur që autori i shkrimit të tregojë vëmendje dhe për arritje të tjera më të vona në kohë, por të lidhura gjithsesi me shkrimin e shenjtë në gjuhën shqipe dhe me variantet përkatëse alfabetike të vëna në përdorim prej përpiluesve.

Gjerësia e mendimit dhe e vështirimeve e bën të plotë përmbajtjen e tij dhe të shfrytëzueshëm për konsultime të natyrës diakronike, tematike dhe historike. Autori tregon vëmendje si ndaj sistemeve shkrimore që shfaqen në themel të riprodhimit të teksteve të marra në shqyrtim (natyra e shkronjave, tradita përkatëse në stil e grafema, vendet ku duhet të jenë përdorur), ashtu dhe në vetë kontekstualizimin gjegjësisht në një kuadër më të gjerë gjeokulturor. Një element qenësor dhe mjaft i nënvizuar për nga rëndësia në brendinë e këtij artikulli është pikërisht trajtimi i shenjave grafematike në vështirim të vendit të përdorimit, të prejardhjes dhe analogjive me vepra të tjera të së njëjtës tematikë dhe destinacion. Një çështje themelore që shtrohet në të është dhe vetë kodi alfabetik që rezulton të jetë përdorur në librin e Buzukut, bashkë me pyetjen e arsyeshme nëse ky i fundit e ka përshtatur vetë një të tillë, apo e ka adaptuar nga përdorues të mëparshëm ose të kohës së vet.

Në artikullin e M. Morozovas (Akademia Ruse e Shkencave) dhe A. Rusakov (Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Akademia e Shkencave e Shqipërisë) janë vënë në vëmendje çështje të njohjes së korpuseve gjuhësore elektronike dhe të dobisë së përdorimit të tyre në rasë të evidentimit të vlerave të teksteve të autorëve të letërsisë shqipe, ndër të cilët autorët kanë përzgjedhur Leonardo de Martino-n, Gjergj Fishtë-n, Ndre Mjedjen, Filip Shirokën, Luigi Gurakuqin, Vincenc Prennushin, Ernest Koliqin, Migjenin, më tej dhe Pjetër Zarishin, Ndue Bytyçin, Preng Doçin, Zef Jubanin, Pashko Vasën, Anton Xanonin, Bernardin Palajn, Lazër Shantojën, Hilë Mosin dhe të tjerë poetë të traditës geqe letrare. Ky artikull orienton në vijimësi studiuesit e gjuhës e të letërsisë shqipe në zbatimin e një metodologjie të veçantë në gjurmimin e teksteve, trajtave, përdorimeve në gjuhën e autorëve dhe të vetë tipareve që dalin në pah përmes analizës më të thelluar të tyre, por orienton vëmendjen dhe ndaj botimesh të mirëfillta kritike të veprave përkatëse, aq më tepër kur bëhet

fjalë për autorë që kanë krijuar në kohë më të hershme e mund të jenë ribotuar gjatë shekullit të kaluar, apo në dekadat e fundit.⁷

Kapitulli që morëm në analizë përmbyllet me trajtesën me titull “Sociolinguistika historike e shqipes përmes veprës së Bardhyl Demirajt”, me autor Ledio Halën (Universiteti i Regensburgut; Universiteti “Ludwig Maximilian”-Mynih), e paraqitur si një shkrim shkencor i artikuluar në nënkrerë dhe saktësime metodologjike në leximin e veprës madhore të Bardhyl Demirajt në vështirime që e kanë të nevojshme përmasën sociolinguistike dhe etnolinguistike, madje me një vëmendje ndaj qasjesh të mëhershme në disiplina që gjejnë te ato diakroniket dhe te arritjet përkatëse lëndën e parë për t’u profilizuar më tej si të tilla.⁸

Çdo kontribut i përmbajtur në këtë kapitull të vëllimit studimor kushtuar profesor Bardhyl Demirajt është reflektim i arritjeve më të mira të autorëve përkatës, të bërë bashkë këtë herë për të nderuar një studiues të rrallë, koleg, mentor, që me perseverancën dhe njëherësh vlerësimin në vijimësi ndaj orientimeve studimore që qëndrojnë në themel të gjurmimeve albanologjike, ka ndërtuar prurje të qëndrueshme që bëhen më të vlerta me kalimin e kohës.

⁷ M. Morozova, A. Rusakov, “Albanian classical poetry in the Albanian National Corpus: Between linguistics and philology”, *vëllim i cituar*, f. 182-197.

⁸ L. Hala, “Sociolinguistika historike e shqipes përmes veprës së Bardhyl Demirajt”, *vëllim i cituar*, f. 198-205.

Izer Maksuti

Mbi gjuhët e rrezikuara dhe arbërishten – me rastin e vlerësimit të një botimi të veçantë

Hyrje

Gjuha nuk është vetëm mjeti kryesor i komunikimit njerëzor, por bartëse e kujtesës kulturore, e identitetit shoqëror dhe e përvojës kolektive. Zhdukja e çdo gjuhe përbën gjithherë humbje të një mënyre të veçantë të botëkuptimit njerëzor.

Në dekadat e fundit, debati për gjuhët dhe varietetet gjuhësore të rrezikuara është shndërruar nga një temë thjesht gjuhësore në një çështje me rëndësi shoqërore e politike. Në Europë, pikërisht Italia dhe Ballkani, janë ndër hapësirat më të pasura për nga shumëllojshmëria gjuhësore, por njëkohësisht edhe ndër më të ekspozuarat ndaj rrezikut të humbjes gjuhësore.

Sipas vlerësimeve të fundit në botë janë më pak se 7000 gjuhë, mbi 45 % prej tyre mbeten të rrezikuara, pasi nuk mësohen dhe si pasojë nuk trashëgohen më tutje nga brezat e rinj. Që nga viti 1960 e këndej bota është më e varfër për rreth 400 gjuhë.¹ Si më të prekura nga këta zhvillime mbeten bashkësi të vogla gjuhësore, për atë humbja e gjuhës, nuk është vetëm një çështje linguistike, por edhe sociale dhe kulturore.² Edhe në “*Atlasin e gjuhëve të rrezikuara nga zhdukja*”, paraqiten gjithsej 50 gjuhë të rrezikuara në botë, prej tyre nëntë në Europë, ndër ta baskishtja, retoromanishtja, si dhe gjuhë tjera pakicë romane dhe kelte.³

Në Atlasin e UNESCO-s për gjuhët në rrezik, gjuhët e botës klasifikohen në shtatë nivele të rrezikut, nga 5 = *e sigurt / safe*, deri te 0 = *e zhdukur / extinct*, si: dalmatishtja, prusishtja e vjetër. Nivelet tregojnë përmasat e ruajtjes së gjuhëve ndër breza dhe përdorimin e tyre në përditshmëri. Nivelet 1, cilësuar

¹ Shih më shumë për këtë, UNESCO; Endangered Languages Project: <https://www.endangeredlanguages.com/about-endangered-languages>

² Shih në këtë atlas përfshihen mbi 2500 gjuhë të rrezikuara nga zhdukja. Christopher Moseley (Ed.). (2010). UNESCO. *Atlas of the World's Languages in Danger* (3. Aufl.). UNESCO Publishing.

³ Arnfrid Schenk & Stefan Schnell (2025). *Atlas der vom Aussterben bedrohten Sprachen: Von Nordfriesland bis nach Amazonien*. Köln.

si *Critically Endangered* / kritikisht e rrezikuar: cornishtja / Cornish, votishtja / Votic. Niveli 2, *Severely Endangered* / gjuhë të rrezikuara rëndë, si: karelishtja / Karelian, livonishtja / Livonian, samishtja e Ume-s / Ume Sami; dhe niveli 3, *Definitely Endangered* / definitivisht e rrezikuar, konsiderohen gjuhë të rrezikuara, sepse fliten kryesisht nga brezat e moshuar, transmetimi ndër breza është i dobët ose i ndërprerë dhe përdorimi i tyre është shumë i kufizuar. Arbërishtja, në varësi të rajonit dhe komunitetit (sidomos në Arbërinë e Veriut), luhatet ndërmjet nivelit 3 dhe nivelit 2 të rrezikimit, ndërsa arvanishtja paraqet një shkallë më të lartë rrezikimi, për shkak të ndërprerjes pothuajse të plotë të transmetimit ndër breza. Nivelet 4, *Vulnerable* / e cenueshme, si: arumanishtja, irlandishtja, korsikishtja, sami verior), 5-, *Stable yet threatened* / e qëndrueshme, por e kërcënuar, si: bretonishtja, skocishtja, dhe 5, *Safe* / e sigurt, si: anglishtja, frëngjishtja, gjermanishtja, spanjishtja, rusishtja etj., nuk janë të rrezikuara; ato fliten nga shumica dhe bartja te brezat e ardhshëm është e paprekur.⁴

Libri i titulluar *Endangered Language Varieties in Italy and the Balkans*, vëllimi i përmbledhur, me titullin e përshtatur në shqip “*Varietetet gjuhësore të rrezikuara në Itali dhe në Ballkan*”, i botuar në vitin 2024 nga shtëpia botuese e Akademisë së Shkencave të Austrisë (Verlag der Österreichischen Akademie der Wissenschaften), përmbledh kontributet e shkruara të një konference ndërkombëtare, e cila është mbajtur në vitin 2018 në Villa Vigoni në Itali.⁵

Gjatë recensimit të këtij botimi edhe për një revistë⁶ tjetër, vlerësuam se për lexuesin shqiptar libri ka një vlerë shtesë, pasi trajton tema për ruajtjen e gjuhëve të rrezikuara dhe katër artikuj më vete i kushtohen arbërishtes, për të cilët do të ndalemi në këtë shkrim më gjerësisht.

Ky botim ofron një panoramë shumëgjuhëshe të hulumtimeve gjuhësore, kulturore dhe sociolinguistike mbi gjuhët e pakicës dhe gjuhët rajonale në Itali dhe në Europën Juglindore. Ai ndërthur me sukses kërkimin empirik, reflektimin kulturor-politik dhe përgjegjësinë shkencore. Forca e tij qëndron jo vetëm në gjerësinë tematike, por edhe në autoritetin shkencor të botuesve dhe të autorëve pjesëmarrës. Qëllimi i tij është të hedhë dritë mbi situatën

⁴ Krh. C. Moseley. 2010, f. 11-12.

⁵ Monica Genesin, Karl Gerhard Hempel dhe Thede Kahl, “Varietetet gjuhësore të rrezikuara në Itali dhe në Ballkan”, me titullin origjinal: *Endangered Language Varieties in Italy and the Balkans / Bedrohte Sprachvarietäten in Italien und auf dem Balkan / Varietà linguistiche a rischio in Italia e nei Balcani*, botuar nga Austrian Academy of Sciences Press, Vjenë, 2024, 384 fq. (*Vanishing Languages and Cultural Heritage* [VLACH], vëllimi 4) ISBN 978-3-7001-9685-3.

⁶ INTERKULTURA, Revistë shkencore e Fakultetit të Shkencave Humane, Nr. 7, 2025. Universiteti “Nënë Tereza” në Shkup, <https://unt.edu.mk/wp-content/uploads/2026/05/INTERKULTURA-Nr.-7-2025.pdf>.

komplekse të varieteteve gjuhësore të rrezikuara në Gadishullin Apenin dhe në Europën Juglindore, duke trajtuar njëkohësisht çështje të mbrojtjes së gjuhës, rivitalizimit dhe përgjegjësisë gjuhësore-politike në një kuadër evropian. Të gjitha studimet këtu pasqyrojnë në mënyrë shembullore procesin e zhvillimit të rrezikimit të gjuhëve dhe të zhdukjes së tyre.

Të tre botuesit janë emra të dëshmuar në këtë fushë: Monica Genesin⁷, një njohëse e shquar e kontakteve gjuhësore italo-shqiptare dhe romane-ballkanike dhe një përfaqësuese e dalluar në fushën e albanologjisë dhe gjuhësisë ballkanike në Itali; Karl Gerhard Hempel, specialist i studimeve sociolinguistike, sidomos mbi peizazhin gjuhësor, dhe Thede Kahl⁸ që është një nga ballkanologët më të njohur të kohës sonë, krijojnë së bashku një redaksi të rrallë për nga ana e përplotësimit të kompetencave shkencore. Ky vëllim i përmbledhur përfshin artikuj shkencorë nga një grup autorësh të mirënjohur në fushën e studimeve mbi pakicat gjuhësore evropiane, si Walter Breu (Universitët Konstanz), Lucija Šimičić (Kroaci), Fiorenzo Toso (Itali), Maria Luisa Pignoli, Emilia Conforti (Itali) e të tjerë. Secili prej tyre sjell një ekspertizë të veçantë rajonale, duke ndihmuar në krijimin e një panorame të gjerë dhe të thellë mbi larminë gjuhësore të kësaj pjese të Europës.

Në një kontekst më të gjerë evropian, ky vëllim përfaqëson një botim të rrallë me rëndësi krahasuese, që lidhet në mënyrë tematike dhe metodologjike me botime si *Balkan and South Slavic Enclaves in Italy* (Kahl/Krapova/Turano, 2018)⁹ dhe *The Romance-Speaking Balkans* (Sorescu-Marinković et al., 2021)¹⁰, por i tejkalon ato në përmasa më të gjera dhe me të dhëna të përditësuara.

Në këtë kontekst, është me interes të përmenden edhe studime dhe botime tjera, si ai i shkrimtarit austriak Karl-Markus Gauss: “*Europianët që po shuhen: Në udhëtim te sefardët e Sarajevës, gjermanët e Gotçes, arbëreshët, sorbët dhe aromunët*”, ku autori përshkruan me ndjeshmëri poetike jetën e komuniteteve

⁷ Monica Genesin punon si profesoreshe e gjuhës dhe letërsisë shqipe në Università del Salento në Lecce, si dhe shquhet për veprimtarinë e saj akademike, me pjesëmarrje në projekte ndërkombëtare, sidomos në fushë të albanologjisë. Shih më shumë për këtë në: <https://www.unisalento.it/scheda-utente/-/people/monica.genesin>

⁸ Thede Kahl profesor në Universitetin e Jenës, <https://www.gw.uni-jena.de/3390/kahl-thede> dhe anëtar i Akademisë së Shkencave të Austrisë, <https://www.oeaw.ac.at/m/kahl-thede>.

⁹ Thede Kahl / Iliana Krapova / Giuseppina Turano (eds.) (2018). *Balkan and South Slavic enclaves in Italy: Languages, dialects, and identities*. Cambridge Scholars Publishing.

¹⁰ Annemarie Sorescu-Marinković, Mihai Dragnea, Thede Kahl, Blagovest Njagulov, Donald L. Dyer & Angelo Costanzo (Eds.). (2021). *The Romance-Speaking Balkans: Language and the politics of identity* (Brill's Studies in Language, Cognition and Culture, Vol. 29). Brill.

të vogla evropiane, mes tyre edhe arbëreshët dhe arumunët.¹¹ Të përmendim këtu edhe botimet e shumta me vlerë mbi arbëreshët, nga vetë studiuesit arbëreshë, si Françesko Altimari (Francesco Altimari), Universiteti i Kalabrisë¹², Mateo Mandala (Matteo Mandalà), Universiteti i Palermos¹³, si dhe shumë të tjerë, por edhe nga autorë shqiptarë si: Bardhyl Demiraj, Eqrem Çabej, Fatmir Toçi, Jup Kastrati, Mustafa Ibrahim, Rexhep Zllatku etj. Janë të njohur edhe studiuesit austro-gjermanë me botimet e tyre themeltare edhe për arbëreshët e arvanitët dhe gjuhën e tyre, që në pjesën e dytë të shek. XIX dhe në fillim të shekullit XX si: Gustav Meyer, Maximilian Lambertz, si dhe të tjerë nga gjysma e dytë e shek. XX, si: Claus Haebler, Hans-Jürgen Sasse, Klaus Rother, Walter Breu, Elvira Glaser etj.

Ndryshe nga këto botime, që disa janë më tepër filologjike e përshkruese, libri për të cilin bëjmë fjalë ndjek një qasje më gjithëpërfshirëse, të mbështetur në analiza kulturore, sociolinguistike dhe politike. Vepra me përmbledhje artikujsh shkencorë, e redaktuar dhe botuar nga Genesin, Hempel dhe Kahl, mund të shihet si kundërpeshë shkencore e panoramës kulturore që ofron Gauss. Ajo plotëson përshkrimin letrar me kërkime empirike, saktësi gjuhësore dhe dokumentim të thellë akademik.

Përmbajtja e artikujve për politikën gjuhësore të ruajtjes së gjuhëve dhe arbërishten

Pas tekstit hyrës të botueseve, libri përfshin 17 artikuj, të ndarë në katër njësi tematike: politika gjuhësore e pakicave, peizazhet gjuhësore, vitaliteti i varianteve të rrezikuara dhe kontakti gjuhësor dhe shumëgjuhësia, ku trajtohen nga këndvështrime të ndryshme të gjitha këto dukuri të varieteteve të rrezikuara në Itali dhe në Europën Juglindore. Këto studime janë botuar në tri gjuhë: gjermanisht, anglisht dhe italisht dhe ndahen sipas fushave tematike të sipërpërmendura, duke përfshirë perspektiva sociolinguistike, dialektologjike, didaktike dhe historike.

Artikulli i parë hyrës i këtij vëllimi, hartuar nga të tre botuesit: Monica Genesin, Karl Gerhard Hempel dhe Thede Kahl, titulluar: “*Mbrojtja dhe ruajtja e gjuhëve minoritare dhe rajonale në Ballkan dhe Itali*”, nga faqja 11-24, përmes pesë nënkapitujve tematikë si: 1. *Politika gjuhësore e pakicave në Europë: perspektivat e revitalizimit gjuhësor*, 2. *Peizazhet gjuhësore*, 3. *Si “mbijetojnë” gjuhët minoritare?*, 4. *Gjuhësia e kontaktit dhe shumëgjuhësia si fenomen i gjuhëve të pakicave*, si dhe 5. *Vdekja, zhdukja apo mbijetesa e gjuhëve*, ofron një panoramë të gjerë dhe të integruar të debatit bashkëkohor

¹¹ Karl-Markus Gauß. (2022). *Die sterbenden Europäer: Unterwegs zu den Sepharden von Sarajevo, Gotscheer Deutschen, Arbëreshe, Sorben und Aromunen*. Unionsverlag.

¹² <http://www.albanologia.unical.it/info.htm>

¹³ <https://www.unipa.it/persona/docenti/m/matteo.mandala>

mbi mbrojtjen e gjuhëve të rrezikuara. Falë qartësisë analitike, mbështetjes empirike dhe lidhjes së drejtpërdrejtë me diskurset ndërkombëtare të politikës dhe planifikimit gjuhësor, ky artikull hyrës jo vetëm që përcakton në mënyrë koherente studimet pasuese, por ofron edhe një pikë orientimi të fortë për kërkime të ardhshme krahasimtare, në fushën e planifikimit dhe politikës gjuhësore për gjuhët minoritare.

Në punimin e dytë të kësaj vepre përmbledhëse, të tre botuesit paraqesin artikullin me titull: “*Konsensus për mbrojtjen dhe ruajtjen e gjuhëve minoritare dhe rajonale*”, i hartuar në dy gjuhë, gjermanisht dhe italisht, përmes së cilit pasqyrohet edhe fryma shumëgjuhëshe dhe ndërkulturore e këtij vëllimi. Ky artikull synon të tematizojë në mënyrë kritike nocionin shpesh të supozuar të “konsensusit” ndërmjet aktorëve politikë, institucioneve dhe vetë komuniteteve gjuhësore. Autorët tregojnë se, në praktikë, ky konsensus rrallëherë është homogjen, pasi koncepti i “mbrojtjes” merr kuptime të ndryshme në varësi të palës përkatëse: nga njohja simbolike dhe promovimi kulturor, deri te mbështetja arsimore apo barazia e plotë institucionale. Një vlerë e veçantë e këtij artikulli qëndron në analizën e tensioneve ndërmjet politikave top-down (nga lart-poshtë) dhe iniciativave bottom-up (poshtë-lart), duke argumentuar bindshëm se ruajtja dhe revitalizimi i suksesshëm i gjuhëve të rrezikuara, mund të arrihet vetëm aty ku masat shtetërore ndërthuren me institucionet dhe angazhimin e komuniteteve lokale.

Studimi i autorit Dejan Matić: “*Përkufizimi i vdekjes së gjuhës*”, së pari ka vlerë teorike për konceptimin, përkufizimin dhe sqarimin në mënyrë sistematike të nocionit “vdekja e gjuhës”, i cili përdoret gjerësisht në sociolinguistikë, por ende shpesh mbetet i paqartë, ose i sqaruar thjesht e jo mjaftueshëm. Autori e kundërshton qasjen që e koncepton “vdekjen e gjuhës” si një ngjarje të rëndomtë, apo si rezultat të drejtpërdrejtë të rënies së numrit të folësve. Ai e përkufizon dhe përshkruan procesin si tepër kompleks, që zhvillohet në shumë faza, nga ndikime të shumëfishta shoqërore, që shtrihet në kohë dhe përfshin përmasa të ndryshme strukturore, funksionale dhe simbolike. Ky artikull ofron një mjet të saktë përkufizues për dallimin e termave si: vdekje e gjuhës, ndërrim i gjuhës dhe erozion gjuhësor. Për arbërishten e tëra është e një rëndësie të veçantë, pasi varësisht nga rajonet e ndryshme ku ende përdoret, po dëshmojnë faza të ndryshme të humbjes së gjuhës.

Një element qendror i studimit është diskutimi i mekanizmave tipikë dhe shkaqeve të vdekjes së gjuhës, si humbja graduale e kompetencës, tërheqja nga domenet kyçe të përdorimit dhe, mbi të gjitha, ndërprerja e transmetimit dhe ruajtjes nga brezat e ardhshëm. Në këtë kontekst (shih fig. 1, në fq. 41), e cila paraqet “Sasse’s Gaelic-Arvanitika Model (GAM)”, është veçanërisht domethënëse për lexuesin shqiptar, pasi ofron një kornizë krahasuese që ndihmon në kuptimin e proceseve të ngjashme të dobësimit gjuhësor, te komunitete si arvanitët, arbëreshët, apo edhe varietete të tjera të shqipes jashtë

territorit shtetëror. Modeli ilustron qartë se vdekja e gjuhës nuk është një akt i menjëhershëm, por rezultat i një vargu zhvendosjesh funksionale dhe ideologjike, ku gjuha humbet gradualisht rolin e saj, në jetën e përditshme dhe në ndërtimin e identitetit.

Vlera e veçantë e këtij artikulli qëndron në ndërthurjen metodike të kriterëve gjuhësorë me faktorë sociokulturorë, si prestigji, lidhja identitare dhe përdorimi institucional, çka e bën analizën veçanërisht të qëndrueshme teorikisht. Në kuadrin e këtij vëllimi përmbledhës, artikulli i Matić-it krijon një bazë konceptuale të përbashkët, mbi të cilën mbështeten në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë studimet empirike të rasteve konkrete. Në këtë mënyrë, ai kontribuon ndjeshëm në koherencën e përgjithshme të librit dhe ofron një pikë referimi të domosdoshme për studiuesit e gjuhëve të rrezikuara, veçanërisht në kontekstin ballkanik dhe albanologjik.

Artikulli me titull: *“Ndarje gjuhësore apo translingualizëm? Mbi strukturën dhe funksionin e tabelave shumëgjuhëshe në peizazhin gjuhësor të Tirolit të Jugut”*, i Karl Gerhard Hempel ofron një analizë për statusin gjuhësor dhe barazinë e gjuhëve, bazuar në peizazhin gjuhësor. Duke analizuar mbishkrimet zyrtare dhe private në peizazhin gjuhësor të Tirolit të Jugut, autori dëshmon se modeli dominues karakterizohet nga një bilinguizëm i ndarë, i cili pasqyron një politikë gjuhësore të orientuar drejt barazisë formale mes gjermanishtes dhe italishtes. Artikulli evidenton edhe shembuj të përdorimit praktik të shumëgjuhësisë, veçanërisht nga aspekti privat, të cilat interpretohen si shenja të një potenciali translingual në praktikën e përditshme gjuhësore. Në këtë kuptim, peizazhi gjuhësor i Tirolit të Jugut konceptohet si një mjedis për arritjen e kompromisit, ndërmjet normës institucionale dhe praktikave sociale. Përtej vlerës analitike, ky studim ka rëndësi të veçantë, për krahasimin me zona tjera shumëgjuhëshe, përfshirë Republikën e Maqedonisë së Veriut, pasi gjendja e peizazhit gjuhësor, si një ndër treguesit e dukshëm për statusin e gjuhës, dëshmon për nivelin e zbatimit të politikave të duhura gjuhësore në një vend.

Një nga blloqet tematike më të rëndësishme, mendoj për lexuesin shqiptar, të këtij vëllimi përmbledhës lidhet me gjendjen e varieteteve arbëreshe në Itali dhe me efikasitetin e politikave gjuhësore për ruajtjen e tyre. Kontributi i dy albanologëve të njohur Monica Genesin dhe Joachim Matzinger-it, mbi peizazhin gjuhësor të komunitetit arbëresh të San Marzano di San Giuseppe (provinca e Taranto-s, Pulia) përbën një studim rasti, me një metodologji pune, që duhet marrë si shembull, i cili e bën të dukshëm raportin e ngushtë ndërmjet përdorimit të gjuhës në hapësirën publike dhe kontekstit sociolinguistik. Duke u nisur nga një periudhë kritike mes viteve 1960–1980, kur arbërishtja refuzohej nga vetë pjesëtarët e popullsisë vendase si gjuhë “e prapambetur”, autorët ndjekin procesin e ngadalshëm, por të dallueshëm, të kalimit drejt një rivlerësimi të kujdesshëm të trashëgimisë gjuhësore dhe kulturore. Vëmendje e

veçantë i kushtohet rolit të toponimisë¹⁴ dhe mbishkrimeve publike si pjesë të njohjes simbolike në planin e politikave gjuhësore. Në pjesën e dytë të artikullit, mbi bazën e një kërkimi në terren të realizuar në vitin 2017, analizohet në mënyrë sistematike toponimia urbane, odonimet e San Marzano-s, duke u treguar se prania e arbërishtes në hapësirën publike mbetet selektive dhe shpesh fragmentare, por megjithatë mund të lexohet si tregues i ndryshimeve në qëndrimet gjuhësore dhe i formave të reja të ndërtimit të identitetit lokal. Ky kontribut shquhet për pozicionimin e qartë teorik në fushën e studimeve mbi peizazhin gjuhësor, dhe ofron njëkohësisht njohuri të vlefshme empirike për albanologjinë, duke dëshmuar se si politika e duhur gjuhësore, kujtesa kolektive dhe përpjekjet për revitalizim ndërthuren në nivel lokal.

Në vazhdim (f. 183-203), studimi i Maria Luisa Pignoli-t, ofron një pasqyrë të përditësuar, empirike dhe teorikisht të argumentuar mbi vitalitetin e arbërishtes në zonën e Arbërisë së Veriut, që përfshin Abruco-n (Abruzzo), Molise-n, Pulia (Puglia) Veriore dhe Kampania (Campania). Autorja dëshmon se këto varietete ndodhen në faza të ndryshme të dobësimit gjuhësor, në disa raste duke iu afruar zhdukjes funksionale, ndërsa në të tjera duke ruajtur forma të kufizuara stabiliteti në bashkësinë gjuhësore. Një vlerë e veçantë e këtij kontributi qëndron në refuzimin e qasjeve homogjenizuese, pasi këtu arbërishtja paraqitet si një vazhdimësi dinamike varietetesh dhe praktikash lokale, e ndikuar nga faktorë kompleksë si arsimi, migrimi, prestigji gjuhësor dhe mbështetja institucionale. Në mënyrë plotësuese, analiza për ndikimin e ligjit italian 482/1999¹⁵, mbi mbështetjen dhe mbrojtjen e arbërishtes, sjell një vlerësim kritik të kornizës ligjore ekzistuese. Ndërsa ky ligj shënon një hap të rëndësishëm drejt njohjes zyrtare të komuniteteve arbëreshe si pakicë gjuhësore historike, kontributi në fjalë tregon se efektet e tij konkrete në përdorimin e përditshëm të gjuhës mbeten të kufizuara.

Masat e parashikuara kanë prodhuar kryesisht nisma formale dhe simbolike, pa arritur të sigurojnë një status funksional të qëndrueshëm të arbërishtes në arsim, administratë dhe hapësirën publike, ku përdorimi i një “Dachsprache” (gjuhë e përbashkët për dialektet arbëreshe), do të mund të kishte ndihmuar në unifikimin e komunikimit. Siç theksohet edhe nga studiuesja Pignoli, mungesa e një planifikimi të qartë të statusit dhe e modeleve

¹⁴ Shih me interes për shqipen, po ashtu projekti hulumtues i etimologut të njohur austriak, Joachim Matzinger, në Akademinë e Shkencave të Austrisë, me titull: “Sprachgeschichte der Ortsnamen Albanien” (Historia e gjuhës e toponimeve të Shqipërisë), <https://www.oeaw.ac.at/en/ihb/forschungsbereiche/balkanforschung/forschung/sprache-und-siedlungs-geschichte/sprachgeschichte>.

¹⁵ <https://www.provincia.tn.it/de/Nachrichten/Einblicke/Gesetzgebung-zum-Schutz-historischer-sprachlicher-Minderheiten>

të qëndrueshme arsimore, e bën ligjin 482/1999 një instrument të domosdoshëm, por jo të mjaftueshëm për ndaljen e humbjes graduale të domeneve të përdorimit gjuhësor.

Studiuesja e njohur arbëreshe dhe albanologia Emilia Conforti¹⁶ në studimin e saj: “*Aspekte kyçe në mësimdhënien e gjuhës italo-shqiptare*”, argumenton në mënyrë të qartë për nevojën e njohjes së statusit zyrtar të arbërishtes te komuniteti arbëresh në Itali, duke vlerësuar rolin e gjuhës si instrument thelbësor të identitetit politik dhe kulturor. Autorja vë në pah se institucionalizimi i gjuhës nuk përfaqëson vetëm një akt simbolik, por një mekanizëm konkret për fuqizimin e përdorimit publik dhe shoqëror të saj. Ajo sugjeron se orientimi drejt një modeli standardizimi funksional, në raport me shqipën standarde, do të mund të ndihmonte në mbrojtjen dhe ruajtjen e dialekteve të arbërishtes në Itali, duke i pranuar ata si pjesë përbërëse të trashëgimisë kulturore dhe gjuhësore të Italisë dhe më të gjerë të asaj europiane. Emilia Conforti trajton këtu çështje veçanërisht të ndjeshme dhe me rëndësi të madhe praktike, sidomos në fushën e mësimdhënies së arbërishtes te komunitetet arbëreshe. Ajo analizon sfidat kryesore didaktike dhe institucionale, duke dëshmuar se mësimi i gjuhës shpesh lëkundet mes standardizimit normativ dhe ruajtjes së të folmeve lokale.

Një vlerë e veçantë e këtij punimi qëndron në reflektimin kritik mbi faktin nëse programet shkollore kontribuojnë realisht në vitalizimin e gjuhës apo, përkundrazi, krijojnë pa dashje një distancë mes gjuhës së mësimi dhe varieteteve të përdorimit të përditshëm. Në mënyrë të nënkuptuar, autorja rekomandon një model më të orientuar kah komuniteti dhe më miqësor ndaj varieteteve, i cili ndërthur identitetin, kompetencën gjuhësore dhe praktikën kulturore, duke ndërtuar kështu një urë të rëndësishme mes didaktikës së gjuhës, planifikimit dhe politikave gjuhësore për pakicat.

Së bashku, këto tri kontribute ndërtojnë një tablo realiste të dobishme mbi sfidat aktuale të ruajtjes së arbërishtes në Itali. Ato e zhvendosin diskutimin nga niveli thjesht normativ drejt një reflektimi më të thellë mbi raportin mes njohjes ligjore, praktikës shoqërore dhe vitalitetit real gjuhësor, duke e bërë këtë pjesë të vëllimit veçanërisht të vlefshme për albanologjinë, sociolinguistikën dhe studimet mbi politikat gjuhësore të pakicave në Europë.

Studiuesit gjermanë Elvira Glaser¹⁷ dhe Walter Breu¹⁸, krahas hulumtimeve të tyre në fushën e gjermanistikës dhe në sllavistikë, njihen edhe

¹⁶ <https://albanialetteraria.it/autori/emilia-conforti>;

<https://www.koha.net/kulture/arbereshja-rrefen-se-si-ruhet-gjuha-shqipe-ne-itali>

¹⁷ Shih po ashtu për studiuesen e njohur Elvira Glaser:

https://www.ds.uzh.ch/apps/cms/pfs/personen_en.php?detail=47&get=pb

¹⁸ Shih më tepër për studimet e shumta të tij edhe në këtë fushë:

<https://www.uni-konstanz.de/FuF/Philo/Sprachwiss/slavistik/breu/PubGesamt.pdf>

për kontributin e tyre në albanologji, veçanërisht për botimet kushtuar arbërishtes dhe komuniteteve arbëreshe.

Te studimi i Walter Breu-t, me titull: *“Kontakti gjuhësor në krahësim: sistemi foljor në shqipen dhe sllavishten e Molises”*, gjejmë një analizë me qasje krahasimtare, të dy ishujve gjuhësorë, përkatësisht të të folmeve të fshatrave sllave dhe shqiptare në Molise, në Italinë e Jugut. Në qendër të analizës qëndrojnë kategoritë gramatikore të aspektit, të kohës, të mënyrës dhe të diatezës së foljes, përmes të cilave autori shqyrton zhvillimet strukturore të shkaktuara nga kontakti i gjatë dhe i drejtpërdrejtë gjuhësor me varietete romane. Duke qenë se të dy komunitetet pakicë, ndajnë të njëjtin mjedis kontakti, krahasimi rezulton metodologjikisht i qëndrueshëm dhe nxjerr në pah si ngjashmëritë, ashtu edhe dallimet në sistemin foljor të shqipes dhe të sllavishtes së Molises. Pjesa hyrëse e kontributit ofron gjithashtu një pasqyrë të situatës historike dhe demografike të dy pakicave. Përmes analizave të hollësishme morfosintaksore, Breu dëshmon se kontakti gjuhësor mund të prodhojë ndryshime strukturore afatgjata, pa e zhdukur plotësisht individualitetin tipologjik të gjuhëve në kontakt.

Ky studim përbën kulmin strukturor të vëllimit, duke dëshmuar vlerën e lartë shkencore për albanologjinë dhe sllavistikën, si edhe rëndësinë e gjuhësisë për studimin e varieteteve gjuhësore të rrezikuara dhe kërkimin bashkëkohor të kontaktit gjuhësor.

Gjatë paraqitjes dhe vlerësimit të këtij botimi u ndalëm qëllimisht më së shumti, së pari te tre artikujt që flasin në përgjithësi për çështje të shumëgjuhësisë, të politikave gjuhësore dhe të kontaktit gjuhësor, dhe në pjesën e dytë, veçanërisht më shumë te katër studimet mbi arbërishten.

Por nga këtu mund të mësohet shumë, në këtë rast për ruajtjen e arbërishtes, edhe prej studimit me titull: *“Friaulishtja: Mbështetja e gjuhës së një pakice historike, autoktone”*, i cili ofron një analizë të zhvillimit historik, të gjendjes së tanishme sociolinguistike, si dhe përshkruan masat mbrojtëse institucionale për këtë gjuhë pakicë. Gjatë përshkrimit dëshmohet se kemi dobësim dhe tkurrje të vazhdueshme të përdorimit të kësaj gjuhe, edhe pse kjo ka një traditë të gjatë shkrimi dhe një ngulitje shekullore rajonale. Autori i studimit thekson se në krahasim me gjuhët tjera, për këtë gjuhë tepër vonë, që nga vitet 1990-të, janë marrë masa të qëllimshme për mbrojtje, që kishin qëllimin e shtimit të pranisë së saj në administratë, në arsim, në medie dhe në përdorim publik. Këto masa institucionale të politikës gjuhësore, nuk e ndalën dot humbjen e gjuhës, por ndihmuan dukshëm në procesin e ngadalësimit dhe rritjen e prestigjit shoqëror të kësaj gjuhe.

Përmes krahasimit, për arbërishten, kjo përvojë e kësaj gjuhe ofron një mundësi për të marrë mësim, pasi të dyja gjuhët pakicë në Itali kanë një histori shekullore, të cilat ballafaqohen me sfida të ndryshme mbijetese. Gjersa friaulishtja dëshmon një traditë të gjatë të shkrimit dhe një mbështetje

institucionale, arbërishtja mbetet mjaft e ndarë nëpër rajone të ndryshme, shpesh e kufizuar vetëm në përdorim e saj në familje. Nga ky kontribut për këtë gjuhë mësojmë po ashtu se masat institucionale, si përfshirja e gjuhës në shkollë, përdorimi i shtuar në jetën publike dhe prania në medie, edhe për rastin e arbërishtes mund të jenë tepër të rëndësishme, por ndikimin e duhur mund ta arrijnë vetëm atëherë nëse do të përshtaten me kërkesat e veçanta të bashkësisë gjuhësore përkatëse. Nga ky rast studimi, vjen paralajmërimi se mbrojtja e gjuhës nuk duhet kuptuar vetëm përmes procesit nga lart-poshtë. Për rastin e arbërishtes kjo do të thotë se, njohja ligjore dhe mbështetja institucionale edhe pse janë parakushte të domosdoshme, ruajtja afatgjate e gjuhës, megjithatë varet kryekëput prej pjesëmarrjes aktive të komunitetit, të ruajtjes dhe bartjes ndër breza, si dhe të vlerësimit pozitiv të gjuhës si thesar kulturor.

Po ashtu i një rëndësie të veçantë është punimi i studiueses Lucija Šimičić: *“Mbrojtja institucionale dhe ruajtja e qëndrueshme e pakicave gjuhësore në Kroaci”*. Bazuar në studimin e rastit kroat, nga autorja dëshmohet edhe në këtë çështje se, mbrojtja ligjore dhe njohja institucionale janë të domosdoshme, por assesi parakushte të mjaftueshme për vazhdimësinë dhe ruajtjen e gjuhës. Nga kjo njohje drejtpërdrejt mund të mësohet edhe për çështjen e arbërishtes, e cila megjithëse ka njohje ligjore në Itali, shpesh i mungon zbatimi në praktikë, si dhe mbetet i pamjaftueshëm mësimi i saj në shkollë, por edhe prania e paktë në përdorim publik.

Studimi i autores Malinka Pila: *“Periudha hipotetike në resianisht: një krahasim me sllovenishten”*, na jep të dhëna me vlerë mbi ndryshimet strukturore të gjuhës nën ndikimin e fortë të një gjuhe shumice, dominuese në shoqëri. Këto analiza sidomos për arbërishten janë me shumë rëndësi, pasi kontakti i vazhdueshëm i saj me italishten, pason jo vetëm me ndikime leksikore, por edhe morfo-sintaksore, të cilat në një periudhë afatgjatë mund të çojnë në erozion të gjuhës.

Po ashtu të rëndësishme mbeten edhe studimet mbi gjuhët e pakicave më të vogla dhe më pak të njohura, si te punimi i autorit Livio Gaeta: *Written and oral sources for the Walser linguistic islands in Italy*. (Burimet e shkruara dhe gojore për ishujt gjuhësorë Walser në Itali). Këto për arbërishten janë me shumë vlerë, nga të cilat mund të mësohet, sepse dëshmojnë se mekanizmat e humbjes së gjuhës ndjekin rrjedha të ngjashme, pavarësisht konteksteve të ndryshme historike dhe kulturore. Nga studime të tilla vërtetohet rishtas se fragmentimi i bashkësive gjuhësore, ndërprerja e bartjes te brezat e rinj, si dhe kufizimi i përdorimit në domene funksionale, përbëjnë shembuj të përsëritur.

Në tërësi, vëllimi paraqet një kontribut të rëndësishëm të studimeve evropiane mbi gjuhët e rrezikuara, duke ofruar një kornizë analitike që ndërthur përshkrimin empirik me reflektimin teorik, por edhe me një dimension shoqëror dhe politik të ruajtjes së gjuhëve. Për studimet mbi arbërishten, ai ofron jo vetëm materiale krahasimtare dhe qasje metodologjike të përpunuara,

por edhe një perspektivë më të gjerë mbi sfidat e ruajtjes dhe transmetimit të gjuhës ndër breza.

Megjithatë, disa prej kontributeve do të mund të thellonin më tej dimensionin praktik të planifikimit gjuhësor dhe mekanizmat konkrete të zbatimit të politikave mbrojtëse në nivel lokal.

Pikërisht kjo hapësirë reflektimi e bën vëllimin jo vetëm një përmbledhje studimesh, por një pikënisje për kërkime të mëtejshme dhe për një debat më të strukturuar mbi të ardhmen e varieteteve të rrezikuara, përfshirë edhe arbërishten.

Gerd-Dieter Nehring

**Anastas Dodi, *Hyrje në gjuhësi*, Naimi: Tiranë 2019,
303 f.**

Vepra *Hyrje në gjuhësi* e Anastas Dodit (20.07.1933 - 08.05.2008), e botuar në shqip në vitin 2019 në Tiranë përfaqëson një provë të suksesshme për të paraqitur drejtime të rëndësishme gjuhësore, që nga gjuhësia historike - krahasuese deri te gjuhësia kompjuterike, si dhe bazat e gjuhës shqipe, veçanërisht për mësimdhënien universitare, dhe për t'i bërë ato të shfrytëzueshme nga një publik i gjerë, para së gjithash në hapësirat shqipfolëse. Ajo bazohet për këtë përmbledhtazi në studime shkencore jo vetëm të studiuesve vendas, por para së gjithash edhe të studiuesve me famë ndërkombëtare anglo-amerikanë, francezë dhe evropianolindorë, shpesh nga gjysma e dytë e shekullit të kaluar dhe fillimi i shekullit tonë. Me këtë, vepra me tetë krerë shënon në krahasim me Hyrjet e tjera shqip jo rrallë një fillim të ri.

Në krerët e parë (f. 1-47) Anastas Dodi i kushtohet dukurisë së gjuhës dhe shkencës për të në marrëdhëniet e tyre të shumëllojshme. Reflektimet e tij përfshijnë herë pas here aspekte historike dhe përqendrohen në raportin e gjuhës dhe shoqërisë, të gjuhës kombëtare dhe gjuhës standarde si dhe në konceptin e normës gjuhësore standarde. Në mënyrë të sintetizuar paraqiten në to dialektet kryesore dhe nëndialektet e shqipes si dhe tiparet e tyre dalluese. Për këtë autori ndjek rezultatet e pranura gjerësisht të studimeve albanistike. Këtu dhe në shpjegimet pasuese ato ilustrohen mirë me shembuj, shumica nga shqipja. Anastas Dodi hedh një vështrim kritik mbi konceptin e racës (f. 21).

Në krerët 3-7 autori përshkruan pjesët përbërëse klasike më të rëndësishme të gjuhësisë: leksikologjinë, fonetikën, gramatikën dhe shkrimin. Si bazë për këtë shërben para së gjithash koncepti i gjuhës si një sistem funksional shenjash.

Në mënyrë të detajuar, autori paraqet në fushën e leksikologjisë (f. 49-77) pikëpamjet tradicionale, si në përkufizimin e fjalës, në përshkrimin e kuptimeve leksikore dhe frazeologjike dhe në marrëdhëniet e leksikut si në sinonimi dhe homonimi. Ai ndalet ndër të tjera nga njëra anë te tabutë dhe eufemizmat si dhe në tema të historisë së gjuhës dhe të etimologjisë, nga ana tjetër tërheq vëmendjen për studiues të shqipes të respektuar në botë. Çështjet e terminologjisë, leksikalizimit, idiomatikës, krahas klasifikimit të

frazeologjizmeve, trajtohen shkurt, në përgjithësi. Kreu i leksikologjisë përfundon me një përmbledhje fjalorësh të rëndësishëm për përdoruesit e gjuhës shqipe.

Në shpjegimet për fonetikën (f. 79–118) Anastas Dodi konfirmohet si njohës i shkëlqyer i realiteteve tingullore dhe i studimit të tyre. Ai përqendrohet jo vetëm te tingujt dhe te formimi i tyre, por përfshin në paraqitjen e tij të lehtë për t'u kuptuar edhe çështje të prozodisë së fjalëve dhe të intonacionit të fjalisë. Vepra e tij i kapërcen këtu kufijtë e një Hyrjeje të thjeshtë. Kreu i fonetikës nis si zakonisht me objektin e fonetikës dhe disiplinat e saj, me paraqitjen e tingujve dhe të mundësive të përshkrimit të tyre në veçanti në lidhje me lartësinë, forcën e shqiptimit, gjatësinë dhe rezonancën, ku u referohet ndër të tjera rezultateve kërkimore të Rrethit Gjuhësor të Pragës. Aparati i të folurit si dhe ndarja e tingujve sipas tij paraqitet në mënyrë shumë të qartë. Pasojnë shpjegime për fonemat dhe variantet fonemore, për rrokjen si dhe ndërrimet tingullore duke mbajtur parasysh zhvillimet historike. Kreu përfundon me shpjegime për prozodinë e fjalëve, përfshirë edhe theksin dytësor, për transkriptimin që i referohet zbatimit ndërkombëtar të tij si dhe transliterimit. Shumë dobiprurëse veçanërisht për personat që nuk e kanë shqipen gjuhë amtare janë shënimet për theksimin e fjalëve në shqip si dhe për intonacionin e fjalisë.

Kreu V kushtuar Gramatikës (f. 119–156) ka pothuajse të njëjtën gjatësi sa kreu pararendës i fonetikës, përse i përket numrit të faqeve. Në pjesën e Morfologjisë trajtohet formimi i fjalëve (në fushën e formimit të fjalëve të përbëra dhe/ose të fjalëve të përngjitura), kufijtë midis morfologjisë dhe sintaksës kuptohen dhe paraqiten të ndërthurura. Në krye të këtij kreu jepen shpjegime të koncepteve, ngjashëm me kreun e mëparshëm. Shpjegohen konceptet e gramatikës, marrëdhëniet midis morfemës dhe alomorfrit si dhe mjetet “gramatikore”, domethënë morfologjike-gramatikore të gjuhëve, me të cilat shprehin kuptime gramatikore. Këto mund të kuptohen më mirë në renditjen e kategorive gramatikore (f. 136 dhe në vijim, siç janë: numri, gjinia, rasa, aspekti, mënyra, diateza dhe veta). Më tej përmenden llojet e fjalëve jokuptimplota (parafjalët, lidhëzat, pjesëzat, nyjat, pasthirrmat) si dhe shfaqja e rrënjëve ose të temave të ndryshme të format e fjalëve (krh.: *ka-m*, *pat-a*). Rendin e fjalëve si dhe intonacionin, d.m.th. çështjet e ndarjes dhe të ndërtimit të thënieve sipas gjymtyrëzimit aktual (sipas temës dhe remës), autori nuk i përfshin drejtpërdrejt në sintaksë, për ndarjen e llojeve të fjalëve ai ndjek kriteret ndër të tjera shqiptare. E njëjta gjë vlen edhe për marrëdhënie specifike sintaksore, nëse marrim parasysh para së gjithash ndarjen që u bën togfjalëshave, lidhjen morfologjike midis gjymtyrëve të tyre nëpërmjet përshtatjes së kategorive morfo-sintaktike (kongruencës), me anë të drejtimit të rasave (reksionit) dhe pa shënim morfo-sintaktik si ndajshim (adjunksion ose

bashkim)] (f. 150 dhe në vijim). Më tej klasifikohen në mënyrë të qartë llojet e fjalive (f. 151 dhe në vijim).

Kreu “Shkrimi” (f. 157-178) fillon me një shpjegim të origjinës dhe evolucionit të shkrimit në formën e piktogrameve, ideogrameve dhe fonogrameve. Më pas diskutohen konceptet e grafemës dhe alografit, si dhe marrëdhënia e tyre me drejtshkrimin, duke u përqendruar në çështjet që lidhen me shkrimin bashkë dhe ndaras, shkronjat e mëdha dhe të vogla, si dhe vendosjen e vizës ndarëse. Autori i kushton vëmendje të veçantë alfabetit shqip, duke ofruar një përshkrim të shkurtër të evolucionit të tij. Vlerësim i veçantë i bëhet Kongresit të Alfabetit të Gjuhës Shqipe të mbajtur në vitin 1908 në Manastir (*maq.* Bitola). Në një tabelë rreshtohen fonemat e shqipes sipas dendurisë së shfaqjes së tyre në fjalë. Vendet e para i zënë zanoret e shqipes, të ndjekura nga grafemat *t*, *r* dhe *n*.

Kreu i parafundit (f. 179-200) trajton në një mënyrë të kuptueshme klasifikimin e gjuhëve në format e ndryshme të tyre. Ai përfshin në të njëjtën kohë konsiderata për gjuhësinë historike-krahasuese të gjysmës së dytë e shekullit të 19-të, por edhe karakteristika të përbashkëta tipologjike të gjuhëve, si dhe tipare dalluese të gjuhëve ballkanike, të tilla si nyjen e prapme, zhdukjen e paskajores dhe, duke iu referuar në mënyrë të veçantë F. v. Miklosiçit, formimin e kohës së ardhme. Kjo pasohet nga shpjegime për origjinën e shqiptarëve dhe emrin e tyre. Autori thekson në këtë kuadër edhe autoktoninë e shqiptarëve në Ballkan, mosromanizimin e gjuhës së tyre dhe faktin se, deri në Mesjetë, kishte boshllëqe të shumta në argumentet shkencore për këtë temë.

Një hapësirë e gjerë në Hyrjen e A. Dodit (f. 201-282) i është kushtuar përshkrimit të drejtimeve të ndryshme në gjuhësi. Ajo fillon me gjuhësinë historike- krahasuese, veçanërisht nga shekulli i 19-të deri në vitet 1950, dhe, pasi njihet arritjet e F. de Sosyrit, përqendrohet në Shkollën e Pragës dhe drejtimit e ndryshme të saj (f. 224-237, 250-255), si dhe në gramatikën gjenerative të gjysmës së dytë të shekullit të 20-të, në mënyrë të veçantë te Noam Çomski (f. 255-269). Në këtë kuadër, trajtohet çështja e universaleve, gjuha si fenomen biologjik dhe lidhja midis gjuhësisë dhe shkencave konjitive, po ashtu edhe koncepte të tilla si kompetenca dhe performanca (f. 269-275) dhe mundësitë e zbatimit të rezultateve të gjuhësisë kompjuterike (f. 275-282).

Bibliografia që qëndron në themel të veprës përmban 87 botime të rëndësishme. Një tregues tematik i përmbajtjes (f. 289-295) lehtëson përdorimin e lëndës. Me gjithë disa ngjashmëri, kjo vepër dallohet nga Hyrjet në albanologji dhe ballkanologji. Ndërsa mund të ofrojë vetëm tablo të përgjithshme dhe përzgjedhje nga fusha të caktuara të albanistikës dhe ballkanistikës, në fund të fundit ajo përfshin në një masë të madhe, gjë që është risi, shkollat dhe drejtimit në gjuhësi. Autori përfiton për shpjegimet që jep nga përvoja e tij e pasur pedagogjike, veçanërisht si profesor në Universitetet e Tiranës, Prishtinës dhe Shkupit, më tej edhe nga rezultatet kërkimore

ndërdisciplinore të punës së tij, të cilat respektohen në plan kombëtar dhe ndërkombëtar. Ai vlerësohet si përfaqësuesi më i rëndësishëm i fonetikës në albanistikë dhe, ndër të tjera, si nismëtar i fonetikës eksperimentale. Me *Hyrjen e tij në gjuhësi*, ai arrin të paraqesë me sukses themele të rëndësishme të gjuhësisë së përgjithshme dhe shqiptare, shprehur në një gjuhë standarde shqipe të lehtë për t'u kuptuar. Në këtë mënyrë, ai inkurajon ata që janë të interesuar për shqipen të shkëmbejnë mendime mbi çështjet gjuhësore dhe albanologjike. Në të njëjtën kohë, pashmangshëm autori është i detyruar të integrojë edhe një leksik specifik gjuhësor. Në varësi të kufizimeve të natyrshme, të cilave u nënshtrohet çdo Hyrje, veprat e ardhshme mund të thellohen në sociolinguistikë, në lidhje me situatën aktuale gjuhësore të shqipes, zhvillimin e leksikut në tërësi dhe albanistikës gjermane. Pavarësisht nga kjo, *Hyrja në Gjuhësi* e Anastas Dodit mbetet një përmbledhje e shkëlqyer e mësimdhënies në lëndën e gjuhësisë dhe albanologjisë. Lexuesit dhe përdoruesit mund të përfitojnë prej saj në shumë mënyra.

Berlin

(përkthyer nga gjermanishtja në shqip nga A. Dodi)

JETA SHKENCORE

Frederik Rreshpja në poezi e përjetësi

Më datën 3 mars 2026, në sallën “Akademikët” (Akademia e Shkencave e Shqipërisë) u mbajt tryeza shkencore me tematikë “Frederik Rreshpja në poezi e përjetësi”, organizuar nga Departamenti i Studimeve Letrare (Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Akademia e Shkencave e Shqipërisë). Në fjalën e përshëndetjes të mbajtur nga akademik Valter Memisha, drejtor i Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë, u nënvizua dhe rëndësia e mbajtjes së kësaj tryeze në rasë të njëzetvjetorit të ndarjes nga jeta të Frederik Rreshpjes (1940-2006), lirikut të pangjashëm që la gjurmë me një krijimtari të veçantë poetike. Në kumtesat e mbajtura u trajtuan aspekte qenësore të kësaj krijimtarie, me nënvizime dhe të motiveve që përmbahen në të, duke u përkujtuar dhe në elemente të përmbajtjes dhe të kompozimit.

Në këtë tryezë shkencore kumtuan studiuesit Evalda Paci (Symposium in memoriam celebris poetae et auctoris), Xhahid Bushati (Disa këndvështrime për poetin Frederik Rreshpja), Virion Graçi (Frederik Rreshpja, poezi e përjetësi), Arben Prendi (Estetizimi i dhimbjes, vetmisë, fatit dhe vdekjes në poezinë e Frederik Rreshpjes), Viola Isufaj (“Les Lions Brisés de l’Enfance” - zgjedhjet leksikore dhe stilistike të A. Zotos në përkthimin e poezisë së Rreshpjes në gjuhën frënge), Roven Vata (Dhimbja dhe vetmia në perceptimin poetik të Frederik Rreshpjes), Neli Naço (Hipostazat e vetmisë në poezinë e Frederik Rreshpjes).

Në përmbyllje të kësaj tryeze u ndanë kujtime të veçanta nga jeta dhe veprimtaria e Frederik Rreshpjes, krijimtaria poetike e të cilit është ribotuar në një pjesë të konsiderueshme dhe në vitet e fundit, duke bërë të mundur të rilexohet dhe në dritë të një formatimi të ri kritik dhe përmbajtësor.

Evalda Paci

Veprimtari shkencore me rastin e 90-vjetorit të lindjes së akademikut Bahri Beci

Me rastin e 90-vjetorit të lindjes së akademikut Bahri Beci (1936–2023), studiues i shquar i gjuhës shqipe, Akademia e Shkencave e Shqipërisë zhvilloi më 6 mars 2026 një veprimtari përkujtimore në nder të figurës dhe trashëgimisë së tij shkencore. Aktiviteti u organizua nga Seksioni i Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike dhe Komisioni i përhershëm i Gjuhësisë dhe i Letërsisë pranë ASHSH-së.

Veprimtarinë e hapi zëvendëskryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë akad. Vasil Tole, i cili përshëndeti të pranishmit dhe vlerësoi figurën dhe kontributin e akademikut Bahri Beci në studimet albanologjike dhe në zhvillimin e gjuhës shqipe. Akad. Tole theksoi dimensionin e spikatur ndërkombëtar të veprimtarisë së tij shkencore, duke e cilësuar akad. Becin jo vetëm si një studiues të shquar të gjuhës shqipe, por edhe si një ambasador të saj në hapësirën europiane.

Ai nënvizoi se botimet e tij në gjuhë të huaja kanë pasuruar bibliografinë gjuhësore të shqipes dhe kanë zgjeruar praninë e saj në auditorin akademik ndërkombëtar. Në vijim të fjalës së tij, akad. Tole u ndal edhe te kontributi i veçantë i akad. Becit në studimin dhe standardizimin e gjuhës letrare, duke përmendur veprat “Probleme të politikës gjuhësore dhe të planifikimit gjuhësor në Shqipëri” dhe “Historia e standardizimit të shqipes: politika dhe planifikimi gjuhësor në Shqipëri”, të cilat përbëjnë referenca të rëndësishme në studimet mbi politikën gjuhësore.

Më pas vijuan kumtesat që vinin në dukje aspekte të veçanta të veprimtarisë shkencore të akademikut Bahri Beci.

Prof. Enkeleida Kapia & dr. Plator Gashi në kumtesën e tyre me titull “Nga Shkodra në Prishtinë: konfirmim empirik i një hipoteze të Bahri Becit mbi kurbën melodike”, paraqitën një nga rezultatet e studimit të tyre mbi intonacionin e shqipes që lidhet me një hipotezë të shprehur nga Bahri Beci: të hulumtohej kurba melodike e dialekteve të shqipes, hipotezë të cilën e konfirmojnë matjet empirike në disa të folme të gegërishtes.

Prof. Tomorr Plangarica vlerësoi kontributin e akad. Bahri Becit në institucionalizimin dhe zhvillimin e dijes gjuhësore. Ai theksoi se përmes studimeve të tij, akad. Beci ka sjellë prurje të rëndësishme në fusha të ndryshme të gjuhësisë, si dialektologjia e shqipes dhe struktura dialektore e saj, politika dhe planifikimi gjuhësor, standardizimi i gjuhës, norma gjuhësore,

sistemi gjuhësor dhe problemet e standardizimit, si edhe ndikimi i gjuhës letrare mbi dialektet. Po ashtu, ai përmendi kontributet e tij në studimin e variacionit sociolinguistik, në mësimdhënien e shqipes si gjuhë amtare dhe për të huajt, në përdorimin e metodave statistikore në studimet gjuhësore, si edhe në hartimin dhe përdorimin e teksteve shkollore.

Në nder të përkujtimit të tij, prof. Anila Omari, duke folur për kontributin e akad. Bahri Becit në studimin e dialekteve, u ndal veçanërisht në interesin e tij të hershëm për historinë e formimit të dialekteve të shqipes dhe me problemet e lashtësisë së ndarjes dialektore të saj. Çështja e strukturës dialektore të shqipes, historisë së saj, vendit dhe shkaqeve të formimit të saj për prof. Bahri Becin ka qenë një shqetësim i vazhdueshëm, me vlerë dhe interes jo vetëm shkencor, po edhe kombëtar. Me serinë e punimeve mbi historinë e strukturës dialektore të shqipes, deri në librin e fundit sintezë të studimeve të deritanishme në këtë fushë, autori ka dhënë një kontribut për konfirmimin e tezës së formimit të dy varianteve dialektore të shqipes në antikitetin e vonë ose në mesjetën e hershme, para huazimeve sllave, gjë që përfaqëson edhe një nga argumentet në të mirë të vjetërsisë dhe shtrirjes së shqiptarëve në hapësirat e tyre të sotme.

Prof. dr. Mimoza Kore u përqendrua në ndihmesën e akademik Bahri Becit mbi vendin dhe rolin e gjuhës shqipe në formimin e bashkësisë gjuhësore ballkanike.

Nga fusha e kontributit të akad. Becit në fushën e standardizimit të shqipes, prof. Mimoza Prikë kumtoi për “Prijë kodifikuese të shqipes në vëmendjen e një gjuhëtari vizionar”.

Prof. Merita Bruci, kolege e bashkëpunëtore e Bahri Becit në fushën e teksteve mësimore të shqipes për të huajt, mbajti kumtesën “Akademik Bahri Beci: një shpirt e një mendje kushtuar shkencës e kulturës kombëtare”. Për ndihmesën e akademikut Bahri Beci në lëmin e fonetikës së shqipes foli dr. Valbona Sinanaj.

Aktiviteti u zhvillua në një atmosferë vlerësimi dhe respekti për figurën e akademikut Bahri Beci, ku ligjëruesit rikujtuan kontributin e tij të çmuar në zhvillimin e gjuhësisë shqiptare dhe në promovimin e gjuhës shqipe në rrafshin kombëtar dhe ndërkombëtar.

Veprimtaria u përmbyll me përshëndetjen e vajzës së akademikut Bahri Beci, e cila, në emër të familjes, shprehu mirënjohjen për organizimin e kësaj veprimtarie përkujtimore në nder të jetës dhe veprës së tij.

**Prezantime të Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë
në Panairin V mbarëkombëtar të librit akademik
dhe shkencor**

Në kuadër të Panairit V mbarëkombëtar të librit akademik dhe shkencor, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë (IGJL) prezantoi tri vepra: *Shkencat e ligjërit dhe diskursi letrar (Variacione mbi një temë)* të prof. dr. Plangaricës; *Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe*. Vëllimi IV, botim i ASHSH-së (përgatitur për botim nga prof. as. dr. Adelina Çerpja, akad. prof. dr. Valter Memisha, prof. dr. Artur Lama) dhe studimin *Letërsi e vjetër shqipe në kontekst ballkanik e evropian (shekujt XVI–XVII)* të prof. as. dr. Evalda Pacit.

Prezantimin e hapi akad. Valter Memisha, drejtor i Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë. *Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe*. Vëllimi IV, u prezantua nga prof. as. dr. Adelina Çerpja. Në vlerësimin e saj, ajo theksoi se punimet e përfshira analizojnë jo vetëm aspektin leksikor, por edhe atë terminologjik e leksikografik, duke i dhënë rëndësi të veçantë njësimiit dhe zbatimit të normës së shqipes. Sipas saj, “leksiku i shqipes është në ndryshim të vazhdueshëm, çka e bën studimin e tij thelbësor për të kuptuar zhvillimin e gjuhës në tërësi”. Ky vëllim dëshmon potencialin krijues të shqipes dhe nevojën për kërkime të pandërprera në këtë fushë të albanologjisë. Studimet e përfshira shërbejnë si mbështetje e vlefshme për pasurimin e gjuhës dhe për përpunimin e mëtejshëm të normës standarde, duke e parë këtë botim si pikënisje të rëndësishme për kërkime të reja shkencore. Vepra ndërthur trashëgiminë e ndërtuar më herët me qasjet bashkëkohore të kërkimit gjuhësor dhe, si e tillë, shërben njëkohësisht si mbështetje dhe si pikënisje për hulumtime të mëtejshme në fushën e gjuhësisë shqiptare. Realizimi i saj është bërë i mundur falë kontributit të studiuesve nga IGJL, Universiteti i Tiranës, Universiteti i Shkodrës, Universiteti i Durrësit, si edhe nga institucione kërkimore e akademike në Prizren, Prishtinë, Shkup, Vjenë, Munih dhe Shën Petersburg.

Prof. dr. Artur Lama prezantoi librin e prof. dr. Tomorr Plangaricës, *Shkencat e ligjërit dhe diskursi letrar (Variacione mbi një temë)*, duke e vlerësuar si rezultat të një reflektimi të gjatë mbi kërkime dhjetëvjeçare. Ai theksoi se vepra përmbledh materiale nga konferenca, ligjërata dhe botime të rëndësishme shkencore, duke dëshmuar një dialog të vazhdueshëm me traditën

akademike europiane. Sipas tij, libri shpall një program të dyfishtë: nga njëra anë synon të konsolidojë shkencat e ligjërimit si fushë të mirëpërcaktuar studimi, dhe nga ana tjetër nxit lirinë konceptore dhe variacionin në trajtimin e temave. Autori nuk ndjek një qasje të ngurtë doktrinare, por një mendim të hapur e krijues. Në përmbyllje, Lama e konsideroi librin një pikë orientimi për albanologjinë bashkëkohore, sepse formulon saktë problemet dhe hap rrugë për diskutime të reja. Vepra mbush një boshllëk në studimet shqiptare mbi shkencat e ligjërimit dhe rekomandohet si literaturë e rëndësishme për studiuesit e gjuhësisë dhe letërsisë.

Librin e prof. as. dr. Evalda Pacit, *Letërsi e vjetër shqipe në kontekst ballkanik e evropian (shekujt XVI–XVII)* e prezantoi prof. as. dr. Merita Sauku Bruci. Ajo e vlerësoi për vëzhgimet e thelluara mbi rrethanat e realizimit të veprave më të rëndësishme të letërsisë së vjetër shqipe, të vendosura në kontekstin e zhvillimeve kulturore të kohës, sidomos në raport me kulturën librore dhe shtypshkrimin. Vëllimi trajton çështje të censurës librore, ndikimin e Konkilit të Trentit (1545–1563), rolin e enteve botuese të shekullit XVII, si edhe elemente të identitetit kombëtar dhe trashëgimisë komplekse të ruajtura përmes akteve kishtarë. Gjithashtu, përfshin kontributet e studiuesve të albanologjisë mbi këtë periudhë të rëndësishme të kulturës së shkrimit dhe letërsisë humaniste. Recensentë shkencorë të veprës janë prof. dr. Monica Genesi (Universiteti i Salentos) dhe prof. as. dr. Merita Bruci (Departamenti i Studimeve Letrare, IGJL, ASHSH), ndërsa redaktor shkencor është akad. Valter Memisha.

U mbajt tryezë shkencore për anglicizmat e pastabilizuar në gjuhën shqipe

Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Akademia e Shkencave të Shqipërisë, zhvilloi tryezën shkencore me temën “Anglicizmat e pastabilizuar në gjuhën shqipe: çështje të drejtshkrimit dhe të integrimit në *Fjalorin e madh të gjuhës shqipe*”.

Veprimtaria u drejtua nga akad. Valter Memisha, prof. dr. Anila Omari dhe prof. dr. Anila Kananaj. Në fjalën e hapjes, akad. Valter Memisha theksoi disa çështje kryesore që lidhen me trajtimin e anglicizmave në fjalor, duke përfshirë huazimet e stabilizuara, çerdhet fjalëformuese, shkurtesat dhe huazimet e paasimiluara, si dhe nevojën për standardizim të mëtejshëm leksikografik të tyre. Ai u shpreh se “Fjalori i madh i gjuhës shqipe” (FMGJSH) është një strukturë e hapur për pasurim dhe rishikim të vazhdueshëm.

Kryetari i Seksionit të Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, akad. Gëzim Hoxha, në fjalën e tij përshëndetëse vlerësoi rëndësinë e këtij takimi, duke theksuar sfidat që sjell ndikimi i anglishtes në shqipen bashkëkohore dhe nevojën për normëzim dhe përshtatje të huazimeve të reja.

Ai nënvizoi se gjuha shqipe, në kushtet e globalizimit dhe të ndikimit të anglishtes si gjuhë ndërkombëtare, përballlet me nevojën për përthithje, përshtatje dhe normëzim të huazimeve të reja, duke ruajtur njëkohësisht identitetin e saj strukturor dhe kulturor.

Sipas tij, tryeza përbën një forum të rëndësishëm shkencor për debat dhe reflektim, i cili do të kontribuojë në orientimin e praktikave leksikografike dhe drejtshkrimore në të ardhmen.

Prof. dr. Anila Kananaj paraqiti fjalorthin me përzgjedhjen e 215 anglicizmave të rinj që u bënë objekt diskutimi në lidhje me drejtshkrimin dhe integrimin e tyre në “Fjalorin e madh të gjuhës shqipe” (2026), duke nxjerrë në pah problematikat që ata paraqesin.

Akad. emeritus Gjovalin Shkurtaç u shpreh se studimi i anglicizmave për t’u përfshirë në FMGJSH duhet bërë fjalë për fjalë dhe duhet marrë vendim për secilën fjalë, nëse duhet përfshirë apo përjashtuar. Gjithashtu, akad. Emil Lafe dhe prof. dr. Memushaj vunë theksin te kujdesi për përdorimin e anglicizmave,

duke i pranuar vetëm në rastet kur shënojnë një koncept të ri dhe nuk kanë ekuivalent në shqip.

Në vijim të aktivitetit u paraqitën referime nga studiues të njohur si prof. dr. Rami Memushaj, prof. dr. Aristotel Spiro, prof. dr. Rrahman Paçarizi dhe prof. asoc. dr. Adelina Çerpja, të cilët trajtuan vendin e anglicizmave në fjalor, parimet drejtshkimore, zhvillimet historike të shkrimit të tyre dhe procesin e kalimit nga përdorimi i lirë në normë.

Pas diskutimeve me të pranishmit, në përfundim u theksua se “Fjalori i madh i gjuhës shqipe” mbetet një projekt i hapur për pasurim dhe rishikim të vazhdueshëm, në përputhje me zhvillimet bashkëkohore të gjuhës.

**Mbahet ligjërata “Korpusi sosyrian në fillesat
e institucionalizimit konjitiv të gjuhësisë së diskursit”
nga prof. dr. Tomorr Plangarica**

Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, pranë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, organizoi më 4 maj 2026 ligjëratën me temën: “Korpusi sosyrian në fillesat e institucionalizimit konjitiv të gjuhësisë së diskursit”, mbajtur nga prof. dr. Tomorr Plangarica.

Veprimtaria u hap nga prof. dr. Artur Lamaj, i cili e vlerësoi ligjëratën si një orientim të dobishëm për gjuhësinë e diskursit, duke theksuar rëndësinë e ndërtimit të dijes mbi themele të qarta dhe rolin e korpusit sosyrian. Ai nënvizoi vlerën e trashëgimisë së Ferdinand de Saussure në perspektivën e vazhdimësisë së mendimit gjuhësor.

Ligjërata u zhvillua në kuadër të ciklit “Çështje problemore të gramatikës diskursive”. Me këtë rast, prof. Plangarica paraqiti një analizë të thelluar mbi risitë e gjuhësisë së diskursit dhe rikonceptimin e trashëgimisë sosyriane në raport me strukturalizmin dhe gjuhësinë e të folurit, duke u ndalur te dorëshkrimet e tij.

Prof. dr. Plangarica theksoi se dorëshkrimet e Saussure-it, themelues i gjuhësisë moderne dhe autor i veprës së njohur *Cours de linguistique générale* (1916), të botuara pas vdekjes, patën ndikim vendimtar në zhvillimin e strukturalizmit dhe në formësimin e gjuhësisë së shekullit XX. Trashëgimia e tij mbetet thelbësore për të kuptuar zhvillimet bashkëkohore.

Ai u ndal edhe te mendimi gjuhësor shqiptar. Një vend të rëndësishëm në ligjëratën e tij zuri çështja e autenticitetit të dokumentacionit të lënë trashëgim nga Saussure-i dhe vlerësimi i atij dokumentacioni (kryesisht dorëshkrime) në korpusin sosyrian. Prof. Plangarica theksoi se në këtë korpus krijohet një hierarki disashkallëshe: vepra të publikuara – dorëshkrime – fletore studentësh – kursi i gjuhësisë së përgjithshme. Për shkak të pranisë së pakët të studimeve të botuara prej Saussure-it në gjallje të tij, marrin përparësi informacionet, trajtimet dhe interpretimet e pranishme në dorëshkrimet e tij, një pasuri e vyer prej rreth pesë mijë faqesh. Duke u mbështetur në këtë trashëgimi (ende e pastudiuar sa dhe si duhet në tërësinë e saj) studiuesit e sotëm ngulmojnë për një qëndrim ndryshe ndaj shumë koncepteve të trashëguara nga tradita, si dualitetet në mendimin gjuhësor të Saussure-it: gjuhë e folur / gjuhë e shkruar, sinkroni / diakroni, gjuhësi e brendshme / gjuhësi e jashtme, gjuhë / diskurs, etj.

Dorëshkrimet mundësojnë krijimin e një ideje të qartë se Saussure-i vlerësonte po aq shqyrtimin e gjuhës sa edhe të të folurit. Ai e mendonte gjuhësinë si të ndarë në dy pjesë me vlerë të barabartë: gjuhësinë e gjuhës dhe gjuhësinë e të folurit, pa e shpërfillur këtë të fundit. Në dorëshkrime del qartë synimi për një gjuhësi dinamike dhe jo statike, ku sinkronia dhe diakronia ndihmojnë njëherazi në shqyrtimin e dukurive gjuhësore e diskursive. Për më tepër, Saussure-i kishte arritur në dallimin e konceptit “diskurs” dhe vlerave që përftohen në shqyrtime duke pasur parasysh “diskursivitetin”, “diskursiven”, “njësitë diskursive”, “gjuhën diskursive”, “ligjërimin diskursiv”, “rendin” apo “natyrën e diskursit” – të gjitha këto emërtime të pranishme në dorëshkrimet e tij, veçanërisht: “Për thelbin e dyfishtë të ligjëritimit” dhe “Shënim mbi diskursin”, të përfshira tashmë në veprën e botuar më 2002: “Shkrime për gjuhësinë e përgjithshme:; mbështetur në dorëshkrimet e zbuluara më 1996-ën.

Po ashtu, prof. Plangarica u ndal në vlerat e jashtëzakonshme të një pjese të shpërfillur për një kohë nga gjuhëtarët – trashëgimisë sasyriane dorëshkrimore – që lidhet me studimet e Saussure-it për anagramat, metrikën e vargjeve latine, legjendat gjermanike, Vedat etj. Në këto shqyrtime, Saussure-i shfaq një qasje interesante ndaj shenjës gjuhësore, duke u prirur drejt tekstit, përtej fjalës, tekstualitetit dhe diskursivitetit. Kjo e bën atë një gjuhëtar të tekstit, ndërsa trashëgimia e tij mbetet e vlefshme për sot dhe të ardhmen e gjuhësisë së diskursit. I vendosur në raport me gjuhësinë e të folurit dhe me traditën vendase, ky rikonceptim i trashëgimisë sasyriane hap perspektiva të reja për institucionalizimin konjitiv të dijeve në gjuhësinë e diskursit.

Në mbyllje, prof. Plangarica nënvizoi rëndësinë e rileximit të veprave madhore si mënyrë për të kuptuar më mirë kapërcimet teorike dhe metodologjike në historinë e ideve gjuhësore, duke theksuar se mendimi gjuhësor shqiptar ndodhet sot në pragun e një kapërcimi të ri, ku studimet mbi shqipen po ndërthuren me qasje ndërdisiplinare dhe epistemologjike, duke e bërë këtë fushë më të hapur ndaj risive teorike.

Pas prezantimit, pjesëmarrësit, pedagogët dhe studentët, diskutuan mbi trashëgiminë sasyriane dhe ndikimin e saj në gjuhësinë moderne, si dhe mbi sfidat e modelit gjuhësor, rolin e veprave dhe perspektivat për institucionalizimin konjitiv të dijeve në gjuhësinë e diskursit.

**Ligjërata: “Pesha e parimit morfologjik
dhe fonologjik në drejtshkrimin e gjuhës shqipe”
nga prof. dr. Rami Memushaj**

Ligjërata u mbajt më 22 maj 2026 në mjediset e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, me organizimin e Seksionit të Shkencave Shoqërore Albanologjike dhe Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë, në përbërje të Akademisë së Shkencave.

Ligjërata u ndoq me interes nga studiues të shumtë të pranishëm nga universiteti i Tiranës e ai i Prishtinës si dhe nga pjesëmarrës virtualë online.

Prof. dr. Rami Memushaj trajtoi çështjet themelore të ortografisë së shqipes, duke u ndalur te roli i parimit fonologjik dhe morfologjik në shkrimin e fjalëve. Ai paraqiti bazat teorike dhe praktike të drejtshkrimit të shqipes, duke e vënë theksin në rolin e dy parimeve themelore që e udhëheqin atë.

Në ligjërata u shpjeguan konceptet bazë të ortografisë, grafemës dhe ortogramit, duke u ndalur te përputhja grafemë-fonemë (parimi fonologjik) dhe ruajtja e morfemës në shkrim pavarësisht ndryshimeve fonetike (parimi morfologjik). Përmes krahasimeve me gjuhë të tjera dhe literaturës ndërkombëtare, u theksua se drejtshkrimi i shqipes është një sistem i ndërmjetëm, ku veprojnë të dy parimet. Përmes analizave dhe përlllogaritjeve të bazuara në Fjalorin e vitit 2006, u theksua se parimi morfologjik ka peshën kryesore në drejtshkrimin e gjuhës shqipe, ndërsa parimi fonologjik mbetet ndihmës.

Gjithashtu, prof. dr. Memushaj solli edhe një diskutim të veçantë mbi shkrimin e zanores ë të patheksuar, si një “nyje problematike” e drejtshkrimit, ku bashkëveprojnë aspektet fonetike, morfologjike dhe semantike.

Pas mbylljes së ligjëratës veprimtaria u shoqërua me diskutime, ndër të cilat spikati diskutimi i prof. Aristotel Spiros, i cili mbrojti pikëpamjen e tij për mungesën e parimit morfologjik në drejtshkrimin e shqipes, pikëpamje që u shoqërua me debate të gjalla nga diskutues të ndryshëm, si prof. Rrahman Paçarizi, prof. Linda Mëniku, prof. Seit Mansaku e të tjerë.

Ligjërata e prof. dr. Memushaj u vlerësua si një kontribut i rëndësishëm në debatin shkencor mbi drejtshkrimin e shqipes dhe zhvillimet e tij në kohë.

TABLE OF CONTENTS

Bardhyl Demiraj	Evidence of Christian humanism in the biblical texts of Gjon Buzuku's 'Missal' (III) – Reference models for Gjon Buzuku's 'Missal'.....	5
Aristotel Spiro	The Fundamental Principle of the Albanian Orthography.....	75
Adelina Çerpja	Neologisms and Lexicographic Planning in the Albanian Language.....	107
Oreste Parise	The Santori Theatre in the context of Calabrian and Neapolitan theatre.....	129
Kristina Jorgaqi	The linguistic interests of the polymath Peter Prifti (1924-2010).....	171
Abdurrahim Maxhuni	Development Trends in Albanian Terminology after World War II.....	179

ISSUES AND DISCUSSIONS

Bardhyl Demiraj	Observations on the restored copy of Don Gjon Buzuku's 'Missal' – II. The fragments at the end of the text.....	195
-----------------	---	-----

CRITIQUES AND BIBLIOGRAPHY

Anila Omari	Scientific and Celebrative Activities.....	219
	Indo-European Linguistics in the Festschrift in Honour of Prof. Bardhyl Demiraj: Albanological Studies in Indo-Europeanistics, Philology and Contact Linguistics, Academy of Sciences of Albania, Tirana 2026.....	221
Evalda Paci	On Philological Studies in the Festschrift in Honour of Prof. Bardhyl Demiraj (Academy of Sciences of Albania, Tirana, 2025).....	227
Izer Maksuti	Endangered languages and Arbërisht a special publication evaluation.....	233
Gerd-Dieter Nehring	Anastas Dodi, <i>Hyrje në gjuhësi</i> , Naimi: Tirana 2019, 303 pp.....	245

SCIENTIFIC LIFE

Frederik Rreshpja in Poetry and Eternity (E. Paci).....	249
Scientific event on the occasion of the 90th anniversary of the birth of the academic Bahri Beci.....	251
Presentations by the Institute of Linguistics and Literature at the 5th Pan- Albanian Fair of Academic and Scientific Books.....	253
A scientific conference on unstabilised Anglicisms in the Albanian language was held.....	255
Lecture: "The Saussurean Corpus in the Beginnings of Cognitive Institutionalization of Discourse Linguistics" by prof. dr. Tomorr Plangarica.....	257
Lecture: "The Weight of Morphological and Phonological principles in the Spelling of the Albanian Language" by prof. dr. Rami Memushaj.....	259